

LËVIZJA

BASHKË



Programi qeverisës i Lëvizjes BASHKË

Mars 2025

1. SHTETI ZHVILLIMOR /4

1.1 INDUSTRIA NXJERRËSE DHE PËRPUNUESE /6

1.2 BUJQËSIA /22

1.3 NDËRTIMI, INFRASTRUKTURA DHE ENERGJIA /39

1.4 TURIZMI /53

1.5 TË ARDHURAT E BUXHETIT DHE TAKSIMI /58

2. SHTETI SOCIAL /62

2.1 PENSIONET /63

2.2 KUJDESI SOCIAL /78

2.3 SHËNDETËSIA /84

2.4 ARSIMI /92

2.5 STREHIMI /102

2.6 MJEDISI /110

2.7 SPORTI /115

3. SHTETI I SË DREJTËS /120

3.1 SISTEMI I DREJTËSISË /121

3.2 ANTIKORRUPSIONI DHE SUNDIMI I LIGJIT /124

4. PJESËMARRJA DEMOKRATIKE /129

4.1 DEMOKRATIZIMI POLITIK /130

4.2 PUNA /133

4.3 BARAZIA GJINORE /143

4.4 KULTURA /151

4.5 MEDIA /156

4.6 PJESËMARRJA DHE SIGURIA DIGJITALE /165

4.7 POLITIKA E JASHTME DHE DIASPORA /169

4.8 INTEGRIMI NË BASHKIMIN EVROPIAN /174

1. SHTETI ZHVILLIMOR

Modeli aktual zhvillimor i Shqipërisë mbështetet fort në punësim me paga të ulëta, kushte fleksibël pune dhe industri me vlerë të ulët. Pavarësisht investimeve të huaja, kryesisht në sektorë të tillë si prodhimi, veshjet dhe këpucët, kjo strategji keqzhvillimi ka ngritur një strukturë të brishtë ekonomike, të ndjeshme ndaj tronditjeve të jashtme, veçanërisht gjatë krizave ekonomike globale. Për shembull, varësia e vendit nga eksportet me vlerë të ulët, kryesisht në industrinë fashione, e bën atë të ndjeshëm ndaj rreziqeve nga ndryshimet e preferencave të konsumatorëve dhe ciklet ekonomike globale.

Pozita e Shqipërisë në zinxhirin global të vlerës mbetet e pasigurt. Niveli i produktivitetit të Shqipërisë është më i ulët në rajon, me sektorë të punës intensive që dominojnë ekonominë. Mungesa e një politike të qartë industriale ka penguar zhvillimin e lidhjeve të përpame dhe të mbrapme, duke i pamundësuar vendit të ngjitet më lart në zinxhirin global të vlerës. Shqipëria është e bllokuar për të kaluar nga sektorët me produktivitet të ulët në industri me vlerë të lartë.

Koncepti i politikës zhvillimore industriale thekson rëndësinë e ndërhyrjes së institucioneve publike për të mbështetur inovacionin dhe ato industri që mund të ndihmojnë në diversifikimin dhe avancimin e një ekonomie. Për Shqipërinë, këto politika mund të

përqendrohen në promovimin e industrive me teknologji më të lartë, avancimin e teknologjisë dhe novacionin, të cilat janë thelbësore për të dalë nga cikli i prodhimeve me vlerë të ulët.

Modeli i deritanishëm ekonomik i Shqipërisë është bazuar tek avantazhi krahasues i pagave të ulëta dhe intensitetit të lartë të shfrytëzimit të forcës punëtore, duke u specializuar në sektorë ku ka më pak kosto mundësie. Fokusimi i Shqipërisë në punë me kualifikim të ulët e dobëson qëllimin afatgjatë të zhvillimit ekonomik. Pavarësisht se kjo qasje mund të ketë kuptim afatshkurtër nga pikëpamja e avantazhit të krahasuar, ajo dështon të krijojë një ekonomi të diversifikuar që mund të përballojë tronditjet ekonomike dhe të kontribuojë në standarde më të larta të jetesës.

Për të kaluar këtë pengesë, Shqipëria duhet të evoluojë avantazhin e saj të krahasuar nga punët me kosto të ulëta në sektorë më të sofistikuar dhe të mbështetur në teknologji. Është e rëndësishme ndërhyrja strategjike e institucioneve publike për të nxitur sektorë me produktivitet më të lartë, edhe nëse këto sektorë nuk janë fillimisht në përputhje me avantazhet ekzistuese të krahasuara, por kanë potenciale të ndërtojnë avantazhe të krahasuara dinamike. Kjo politikë zhvillimore industriale do të përfshinte krijimin e një mjedisi që mundëson zhvillimin e industrive që mund të prodhojnë produkte me vlerë më të lartë dhe të çojnë ekonominë në një nivel më të lartë të zinxhirit global të vlerës.

Lëvizja BASHKË beson te karakteri zhvillimor i një shteti llogaridhënës ndaj qytetarëve i cili lufton monopole dhe oligopole dhe, përmes politikave mbështetëse dhe orientuese, nxit zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit, shfrytëzon në mënyrë të qëndrueshme avantazhet krahasuese natyrore në

bujqësi e turizëm dhe koncepton e materializon avantazhet krahasuese dinamike të vendit tonë, duke nxitur investimet e huaja dhe vendase në sektorë të rinj të industrisë, si për shembull industria automotive dhe teknologjia e informacionit, dhe përgatit një forcë punëtore gjithnjë e më të kualifikuar dhe produktive.

1.1 INDUSTRIA NXJERRËSE DHE PËRPUNUESE

Guri i themelit mbi të cilin mbështetet një ekonomi e shëndoshë është një industri e konsoliduar, që përdor teknologji të avancuar për të nxjerrë në treg mallra cilësore që i sjellin ekonomisë një vlerë të shtuar, ulin deficitin tregtar përmes eksportit dhe tërheqin investimet e qëndrueshme të kapitalit të huaj në vend. Industria e vogël dhe e mesme, e bazuar te biznesi familjar dhe me pak punëtorë, është baza ku mbështet ekonomia e vendit. Objektivi i një shteti zhvillimor është që, krahas mbështetjes së industrisë së vogël dhe të mesme, të nxisë edhe industrinë e mëdha e të qëndrueshme, të cilat do të sillnin një rritje të hovshme të produktivitetit.

Për fat të keq, industria shqiptare prej disa vitesh ka hyrë në një krizë të thellë. E braktisur totalisht nga një qeveri që e sheh të ardhmen te spekulimi në fushën e ndërtimeve përmes pastrimit të parave të krimit, industria prodhuese e vendit po shkon drejt falimentit. Edhe pse industria nxjerrëse dhe përpunuese ka kontribuar ndër vite nga 48% deri 62% të eksportit total në shkallë vendi, viti 2024 shënoi një rekord historik negativ sa i përket deficitit tregtar prej 469 miliardë lekësh, ku eksportet ranë me 14% dhe importet u rritën me 2% krahasimisht me një vit më parë.

Dy faktorët kryesorë që kanë ndikuar negativisht në të gjithë sektorët e industrisë kanë qenë rënia e valutës së euros kundrejt lekut me rreth 8% dhe mungesa e forcës punëtore për shkak të emigrimit masiv.

Goditjen më të rëndë e ka marrë sektori fason që përfaqëson rreth 30% të eksporteve të vendit. Mbyllja e shumë fabrikave të përpunimit të tekstileve dhe të këpucëve në vend ka lënë pa punë me mijëra punëtorë. Në të njëjtën situatë ndodhet edhe industria e lehtë ushqimore, e cila detyrohet të importojë lëndën e parë – që zë rreth 70 deri 80% të kostos – për shkak të rënies së produktit bujqësor e blegtoral vendas.

Industrinë e nxjerrjes së naftës dhe të mineraleve si kromi, bakri etj. prej dekadash janë kthyer në monopole, kryesisht nga kompani të huaja, nga të cilat buxheti i shtetit përfiton fare pak. Vendburimet e njohura të mineraleve kryesore po shterojnë dita-ditës për shkak të shfrytëzimit pa kriter nga oligarkë e banditë lokale.

Për të arritur këto qëllime, në radhë të parë propozojmë forcimin e rolit dhe të kontrollit të shtetit në menaxhimin e pasurive natyrore të nëntokës shqiptare përmes rinegocimit të kontratave me kompanitë private dhe ngritjes së kompanive publike që do të rrisin konkurrueshmërinë në treg.

Për mbështetjen dhe zhvillimin e industrisë dhe të sektorëve prodhues në vend, Lëvizja BASHKË propozon themelimin e Fondit Sovran dhe të Bankës Zhvillimore. Fondi Sovran do të shërbejë si një institucion shtetëror i cili do të marrë në bashkëpronësi asetet strategjike të Shqipërisë – sidomos ato që lidhen me pasuritë natyrore të vendit. Fondi Sovran do të shërbejë për tërheqjen e investimeve nga jashtë, për mirëmenaxhimin e aseteve strategjike dhe si instrument investues e zhvillimor në sektorin e industrisë dhe sektorët e tjerë strategjikë. Nga ana tjetër, Banka Zhvillimore do të shërbejë si një instrument kreditues i sektorëve strategjikë me synim mbështetjen e bizneseve prodhuese, rritjen e eksporteve dhe hapjen e vendeve

të sigurtat të punës së kualifikuar. Banka Zhvillimore do të financohet nga një kapital fillestar që mund të vijë nga borxhi i qeverisë, pra një fond i garantuar nga qeveria që e zotëron Banka e Shqipërisë. Fondet shtesë do të vijnë nga tituj borxhi bono/obligacione që do të emetojë Banka Zhvillimore, të cilat mund t'i blejnë individë, biznese, banka private, Banka e Shqipërisë etj., si dhe do të synohet bashkëpunimi dhe mbështetja e Bankës Botërore (BB) dhe e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Në mënyrë që produktet industriale *Made in Albania* të konkurrojnë në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare, Lëvizja BASHKË e konsideron si thelbësor rolin mbështetës të shtetit përmes politikave subvencionuese që bazohen te parimi i llogaridhënies dhe te cilësia e produktit për eksport.

Për industrinë ushqimore është e domosdoshme rritja e shkallës së përpunimit në vend e lëndës së parë natyrore, ashtu sikurse për manifakturën nevojitet diversifikimi i linjave të prodhimit dhe shkuarja drejt prodhimit me cikël të plotë. Në të njëjtën kohë, kjo industri nuk mund të mbështetet më te kostoja e lirë e krahut të punës, por duhet të ofrojë vende pune të sigurtat ku respektohen të drejtat e punëtorëve dhe organizimi sindikal.

Ky është vizioni i Lëvizjes BASHKË për të ardhmen e Shqipërisë, ku koncepti i shtetit zhvillimor ecën paralelisht me atë të shtetit social.

1. Industria minerare dhe e naftës

Shqipëria është një vend i pasur në minerale dhe në naftë. Një pasuri e tillë do duhej t'i shërbente vendit për rritjen e vlerës së shtuar përmes përpunimit të resurseve, nxjerrjen e produkteve të përpunuara dhe nënprodukteve në tregun

shqiptar me çmim më të lirë, shtimin e eksporteve të vendit dhe eventualisht rritjen e mirëqenies së të gjithë qytetarëve.

Roli i kësaj industrie në ekonominë shqiptare nuk mund të nënvlerësohet. Kontributi i industrisë nxjerrëse dhe përpunuese (sektori i minierave dhe naftës) në Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB) në vitin 2021 ishte 4.2%, nga të cilat 2.2% vinin nga sektori minerar (rreth 40.8 miliardë lekë). Kontributi i sektorit në formë të ardhurash për shtetin ka ardhur në rënie: për vitin 2021 kontributi i industrisë nxjerrëse ishte rreth 0.46% (nafta dhe gazi 2.05 miliardë lekë, apo 0.4%; minierat 290 milionë lekë, ose 0.06%). Ndërkohë që të ardhurat për vitin 2024 për buxhetin e shtetit ishin vetëm 1.64 miliardë lekë, duke pësuar rënie krahasimisht me një vit më parë me 9.9% (nga 1.82 miliardë lekë). Vlera e eksporteve nga sektori i nxjerrjes kapi vlerën 61 miliardë lekë, sa 17% e eksporteve të vendit. Kontributi në punësim ishte 4.5%: sektori i naftës dhe i gazit punësonte rreth 11,000 punëtorë (2.1%), ndërsa minierat rreth 12,000 punëtorë (2.4%).

Problematika kryesore lidhet me monopolizimin e sektorit dhe me shfrytëzimin pa kriter të vendburimeve. Gjithashtu, përqindja e përpunimit të resurseve është shumë e ulët, teksa pjesa më e madhe e tyre eksportohen pa u përpunuar. Shteti shqiptar që do duhej të luante rolin e kontrollorit, qëndron në hije. Të dhënat e deklaruara nga institucionet publike bazohen në vetëdeklarime të shoqërive raportuese. Saktësia e këtyre raportimeve lë vend për dyshime dhe për punë në të zezë: 25 kompani që raportuan prodhim, deklaruan 0 të punësuar përgjatë 2017 dhe 2018.

Një rol negativ vendimtar në situatën e krijuar luan mungesa e transparencës. Sipas Ligjit për Hidrokarburet, nuk

parashikohet ndonjë kusht në lidhje me deklarimin publik të Marrëveshjeve Hidrokarbure, çka bën që publiku të ngelet në errësirë sa i përket përfitimeve të kompanive të mëdha që shfrytëzojnë pasuritë kombëtare. Për më tepër, Shqipëria në vitin 2009 u bë pjesë e organizatës ndërkombëtare EITI që përcakton standardet e raportimit për vendet pjesëmarrëse me qëllim sigurimin e transparencës dhe të përgjegjshmërisë në sektorët e naftës, gazit dhe minierave. Raporti i fundit i vendit tonë daton në vitin 2018 dhe në mënyrë të turpshme Shqipëria është pezulluar nga kjo organizatë në vitin 2023 për shkak të mungesës së raportimit. Kusht thelbësor për mirëfunksionimin e sektorit të hidrokarbureve dhe të minierave është transparenca. Prandaj vendi ynë do duhet medoemos të rifillojë raportimin e detajuar të të gjitha të dhënat sa i përket secilës prej hallkave të menaxhimit të këtij sektori nga aktorët shtetërorë dhe ata privatë, duke bërë të mundur riintegrimin në organizatën ndërkombëtare EITI.

Për më tepër, zonat periferike naftëmbajtëse e mineralmbajtëse janë edhe zonat më të varfra të vendit, për shkak se me ligjin aktual vetëm 5% e rentës së mbledhur nga shteti i shkon pushtetit lokal. Një gjë e tillë është e padrejtë për komunitetet lokale dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të këtyre zonave, për vetë faktin se janë pikërisht këto zona të cilat vuajnë nga dëmet e konsiderueshme mjedisore – të cilat shfaqen edhe në shëndetin dhe mirëqenien e banorëve lokalë – dhe që vijnë si pasojë e aktivitetit të industrisë nxjerrëse dhe përpunuese.

Vizioni afatgjatë i Lëvizjes BASHKË në shfrytëzimin e duhur të burimeve minerare dhe hidrokarbure, i frymëzuar nga modeli norvegjez, mbështetet mbi këto shtylla:

- maksimizimin e përfitimit ekonomik të Shqipërisë nga resurset e mineraleve, naftës dhe gazit;
- përdorimin e të ardhurave nga ky sektor në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit, sidomos të zonave të varfra të vendit ku shfrytëzohen vendburimet;
- investimin e të ardhurave nga sektori i naftës te Fondi Sovran nga të cilat do të përfitojnë edhe brezat e ardhshëm;
- rritjen e kapaciteteve profesionale dhe përvetësimin e teknologjisë së fundit nga kompanitë vendase nga ky sektor;
- zhvillimin dhe ruajtjen e standardeve të sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- shfrytëzimin e resurseve në mënyrë graduale dhe të kujdesshme;
- transparencën dhe riintegrimin sa më parë të Shqipërisë në organizatën ndërkombëtare EITI.

A. Industria e naftës

Gjendja aktuale

Shqipëria është ndër të paktat vende naftëmbajtëse në Evropë me rreth 15 vendburime nafte dhe 6 vendburime gazi. Ndër to, vendburimi i Patos-Marinzës konsiderohet si vendburimi tokësor i naftës më i madh në Evropën kontinentale.

Sipas studimeve të kryera para viteve '90, rezervat në pusët e naftës shqiptare arrinin në rreth 437.6 milionë tonë. Megjithatë raportet e huaja dëshmojnë se për shkak të metodave të nxjerrjes të dëmshme dhe pa kriter që janë përdorur deri më sot, rezervat e rikuperueshme

vlerësohet të kenë arritur në vetëm 81 milionë tonë, pra vetëm 15% e rezervave fillestare. Ndërkohë, një sasi e madhe rezervash gjeologjike konsiderohen si të vështira për t'u nxjerrë (rikuperuar), pra me kosto më të lartë ose që kërkojnë një teknologji më të avancuar, si për shembull vendburimi i Shpiragut.

Në sektorin e prodhimit të naftës operojnë gjashtë kompani. Albpetroli është një shoqëri aksionere me kapital të zotëruar tërësisht nga shteti shqiptar, ndërkohë që kompania private kryesore është Bankers Petroleum që ka në koncesion shfrytëzimi vendburimin kryesor të Patos-Marinzës. Bankers Petroleum-i është gjithashtu eksportuesi kryesor i naftës bruto në vend. Nafta bruto eksportohet kryesisht për t'u rafinuar jashtë vendit, ndërsa kërkesat e konsumit të brendshëm përmbushen përmes naftës së rafinuar të importuar.

Problemet kryesore

90% e naftës sot në Shqipëri prodhohet nga Bankers Petroleum-i, që menaxhon vendburimin e Patos-Marinzës, duke e kthyer këtë kompani praktikisht në një monopol privat të një pasurie publike siç është nafta.

Prej 20 vjetësh, që prej marrëveshjes për shfrytëzimin e vendburimit, Bankers-i nuk ka paguar tatim mbi fitimin (50% e fitimit) duke deklaruar gjithmonë fitim zero për shkak të investimeve dhe kostove të fryra jashtë çdo logjike. Ndërkohë që burimi kryesor i të ardhurave për buxhetin e shtetit nga sektori i naftës është renta minerare (rreth 20 milionë dollarë në vit), pjesa e tatim-fitimit që shteti do duhej të kishte përfituar nga Bankers-i përllëgaritet diku te 10 milionë dollarë në vit – pra sa gjysma e rentës. Edhe TVSH për naftën i rimbursohet kompanisë private nga shteti shqiptar.

Për të kuptuar pozitën e dizavantazuar të shtetit shqiptar në raport me kompaninë Bankers, mjafton të përmendim se të ardhurat e buxhetit të shtetit nga sektori i naftës për vitin 2018 ishin përafërsisht sa gjysma e të ardhurave nga sektori minerar, edhe pse ky i fundit po shkon drejt mbylljes.

Albpetroli merr një pjesë të prodhimit të naftës që nxjerr Bankers-i në bazë të marrëveshjes, termat e të cilës nuk janë bërë publike për shkak të klauzolave të konfidencialitetit. Sidoqoftë, nga krahasimi i prodhimit që deklaroi Bankers-i, çdo vit me sasinë që i kalon Albpetrolit, rezultoi që Albpetroli nuk përfiton më shumë se 10% të prodhimit. Ndërkohë që për vende të tjera, si për shembull Norvegjia, në varësi të sasisë së prodhimit, pjesa që merr kompania shtetërore mund të arrijë deri në 50% të prodhimit përmes pronësisë së aksioneve të licencat e dhëna.

Në vitet '70 dhe '80, kur sektori i kërkimit-zbulimit dhe prodhimit, si dhe sektori i rafinimit, procesimit dhe purifikimit të naftës dhe gazit ishin në pronësi dhe administroheshin tërësisht nga shteti, sektorët punësonin afërsisht 25,000 punëtorë. Sot kjo shifër është tkurrur në më pak se 3000, ku 70% e tyre janë të punësuar te Albpetroli.

Pjesë e marrëveshjes me shtetin shqiptar dhe Bankers Petroleum-it ishte që një sasi e caktuar e naftës së prodhuar të shkonte për rafinim në uzinën e rafinimit ARMO sh.a. Përpara privatizimit, kjo uzinë punësonte rreth 2200 punëtorë, duke i dhënë jetë mbarë komunitetit të Ballshit dhe të Fierit. Xhiroja vjetore e kompanisë arrinte në rreth 90-120 milionë dollarë, ndërsa fitimet vjetore arrinin 10-15 milionë dollarë. Detyrimet që paguheshin përmes taksave dhe akcizës arrinin 25-30 milionë dollarë për arkën e shtetit dhe kompania nuk kishte asnjë borxh. Uzina prodhonte deri në 20 nënprodukte të naftës që shfrytëzohen nga industri të

ndryshme. Pas privatizimit të saj në vitin 2009 të oligarku Rezart Taçi, kompania u mbush në borxhe dhe shpalli falimentin. Pas shumë përpjekjesh të naftëtarëve për të fituar pagat e prapambetura, uzina eventualisht u shemb dhe shit për skrap.

Përfitimet e komunitetit ku nxirret nafta kanë qenë të papërfillshme. Përkundrazi, ndotja mjedisore nga shpërthimi i puseve ka ngelur ende pa fajtor dhe pa zgjidhje, ashtu sikurse dëmtimet e shtëpive të banorëve të fshatit Zharrëz në vitin 2017 për shkak të shpërthimeve që kryente kompania Bankers, u tentua të mbuloheshin si tërmete natyrore.

Edhe pse shteti shqiptar ka në pronësi kompaninë Transnafta sh.a. posaçërisht për transportin e naftës, ajo ka ngelur tërësisht inaktive. Bankers Petroleum-i deklaroi se shoqëritë e transportimit të naftës zgjidhen sipas gjykimit të saj. Nafta e papërpunuar e Bankers transportohet përmes një hekurudhe të posaçme, nga vendburimet e naftës në Petrolifera.

Propozimet

Burimet hidrokarbure janë resurse të parinovueshme të cilat natyra ia ka falur Shqipërisë. Ato përbëjnë një pasuri kombëtare që i përket mbarë popullit shqiptar. Rrjedhimisht, detyra e çdo drejtuesi shteti është që ta menaxhojë naftën e nëntokës shqiptare si një aset të shterueshëm dhe jo si një burim të përherëshëm të ardhurash. Dhënia e saj me koncesion të privati, i cili e nxjerr nga pusi dhe e hedh të papërpunuar në tregjet globale, është një shpërdorim që po i bëhet kësaj pasurie publike, duke e mpakur atë vazhdimisht e duke mos lënë asgjë pas. Nëse nafta e nxjerrë do të rafinohej/përpunohej përpara se të nxirrej në treg, vlera e saj e shtuar do të shumëfishohej. Nga ana tjetër, nëse të ardhurat nga shitja e naftës do të investoheshin në një fond sovran i cili do të

siguronte kthimin e investimit, atëherë nafta e Shqipërisë mund të transformohej në një burim të ardhurash për brezat e ardhshëm.

Bazuar mbi këto parime, Lëvizja BASH-KË propozon:

1. Rinegociimi i kontratës me Bankers Petroleum-in për vendburimin e Patos-Marinzës

Si vendburimi tokësor më i madh i naftës, jo vetëm në Shqipëri por në mbarë Evropën kontinentale, nevojitet urgjentisht rinegociimi i kontratës mes shtetit shqiptar dhe koncesionarit. Termat kontraktualë do duhet të kushtëzohen:

a) Kontrollin e shtetit nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), si dhe kompanive të huaja të auditit financiar, për përcaktimin e fitimit që nxjerr çdo vit koncesionari, në mënyrë që tatimi mbi fitimit t'i kalojë buxhetit të shtetit.

b) Ndarjen në mënyrë progresive të sasisë së naftës së prodhuar që i kalon Albpetrolit, në varësi të sasisë së prodhuar çdo vit nga koncesionari.

c) Kontrollin e shtetit sa i përket intensitetit të shfrytëzimit dhe sasisë së naftës së prodhuar në vendburim.

d) Kontrollin e shtetit nëpërmjet AKBN sa i përket teknologjisë së përdorur nga koncesionari, ku përparësi do t'i jepet shfrytëzimit tërësor të vendburimit pa e shkatërruar atë për përfitime afatshkurtra, si dhe përcimit të njohurive teknike (know-how) nga koncesionari të stafi i specializuar i Albpetrolit.

e) Imponimin në kontratë të përdorimit nga ana e koncesionarit të kompanisë shtetërore Transnafta për transportin e naftës, duke siguruar vende pune për komunitetin lokal.

2. Rritja e tatimit mbi fitimin nga 50% në 60%

Me paaftësinë e treguar nga shteti shqiptar deri më sot për ta vjelë këtë tatim nga Bankers Petroleum-i, padyshim që rritja e saj në vetvete do të ishte e pavlerë. Megjithatë, me rritjen e domosdoshme të kompetencave administrative të AKBN, një rritje e tillë është më se e nevojshme. Praktikisht botërore tregojnë se pas investimit fillestar që kryen një koncesionar privat, gradualisht koncesionari e rrit fitimin. Rrjedhimisht, shteti bën rinegocimin e kontratës fillestare duke e rritur gradualisht taksën mbi fitimin. Në 20 vjet që Bankers Petroleum-i ka shfrytëzuar vendburimin e Patos-Marinzës (kontrata mbyllet në vitin 2029), taksa mbi fitimin ka ngelur e njëjtë (dhe është mënjeluar gjithmonë). Ndërkohë që vende si Norvegjia e kanë rritur ndër vite këtë taksë duke arritur aktualisht në 78% të fitimit. Për më tepër, në fund të vitit 2015 Bankers-i raportoi për sasi të konsiderueshme naftë që ndodhen në këtë vendburim: rezerva të provuara në 122.9 milionë fuçi (ekuivalente me 18.6 milionë ton naftë bruto) dhe rezerva të provuara plus të mundshme në 190.3 milionë fuçi (ekuivalente me 28.9 milionë tonë naftë bruto).

3. Rritja e kompetencave të kompanisë shtetërore Albpetrol në prodhimin e naftës

Në një kohë kur 90% e vendburimeve botërore të hidrokarbureve kontrollohen nga kompani shtetërore, është e një rëndësie të veçantë fuqizimi i rolit që luan kompania shtetërore Albpetrol në sektorin e naftës në vend. Duhet përmbysur balanca ku 90% e naftës në vend prodhohet nga kompani private dhe vetëm 10% nga kompani shtetërore. Albpetrol duhet të kthehet gradualisht në një konkurrent të fuqishëm vendas me gjithë operatorët privatë që operojnë

në treg, duke i dhënë kështu qeverisë një pozitë të avantazhuar në negocimin e kontratave me privatët. Nga ana tjetër, Albpetrol do duhet të luajë një rol thelbësor në kërkim-zbulimin dhe përcaktimin e saktë të rezervave të mbetura të naftës në vendin tonë, duke përdorur teknologjitë më të fundit. Në kuadër të transparencës, Albpetrol do duhet të raportojë çdo vit në Kuvendin e Shqipërisë dhe në komisionet e ndryshme parlamentare lidhur me performancën e kompanisë dhe politikën e ndjekura.

4. Ringritja e një uzine rafinerie për përpunimin e naftës që del nga nëntoka shqiptare

Përpunimi i naftës bruto e shumëfishon vlerën e saj në tregun ndërkombëtar. Prandaj ringritja sa më parë e një uzine për rafinimin e naftës vendase do duhej të ishte prioriteti kryesor i çdo qeverie shqiptare. Fatmirësisht, njohuritë teknike për funksionimin dhe menaxhimin e një uzine të tilla janë ende të pranishme, për hir të uzinës që funksiononte vetëm pak vite më parë. Kostoja e ndërtimit të një rafinerie me kapacitetin e asaj të mëparshme, sipas ekspertëve, nuk do t'i tejkalonte 300 milionë dollarë, shifër kjo më se e përballueshme nga buxheti i shtetit shqiptar, duke marrë në konsideratë edhe instrumente të ndryshme të borxhit financiar dhe institucioneve ndërkombëtare që do të menaxhohen përmes Bankës Zhvillimore. Duke u rritur kapaciteti prodhues i Albpetrolit, do të plotësoheshin edhe nevojat e furnizimit të rafinerisë me naftë bruto duke realizuar një cikël të mbyllur të prodhimit dhe nxjerrjes së naftës në tregun vendas dhe atë ndërkombëtar. Për më tepër, ky investim do të hapte vende të reja pune të kualifikuar, si dhe do të rigjallëronte të gjithë aktivitetin ekonomik të qytetit të Fierit e të Ballshit.

5. Bashkëpronësia e kompanive shtetërore mes punëtorëve dhe shtetit shqiptar

Bashkëpronësia përmes kontrollit të aksioneve të kompanive shtetërore të prodhimit dhe përpunimit të naftës mes punëtorëve dhe shtetit në raportin 10%-90%, e njohur ndryshe si *Employee Stock Ownership Plan* (ESOP), do të mundësonte një ambient pune më bashkëpunues, do të nxiste te punëtorët ndjenjën e përkatësisë duke rritur produktivitetin dhe motivimin e tyre, si dhe do t'u ofronte punëtorëve një shtysë financiare të drejtpërdrejtë të lidhur me rentabilitetin e ndërmarrjes. Mënyra e funksionimit do të bazohej në eksperiencat më pozitive botërore, si për shembull kompania ENAP në Kili, ku procesi nis me ngritjen e një trusti për përfitimin e aksioneve nga ana e punëtorëve. Aksionet u alokohen punëtorëve në bazë rrogës, vjetërsisë në punë dhe kriterëve të tjera. Aksionet ruhen në trust dhe nuk mund të tërhiqen menjëherë, por vetëm pasi punëtorët arrijnë objektiva të caktuar në punë (p.sh. kontribut në prodhimtari apo vite pune), kur largohen nga vendi i punës apo kur dalin në pension.

6. Menaxhimi i të ardhurave nga sektori i naftës nga Fondi Sovran

Në mënyrë që të ardhurat e gjeneruara nga nëntoka shqiptare të mos shpërdorohen, por të përdoren si një bazament për të ndërtuar të ardhmen e brezave të rinj, Lëvizja BASHKË propozon ngritjen e një Fondi Sovran për menaxhimin e këtyre të ardhurave, të bazuar te modeli norvegjez. Ndërkohë që zakonisht fondet sovranë i përftojnë të ardhurat pasi ato kanë kaluar më parë nga buxheti i shtetit dhe kanë gjeneruar një surplus, modeli në fjalë bën kalimin e të ardhurave nga sektori i naftës fillimisht në fondin sovran, e më pas një pjesë e kthimit të investimit më pas i shkon buxhetit të shtetit. Fondi do t'i investojë këto të

ardhura në portofole të diversifikuara, si p.sh. në bursë, në bono thesari apo në pasuri të paluajtshme, mundësisht jashtë vendit. Strategjia e investimeve do të përcaktohet nga Banka Zhvillimore dhe nga Ministria e Financave. Në mënyrë që këto të ardhura të mos shpërdorohen, do të propozojmë një rregull buxhetor i cili do të kufizojë përdorimin vjetor të këtij fondi nga qeveria.

7. Ringritja e kapaciteteve teknike

Dikur Shqipëria ka qenë një vend me kapacitete të shkëlqyera teknike sa i përket menaxhimit të sektorit të prodhimit dhe rafinimit të naftës. Me rritjen e rolit të kompanisë shtetërore Albpetrol, nevojitet detyrimisht edhe rindërtimi i kapaciteteve profesionale njerëzore. Në këtë aspekt është i domosdoshëm rithemelimi i Institutit të Hidrokarbureve dhe ndërlidhja e tij me Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave për formimin e inxhinierëve të rinj dhe punësimin e tyre në sektorin e prodhimit dhe rafinimit të naftës. Një rol të rëndësishëm do të luajnë edhe shkollat për përgatitjen e teknikëve, që do të ngrihen në lokalitetet e zonave pranë vendburimeve, duke ndihmuar në ngritjen profesionale të banorëve lokalë.

8. Menaxhimi i intensitetit të prodhimit të naftës në mënyrë të qëndrueshme

Duke e mirëmenaxhuar intensitetin e shfrytëzimit të resurseve të nëntokës shqiptare, fitohet kohë për rritjet e kapaciteteve teknike dhe ngritjen e fondit sovran të menaxhimit të të ardhurave nga sektori i naftës. Rezervat e naftës kanë qenë atje për miliona vjet. Shfrytëzimi i shfrenuar i tyre nga kompanitë private nuk shkon në dobi të popullit shqiptar.

9. Rritja e përqindjes së të ardhurave nga renta që i kalon pushtetit lokal nga 5% në 15%

Një ndër kontradiktat më therëse për vendin tonë është fakti se zonat me aktivitetin më të lartë prodhues të naftës, janë edhe ndër zonat më të varfra të vendit. Prandaj, krahas vëmendjes së duhur për mbrojtjen e mjedisit dhe dëmshpërblimin e banorëve lokalë në rast dëmi, është e domosdoshme rritja e të ardhurave që vijnë nga renta dhe që i kalojnë pushtetit lokal për t'u menaxhuar me përgjegjësi për rehabilitimin e mjedisit dhe plotësimin e nevojave të banorëve të zonës në arsim, shëndetësi, infrastrukturë etj.

10. Rishikimi i Ligjit për Hidrokarburet

Do të rishikohet Ligji për Hidrokarburet që aktualisht nuk i zbardh kontratat me kompanitë koncesionare. Publiku shqiptar ka të drejtën të njohë se kush dhe si i shfrytëzon pasuritë kombëtare.

11. Miratimi i Statusit të Naftëtarit

Një e drejtë themelore që do të vlerësojë kontributin e të gjithë atyre që kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë në sektorin e nxjerrjes dhe përpunimit të naftës.

B. Industria minerare

Gjendja aktuale

Shqipëria njihet si një vend i pasur në minerale të ndryshme, si krom, bakër, hekur-nikel, qymyr, gur gëlqeror, argjilë, e së fundmi edhe litium. Shumë prej këtyre mineraleve janë të lakmuara nga tregjet evropiane dhe botërore. Në disa metale, prodhimi i vendeve të Ballkanit

(ku prodhimi nga Shqipëria zë vendin kryesor) është sa 50% e prodhimit të BE.

Sa i përket mineralit të kromit, Shqipëria zë vendin e tretë në Evropë pas Turqisë dhe Finlandës me 285 vendburime. Megjithatë, nga 39 milionë tonë krom në vendburimet e njohura prej studimeve të para viteve '90, deri më sot janë shfrytëzuar rreth 35 milionë tonë krom. Pas vitit 2000 e gjithë industria e kromit – ajo e shfrytëzimit të vendburimeve dhe fabrikat e përpunimit për prodhimin e ferrokromit në Elbasan dhe në Burrel – kaluan nën administrim privat. Aktualisht, kompania turke Yildirim Holding zotëron vendburimin kryesor të mineralit të kromit në Bulqizë, si dhe 4 nga 6 furrat e prodhimit të ferrokromit. Kina, Italia dhe Shtetet e Bashkuara kanë qenë destinacionet kryesore të eksportit për ferrokromin. Të ardhurat që gjenerohen nga shitja e produkteve të kromit përbëjnë rreth 60-70% të gjithë të ardhurave të krijuara nga sektori minerar. Për më tepër, sektori i kromit është i një rëndësie të veçantë edhe sepse punëson rreth 64% të fuqisë punëtore që punon në miniera. Prej tyre, 70% ndodhen në Bulqizë.

Sektori i përpunimit të bakrit, gjatë viteve '80 ka qenë sektori më i suksesshëm në industrinë e nxjerrjes së mineraleve në Shqipëri. Nga 108 vendburime bakri, kanë qenë të njohura 69 milionë tonë bakër, nga të cilat janë shfrytëzuar rreth 21 milionë tonë. Sidoqoftë, si rezerva të rikuperueshme me kosto rentabël vlerësohen rreth 27 milionë tonë. Niveli i përpunimit të bakrit ngelet vetëm në nivel koncentratit, pasi nuk ka një kombinat metalurgjik shkrirjen dhe rafinimin e tij, e më tej përpunimin në metal (nga 4 të tilla që kanë qenë para viteve '90). Dy kompani turke zotërojnë pothuajse të gjitha lejet e shfrytëzimit të këtij minerali në Shqipëri.

Industria e prodhimit të xeherorit të hekurit dhe e përpunimit të tij është inekzistente për shkak të kostos së lartë dhe përqindjes së ulët të metaleve të rralla (si kobalti). Shkrirja e mbetjeve metalore (si skrap), industri e cila renditet e dyta pas naftës sa i përket vlerës së produkteve industriale në vend, është përqendruar në duart e koncesionarit turk KURUM International, kompani e cila ka nën administrim edhe tre prej HEC-eve kryesore në vend. Kjo kompani e tregton rreth 41% të produktit të hekurit për ndërtim në tregun shqiptar, ndërsa pjesën tjetër në Kosovë, Maqedoni dhe Serbi. Në vitin 2016 ajo shpalli falimentin me qëllim ristrukturimin e borxhit të saj ndaj bankave kreditore, ndërsa edhe në gusht të vitit 2024, duke pretenduar vështirësi ekonomike, ajo ndërpreu prodhimin dhe nxori përkohësisht në rrugë rreth 500 punëtorë.

Edhe pse vendi ynë ka rreth 800 milionë tonë rezerva të qymyrit dhe rreth 158 milionë tonë torfa, minierat e shfrytëzimit të tyre janë mbyllur për shkak të çmimit të ulët të tyre dhe mungesës së rentabilitetit për shfrytëzimin nga kompani private.

Sektori minerar është mjaft i fragmentuar, ku nga 556 subjekte që operojnë në treg, 236 kanë leje minerare për sektorin e kromit (43%), 32 për hekur-nikel dhe 17 për bakër. Të kategorizuara sipas strukturës së shitjeve dhe madhësisë së ndërmarrjes, sa i përket industrisë nxjerrëse rreth 60% e shitjeve kryhen nga ndërmarrje të mëdha (mbi 250 punëtorë), 15% nga ndërmarrje të mesme (50 deri 250 punëtorë) dhe 20% nga ndërmarrje të vogla (10 deri 50 punëtorë). Në sektorin e industrisë përpunuese gjendja është disi më e balancuar (33% ndërmarrje të mëdha, 35% të mesme dhe 26% të vogla). Nga tabloja e mësipërme vërehet se tregu i industrisë nxjerrëse dominohet nga ndërmarrjet e mëdha.

Problemet kryesore

Në 34 vjet shfrytëzim që i është bërë mineraleve të nëntokës shqiptare, investimet kanë qenë minimale ndërsa zhvatja galopante. Kompanitë e huaja dhe sidomos ato vendase e kanë copëzuar sektorin në shumë duar, ku ka mbizotëruar informaliteti dhe mungesa e llogaridhënies, si në përparimin e fronteve të galerive, në sasitë e prodhimit të mineraleve, në respektimin e kontratave me punëtorët dhe në sigurinë në vendin e punës. Subjektet private kanë përdorur vendburimet e njohura që më parë me një intensitet të lartë shfrytëzimi, me qëllimin nxjerrjen e mineraleve në tregjet ndërkombëtare, duke bërë çmos për të mënjeluar detyrimet ndaj shtetit.

Si sektori privat, ashtu edhe agjencitë e ndryshme shtetërore, kanë hequr dorë tërësisht nga investimet në kërkim-zbulimin e vendburimeve të reja, çka do të mundësonte një strategji afatgjatë të zhvillimit të sektorit minerar. Kjo bën që shumë vendburime të vogla të ngelen të pashfrytëzuara për shkak të riskut të lartë në investime për sektorin privat, procedurave të fryra burokratike dhe mangësive në ligjin aktual. Kështu, një kompani private që të investojë në kërkim-zbulim – ku koeficienti i suksesit është 10% – duhet të përballlet edhe me procedura burokratike që lidhen me hyrjen në negociata me banorët që janë pronarë të tokës, me një kohë shumë të shkurtër të lejes së kërkim-zbulimit prej 2 vjetësh plus 1 vit shtyrje, me kufizime të lejes sa i përket shtrirjes në territor etj.

Monopolizimi i sektorit bën që fare pak kompani të huaja (turke) të kenë fituar lejet për shfrytëzimin e mineraleve kryesore si kromi, bakri etj., dhe t'i mbajnë këto leje të bllokuara për vite me radhë, edhe pse në vendburime të caktuara nuk prodhojnë mineral. Kjo e bën të pamundur për kompani të tjera që të hyjnë në treg duke konkurruar në mënyrë

të ndershme me kompanitë ekzistuese, duke e kthyer nëntokën shqiptare në monopolin e një pakice kompanish të huaja.

Koncesionarët privatë shpeshherë nuk respektojnë planet e lejeve të shfrytëzimit, duke prodhuar me intensitet të lartë në zona me përqendrim të lartë të mineralit, e duke lënë të pashfrytëzuar pjesën tjetër – një praktikë kjo që në zhargon thuhet se “e vdes minierën”. Ndërkohë, vendburimet e njohura të mineralit të kromit po shterojnë, pasi ekspertët konstatojnë se burime të shfrytëzueshme kanë mbetur më pak se 10% dhe sektori mund të vazhdojë të shfrytëzohet edhe për maksimumi shtatë vjet. Një situatë e ngjashme evidentohet edhe për vendburimet e mëdha të bakrit.

Nga ana tjetër, shkalla e përpunimit të mineraleve për të nxjerrë në treg produkte me vlerë të shtuar që do të shërbenin në industritë e avancuara, është në nivele minimale. Më shumë se 65% e sasisë së kromit të prodhuar shkon në eksport thjesht si mineral i papërpunuar dhe si produkt ferrokrom shkon vetëm rreth 8% deri 30% e sasisë së mineralit të prodhuar. Kapaciteti prodhues i ferrokromit në vendin tonë rezulton të jetë më i ulët se ai në periudhën para dhënies me koncesion të dy uzinave përpunuese, me një shfrytëzim kapaciteti përpunues në rreth 40%. Kjo situatë vazhdon e tillë, edhe pse çmimi i eksportit të ferrokromit në tregjet ndërkombëtare është 8 deri 11 herë më i lartë se çmimi i kromit, ndërsa vlera e eksporteve është rreth 2 herë më e madhe. Sa i përket mineralit të bakrit, shkalla e përpunimit arrin vetëm në koncentrat bakri dhe jo në produkte metalurgjike.

Përfitimet e shtetit shqiptar nga industria minerare janë minimale. Renta minerare, që përfshin një nga burimet kryesore të të ardhurave në buxhetin e shtetit, për mineralin e kromit u bë zero lekë për vitet 2021-2023. Kjo nismë ligjore, sipas ekspertëve, i ka kushtuar të ardhurave të

buxhetit vendor rreth 15-20 milionë euro në tre vjet. Ç’është edhe më skandaloze, bashkitë vendore përfitojnë vetëm 5% të të ardhurave të shtetit nga renta minerare, duke bërë që zonat kryesore mineralmbajtëse, si Bulqiza, Hasi, Rubiku etj. të jenë ndër bashkitë më të varfra të vendit.

Ndërkohë që koncensionari më i madh i hekurit në vend (KURUM International) ankohet për vështirësi ekonomike duke hedhur në rrugë 500 punëtorë, sipas të dhënave të pasqyrave financiare të kësaj kompanie rezulton se fitimi i saj gjatë vitit 2023 ka qenë 4,462,168,911 lekë. Një veprim i tillë duket më shumë si një kërcënim ndaj shtetit shqiptar për të mbuluar skandalin e trafikimit të dy anijeve me 60 dhe 40 kontejnerë mbetjesh të rrezikshme, që u nisën fillimisht drejt Tajlandës, e që tani ndodhen të sekuestruara në Portin e Durrësit.

Edhe pse minierat përbëjnë mundësinë e vetme të punësimit për banorët lokalë, ato njëkohësisht janë kthyer në burime të vazhdueshme aksidentesh, shumë prej të cilave me pasojë vdekjen. Avancimi i punës në zonat e shfrytëzuara (kolonat e lëna për ruajtjen e objekteve sipërfaqësore dhe pjesë fundore të blloqeve të shfrytëzuar më parë) jo vetëm kanë dëmtuar vendburimet e njohura me mënyrën e shfrytëzimit, por vazhdojnë të krijojnë premisa për dëmtimin e shëndetit të punonjësve dhe aksidenteve fatale. Sipas statistikave zyrtare, gjatë tre mandateve kur ka qeverisur Edi Rama, numri i minatorëve të vdekur në vendin e punës është mbi 60 vetë. Për vitin 2023, sipas raportit të Inspektoratit të Punës, në miniera ka pasur 25 të aksidentuar nga të cilët një me pasojë vdekjen. Të dhënat nga bota dëshmojnë se jeta e një minatori shqiptar është 25 herë më e rrezikuar se ajo e një minatori në SHBA, 17 herë më e rrezikuar se e minatorit në Kinë, 10 herë më e rrezikuar se e minatorit në Peru dhe 8 herë më e rrezikuar se e minatorit në Afrikën e Jugut.

Propozimet

- Forcimi institucional dhe profesional i administratës publike dhe institucioneve në varësi të saj përmes promovimit të specialistëve të mirëfilltë në rangjet drejtuese dhe përmes ngritjes së infrastrukturës teknike. Kjo do të sigurojë rritjen e kontrollit nga ana e shtetit e të gjithë aktivitetit nxjerrës dhe përpunues në vend, dhe njëkohësisht ruajtjen e marrëdhënieve korrekte me investitorët privatë vendas dhe të huaj.
- Rritja e aktivitetit të kërkim-zbulimit nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) duke përdorur teknologji moderne zbulimi për vendburime më të thella nga ato ekzistueset me potencial shfrytëzimi nga 10.000 deri në 50.000 tonë metal, si dhe rivlerësimi i rezervave ekzistuese me përmbajtje të ulët të mineralit. Marrja e riskut nga shteti për kërkim-zbulimin do t'i hapte rrugën hartimit të një strategjie afatgjatë të sektorit dhe tërheqjen e investitorëve të huaj.
- Monitorim i vazhdueshëm dhe zbatim i kontratave koncensionare, sidomos në drejtimin e shfrytëzimit të qëndrueshëm të vendburimeve dhe sigurisë në punë.
- Promovimi i sektorit minerar përmes hartimit të studimeve të fizibilitetit nga bashkëpunimi ndërinstitucional mes institucioneve publike si AKBN, SHGJSH, FGJM, si dhe hartimi dhe publikimi vjetor i hartës metalogjenike dhe gjendjes së rezervave të xeherorëve të ndryshëm, duke bërë një vlerësim të tyre sipas standardeve ndërkombëtare.
- Hartimi i një strategjie të mirëfilltë për tërheqjen e investitorëve në sektorin minerar nga bizneset e vogla dhe të mesme për shfrytëzimin e vendburi-

meve më të vogla përmes zbatimit të politikave lehtësuese, të tilla si:

- Furnizimi me energji elektrike me çmime preferenciale.
 - Heqjen e procedurave të gjata burokratike për kompanitë përmes ndërmjetësimit të shtetit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.
 - Lehtësimi i barrës tatimore për ato biznese që investojnë në teknologji dhe në rritjen e aftësive teknike të punëtorëve.
 - Shtimi i kohëzgjatjes për lejet e kërkim-zbulimit nga 3 vjet në 6 vjet.
 - Përfitimi i kredive të buta nga Banka Zhvillimore për blerjen e makinerive të nxjerrjes dhe të përpunimit.
 - Sigurimi i infrastrukturës rrugore dhe i furnizimit me energji nga ana e shtetit.
 - Shkurtimi i kostove dhe i procedurave burokratike për nxjerrjen e licencave të shfrytëzimit.
 - Ofrimi i kurseve të specializimit pa pagesë nga FGJM për rritjen e kapaciteteve profesionale të inxhinierëve.
 - Krijimi i kadastrës minerare dhe publikimi i zonave të lira për aktivitet minerar duke krijuar mundësi për rritjen e interesit të investimeve.
- Themelimi i një kompanie shtetërore për industrinë nxjerrëse të mineraleve kryesore, për të rritur konkurrueshmërinë në treg me operatorët privatë.

- Përdorimi i një buxheti prej 400 milionë dollarësh nga Fondi Sovran në bashkëpunim me investitorë të huaj për ngritjen e një kombinati metalurgjik me 51% të aksioneve në pronësi të shtetit, për përpunimin e mineralit të bakrit në shkrirje, rafinim dhe përpunim e metali. Shteti do duhet të bëjë rinegocimin e kontratave me aktorët privatë për furnizimin e kombinatit (deri në masën 80%) me koncentrat bakri, me opsionin edhe për importimin nga vende të rajonit, si p.sh. Kosova. Paralelisht, intensifikimi i kërkim-zbulimit mund të rrisë rezervat e rikuperueshme deri në 30-40 milionë tonë.
- Rishikimi i licencave për shfrytëzimin e mineraleve dhe pezullimin e atyre
- Rinegocimi i kontratave me kompanitë nxjerrëse dhe përpunuese të kromit për kanalizimin e koncentratit të kromit drejt fabrikave të ferrokromit, duke bërë të mundur rritjen e vlerës së shtuar nga shitja e këtij minerali.
- Rinegocimi i kontratës koncesionare me KURUM International, ku do të rivlerësohet rentabiliteti ekonomik i kësaj kompanie, si dhe do të përforcohen kontrollet e institucioneve shtetërore për mbetjet toksike që prodhon kjo kompani.
- Nisja e një projekti-pilot për riaktivizimin e një miniere shtetërore të qymyrgurit dhe për shfrytëzimin e tij në industrinë e prodhimit të çimentos dhe në përdorimin e termocentraleve të vegjël deri në 5 MW, me djegie në temperatura të ulëta 800-900 gradë C dhe me impiant të pastrimit të tymrave që mënjanon ndotjen e mjedisit.
- Rritja e sigurisë në vendin e punës përmes hartimit dhe miratimit të "pemës minerare" të shfrytëzimit të galerive, duke përcaktuar qartazi me

koordinata lokale kufijtë e zonave të rrezikshme, kufijtë e zonave minerare të lejuara për shfrytëzim, së bashku me rrugët e lëvizjes, drejtimin, kohëzgjatjen dhe radhën e shfrytëzimit, etj.

- Respektimi i rreptë i rregullores së sigurimit teknik.
- Miratimi i Statusit të Minatorit, që do të siguronte disa të drejta themelore për minatorët në gjendje pune dhe ata në moshë pensioni.
- Rritja e përqindjes së të ardhurave nga renta që i kalon pushtetit lokal nga 5% në 15%.

II. Industria tekstile dhe e këpucëve

Gjendja aktuale

Që prej vitit 2013 industria tekstile dhe e këpucëve në Shqipëri ka ardhur duke u zgjeruar e duke u bërë një ndër sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare. E bazuar kryesisht në modelin fason – atë të përpunimit të lëndës së parë që më pas eksportohet te porositësit e huaj – kjo industri përbën rreth 30% të eksporteve të vendit. Një numër shumë i vogël i kompanive të përpunimit të këpucëve ia kanë dalë që të kalojnë me cikël të plotë prodhimi, pra me një produkt të përfunduar që del në treg me logon *Made in Albania*. Njëkohësisht, ky është një ndër sektorët me punësimin më të lartë në vend i cili në vitin 2023 numëronte mbi 740 kompani ku punonin rreth 60.000 punëtorë, kryesisht gra. Në shumë prej zonave periferike dhe rurale të vendit ndërmarrjet fasone janë e vetmja mundësi punësimi e të ardhurash për banorët, sidomos për gratë.

Megjithatë, kriza që ka kapluar mbarë sektorin e industrisë prodhuese prej vitit 2023 ka shfaqur simptomat e saj edhe në industrinë fasonë. Në vitin 2024 ky sektor pësoi një tkurrje të paprecedent: eksportet e veshjeve dhe këpucëve pësuan rënie me 16.5% në vlerë, teksa punësimi në fabrika pësoi rënie me rreth 20%, duke shkaktuar humbjen e rreth 11 mijë vendeve të punës. Në shkurt të vitit 2024, qeveria shqiptare njoftoi me pompozitet lëshimin e një garancie sovranë prej 4 miliardë lekësh me interesa të ulëta për t'i ardhur në ndihmë biznesit fason. Megjithatë, efekti i saj në sektor ishte i parëndësishëm për dy arsye: e para, sepse shpërndarja e saj përmes bankave private u bë brenda një intervali kohor shumë të ngushtë – nga muaji gusht deri në tetor 2024; e dyta, sepse prej saj mund të përfitonin vetëm ato pak biznese që prodhojnë me cikël të plotë dhe jo pjesa më e madhe e bizneseve që prodhojnë me porosi. Për vitin 2025 ekspertët parashikojnë falimentimin e shumë prej bizneseve fasonë, me pasoja të rënda në ekonomi dhe në punësim.

Problemet kryesore

Duke qenë tërësisht i orientuar nga eksporti dhe meqenëse shumë prej kontratave me porositësit nga jashtë vendit janë lidhur në valutën euro, biznesi fason është prekur rëndë nga rënia e euros në raport me lekun. Kjo situatë ka sjellë rënien e xhiros mujore me 20-25%, çka ka detyruar bizneset që të reduktojnë linjat e prodhimit. Efekti shkatërrimtar i rënies së euros në industrinë e vendit është mohuar publikisht nga kryeministri Edi Rama.

Mungesa e subvencioneve të efektshme dhe e politikave fiskale lehtësuese nga shteti shqiptar, ka bërë që rritja e kostove të prodhimit t'i zhvendosë klientët historikë të Shqipërisë drejt vendeve të tjera, si ato të Afrikës Veriore, ku kostot

e prodhimit janë më të ulëta. Buxheti i miratuar për vitin 2025, i cili nuk u shpërndajë nga një paketë fiskale, nuk parashikon mbështetjen e biznesit prodhues dhe eksportues që vuan nga mungesa e likuiditetit, e që për pasojë nuk mund të bëjë diversifikimin e impianteve prodhuese apo të mënyrës së prodhimit.

Nga ana tjetër, shteti shqiptar nuk ka nënshkruar marrëveshje bilaterale me vendet nga ku merret lënda e parë për industrinë fasonë. Të tilla marrëveshje do të mund të ulnin kostot dhe të lehtësonin ndjeshëm barrën mbi prodhuesit vendas. Gjithashtu, marrëveshjet tregtare me vendet e Bashkimit Evropian do të mundësonin aksesin e bizneseve shqiptare në tregjet evropiane.

Kriza e përgjithshme e sektorit reflektohet edhe te marrëdhëniet në vendin e punës, ku për shkak të mosrespektimit të të drejtave që sanksionon Kodi i Punës, punëtoret e fabrikave kanë bojkotuar prodhimin në dhjetëra raste. Kushtet e punës janë të vështira, ku vetëm 35% e kompanive në sektorin tekstil (rreth 160) dhe 15% e kompanive në sektorin e këpucëve (rreth 40) janë certifikuar sipas standardit ndërkombëtar të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës, ISO 45001. Kjo situatë, e shoqëruar edhe me pagat e ulëta, ka sjellë një mungesë të rëndësishme të krahut të punës.

Propozimet

Vizioni i Lëvizjes BASHKË për rimëkëmbjen e sektorëve të industrisë tekstile dhe të këpucëve bazohet te një strategji e mirëfilltë për mbështetjen e bizneseve prodhuese dhe eksportuese, bazuar në:

- Bashkërendimin me Bankën e Shqipërisë për marrjen e të gjitha masave të nevojshme për kufizimin e qarkullimit të valutës së euros në tregun shqiptar.

- Subvencionimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes Bankës Zhvillimore për blerjen e lëndës së parë dhe orientimin e tyre drejt një linje prodhimi me cikël të plotë, duke bërë të mundur daljen në treg me markat shqiptare.
- Mbështetjen e bizneseve të mëdha për automatizimin e procesit të prodhimit dhe rinovimin e makinerive. Kjo mbështetje do të kushtëzohet nga dy faktorë: a) garantimi i cilësisë së mallrave si produkte eksporti, dhe b) implementimi i standardit ndërkombëtar ISO 45001 për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve në vendin e punës.
- Nisjen e bisedimeve për lidhjen e marrëveshjeve bilaterale me vendet nga importohet lënda e parë për industrinë fashione dhe unifikimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE për të mundësuar aksesin e markave shqiptare në tregjet evropiane.
- Promovimi i produkteve *Made in Albania* nëpër panairët ndërkombëtare.

III. Industria e lehtë ushqimore Gjendja aktuale

Industria ushqimore agro-përpunuese është ndër sektorët më të rëndësishëm të industrisë dhe sektori me më shumë potencial zhvillimor afatgjatë për vendin dhe për ekonominë e Shqipërisë. Ajo është e lidhur ngushtësisht dhe e ndërvarur nga sektorë të tjerë kyç si bujqësia, blegtoria e turizmi, dhe shërben si një pikë ndërlidhjeje mes tyre: grumbullimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale vendase dhe përpunimi i tyre mundëson një vlerë të shtuar për prodhuesit dhe për ekonominë shqiptare. Njëkohësisht, ajo

përbën bazën për ngritjen e një agroturizmi cilësor dhe të qëndrueshëm, si dhe për eksportimin e produkteve cilësore që mbajnë logon *Made in Albania*.

Megjithatë, në kushtet e keqqeverisjes aktuale industria e përpunimit të ushqimeve gjendet në prag të falimentit. Edhe pse Shqipëria është një vend me traditë të gjatë në kultivimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale të cilësisë shumë të lartë, si produktet e mishit, të peshkut, të qumështit dhe të bimëve të ndryshme, mungesa e vëmendjes së shtetit sa i përket subvencioneve dhe politikave fiskale që favorizojnë produktin vendas ka futur në krizë mbarë industrinë e përpunimit të ushqimeve. Mungesa e produktit vendas i ka shtyrë përpunuesit që t'i drejtojnë sytë drejt lëndës së parë që vjen nga importi.

Për vitin 2023 vlera e shitjeve të produkteve industriale ushqimore të përpunuara kapi shifrën 43,500 milionë lekë, duke pësuar një rënie me rreth 5% krahasuar me një vit më parë. Në të njëjtin interval kohor, numri i krerëve të gjedhëve ra me 11%, i derrave me 16% dhe i pulave me 2%; sasia e qumështit të grumbulluar ra me 8%; eksportet e produkteve të peshkut ranë me 4.7%. Të përballur me këtë situatë, prodhuesit e industrisë kanë apeluar shumë herë për ndërhyrjen e shtetit shqiptar në sektor, deri tani pa një përgjigje konkrete.

Problemet kryesore

Dy faktorët kryesorë që kanë goditur të gjitha degët e industrisë ushqimore agro-përpunuese kanë qenë mungesa e fuqisë punëtore dhe zhvlerësimi i euros në raport me lekun. Hemorragjia e vazhdueshme jashtë vendit, fenomen ky i përhapur sidomos te popullata në moshë pune, e ka ndikuar negativisht sektorin si nga vështirësia në gjetjen e punëtorëve, ashtu edhe nga perspektivat e konsumit të mallit që nxirret në tregun vendas.

Nga ana tjetër, rënia drastike që ka pësuar valuta e euros në raport me lekun ka sjellë uljen e fitimeve për ata prodhues që e eksportojnë produktin e tyre.

Një tjetër faktor i rëndësishëm që e ul ndjeshëm konkurrueshmërinë është TVSH prej 20%, ndërkohë që për prodhuesit në vendet e rajonit kjo taksë është në masën 5-7%, duke u dhënë atyre një avantazh të konsiderueshëm në raport me prodhuesit shqiptarë. Madje edhe kompensimi i pjesshëm i TVSH që u bëhej produkteve të bulmetit u hoq në vitin 2022 me pretendimin se do të kompensohej nga subvencionet shtetërore.

Mungesa e unifikimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian sa i përket sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së investimeve, ka privuar prodhuesit shqiptarë nga mundësia e eksportimit të produkteve të tyre drejt vendeve të BE dhe ka kufizuar investimet e huaja në këtë sektor. Kjo situatë vazhdon prej 18 vjetësh (prej nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit në vitin 2006) dhe sjell efekte negative zinxhir, prej rënies së investimeve të huaja te mungesa e konkurrueshmërisë në rajon e deri te rënia e produktit të blegtorisë në vend. Një tjetër faktor që pengon eksportin drejt tregjeve evropiane është mungesa e laboratorëve të akredituar për kryerjen e analizave të produkteve ushqimore sipas standardeve të BE.

Sa i përket industrisë së përpunimit të mishit, qeveria shqiptare që prej vitit 2006 ka vendosur një taksë 10% për importin e mishit si lëndë e parë në vend, me justifikimin e mbrojtjes së produktit vendas të mishit. Megjithatë, në mungesë të politikave të tjera subvencionuese, kjo masë ka rezultuar totalisht e pafektshme për nxitjen e produktit vendas. Ajo është vetëm një kosto shtesë për industrinë, çka ul konkurrueshmërinë e produkteve shqiptare në raport me prodhuesit në rajon.

Nga ana tjetër, mungesa e fermave të rritjes së derrave në vend e ka detyruar industrinë e përpunimit të mishit të varet thuajse totalisht nga mishi i importit që vjen nga Brazili, kostoja e të cilit është 35-38% më e ulët sesa produktet e importuara nga BE apo SHBA. Megjithatë, te mishi i derrit që vjen nga Brazili është evidentuar prania e substancës së dëmshme raktopaminë, e cila është e ndaluar në BE, Rusi dhe Kinë. Kjo ka bërë që në mungesë të laboratorëve për kryerjen analizave, shëndeti i konsumatorit shqiptar të vihet në rrezik, por edhe që produktet industriale të derrit që prodhohen në Shqipëri të mos eksportohen dot drejt tregjeve evropiane.

Industria e përpunimit të peshkut përballët me kufizimet e vendosura nga BE sa i përket kuotave të eksportit të peshkut të përpunuar drejt tregut evropian në vetëm 1600 tonë në vit, teksa tejkalimi i kuotave shoqërohet me taksimin e produktit me 25%. Deri më tani qeveria shqiptare ka qenë e paaftë të rinegociojë kuotat me Bashkimin Evropian.

Propozimet

Zgjidhja e nevojshme për nxjerrjen e sektorit të industrisë ushqimore agro-përpunuese nga situata në të cilën ndodhet nuk mund të kufizohet vetëm në masat e marra brenda sektorit, por ajo duhet të shoqërohet me politika zhvillimore të ndërlidhura edhe me sektorët e bujqësisë, blegtorisë, me subvencione shtetërore dhe me masa të politikave fiskale që i japin përparësi produktit industrial vendas. Propozimet e Lëvizjes BASHKË janë si më poshtë:

- Bashkërendimi me Bankën e Shqipërisë për marrjen e të gjitha masave të nevojshme për kufizimin e qarkullimit të valutës së euros në tregun shqiptar dhe rritjes së saj në raport me lekun.

- Subvencionimi nga ana e shtetit përmes Bankës Zhvillimore për një periudhë 5-vjeçare e sipërmarrjeve të reja për përpunimin e mishit, peshkut, bulmetit dhe bimëve mjekësore, me kushtin që të përdoret produkti vendas si lëndë e parë të paktën deri në masën 70%.
- Ngritja e laboratorëve të akredituar sipas standardeve të Bashkimit Evropian pranë institucioneve publike të Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT) dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) për kryerjen e të gjitha analizave të nevojshme dhe për certifikimin e produkteve shtazore dhe bimore. Kjo masë do të mundësonte njëkohësisht mbrojtjen e konsumatorit shqiptar përmes mbikëqyrjes së sigurisë ushqimore dhe lehtësimin e eksportimit të produkteve vendase drejt BE.
- Unifikimi me hapa sa më të shpejtë i legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE, duke mundësuar thithjen e investimeve të huaja në sektor dhe lehtësimin e eksporteve të produktit vendas drejt tregjeve evropiane.
- Rinegociimi me BE i kuotave të eksportit të peshkut të përpunuar drejt tregut evropian nga 1600 tonë në 4000 mijë tonë në vit.
- Në afatmesëm, heqja e taksës 10% për importuesit e mishit për të rritur konkurrueshmërinë me vendet e rajonit. Kjo masë do të shoqërohet me subvencione nga shteti shqiptar dhe nga Bashkimi Evropian për shtimin e konsiderueshëm të blegtorisë vendase, me synimin afatgjatë për ta kthyer atë në furnizuesen kryesore të industrisë së përpunimit me lëndë të parë.

1.2 BUJQËSIA

I. Gjendja e përgjithshme

Sipërfaqja e përgjithshme e territorit të Shqipërisë është 28,748 km². Pyjet konsiderohen si një ndër burimet kryesore natyrore, që mbulojnë 41.6% të sipërfaqes së përgjithshme. Rreth 24% është tokë bujqësore dhe 16% kullota dhe livadhe të përhershme. Shqipëria është gjithashtu e pasur me burime ujore me një vijë bregdetare prej 476 km, ku zhvillohen aktivitetet e peshkimit.

Shqipëria ka një popullsi totale prej 2,402,113 banorësh (INSTAT 2024). **Popullsia rurale** llogaritet në 964,791 banorë (2019). Përqindja e popullsisë rurale ka rënë vazhdimisht nga 42,57% në vitin 2015 në 38,89% në vitin 2019, e shkaktuar nga **emigrimi** dhe përgjithësisht nivelet më të ulëta të lindjeve. Nuk u gjetën statistika të popullsisë rurale në vitin 2023.

Zhvillimi ekonomik në zonat rurale karakterizohet nga mbizotërimi i sektorit ekonomik nga bujqësia. Kontributi i bujqësisë në totalin e vlerës së shtuar bruto të ekonomisë (VSHB) është rreth 22% ndaj VSHB-së kombëtare. Në Ballkanin Perëndimor shohim se Maqedonia e Veriut e ka vetëm 8% impaktin e bujqësisë në ekonomi dhe Serbia rreth 10%. Ndërkohë, Bashkimi Evropian e ka shumë herë më të ulët, rreth 1.5-2%. Fakti që pesha e saj është kaq e rëndësishme tregon prapambetje të thellë të sektorëve të tjerë të ekonomisë. Në vitin 2023, 32.3% e **forcës totale të fuqisë punëtore** ishte në bujqësi, pylltari dhe peshkim, me një rënie totale prej mbi 13% gjatë dekadës së fundit, kryesisht për shkak të migrimit. Gjithsesi, ka dyshime të forta se këto

të dhëna nuk paraqesin realitetin. Për më tepër do të flitet në seksionin 3.5.3. *Shërbimi Statistikor*.

Prodhimi bujqësor dominohet nga fermat e vogla dhe fermat familjare. Rreth 85% e fermave klasifikohen si të vogla dhe kryesisht prodhojnë për vetëkonsum. Madhësia mesatare e pandryshuar prej 1.2 ha, e kombinuar me fragmentimin dhe të drejtën e paqartë të pronës janë sfidat kryesore për rritjen dhe konkurrencën e sektorit të bujqësisë. Megjithatë, pronarët e vegjël luajnë rol kritik për sigurimin e ushqimit të popullsisë shqiptare, si dhe për uljen e varfërisë në zonat rurale, por janë të integruar në mënyrë të pamjaftueshme në zinxhirët e shkurtër të furnizimit. Vështirësitë strukturore të trashëguara të fermave, mungesa e mbështetjes së duhur nga instancat publike dhe korrupsioni i lartë në fondet e destinuara për fermerët kanë bërë që ky sektor të jetë i zhytur në prapambetje në tre dekadat e fundit.

II. Problemet kryesore të sektorit: Bujqësia në pikiatë

Struktura e rritjes ekonomike në vitin 2023 tregoi rënie të theksuar të prodhimit në vend dhe sidomos bujqësisë, sektorit më të madh në ekonomi. Të dhënat zyrtare të INSTAT referuan se bujqësia shënoi rënie me 0.68% në vitin 2023 (*figura*). Kjo është rënia më e fortë e regjistruar që nga viti 1997.




Figura 1: Kontributi i sektorit të bujqësisë në Produktin e Brendshëm Bruto (Burimi: INSTAT)

Tendenca rënëse e ritmeve të rritjes filloi që nga viti 2013. Në dhjetë vitet e fundit bujqësia është rritur mesatarisht 1%, teksa rezultati është dobësuar tre vitet e fundit për t'u kthyer negativ më 2023. Nga viti 2007 deri në 2010 bujqësia është rritur mesatarisht 3.7% në vit (grafiku 2).




Figura 2: Rritja reale e sektorit të bujqësisë ndër vite (Burimi: INSTAT)

Të dhëna më të detajuara tregojnë se rënia më e madhe ka ndodhur në sektorin e blegtorisë dhe në mbylljen e fermave të vogla, ngastrave për vetëkonsum.

Pakësimi i popullsisë në fshat nga emigracioni i brendshëm dhe i jashtëm, në njërën anë, dhe mungesa e subvencioneve shtetërore, në tjetrën, e kanë përkeqësuar klimën në sektor. Në vitin 2022 numri i krerëve në blegtori shënoi rënie vjetore me rreth 13%, ndërsa gjatë dekadës krerët u përgjysmuan. Prodhuarit dhe blegtorët pohojnë se kostot në zinxhirin e blegtorisë dhe bujqësisë janë më të larta nga çmimi i lartë i

inputeve për shkak se shteti ynë nuk e subvencionon sektorin, ndërkohë që në rajon subvencionet janë disafish më të larta, dhe se mekanizimi i bujqësisë është shumë i ulët duke rritur kostot dhe ulur rendimentin.

Në krahasim me vendet e rajonit, Shqipëria ka nivelin më të lartë të të punësuarve në bujqësi se çdo vend tjetër. Sipas të dhënave nga institutet e statistikave, në vend janë mbi 32% e të punësuarve në këtë sektor, krahasuar me 19% në Bosnjë Hercegovinë e Serbi, 16.4% në Maqedoninë e Veriut dhe vetëm 7.6% në Malin e Zi. Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e fermerëve në Shqipëri janë informalë. Nëse paligjshmëria është fjala që kemi dëgjuar më shpesh këto vite, shifrat e sektorit të bujqësisë janë më të frikshmet. Sipas të dhënave nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në vend janë mbi 355 mijë ferma bujqësore, ndërsa vetëm 61 mijë prej tyre janë formalizuar. Pra më shumë se 85 për qind e fermerëve nuk identifikohen me anë të një NIPT-i.

Sipas të dhënave nga Instituti i Statistikave, paga mesatare në aktivitetin "Bujqësi, silvikulturë dhe peshkim" ishte 350 euro në shtator 2022, më e ulëta nga të gjithë aktivitetet e tjera.

Në vendet e rajonit, të punësuarit në bujqësi paguhen dyfish, me përjashtim të Kosovës, që është nën nivelin tonë (të dhënat për Kosovën janë të disponueshme deri në fund të vitit 2021). Rekordin e mban Mali i Zi, me 817 euro në muaj, por edhe në Serbi e Bosnjë, të ardhurat i kalojnë 700 euro në muaj.

Maqedonia e Veriut ka rritur me shpejtësi pagat në bujqësi dy vitet e fundit, duke e çuar në rreth 620 euro në muaj, nga 485 euro në shtator 2019, sipas të dhënave nga Zyra e Statistikave Shtetërore të Maqedonisë së Veriut.

III. Propozimet për modernizimin e sektorit bujqësor

Nisur nga fakti se sektori bujqësor jep më shumë në PBB në krahasim me vendet e rajonit e BE dhe merr shumë më pak nga buxheti sesa këto vende, Lëvizja BASHKË e ka shpallur sektorin bujqësor një prioritet zhvillimor. Për ta shpëtuar bujqësinë nga kriza ku është futur dhe për modernizimin e saj duhen ndërmarrë një sërë masash. Më poshtë gjenden propozimet e Lëvizjes Bashkë këtë qëllim.

Pronësia e tokës

Pronësia e tokës do të jetë një ndër pikat kryesore të programit për modernizimin e bujqësisë, pasi moszgjidhja e kësaj problematike do të sillte dështimin e cilësdo politikë për zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Problematika të mëdha lindën me zbatimin e Ligjit 7501. Veç copëzimit dhe uljes së rendimentit, pajisja me certifikatë pronësie të tokës bujqësore ka qenë një sfidë e jashtëzakonshme e cila nuk është zgjidhur edhe sot, 34 vite më pas. Aktualisht rezulton se vetëm 40% e parcelave të tokës janë të regjistruara me Aktin e Marrjes së Tokës në Përdorim (AMTP) dhe vetëm një pjesë shumë e vogël e pronarëve të tyre kanë marrë certifikatën përfundimtare të pronësisë (tapinë).

Ligji 7501 nuk u pranua nga e gjithë popullsia. Rreth 25% e saj, kryesisht qarqet e Dibrës dhe Kukësit, e mohuan tërësisht reformën duke u kthyer tek e drejta zakonore, pra te trashëgimia. Këto toka bujqësore janë ende të panjohura ligjërisht, ndaj pronarët faktikë të tyre nuk zotërojnë një akt pronësie. Kjo sjell mungesën e mundësisë së lënies me qira, të shitjes apo edhe të aplikimit për subvencione.

Duke u nisur se banorët mes tyre e marrin për të mirëqenë këtë ndarje dhe nuk ka konflikte mes tyre, Lëvizja BASHKË do të propozojë pajisjen me certifikatë pronësie sipas ndarjes së dakordësuar në bazë të trashëgimisë së këtyre tokave. Kurse një pjesë e mirë e qarqeve Tiranë, Elbasan dhe Durrës tentuan të bëjnë një ndarje të përzier: morën tokat për frymë sipas ligjit, por te vendndodhjet ku ishin familjet e gjyshërve të tyre.

Kryesisht, qarqet e Fierit, Beratit dhe të jugut të Shqipërisë e pranuan ndarjen e re të tokës dhe pavarësisht problemeve dhe mosmarrëveshjeve, një pjesë e mirë e parcelave janë regjistruar me AMTP. Përgjatë bëjnë fshatrat e Himarës, të cilët kanë problematikë të ngjashme me veriun e Shqipërisë pasi disa prej tyre kërkuan të ktheheshin tek e drejta e trashëgimisë.

Edhe në rastet kur pronarët janë të pajisur me AMTP, krijohen problematika në regjistrimin e këtyre tokave te trashëgimtarët pasi pronari ka ndërruar jetë. Edhe pse kanë hapur dëshminë e trashëgimisë, institucioni i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për shkak të zvarritjeve burokratike u kërkon qytetarëve të paguajnë penalitete prej 25 lekë dita për çdo ditë vonesë nëse prona nuk regjistrohet brenda 30 ditëve nga çelja e trashëgimisë. Veçanërisht kur fëmijët kanë emigruar prej vitesh dhe nuk kanë arritur të mbyllin procedurën e kalimit të pronës në emrin e tyre, ky penalitet përkthehet në shuma të konsiderueshme.

Lëvizja BASHKË do të ngrejë një strukturë për verifikimin e këtyre AMTP-ve dhe do të marrë nisma për t'i stimuluar pronarët që ta përfundojnë procesin e regjistrimit të pronësisë së tokës bujqësore. Gjithashtu do të revokohen/anulohen të gjitha penalitetet e shkaktuara nga burokracitë e sipërpërmendura. Në këtë mënyrë do të nxiten investimet

në bujqësi dhe fermerët do të mund të aplikojnë dhe të përfitojnë nga subvencionet.

Formimi i Shoqërive të Bashkëpunimit Bujqësor

Në kushtet specifike të bujqësisë sonë, me afro 350 mijë fermerë, shërbimet e kërkimit dhe këshillimit bujqësor e kanë mjaft të vështirë të operojnë me efektivitet. Ndonëse kuadri ligjor për kooperimin ekziston, shërbimet reale ndaj fermerëve të interesuar çalojnë ndjeshëm. Ndonëse numri total i SHBB-ve duket tepër optimist, rreth 100 të tilla, me shumë mundësi vetëm një numër shumë i vogël funksionojnë vërtet si të tilla.

Ekonomia bujqësore, ashtu si edhe në fusha të tjera të ekonomisë, ka si forcë dinamike të saj bashkëpunimin. Bashkëpunimi synon të plotësojë nevojat e përbashkëta të anëtarëve. Fermerët bashkëpunojnë kur krijojnë bindjen se kapaciteti individual nuk është i mjaftueshëm në arritjen e objektivave fitimprurëse dhe kur ky bashkëpunim rezulton në përfitime të prekshme për të gjithë. Bashkëpunimi mund të jetë efektiv vetëm nëse aspektet e reciprocitetit dhe transparencës kuptohen dhe pranohen me ndërgjegje.

SHBB-të në BE përfaqësojnë mbi 50% të ofertës për inpute bujqësore dhe mbi 60% të ofertës së grumbullimit, përpunimit dhe marketingut të produkteve bujqësore.

Llojet e SHBB-ve:

1. SHBB Furnizuese: furnizojnë anëtarët me inpute për prodhimin bujqësor si fara, plehra kimikë, pesticide-insekticide, karburant, shërbimet e makinerive etj.
2. SHBB Marketingu: qëllimi kryesor është të ndihmojë fermerët të shesin produktet e tyre. Realizojnë procesin

e përpunimit, paketimit, shpërndarjes dhe shitjen e produkteve bujqësore duke siguruar tregje më të mëdha dhe rritur fitimet.

3. SHBB Shërbimesh: ofrojnë shërbime si transporti, grumbullimi dhe ruajtja dhe asistencë teknike.
4. SHBB Kreditimi: ofrojnë shërbime financuese/kreditimi për fermerët si dhënie kredie me interes të ulët për fermerët duke i ndihmuar për procesin e prodhimit dhe për investimet e ardhshme.
5. SHBB Makinerish: ndihmojnë fermerët në përdorimin e makinerive të shtrenjta duke reduktuar kostot individuale dhe duke siguruar një përdorim më të mirë të resurseve/burimeve.

Problemet e SHBB-ve

Ngritja e SHBB-ve në vendin tonë ka hasur në probleme të ndryshme si:

- Probleme të natyrës ekonomike si mungesa e investimeve në kapitalin shoqëror nga ana e vetë anëtarëve, mungesë grantesh nga qeveria apo nga institucionet e tjera dhe nga normat e larta të interesit nga bankat.
- Probleme të natyrës sipërmarrëse nga mungesa e formimit profesional të drejtuesve të SHBB-ve, mungesa e diversifikimit të produkteve dhe shërbimeve në SHBB-të ekzistuese (p.sh. zgjerimi i shërbimeve si konsulencë, përpunim, marketing etj.) dhe nga mungesa e daljes në treg me një produkt të tyrin, pra marka dhe certifikimi i produktit.
- Probleme të natyrës shoqërore si mosbesimi në modelin e SHBB dhe mosbesimi i anëtarëve kundrejt drejtuesit të SHBB.

- Probleme të natyrës institucionale si mungesa e mbështetjes teknike nga shteti dhe mungesa e formimit në çështje që lidhen me ngritjen dhe funksionimin e SHBB-ve.
- Një ndër pengesat e formimit të SHBB-ve është kuadri ligjor i mangët dhe politikat fiskale të pafavorshme. Aktualisht, tatimi mbi fitimin për SHBB-të është 5%, kurse fermerët e veçuar me xhiro deri në 10 milionë lekë në vit e kanë 0%. Kjo dukuri çon në konkluzionin se politikat fiskale në fuqi nuk e nxisin bashkëpunimin, përkundrazi e pengojnë atë.

Fakti se që prej vitit 2015, numri i SHBB-ve nuk është rritur tregon se procesi i kooperimit ka mbetur në vend. Kjo ngecje, mund të shpjegohet pjesërisht me frikën për pagesat e tatimit mbi fitimin që SHBB-të janë të detyruara të paguajnë pas regjistrimit. Ndaj rekomandohet aplikimi i masave mbështetëse si politikat fiskale, grante e kredi të zbutura, lehtësira në qasjen e shërbimeve dhe programeve publike etj. Gjithashtu, puna e këshilluesve bujqësor për nxitjen e fermerëve për të kooperuar çalon ndjeshëm, ndaj fushata ndërgjegjësimi për nxitjen e kooperimit në bujqësi duhet të jenë të shpeshta dhe më produktive.

3.2.2. Përfitimet Reale në Vendin Tonë nga Formimi i SHBB-ve

Formimi dhe rritja e SHBB-ve ka përfitime të shumta për fermerët pjesëmarrës.

1. Mundëson integrimin vertikal të fermerëve në zinxhirin agro-ushqimor; përfshirja e hallkave të ndryshme të prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të produkteve bujqësore brenda një organizate të vetme.
2. Optimizon faktorët e prodhimit në sajë të përmirësimit të teknologjive bujqësore.

3. Mundëson dhe realizon studime tregu dhe rrjedhimisht planifikim të mbjelljeve.
4. Sjell sigurimin e sasisë dhe cilësisë së duhur të produkteve që kërkon konsumatori duke evituar shitjen e tyre nën kosto dhe rrezikun e hedhjes së tyre si rezultat i mbingopjes së tregut apo i blerjes me çmim shumë të ulët nga grumbulluesit.

Për të reduktuar problemet e mbingopjes dhe urisë së tregut, rekomandohet ngritja e Agjencive Rajonale të Marketingut, të cilat janë funksionale në BE. Këto agjenci këshillojnë dhe, kur është e nevojshme, përcaktojnë se cilat kultura duhet të mbjellin, sa duhet të mbjellin dhe kur duhet ta nxjerrin produktin në treg, në mënyrë që të kapin vlerën më të lartë të tregtimit. Nëse fermerët nuk bashkëpunojnë, edhe efektiviteti i këtyre agjencive do të jetë i ulët duke pasur parasysh numrin e madh të fermave dhe sipërfaqen e tyre shumë të vogël.

Aktualisht, fermerët tanë realizojnë vetëm prodhimin dhe rrallë herë shitjen në tregje të produkteve bujqësore, ndërsa inputet, ruajtja dhe përpunimi, shitja me shumicë e pakice janë të përqendruara në duart e të tretëve (grosistëve), të cilët marrin pjesën më të madhe të fitimit dhe fermeri nuk shpërblehet për punën e bërë.

SHBB-të e kanë fuqinë që të reduktojnë hallkën e ndërmjetësit, pra aty ku shkon vlera më e madhe e produkteve. Nëse fermerët bashkëpunojnë, ata përqendrojnë në duart e tyre hallka të tjera të zinxhirit agro-ushqimor, përfshirë edhe tregtimin deri te konsumatori apo shitësi me pakicë. Në këtë mënyrë, vlera e shtuar e produktit bujqësor do të shkojë për vetë fermerin.

Krijimi dhe funksionimi i SHBB-ve sjell edhe përfitime të tjera si:

- Rritje e sigurisë ushqimore dhe e gjurmueshmërisë
- Nxitje të punësimit dhe ulje të shkallës së informalitetit në zonat rurale. Fermerët shqiptarë deklarohen si të vetëpunësuar në fermat e tyre dhe nuk deklarojnë shitjet. SHBB-të bëjnë të ligjshëm aktivitetin prodhues, duke i hapur rrugë edhe tregtimit të produkteve si brenda dhe jashtë vendit.
- Rritje në ndikimin e politikave qeveritare dhe në aspektet legjislativo-administrative për të vendosur në favor të tyre.
- Rritje e cilësisë së jetesës, frenim i emigrimit të rinjve, ruajtjen e mjedisit etj.

Rekomandime për funksionimin e SHBB-ve

Në mënyrë që numri i SHBB-ve të rritet dhe ato të funksionojnë në mënyrë efektive, rekomandohet:

1. Ngritja e kapaciteteve të ndryshme publike për:

- Të ndihmuar fermerët për krijimin, regjistrimin dhe menaxhimin e SHBB-ve.
- Të ndihmuar në aplikimet për mbështetje nga qeveria apo nga donatorët.
- Përgatitjen e planeve të biznesit.
- Të lehtësuar qasjen e fermerëve në pajisje, infrastrukturë etj.

2. Nevoja për stimuj fiskalë dhe ngritja e SHBB-ve të suksesshme (model) për të shërbyer si shembull.

3. Kreditimi dhe siguri i prodhimit.

4. Nxjerrja e akteve nënligjore për rregullimin e funksionimit të SHBB-ve.

Rregullimi i pikave të grumbullimit

Gjatë vitit 2024, por edhe më parë, kanë ndodhur protesta masive nga ana e fermerëve pothuajse në të gjithë vendin. Blegtorët në Tepelenë, fermerët e perimeve në Roskovec, Fier e Berat, fermerët e Korçës etj., kanë protestuar kryesisht për çmimin e ulët të vendosur nga pikat e grumbullimit për të blerë produktet e tyre. Për më tepër, shteti e përkeqëson këtë situatë duke vendosur një hendek të madh në aplikimin e TVSH-së. Kur fermeri shet produktin e tij te grumbulluesi, nuk paguan TVSH; kurse kur produkti del nga pika e grumbullimit aplikohet një TVSH prej 20%, duke detyruar këtë të fundit të rrisë çmimin me 20% vetëm për të barazuar çmimin.

Fermerët dorëzojnë prodhimin e tyre te pika e grumbullimit. Zakonisht grumbulluesit kur marrin prodhimin te fermerët, nuk paracaktojnë çmimin e blerjes së produktit. Pasi marrin prodhimin, grumbulluesit e magazinonë duke bërë ambalazhimin për eksport jashtë vendit apo edhe shitje për tregjet brenda vendit. Pasi gjejnë treg, grumbulluesit njoftojnë fermerët për çmimin me të cilin do të blejnë prodhimin që e kanë grumbulluar disa ditë më herët. Në këtë rast, fermerët janë të pasigurt për përfitimet e tyre, ata kanë dorëzuar produktin pa pasur asnjë ide se sa do ta shesin, pasi çmimi do të caktohet nga grumbulluesi. Kjo është një anomali ekonomike pasi në fakt është rast i rrallë në një ekonomi tregu, ku çmimin e vendos blerësi dhe jo shitësi. Kjo situatë është denoncuar nga vetë fermerët, të cilët kanë kërkuar miratimin e bursës e njëkohësisht caktimin e një çmimi dysheme për prodhime bujqësore të caktuara, çmime të cilat nuk bien nën koston e prodhimit.

Ndërkohë që tonelata të tëra me prodhime si qumështi, qepë, patate dhe frutat e perime të ndryshme kanë përfunduar në kanal, shteti ka bërë rolin

e spektatorit, pasi Ministria e Bujqësisë është justifikuar me mosndërhyrjen në treg për shkak të ekonomisë së lirë. Po ndryshe nga sa pretendon Ministria, Bashkimi Evropian ka përcaktuar rregulla të qarta, madje edhe me ndërhyrje në treg në momente që vërehen anomali me çmimet. Në rregulloren e Këshillit të Bashkimit Evropian për organizimin e përbashkët të tregjeve agro-bujqësore, përcaktohet se shteti mund të ndërhyjë me vendosjen e çmimeve referencë në mënyrë që fermerët të mos dëmtohen. Në këtë mënyrë shmanget edhe fiksimi i çmimeve dhe rastet e monopolit në rajone të caktuara.

Në rregulloren e Bashkimit Evropian për tregjet ka edhe praktika të tjera funksionale për të ndihmuar fermerët. Një prej tyre është grumbullimi i prodhimeve bujqësore dhe ruajtja e tyre në ambiente frigoriferike pa pagesë deri në gjetjen e tregut. Në një rast tjetër Bashkimi Evropian ndërhyr në treg, duke mbledhur prodhimet bujqësore dhe blegtorale të fermerëve, të cilat kanë mbetur stok, dhe më pas i shpërndan ato për grupet në nevojë apo institucionet, si: shkolla, kopshte, çerdhe, spitale, qendra sociale etj. Në këtë mënyrë vendet anëtare të BE jo vetëm ndihmojnë fermerët të mos dëshetojnë në shitjen e prodhimeve të tyre, por njëkohësisht evitojnë prokurimet publike për blerje ushqimesh për institucionet publike.

Në Shqipëri kjo zgjidhje do të ishte shumë efiçiente pasi do të shmangeshin prokurimet e fryra për blerje ushqimesh për institucionet publike, e njëkohësisht fermerët nuk do të ankoheshin për mungesë tregu.

Lëvizja BASHKË do të propozojë masat e sipërpërmendura dhe barazimin e TVSH-së si në hyrje dhe në dalje për të zgjidhur në një periudhë afatshkurtër problemet e fermerëve me pikat e grumbullimit. Në synimin afatgjatë, vetëm ngritja e

SHBB-ve do të mund të zgjidhë njëherë e përgjithmonë problemin e mbajtjes së pjesës dërrmuese të fitimit nga grumbulluesit.

Subvencionimi i sektorit bujqësor

Garantimi i sigurisë ushqimore (Food Security) në Shqipëri është thelbësor për të ushqyer popullatën me nivelin e kalorive që kërkohen dhe me ushqime cilësore. Sipas të dhënave më të fundit në raportin “Gjendja e Sigurisë Ushqimore dhe Ushqyerjes në Botë në 2022” të publikuar nga Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara, 1 në 3 shqiptarë vuan nga pasiguria ushqimore për shkak të mungesës së të ardhurave. Ndaj për të pasur çmime më të përballueshme për këtë grup popullate duhet që prodhimi bujqësor vendas të rrisë rendimentin dhe të subvencionohet për të ulur çmimet.

Një ndër qëllimet kryesore të subvencioneve në bujqësi është sigurimi i një standardi të drejtë jetese për komunitetin rural duke rritur fitimet individuale të fermerëve, pasi të ardhurat mesatare të banorëve të zonave rurale mbeten dukshëm nën të ardhurat mesatare të pjesës tjetër të popullsisë.

Subvencionimi i sektorit bujqësor në vendin tonë është padyshim më i ulëti në rajon. Pavarësisht se kontribuon me rreth 20% të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), bujqësia merr vetëm 1.9% të buxhetit. Vendet fqinje, pavarësisht peshës disa herë më të vogël në PBB, alokojnë nga buxheti përqindje më të larta se vendi ynë (3-5%). Për më tepër, buxheti i bujqësisë në vendin tonë shkon kryesisht për administratën (55%) dhe vetëm 45% si mbështetje direkte. Shtete si Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia e subvencionojnë shumë më tepër fermerin e tyre në formë direkte. Në këto shtete 70-80% e buxhetit të bujqësisë shkon si

pagesa direkte dhe vetëm 20% për administratën. Kjo bën që konkurrenca nga këto shtete të jetë e ashpër dhe produkti shqiptar të dalë në treg me një kosto më të lartë. Bujqësia është sektori më i madh në vend, por dy vitet e fundit në rënie po zgjojnë sërish kanalet e importit, teksa eksportet kanë mbetur në vendnumëro. Aktualisht rreth 70% e produkteve bujqësore në tezgja dhe supermarkete vijnë nga importi, duke konkurruar në çmime edhe ato pak fermerë vendas që tentojnë të prodhojnë për treg.

Situata në sektor pritet të përkeqësohet më tej këtë vit pasi buxheti i shtetit dhe më pak financim, teksa mbështetja e BE nga fondet IPARD mbetet e bllokuar. Në buxhetin 2024 sektori i bujqësisë mori 9.6% më pak financime se plani i 2023. Fondet totale për Ministrinë e Bujqësisë ishin planifikuar të jenë 14,1 miliardë lekë më 2024, nga 15,6 miliardë lekë më 2023. Por pas rishikimit të buxhetit këto fonde u shkurtuan akoma, duke shkuar në 13.9 miliardë lekë. Shkurtime më të mëdha i ka marrë mbështetja ndaj fermerit dhe zhvillimit rural, ku nga 10 miliardë lekë të dhëna një vit më parë, do të jepen vetëm 6.8 miliardë lekë në 2024, pra 32% më pak. Ndaj edhe situata në këtë sektor jetik pritet të keqësohet edhe më tej. Rrjedhimisht, duhet ndërhyrë urgjentisht me një plan masash për shpëtimin e sektorit të bujqësisë dhe modernizimin e tij.

Sektori i blegtorisë është ai që e ka vuajtur më tepër këtë problem. Me heqjen e përjashtimit të TVSH, duke rikthyer edhe një herë nivelin 20%, situata e blegtorëve u përkeqësua më tej. Çmimi i qumështit në fermë aktualisht është 40% deri në 60% më i lartë se në BE dhe rajon. Në Shqipëri vitin e kaluar blegtorët që kishin mbi 10 krerë lopë morën nga 98 euro për kokë me dy këste. Ndërsa në Serbi, pas grevës së blegtorëve vitin e kaluar, subvencioni për një lopë qumështi është 365 euro dhe për çdo litër blegtori

merr mbrapsht 0.16 cent. Kjo diferencë në çmime po i orienton fabrikat shqiptare drejt importit të qumështit nga jashtë, çka do të thotë se është një presion i shumëfishtë për blegtorët që tashmë vuajnë nga kostot e larta të lëndës së parë.

E njëjta panoramë ndodh edhe në bujqësi, ku përgjithësisht fermerët shqiptarë subvencionohen shumë herë më pak se kolegët e tyre në rajon. Nëse krahasojmë Shqipërinë me Kosovën, do të shohim se edhe këtu diferencat janë të mëdha. Kosova subvencionon gjithsej 28 nënsektorë dhe kultura bujqësore, kurse Shqipëria vetëm tetë. Në vendin tonë është zhdukur mbështetja për grurin, misrin, perimet dhe dru-frutorët e fushës (subvencionohen vetëm serrat), kurse në Kosovë subvencionet variojnë nga 304 euro/ha për drithërat si misri elbi, thekra dhe tërshëra, 504 euro për hektar për dru-frutorët, 554 euro/ha për perimet në fushë të hapur dhe 614 euro/ha për grurin. Një e metë e madhe e subvencioneve në Shqipëri është se në përgjithësi subvencionet jepen vetëm për sipërfaqe të tokës së mbjellë sipas një kulture të caktuar, por jo për prodhimin direkt. Subvencionimi i prodhimit për sasi dhe cilësi malli jo vetëm do sillte të ardhura më të larta për fermerin, por gjithashtu do nxiste të fiskalizimin e tij.

Kërkimi shkencor në bujqësi dhe problematikat e tij në Shqipëri

Zhvillimi bujqësor i çdo vendi është ngushtësisht i lidhur me shkallën e kërimit shkencor në bujqësi. Vendet më të zhvilluara i dedikojnë një përqindje të lartë të buxhetit kësaj fushe.

Misioni i kërimit bujqësor është rritja e efikasitetit dhe cilësisë së prodhimit bujqësor duke mundësuar të ardhura më të larta dhe jetesë të mirë për fermerin, por njëkohësisht duke marrë parasysh kufizimet ekologjike dhe sociale.

Ndër efektet e kërimit shkencor në bujqësi mund të rendisim:

- Investim shoqëror: sjell përfitime të mëdha publike dhe ekonomike me norma vjetore të kthimit 40%-60% duke rritur kryesisht produktivitetin.
- Rritja e konkurrencës: sektori bujqësor bëhet më i aftë të shesë produktet jashtë vendit, ose të prodhojë zëvendësues për produktet e importit.
- Siguria ushqimore: me rritjen e produktivitetit dhe qëndrueshmërisë, përmirësohet edhe efienca dhe cilësia në procesin e përpunimit dhe shpërndarjes.
- Për më tepër, kërkimi shkencor në bujqësi është i domosdoshëm për përmirësimin e cilësisë së produkteve, uljen e kostos së prodhimit, prodhimin e produkteve unike karakteristike, shtimin e vlerës së lëndës së parë, përdorimin e teknologjive që shtojnë vlerën e produktit, reduktimin e dëmtimeve mjedisore etj.

Problemet dhe sfidat e kërimit bujqësor në Shqipëri

Në vendin tonë, sfida kryesore për Shërbimin Këshillimor mbetet përmirësimi dhe shtimi i kapaciteteve të këshillimit bujqësor publik dhe privat për të rritur aftësinë absorbuese të fondeve në dispozicion për mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural, skemat kombëtare, fondet IPARD, fondin e garancisë për kreditim, projekte etj.

Ndër pikat kryesore të problematikave mund të përmenden:

- Orientim i dobët për veprimtari kërkimore.
- Financim shumë i kufizuar.

- Nxitje të kufizuara për të aplikuar për fonde kërkimore për shkak të shërbimeve të dobëta mbështetëse.
- Rezultate të kufizuara kërkimi.
- Nivel i ulët i botimeve. (Vetëm 1/4 e botimeve citohen në revistat me faktor impakti (impact factor)).

Në vendet në tranzicion mbetet sfida qasja në teknologjitë moderne, transferimi i tyre dhe procesi i ngritjes së kapaciteteve për zgjidhjen e problemeve. Përgjithësisht fermerët adaptojnë përkohësisht teknologjitë kur u ofrohen stimuj, por zbehen ose ndalojnë së praktikuari kur stimujt hiqen.

Për të minimizuar këtë problem, këshillohet që në vendet në tranzicion trendi i Shërbimit Këshillimor të jetë i drejtuar nga kërkesa dhe i orientuar nga tregu.

Shërbimi Këshillimor i drejtuar nga kërkesa:

- Të krijojë mekanizma për inputet e prodhuesve;
- T'u përgjigjet kërkesave të prodhuesve dhe të modifikojë programet sipas reagimit të tyre.
- Të krijojë mekanizma financiarë dhe jofinanciarë që e bëjnë kërkesën më efektive, p.sh. fonde për shërbime këshilluese, kuponë, identifikimin e kërkesave nga organizatat e fermerëve etj.
- Shërbimi Këshillimor i orientuar nga tregu:
- Të identifikojë nevojat e konsumatorit/prodhimit në treg;
- Të lidhet me palët e interesuara të sektorit privat kompanitë e marketingut etj.;
- Të bëjë të mundur kontraktimin e fermerëve të vegjël për shitjet e garantuara të produkteve

Institucionet e kërkimit shkencor

Menaxhimi i kërkimit në bujqësi përfshin vendime me pasoja shkencore, sociale dhe politike. Çdo vend përcakton prioritetet e kërkimit bujqësor bazuar në shumë faktorë kompleks, ndaj edhe kërkohet rishikimi periodik i njësive kërkimore dhe që ato të bëhen pjesë integrale e menaxhimit të kërkimit bujqësor.

Në reformën e vitit 2006, pjesa më e madhe e institucioneve kërkimore kaloi nën varësinë e Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT), por ky i fundit nuk arriti të kryente kërkim të mirëfilltë shkencor për shkak të mungesës së një buxheti të alokuar për kërkimin, si edhe të problemeve infrastrukturore e logjistike.

Për transferimin e praktikave bujqësore u krijuan Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB), të cilat nuk kryejnë kërkim shkencor, por vetëm shërbim këshillimor dhe transferimin e teknologjisë në fushën që mbulon dikasteri. Fillimisht QTTB-të luajtën një rol aktiv për sa i përket transferimit të teknologjive, duke çuar në rritjen e konkurrueshmërisë. Ato u përfshinë në përgatitjen dhe zbatimin e disa prej programeve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit (MBU) që lidhen me skemat e mbjelljes së ullinjve, ujitjen dhe kullimin, skemat e mbështetjes së bujqësisë, sigurinë ushqimore, konsolidimin e tokës etj. Por pas një ecurie pozitive në vitet e para, roli i QTTB-ve u zbeh vit pas viti derisa ato nuk e kryejnë dot misionin që u është ngarkuar dhe duket sikur kanë dalë jashtë funksionit. Në këto kushte, QTTB-të kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme si:

1. Orientimi i qartë i tyre drejt nevojave të tregut dhe përcaktimi i prioriteteve të kërkimit dhe transferimit të teknologjive në bashkëpunim me UBT, organizatat e fermerëve, agrobiznesit, strukturat lokale, donatorët etj.

2. Rishikimi i statusit dhe mekanizmave të financimit që lejojnë fleksibilitet në:
 - a) Implementimin e projekteve;
 - b) Përfshirjen në projekte të përbashkëta me departamentet e universiteteve dhe aktorëve të tjerë;
 - c) Aplikimin e incentivave mbi bazën e performancës, ngarkesës dhe rezultateve për çdo ekspert të përfshirë në projekt;
 - d) Rritja e kapacitetit demonstrues të rezultateve dhe testimit të teknologjive të reja.
3. Përcaktimi i rolit të QTTB-ve dhe hartimi i programeve afatgjata në punën përzgjedhëse të materialit mbjellës autokton dhe skemat e prodhimit të hallkave të larta, veçanërisht për produkte tipike dhe me vlerë të lartë ekonomike, produkte organike etj.
4. Mbështetja logjistike me pajisje laboratorike, makineri bujqësore, kompjuterë, teknologji informacioni etj.
5. Përcaktimi i instrumenteve dhe zbatimi i procedurave të vlerësimit të ndikimit.

Një ndër problematikat më të theksuara të QTTB-ve është mos parashikimi i ndikimit financiar të një projekti, ndaj edhe trajnimet e stafit në këtë aspekt duhet të jetë prioritet absolut.

Duhet theksuar se profili i QTTB-ve duhet të ecë fort në rrugën e konsolidimit si qendra model të demonstrimit të teknologjive të reja në bujqësi e blegtori.

Trendi i sotshëm i një bujqësie moderne është krijimi i Shërbimeve Këshillimore Rurale, të cilat janë një urë lidhëse midis kërkimit, edukimit dhe fermerëve. Lëvizja BASHKË do të synojë ngritjen e këtyre strukturave duke marrë shembull nga vende me bujqësi shumë të zhvilluar si Spanja, Itali dhe Franca. Në krahun tjetër, një koordinim më efikas midis UBT dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit do

të jetë kyç për hartimin e një strategjie afatgjatë për nxjerrjen nga metodat primitive dhe modernizimin e sektorit bujqësor.

Në kushtet e vendit tonë çdo kërkim i aplikuar duhet të rezultojë në formën e paketave teknologjike të thjeshta, të qarta, të asimilueshme, shoqëruar këto me udhëzime dhe ilustrime praktike.

Hapat që duhen ndjekur për transferimin e këtyre paketave tek Shërbimi i Këshillimit Bujqësor:

a) Qasja “Trajnuesi i Trajnuesve”; përcimi i informacionit mbi paketat nga ekspertët që i kanë hartuar tek ekspertët e rinj pranë agjencive të këshillimit.

b) Zbatimi në ferma model i këtyre paketave.

c) Në rast suksesi, transferimi në masë të gjërë.

Shërbimi Statistikor

Statistikat e bujqësisë luajnë një rol thelbësor në zhvillimin e një vendi, pasi qeveria bazohet në këto të dhëna për formulimin e programeve dhe politikave të caktuara për zhvillimin e sektorit bujqësor. Ato japin një informacion të detajuar mbi aktivitetet bujqësore në Shqipëri, për sipërfaqen e mbjellë, sipërfaqen prodhuese, sipërfaqe të vjelë, prodhimin, numrin e rrënjëve të drufrutorëve gjithsej dhe në prodhim, si dhe rendimentin sipas kulturave bujqësore. Gjithashtu japin informacion mbi produktet organike të certifikuara, mjetet mekanike të përdorura dhe ujitjen e tokës.

Të dhënat e sektorit bujqësor ngrenë hije të forta dyshime për shifra të ekzagjeruara, sidomos të dhënat makro. P.sh. fakti se sektori bujqësor kontribuon me rreth 18.5% të PBB duket e pabesueshme kur e krahason me vendet e rajonit pasi vlera totale (në USD për

efekte krahasimi) është disa herë më e lartë se e vendeve fqinje, madje më e lartë se Bullgaria, Sllovenia e Kroacia që janë pjesë e BE-së. Grafiku i mëposhtëm na jep një panoramë më të saktë mbi këtë çështje:




Figura 3: Kontributi i sektorit bujqësor të vendeve të rajonit në vitin 2022 (Burimi: www.worldometers.info)

Meqenëse bujqësia zë rreth 18.5% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) në Shqipëri, sipas të dhënave në Worldmeter, PBB e Shqipërisë në vitin 2022 ishte 18,882,095,518 USD.

Pra kontributi i bujqësisë për Shqipërinë është:

$18,882,095,518 \times 0.185 = 3.493$ miliardë USD.

Siç shihet, e vetmja e renditur sipër nesh në rajon është Serbia me një vlerë rreth 3.81 miliardë USD. Bullgaria, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Sllovenia, Kosova dhe Mali i Zi renditen poshtë nesh. Por perceptimi është krejt tjetër. Ndaj edhe duhet kryer një studim i vërtetë dhe serioz mbi rolin e bujqësisë në ekonominë shqiptare.

Nga ana tjetër, shërbimi statistikor është mjaft i lidhur dhe i ndërruar nga Shërbimi i Këshillimit Bujqësor. Këshillimi Bujqësor nuk duhet të ngarkohet plotësisht me detyrat e mbledhjes së statistikave, pasi këto zënë një përqindje mjaft të madhe të kohës së këshilluesit dhe cenojnë ndjeshëm detyrën kryesore të tij. Duke e ngarkuar këshilluesin bujqësor me të dhëna statistikore, as këto të fundit

nuk do jenë të sakta e as këshilluesi nuk do të ketë kohën e mjaftueshme për t'iu dedikuar këshillimit të fermerëve.

Ndihma në inpute, makineri dhe infrastrukturë

Ndër problematikat më të mëdha që fermerët shqiptarë hasin janë çmimet e larta të inputeve bujqësore, mekanizimi shumë i dobët dhe mangësi në mungesën e infrastrukturës ujitëse dhe kulluese. Pavarësisht se sistemi i kaluar la si trashëgimi uzina kur prodhoheshin fertilizantë kimikë, preparate për luftimin e sëmundjeve, qindra rezervuare për vaditje, vepra të mëdha të kanaleve vaditëse dhe kulluese, fatkeqësisht këto vepra nuk u mirëmbajtën dhe shumë prej tyre dolën jashtë funksionit.

Inputet Bujqësore

Përpara ndryshimeve rrënjësore që pësoi vendi ynë me rrëzimin e regjimit diktatorial, ishin në funksionim dy fabrika të mëdha të prodhimit të plehrave kimikë; Azotiku i Fierit dhe Superfosfati i Laçit. Këto fabrika mbulonin nevojën e fermave dhe kooperativave për plehra kimikë. Me daljen e tyre jashtë funksionit, këto preparate importohen nga vende të tjera duke sjellë kështu një rritje të lartë të kostos. Për më tepër, jo pak herë firmat e tregtimit të inputeve bujqësore janë akuzuar për fiksimin të çmimit në situatë monopoli apo edhe për cilësi të dobët të tyre. Shpeshherë në treg gjenden edhe preparate kimike të ndaluara si nga ligjet e BE edhe nga ato të vendit tonë. Kjo rrit rrezikun për sigurinë ushqimore të popullsisë, por edhe vështirësi në eksport, pasi rezultatet e dala nga analizat laboratorike nuk janë të përshtatshme për eksport. Këshillimi bujqësor është shumë i dobët për preparatet e ndaluara, ndaj edhe fermerët nuk janë të informuar për to, duke i aplikuar shpesh herë pa vetëdi-

je (sidomos të produktet për eksport). Në krahun tjetër, inspektorët përgjegjës për kontrollin e pikave të shitjes së preparateve kimike korruptohen nga pronarët e këtyre të fundit apo nuk ndërhyjnë për shkak të lidhjeve të forta të tyre me pushtetin.

Një tjetër problem është mungesa e farave me prodhimtari të lartë. Pas ndryshimit të sistemit, institucionet kërkimore e kishin thuar se të pamundur të rivalizojnin me kompanitë private për shërbimin e farave të gjeneracionit të lartë. Kjo solli pothuajse shkrirjen e këtij shërbimi nga shteti. Sot fermerët në mungesë të farës vendase i drejtohen kompanive të inputeve duke blerë jo pak herë farëra hibride (që nuk prodhojnë më vitin e dytë), apo farëra të cilësisë së ulët.

Në të dyja rastet, kur shteti nuk e ofron dot shërbim e duhur, duhet patjetër të kontrollojë tregun për të evituar rastet e sipërpërmendura; si të fiksimit të çmimeve dhe të kontrollit të cilësisë. Ndër politikat që Lëvizja BASHKË propozon për zgjidhjen e kësaj pengese janë:

1. Kontrolli i tregut nga abuzimet me çmimet dhe me cilësinë.
2. Nxitja e krijimit të SHBB-ve të inputeve bujqësore nga vetë fermerët
3. Nxitje e kompanive për ndërtimin e fabrikave të prodhimit të inputeve bujqësore në vend (nëse është e leverdishme).

Mekanizimi i bujqësisë

Mekanizimi i bujqësisë është një faktor që e mbështet rritjen e rendimentit të punës nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër është mjeti më universal efikas për zbatimin e kërkesave agroteknike shken-core. Të dy këta faktorë të bashkërenditur bëjnë të mundshme që në të njëjtën kohë të ndikojnë në rritjen e rendimentit dhe cilësisë së prodhimeve bujqësore

dhe në uljen e kostos prodhuese. Në Shqipëri ka pak më shumë se 23 mijë makineri bujqësore për rreth 350 mijë ferma bujqësore (0.05 traktorë për fermë). Shqipëria renditet në vendet me një mekanikë më të ulët bujqësore në rajon. Për krahasim, në Serbi janë të regjistruara 631 mijë ferma bujqësore që zotërojnë rreth 403 mijë traktorë me dy akse (0.7 traktorë për fermë). Në Maqedoni ka rreth 171 mijë ferma, me 0.5 traktorë për fermë. Pra investimet në mekanikë bujqësore janë një domosdoshmëri për zhvillimin dhe rritjen e konkurrueshmërisë së bujqësisë shqiptare.

Situata përkeqësohet kur edhe këto pak traktorë shpërndahen në mënyrë të padrejtë te funksionarët e partisë në pushtet, duke lënë kështu në mëshirë të fatit me qindra bujq.

Lëvizja BASHKË propozon ndihmën me subvencione direkte për blerjen e makinerive bujqësore, dhe gjithashtu do të nxisë krijimin e Parqeve Mekanike në formën e SHBB-ve nga vetë fermerët.

Infrastruktura vaditëse dhe kulluese

Si ujitja dhe kullimi kanë një ndikim të veçantë dhe të drejtpërdrejtë në prodhimin bujqësor. Ujitja e bimëve është vërtetuar se sjell një rritje eksponenciale të rendimentit. Në krahun tjetër, një infrastrukturë kulluese eficiente mund të shpëtojë sipërfaqe të tëra nga përmytjet dhe për pasojë nga humbja e prodhimit bujqësor.

Siç u përmend më lart, vendi ynë trashëgoi nga sistemi i kaluar një numër të konsiderueshëm veprash ujore. Të gjitha këto vepra do të duhet të studiohen dhe të rehabilitohen aty ku është e mundur dhe e efektshme ekonomikisht. Rehabilitimi i digave të rezervuarëve duhet të kryhet me urgjencë në tokat me prodhimtari të lartë. Kanalet e kullimit duhet të pastrohen dhe rehabilitohen.

Në të njëjtën kohë, për parandalimin e përmytjeve duhen ndërmarrë masa komplementare si: frenimi i shpyllëzimit dhe pyllëzimi i tokave për mbrojtjen nga erozioni, ndalimi i gërryerjes së lumenjve për përfitim inertesh, rehabilitimi dhe ndërtimi i argjinaturave mbrojtëse, futja në funksion të plotë e hidrovorëve etj.

Një problematikë tjetër është edhe menaxhimi i veprave ujore të cilat u transferuan në vitin 2015 nga administrimi i Ministrisë së Bujqësisë te Bordet Rajonale të Kullimit. Funksionet dhe detyrat kryesore të këtyre të fundit (Bordeve Rajonale të Kullimit Lezhë, Durrës, Fier dhe Korçë) janë reduktuar dhe lidhen kryesisht me shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve kryesore kulluese, hidrovorët, kanalet kryesorë të rreth 22 skemave të mëdha ujitëse, përfshirë edhe 7 rezervuarë të mëdhenj dhe veprat e mbrojtjes nga përmytjet (argjinatura lumore dhe detare si dhe kanalet e ujërave të larta), ndërsa pjesa tjetër e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit i është transferuar në pronësi 61 bashkive. Ky mish-mash sjell burokraci të mëdha të menaxhimi i burimeve ujore, pasi shpesh herë problemet e hasura kërkojnë ndërhyrje si nga pushteti lokal edhe nga Bordet Rajonale të Kullimit.

Tjetër problematikë është përdorimi i ujit të rezervuarëve nga HEC-et; uji kalon fillimisht në HEC, i cili e shfrytëzon ujin për energji duke sjellë edhe rënien e nivelit të tij në rezervuar. Këto HEC-e de jure kanë kufizime për përdorimin e ujit në periudhë (p.sh. nuk lejohet gjatë thatësirave në verë) dhe në sasi, por de facto këto rregulla nuk zbatohen.

Lëvizja BASHKË do të propozojë kalimin e të gjithë infrastrukturës vaditëse nën një institucion si Bordi Kombëtar i Kullimit dhe Vaditjes për të zgjidhur ngërçet që lindin nga burokracitë dhe paqartësia se cili institucion duhet të ndërhyjë për zgjidhjen e problemit. Në krahun tjetër,

duhet rritur patjetër sipërfaqja e vad-itshme. Metodatat moderne të ujitjes, të cilat maksimizojnë efektin e ujitjes dhe kursejnë ujin duhen subvencionuar nga shteti.

Sektori i industrisë agro-përpunuese

Inxhinieria agro-ushqimore është një hallkë shumë e rëndësishme e zinxhirit vertikal të sektorit bujqësor. Industria e agro-përpunimit të ushqimeve, edhe pse ka potencial për t'u zhvilluar më tej, sidomos në prodhimet bujqësore, kishte një vlerë prodhimi prej 559 milionë euro në vitin 2020, dhe duke marrë në konsideratë ritmet e rritjes ekonomike të vitit 2021 me 8.5%, vlera e prodhimit i ka kaluar të 600 milionë eurot në një vit. Nga viti 2015 deri në 2020, vlera e prodhimit në agro-industri është rritur me 21.6%, ndërkohë që numri i punonjësve zyrtarisht është rritur me vetëm 9%. Të dhënat zyrtare tregojnë se produktiviteti në këtë degë të bujqësisë është rritur më shumë se numri i punonjësve. I gjithë sektori i agro-industrisë punëson rreth 13 mijë punonjës me rritje të numrit me 4.4% në katër vitet e fundit.

Industria agro-ushqimore zë rreth 4% të PBB-së, por pjesa më e madhe e saj dominohet nga prodhimi i bukës, një produkt jetik për shqiptarët që ende gjen konsum masiv. Sipas të dhënave zyrtare nga Ministria e Bujqësisë, në vitin 2020, numëroheshin gjithsej mbi 2400 biznese, por 56% e tyre operojnë në prodhimin e bukës. Ndërsa 12.7% e subjekteve operojnë në prodhimin dhe përpunimin e qumështit dhe produkteve të tij dhe në sektorin e prodhimit të vajit operojnë 7.7% e ndërmarrjeve. Ndërmarrjet agro-ushqimore janë të përqendruara kryesisht në Tiranë (31%), Fier (12%) dhe në Durrës (10%). Numri më i lartë i të punësuarve në industrinë agro-ushqimore ishte në Tiranë (34.8%), e ndjekur nga Durrësi (14.6%) dhe Elbasani (9.5%).

Megjithëse kjo industri ka bërë hapa përpara, nuk është realizuar siç duhet lidhja e saj me prodhimin në fushë. Siç dihet, rrethet më prodhuese në bujqësi janë Fieri, Lushnja, Beratit dhe Korça, por shpërndarja e ndërmarrjeve të përpunimit është më e madhe në Tiranë, Fier e Durrës. Shpeshherë fermerët detyrohen të hedhin produktin në kanal pasi nuk kanë mundësi për ta magazinuar apo përpunuar atë për shkak të mungesës së dhomave frigoriferike dhe fabrikave të përpunimit, ose sepse këto të fundit (rasti i blegtorëve të qumështit) ja u marrin me një çmim shumë të ulët.

Në këtë rast, lind nevoja e shoqërimit të zonave produktive me ndërmarrje moderne të përpunimit të produkteve bujqësore. Mund të merren plot shembuj: ngritja e fabrikave të salcës për të shfrytëzuar tepricën e domateve, ngritja e fabrikave të marinadave dhe turshive për perimet, ngritja e fabrikave të ullirit të tavolinës të cilat ndryshe nga ato të vajit të ullirit janë fare të pakta, ngritja e pikave të tharjes së qepës, hudhrës etj.

Lëvizja BASHKË do të nxisë ndërtimin e ndërmarrjeve agro-ushqimore aty ku mungojnë dhe do të rregullojë tregun e shit-blerjes së produkteve ushqimore me ngritjen e bursës së këtyre produkteve, apo krijimin e portaleve për tregtimin me shumicë të tyre. Në këtë mënyrë, ndërmarrjet që abuzojnë me çmimin do të kenë konkurrencë të lartë dhe do të duhet të japin një çmim më të denjë për produktet bujqësore. Me rëndësi të veçantë, do të trajtohet ngritja e industrisë agro-përpunuese në formën e SHBB-ve nga vetë fermerët. Në këtë mënyrë, do të rritet vlera e shtuar e produktit dhe do të sigurohet një cilësi dhe siguri më e lartë e ushqimeve. Në fokus do të jetë edhe certifikimi si i ndërmarrjeve dhe i fermave me standardet e BE-së dhe do të kenë prioritet prodhimi i produkteve organike.

E gjitha kjo do të shoqërohet me një marketing agresiv të ndihmuar nga shteti shqiptar për hapjen e tregjeve të reja. Marketingu dhe shitja e produkteve bujqësore brenda dhe jashtë vendit është po aq jetik sa rritja e prodhimit pasi pa siguruar tregun e shitjes, produktet do të ngelin stok. Shembujt më të mirë vijnë nga Italia dhe Spanja, të cilat kanë punuar fort me emërtimet (markat) e mbrojtura dhe me produktet e mbrojtura të origjinës.

Sigurimi i prodhimit bujqësor

Fermerët në të gjithë Shqipërinë janë shumë të prekur nga ndikimi i kushteve klimatike. Thatësirat e stërzgjatura dhe rrebeshet e breshrit kanë efekte shumë negative në kulturat bujqësore, duke ulur ndjeshëm prodhimin dhe rritur dëmin ekonomik. Fatkeqësisht, fenomene të tilla kanë qenë të shpeshta dhe ndërhyrja e shtetit ka qenë thuajse minimale, për të mos thënë inekzistente.

Lëvizja BASHKË ka në programin e saj zhvillimin e një programi sigurimi të prodhimit bujqësor në shkallë vendi për të mbështetur fermerët në uljen e rrezikut ndaj faktorëve klimatikë (përmbrytjeve, thatësirës, breshrit, ngricës) dhe për të mbrojtur investimet e tyre. Fillimisht do të prezantohet një program pilot për një grup kulturash bujqësore, e më pas do të shtrihet në të gjitha kulturat e tjera. Siguracioni do të mbulojë humbjet, prej së cilës, në vitet e para deri në konsolidimin e programit, 50% do ta paguajë shteti dhe 50% kompania siguruese. Shembulli për t'u ndjekur është Kosova, ku kjo praktikë po zbatohet me efikasitet.

IV. Implementimi

Ashtu siç u shtjellua më sipër, sektori bujqësor po bën regres dhe problemet janë të shumta; duke filluar që nga pronësia e

tokës, parcelat e vogla për familje, infrastruktura e dobët kulluese dhe vaditëse, mospasja e një strategjie për mbjelljen e kulturave bujqësore në zona të caktuara, mosmbështetja e duhur e blegtorëve dhe fermerëve me subvencione, këshillimi i dobët nga ana e këshilluesve të institucioneve shtetërore, përthithja e ulët dhe abuzimet me fondet IPARD, fiksimi i çmimeve nga pikat e grumbullimit, mekanizimi i ulët, mungesa e industrisë përpunuese afër zonave me prodhim të lartë bujqësor, sigurimi i prodhimit etj.

- Lëvizja BASHKË do ta konsiderojë bujqësinë si një sektor strategjik i cili duhet mbështetur me të gjitha forcat dhe buxheti i dedikuar duhet të shkojë rreth 5%, me një dedikim 70-80% për mbështetje direkte në formën e subvencioneve për të arritur vendet e rajonit.
- Pronësia e tokës; rreth 60% e fermerëve shqiptarë nuk zotërojnë certifikatë pronësie, ndaj pronësia e tokës do të jetë një ndër pikat kryesore, pasi moszgjidhja e kësaj problematike do të sillte dështimin e cilësdo politikë për zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.
- Do të ngrihet një grup pune për nxitjen e kooperimit të fermerëve dhe formimin e SHBB-ve, e cila do të zgjidhte problematikën e parcelave të vogla familjare. Do të ngrihet një projekt pilot, me ekspertët më të mirë vendas dhe të huaj për plotësimin e kuadrit ligjor dhe këshilluesish për fermerët. Politikat fiskale duhet të nxisin kooperimin duke e çuar në zero tatimin mbi fitimin dhe për të subvencionuar më fort fermerët që bashkëpunojnë sesa fermerët individualë për të formuar në një rajon prodhues disa forma SHBB si: SHBB grumbulluesish, SHBB përpunuesish dhe marketingu, SHBB inputesh dhe SHBB për mekanikën bujqësore.

Vetëm me bindjen e fermerëve se bashkëpunimi do të rrisë prodhimtarinë dhe të ardhurat, mund të ketë sukses politika e bashkëpunimit.

- Do të ushtrohet një kontroll i fortë në Pikat e Grumbullimit për të minimizuar abuzimet. Fermerëve do t'u mundësohen dhoma frigoriferike me çmim të ulët dhe prodhimet e tyre do të blihen nga institucionet shtetërore. Do të barazohet TVSH si në hyrje (shitje nga fermeri) dhe në shitje nga grumbulluesi.
- Do të ngrihet Bordi Kombëtar i Kullimit dhe Vadtjes duke marrë nën përgjegjësi këto sisteme. Do të investohet në riparimin e digave të rezervuarëve dhe pastrimin e tyre, në ngritjen e argjinaturave të lumenjve për të evituar përmbytjet, në pastrimin dhe riparimin e kanaleve kulluese dhe vaditëse.
- Do të investohet fort në stafin e këshilluesve bujqësorë, ku këshilluesit duhet të trajnohen mbi programet e skemës kombëtare dhe fondet IPARD për të këshilluar fermerët sesi të aplikojnë dhe veçanërisht në planet e biznesit dhe impaktin financiar. Trendi i këshillimit do të jetë i drejtuar nga kërkesa dhe i orientuar nga tregu. Do të krijohen manualë praktikë për t'iu shpërndarë fermerëve dhe agro-përpunuesve për teknologjitë, standardet dhe planifikimin e investimeve. Do të nxitet bashkëpunimi midis UBT dhe QTTB-ve për të nxitur kërkimin shkencor dhe aplikimin e teknikave dhe teknologjive të reja në ferma. Më tej, do të përcaktohet një hartë e produkteve bujqësore, ku sipas cilësisë së tokës dhe klimës do të rekomandohen dhe subvencionohen më tepër vetëm një/disa lloje kulturash bujqësore.
- Do të nxitet krijimi i një fabrike inpuresh bujqësore, e cila do të sig-

uronte plehra kimikë dhe preparate kimike të cilësisë së lartë, në përputhje me rregulloren e BE-së dhe me çmime më të ulëta se ato të importit. Kjo do të evitonte edhe situatën e monopolit të shitjes së këtyre preparateve jetike për bujqësinë.

- Sigurimi i prodhimit nga fatkeqësitë natyrore si përmbytjet, breshëri dhe thatësitë e tejzgjatura.
- Ndërhyrja e shtetit në sigurimin e kontratave të produkteve bujqësore për SHBB-të. Nxitja me subvencione dhe këshillim e bujqësisë organike dhe e certifikimeve me Praktikat e Mira Bujqësore (GAP), HACCP etj., për eksportet jashtë vendit e sidomos në BE.

V. Kostot financiare

Buxheti total i Republikës së Shqipërisë për vitin 2024 është 735.9 miliardë lekë

Buxheti aktual për bujqësinë: 14.8 miliardë lekë = 0.02 (2%)

48% shpenzime kapitale (mbështetje direkte)

52% shpenzime korrente (për administratën)

Lëvizja BASHKË planifikon një rritje të përshkallëzuar të buxhetit deri në 5% në vitin e katërt sipas shkallës së mëposhtme:

Viti 1 – 2.5% : 0.025×735.9 miliardë lekë = 18.4 miliardë lekë

Viti 2 – 3.0% : 0.03×735.9 miliardë lekë = 22.1 miliardë lekë

Viti 3 – 4.0% : 0.04×735.9 miliardë lekë = 29.4 miliardë lekë

Viti 4 – 5.0% : 0.05×735.9 miliardë lekë = 36.8 miliardë lekë

Deri në vitin e katërt raporti i mbështetjes direkte për fermerin me shpenzimet për administratën do të shkojnë në raportin e mëposhtëm:

70% shpenzime kapitale (mbështetje direkte).

30% shpenzime korrente (për administratën).

1.3 NDËRTIMI, INFRASTRUKTURA DHE ENERGJIA

1. Gjendja e sektorëve

Bazuar në të dhënat e INSTAT për vitin 2023 shihet qartë se sektori i ndërtimit dhe i pasurive të paluajtshme ka ndikuar në rritjen e përgjithshme të PBB gjatë vitit 2023 krahasuar me vitin 2022. Peshë e sektorit të ndërtimit në PBB në vitin 2023 ishte 10.2%, ndërsa ajo e sektorit imobiliar 6%. Pra në total këto dy sektorë kanë pasur një peshë prej 16.2% në PBB e vitit 2023.

Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në rritjen e shpejtë dhe ndikimin në këtë masë të këtyre dy sektorëve të ndërlidhur mes tyre janë si vijon: Shtimi me ritme shumë të shpejta i ndërtimeve të objekteve rezidenciale (veçanërisht në Tiranë), pastrimi i parave të krimit të organizuar dhe korrupsionit, vazhdimi i pafundmë i procesit të rindërtimit si pasojë e tërmetit, turizmi nëpërmjet ndërtimit të hoteleve dhe komplekseve rezidenciale, blerjet e të huajve kryesisht në zonat turistike, investimet në sektorin e komunikacionit e veçanërisht në rrugë.

Si sektori i ndërtimit dhe ai i pasurive të paluajtshme në vitin 2023 pësuan rritje të ndjeshme për të dytin vit radhazi dhe, nëse u referohemi të dhënave paraprake të INSTAT-it për vitin 2024 dhe vitin 2025, rritja vazhdon akoma. Rritja ka filluar në vitin 2019, por, siç raporton revista Monitor, në 2023 është arritur rekordi prej 1.3 miliardë euro transaksione bankare. Ndër faktorët kryesor që kanë çuar në këtë shifër janë: Shtimi i ndjeshëm i lejeve të ndërtimit, kanalizimi i parave informale si dhe blerjet e të huajve sidomos në zonat turistike.



Figura 4: (Burimi i të dhënave INSTAT)

Në grafikun e mësipërm duket qartë se sektori i ndërtimi ka favorizuar dhe prioritetizuar ndërtesat përballë investimeve në infrastrukturë.

Pavarësisht se sektori imobiliar dhe ai i ndërtimit kanë njohur rritje të vazhdueshme vitet e fundit, paga mesatare bruto vjetore është rritur mesatarisht me vetëm 2050 lekë. Ky sektor ka mbi 100,000 të punësuar.

Disa nga efektet negative që ka sjellë kjo shpërndarje e pabarabartë e lejeve të ndërtimit janë:

- **Mbipopullimi i zonave të caktuara veçanërisht në Tiranë dhe në zonat turistike bregdetare.**

Po t'u referohemi të dhënave që ka nxjerrë vetë Bashkia e Tiranës në raportet PBA të periudhës 2024-2026, mbipopullimi duket qartë, veçanërisht në pjesën e qytetit në njësitë administrative 1-11.

	Sipërfaqja (Km ²)	Dendësia (Banorë/ Km ²)
Njësia Administrative 1	3.06	16939
Njësia Administrative 2	9.58	8832
Njësia Administrative 3	2.01	22978
Njësia Administrative 4	4.92	13480
Njësia Administrative 5	2.87	30835
Njësia Administrative 6	5.48	12978
Njësia Administrative 7	3.06	25648
Njësia Administrative 8	1.95	21312
Njësia Administrative 9	2.82	23296
Njësia Administrative 10	0.77	35808
Njësia Administrative 11	5.21	12517
Mesatare Njësitë 1-11		16465

Figura 5: (Burimi të dhënave PBA 2024-2026 Bashkia e Tiranës)

Për të kuptuar mbipopullimin në këto zona mjafton të mendojmë që në Gazën e paraluftës dendësia ishte 6500 banorë/km².

- **Infrastrukturë rrugore e pamjaftueshme**

Kjo shpërndarje e pabarabartë ka bërë që sot Shqipëria të jetë shumë mbrapa BE, por edhe vendeve të rajonit në infrastrukturën komunikuese mes qyteteve dhe mes qyteteve e fshatrave. Sipas të dhënave të botuara nga Eurostat në 2023, Shqipëria është vendi i fundit në rajon për gjatësi totale rrugësh për sipërfaqe.




Figura 6: (Burimi të dhënave EUROSTAT)

Jo vetëm gjatësia e rrugëve, por edhe cilësia e tyre lë për të dëshiruar. Sipas të dhënave të INSTAT-it, gjatë vitit 2023 në Shqipëri janë shkaktuar 1285 aksidente ku shpesh herë shkaku ka qenë cilësia e dobët e standardeve të projektimit e realizimit të punimeve. Gjithashtu kur flitet për rrugët nuk mund të lihet pa përmendur edhe kostoja e ndërtimit dhe e mirëmbajtjes së tyre.

- **Sistemi furnizimit me ujë dhe sistemi i kanalizimeve nuk mund të përballojë këtë ndryshim të menjëhershëm të dendësisë së ndërtimeve dhe popullsisë.**

Qarku	Nr.	Qyteti	Furnizimi me uje				Kanalizimet				ITUN		
			Popullsia qe ka f.u		Linjat		Oret e f.u	Popullsia qe ka kanalizime		Linjat		PO/JO	Sa %
			Qytet	Fshat	Reja	Vjetra		Qytet	Fshat	Reja	Vjetra		
Berat	1	Berat	97%	32%	31%	69%	22.6	84%	8%	1%	99%	JO	0
	2	Skrapar	100%	87%	16%	84%	16--17	98%	16%	9%	91%	JO	0
	3	Polican	78%	43%	26%	74%	24	100%	41%	33%	67%	JO	0
	4	Dimal	81%	31%	82%	18%	9--13	76%	0%	6%	94%	JO	0
Diber	1	Klos	100%	41%	97%	3%	7--12	57%	2%	66%	34%	JO	0
	2	Mat	100%	69%	61%	39%	8--22	100%	4%	34%	66%	JO	0
	3	Bulqize	100%	79%	78%	22%	9--11	43%	3%	0%	100%	JO	0
	4	Diber	95%	90%	70%	30%	5--21	88%	0%	38%	62%	JO	0
Durrës	1	Kruje	49%	51%	75%	25%	10--15	29%	0%	90%	10%	JO	0
	2	Durres	98%	93%	80%	20%	13	80%	10%	47%	53%	PO	59%
Elbasan	1	Belsh	85%	64%	57%	43%	6.7	30%	12%	0%	100%	JO	0
	2	Cerrik	94%	60%	80%	20%	21.8	94%	0%	0%	100%	JO	0
	3	Gramsh	94%	81%	67%	37%	24	0%	0%	0%	0%	JO	0
	4	Librazhd	100%	10%	59%	41%	24	97%	1%	66%	34%	JO	0
	5	Elbasan	95%	34%	77%	23%	13.5	95%	0%	3%	97%	JO	0
	6	Peqin	77%	53%	71%	29%	18--22	69%	2%	0%	100%	JO	0
Fier	1	Mallakaster	100%	69%	56%	44%	8--10	75%	0%	83%	0%	JO	0
	2	Roskovec	69%	44%	86%	14%	8.8	72%	16%	0%	100%	JO	0
	3	Patos	55%	41%	26%	74%	11--17	35%	28%	2%	98%	JO	0
	4	Fier	90%	61%	86%	14%	7--24	97%	7%	22%	78%	JO	0
	5	Divjake	100%	48%	96%	4%	6--11	0%	0%	0%	0%	JO	0
	6	Lushnje	63%	95%	65%	35%	10--13	53%	11%	10%	90%	JO	0
Gjirokastrë	1	Dropull	Pop.Q=0	95%	85%	15%	7	Pop.Q=0	2%	0	100%	JO	0
	2	Memaliaj	100%	29%	60%	40%	17.4	100%	1%	10%	90%	JO	0
	3	Libohove	100%	100%	41%	59%	21.5	0	0	0	0	JO	0
	4	Tepelene	100%	60%	35%	65%	20.3	100%	0%	8%	92%	JO	0
	5	Gjirokastrë	85%	51%	95%	5%	11--21	53%	0%	3%	97%	JO	0
	6	Permet	100%	92%	80%	20%	24	99%	43%	36%	64%	JO	0
	7	Kelcyre	50%	35%	73%	27%	22.2	0%	0%	0%	0%	JO	0
Korce	1	Kolonje	100%	100%	87%	13%	20--22	100%	64%	34%	66%	JO	0
	2	Devoll	100%	93%	100%	0%	21.2	0%	0%	0%	0%	JO	0
	3	Pustec	Pop.Q=0	55%	81%	19%	24	Pop.Q=0	24%	100%	0%	JO	0
	4	Maliq	84%	65%	48%	52%	17--19	79%	24%	No Data	No Data	JO	0
	5	Korce	100%	93%	96%	4%	24	97%	44%	74%	26%	PO	73%
	6	Pogradec	100%	75%	90%	10%	20.4	100%	20%	100%	0%	PO	55%
Kukes	1	HAS	100%	55%	100%	0%	8	0%	0%	0%	0%	JO	0
	2	Tropoje	100%	37%	91%	9%	21--23	84%	0%	62%	38%	JO	0
	3	Kukes	94%	40%	83%	17%	4--17	86%	18%	65%	35%	JO	0
Lezhe	1	Kurbin	62%	18%	59%	41%	2--3	55%	10%	0%	100%	JO	0
	2	Mirdite	96%	27%	68%	32%	15	94%	0%	0%	100%	JO	0
	3	Lezhe	100%	42%	86%	14%	22--24	100%	11%	25%	75%	PO	38%
Shkoder	1	M. e Madhe	100%	54%	82%	18%	17--21	25%	75%	8%	92%	JO	0
	2	Vau Dejes	78%	53%	85%	15%	12--16	13%	5%	36%	64%	JO	0
	3	Shkoder	84%	24%	34%	66%	21--23	80%	4%	21%	79%	PO	5%
	4	Fushe Arrez	100%	100%	77%	23%	24	47%	0%	0%	100%	PO	5%
	5	Puke	83%	20%	37%	63%	22--23	83%	0%	0%	100%	PO	5%
Tirane	1	Rrogozhina	64%	67%	74%	26%	7.6	20%	2%	93%	7%	JO	0
	2	Kavaje	61%	100%	77%	23%	10--11	60%	63%	69%	31%	PO	77%
	3	Vore	76%	54%	8%	92%	8	62%	28%	60%	40%	JO	0
	4	Kamez	75%	Pop.F=0	94%	6%	4	83%	Pop.F=0	9%	81%	JO	0
	5	Tirane	100%	95%	51%	49%	13--17	98%	72%	5%	95%	JO	0
Vlore	1	Saranda	99%	95%	94%	6%	24	97%	35%	19%	81%	PO	85%
	2	Delvine	98%	82%	45%	55%	8--24	73%	0%	5%	95%	Jo	0
	3	Finiq	Pop.Q=0	45%	100%	0%	21.4	Pop.Q=0	0%	100%	0	Jo	0
	4	Konispol	100%	100%	94%	6%	24	0%	0%	0%	0%	Jo	0
	5	Himare	92%	96%	16%	84%	19	57%	7%	60%	40%	JO	0
	6	Selenice	100%	66%	60%	30%	7.3	47%	20%	80%	20%	JO	0
	7	Vlore	100%	37%	40%	60%	12.3	81%	0%	37%	63%	PO	65%

Figura 7: (Burimi të dhënave AKUM)

Sipas të dhënave të AKUK-ut të 2022, vetëm katër qytete në Shqipëri furnizohen 24 orë me ujë në pothuajse gjithë sipërfaqen e tyre (qytet + fshat). Qytetet e tjera kanë ende probleme ku, përveç

mungesës së furnizimit 24 orë me ujë, edhe rrjeti i ujësjellësit nuk është i plotësisht i përditësuar duke mbajtur infrastrukturën e përpara viteve '90.

Po t'i referohemi të njëjtit burim të dhënash rreth sistemit të kanalizimeve dhe trajtimit të ujit të ndotur, asnjë qytet nuk është i pajisur plotësisht me sistem kanalizimesh dhe për më tepër asnjë qytet nuk ka impiant pastrimi që të mbulojë tërësisht qytetin. Mungesa e impianteve të pastrimit të ujërave të zeza ndikon drejtpërdrejt në ndotjen e lumenjve dhe deteve dhe për pasojë në shëndetin e popullsisë.

- **Prodhim i pamjaftueshëm i energjisë elektrike**

Drejtimi i investimeve kryesore jo në drejtim të infrastrukturës ka sjellë jo pak probleme edhe në sektorin e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.

	Viti								
	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
1 Prodhimi neto vendas(=1.1+1.2.13)	5,865,671.00	7,135,914.00	4,524,981.00	8,552,154.00	5,207,898.00	5,314,811.00	8,962,703.00	7,002,347.00	8,795,634.00
1.1 TEC	-	-	-	-	-	-	-	-	-
1.2 HEC (=a+b)	5,865,671.00	7,135,913.00	4,553,020.00	8,552,154.00	5,185,702.00	5,282,546.00	8,921,947.00	6,951,087.00	8,705,910.00
a. Publike	4,451,975.00	5,091,616.00	2,945,029.00	5,850,934.00	2,981,106.00	3,091,977.00	5,343,974.00	3,858,262.00	5,123,417.00
b. Prodhues Privat dhe koncensionar	1,413,696.00	2,044,297.00	1,607,991.00	2,701,220.00	2,204,596.00	2,190,569.00	3,577,973.00	3,092,825.00	3,582,493.00
% e prodhimit të energjisë publike	76%	71%	65%	68%	57%	59%	60%	56%	59%
1.3 Te tjere prodhues te energjise te rinovueshme	-	-	-	-	22,196.00	32,265.00	40,756.00	51,260.00	89,724.00
% e energjise se rinovueshme te prodhuar (diell/ere) krahasim totale	-	-	-	-	0.43%	0.61%	0.45%	0.73%	1.02%
2 Importi Bruto	2,355,358.00	1,826,753.00	3,403,043.00	1,771,740.00	3,176,515.00	3,238,681.00	2,252,548.00	3,043,533.00	1,921,743.00
3 Eksporti Bruto	955,941.00	1,868,605.00	488,415.00	2,685,045.00	770,480.00	963,027.00	2,800,443.00	2,122,527.00	2,841,555.00
Diferenca Imp-Exp	1,399,417.00	(41,852.00)	2,914,628.00	(913,305.00)	2,406,035.00	2,275,654.00	(547,895.00)	921,006.00	(919,812.00)
Raporti Eksport / Import	0.41	1.02	0.14	1.52	0.24	0.30	1.24	0.70	1.48
4 Humbjet ne rrjet	2,195,837.00	1,985,901.00	1,876,138.00	1,783,118.00	1,653,465.00	1,631,717.00	1,784,871.00	1,657,835.00	1,654,540.00
4.1 Humbjet ne rrjet ne %	37%	28%	41%	21%	32%	31%	20%	24%	19%
5 Konsumi	5,069,252.00	5,108,160.00	5,653,471.00	5,841,106.00	5,960,499.00	5,958,698.00	6,629,937.00	6,265,818.00	6,221,282.00
Diferenca Prodhim- Konsum	796,419.00	2,027,754.00	(1,128,490.00)	2,711,048.00	(752,601.00)	(643,887.00)	2,332,766.00	736,529.00	2,574,352.00

Figura 8: (Burimi të dhënave ERE)

Vlerat e paraqitura në tabelën e mësipërme janë marrë nga raportimet e ERE-s. Duke lexuar këto të dhëna dallohet qartë një paradoks: Edhe pse sot Shqipëria prodhon më shumë energji elektrike nga sa konsumon, në shumicën e rasteve sasia e energjisë së importuar është më e lartë se ajo e eksportuar.

Vlera e përfërt e investimeve në sektorin e ndërtimit në mln Lekë									
	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Total 2017-2023	Rritja mesatare vjetore 2017-2023
Ndërtesa rezidenciale dhe jo	37,157	48,108	70,784	57,902	80,439	97,768	80,976	473,134	35,506
Rritja mesatare vjetore në Lekë									37,506,000,000
Rritja e lejeve te ndertimit dhe siperfaqeve te ndertimit									
Leje Ndertimi	820.00	1,194.00	1,044.00	961.00	1,396.00	1,420.00	1,602.00	8,437	450
Siperfaqe ndertimi (m ²)	868,500	1,442,783	1,916,719	1,608,211	2,316,642	2,667,497	2,115,819	12,936,171	1,142,779
Rritja e pagave per punetoret ne sektorin e ndertimit									
Paga mesatare mujore bruto	44,015	43,475	42,292	41,532	44,949	51,025	58,367		2050
								Burimi: INSTA	

Figura 9: (Burimi të dhënave INSTAT)

III. Problemet kryesore

Ndonëse në rritje të vazhdueshme dhe pjesë e rëndësishme e PBB, sektori i ndërtimit dhe ai i pasurive të paluajtshme është plot me probleme funksionale dhe ekonomike që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme. Në vijim po rendisim problemet kryesore të këtij sektori.

1. Hyrja në treg dhe qarkullimi i parave të pista që vijnë nga burime të pakontrolluara.

2. Monopolizimi i tregut të ndërtimit nga disa ndërtues kryesore duke bërë thuajse të pamundur hyrjen në treg të subjekteve të reja.

Hyrja dhe qarkullimi në treg i parave të pista është faktori kryesor që ndikon në rritjen e çmimeve të apartamenteve dhe pronave në përgjithësi. Mungesa e konkurrencës së lirë në treg është një faktor tjetër që ndikon në rritjen e çmimeve. Duke qenë sektori i ndërtimit i përqendruar në pak duar, bëhet më e lehtë për ata ndërtues që e zotërojnë të mund të kontrollojnë tregun dhe paracaktojnë çmimet.

3. Abuzimet me fondet publike

Sipas një raporti të KLSH, 1 në 5 lekë humbet, pra 20% e fondeve publike të investuara vidhet dhe shpërdorohet nga ata që menaxhojnë tenderat, projektet dhe nga ata që zbatojnë punimet. Duke eliminuar këtë vjedhje do të krijohet mundësia për më shumë investime në sektorë të tjerë dhe përmirësuar cilësinë dhe kushtet e jetesës së qytetarëve.

4. Investimet në sektor në një drejtim shumë më dominant krahasuar me të tjerat: ndërtimi i objekteve rezidenciale në krahasim me ndërtimet në infrastrukturë e energji.

Fokusimi i ndërtimit në objektet rezidenciale, përveç mbipopullimit të zonave të caktuara dhe mbetjes pas të investimeve në sektorin e infrastrukturës dhe energjisë, sjell edhe disa probleme të mëdha në jetën e përditshme të qytetarëve. Dy më kryesoret janë trafiku i rënduar i cili, përveç vonesës që u krijon banorëve për të arritur në destinacion, shkakton edhe ndotje të vazhdueshme të ajrit dhe përmbytje në rast shirash pasi rrjeti ekzistues i kanalizimeve nuk arrin të përballojë shkarkimet e kaq shumë objekteve.

5. Kontratat dhe koncesionet me PPP

Kontratat koncesionare PPP në ndërtim janë fokusuar në dy drejtime kryesore: ndërtimi i autostradave dhe i HEC-eve të vegjël. Në të dyja këto raste përfitues kryesor nuk është as shteti as qytetarët, por ndërtuesi, si p.sh. në rastin e fundit të rrugës Thumanë-Kashar ku qytetarët do të detyrohen të paguajnë për kilometër më shumë se qytetarët e vendeve të rajonit dhe BE-së.

6. Mangësitë në manualet e çmimeve të ndërtimit

Për tetë vjet, 2015-2023, në Shqipëri nuk ka pasur përditësim të Manualit të Çmimeve të Ndërtimit. Kjo mungesë përditësimi ka mundësuar abuzime me deklarin e shpenzimeve, por edhe me vetë çmimet e realizimit të punimeve dhe cilësinë e tyre. Nga ana tjetër, sot nuk ka Manuale Projektimi e Zbatimi të përditësuar në Shqipëri, por detyrohemi të huazojmë Kode të Huaja projektimi.

7. Ligji i investimeve strategjike

Aktualisht janë dhënë afërsisht 60 leje për investime strategjike dhe këto kryesisht në sektorin e turizmit. Këtyre investimeve strategjike shteti u ka dhënë

afërsisht 580 ha tokë (5.8mln m²). Por pak syresh kanë të bëjnë me investime mirëfilli strategjike pasi pjesa më e madhe janë kryesisht komplekse vilash të cilat janë shitur pas ndërtimit të tyre dhe të vetmit përfitues kanë qenë ata që kanë ndërtuar.

8. Kushtet e punës të të punësuarve në sektorin e ndërtimit.

Kushtet e punës në sektorin e ndërtimit, veçanërisht për punëtorët specialistët e ndërtimit, janë skandaloze. Sipas të dhënave të Inspektoratit të Punës, numri i aksidenteve vjen në rritje gradualisht. Duhet theksuar që këto vlera nuk janë të sakta pasi një pjesë e madhe e aksidenteve në kantiere nuk deklarohen, por punëtorët dërgohen në spitale private pikërisht për të evituar deklarimin e aksidenteve.

Aksidente ne vendin e punes




Figura 10: (Burimi të dhënave INSTAT)

Pjesa më e madhe e këtyre aksidenteve kanë ndodhur në sektorin e ndërtimit.

Gjithashtu duhet theksuar se edhe profesionistët që punojnë në këtë sektor nuk janë kushtet më optimale të punës, pasi në shumicën e rasteve detyrohen të mbingarkohen dhe orët shtesë nuk u njihen sipas kërkesave të Kodit të Punës.

III. Alternativa e Lëvizjes BASHKË

Lufta ndaj qarkullimit të parave te pista që hyjnë nëpërmjet tregut të ndërtimit

Vitet e fundit dyshimi i futjes në treg e parave të pista duke shfrytëzuar sektorin e ndërtimit, sidomos në pjesën e ndërtimeve rezidenciale, është bërë gjithnjë e më i madh. Kjo praktikë ka sjellë jo vetëm rritjen artificiale të çmimit të banesave, por edhe forcimin fiktiv të lekut, duke dëmtuar ekonominë prodhuese dhe eksportet. Masat që propozojmë për të luftuar këtë fenomen janë si më poshtë:

1. Veting i të gjitha subjekteve ndërtuese në Shqipëri, të administratorëve/pronarëve të tyre si dhe investorëve.
2. Vetingu do të mundësonte kontrollin e ligjshmërisë së vënies së pasurisë së këtyre subjekteve/ individëve. Në rast shkeljesh të rënda të ligjit (përfshirjes në aktivitet të krimit të organizuar), pasuritë e këtyre subjekteve do të konfiskoheshin për interesin publik dhe do të shkonin për strehim social.

Ndalim i marrëdhënieve të kleringut në sektorin e ndërtimit mes investorëve dhe nënkontraktorëve.

Marrëdhënia e kleringut mes palëve në sektorin e ndërtimit ka tre efekte kryesore negative në ekonomi. Nuk lejon qarkullimin e plotë të parave për punë të realizuar duke ulur në këtë mënyrë nivelin e taksimit të investorëve dhe nënkontraktorëve. E dyta, u jep dorë të gjithëve të fillojnë një ndërtim rezidencial edhe pa pasur të ardhura sepse pagesa e punimeve fillestare në një pjesë të madhe të saj do të mbulohet nga marrëdhënia e kleringut. E treta dhe më e rëndësishmja, duke vendosur çmime

arbitrare/ fiktive kleringu, mundësia e qarkullimit të parave të pista dhe evazionit fiskal është shumë e madhe. Duke ndaluar marrëdhëniet e kleringut në ndërtim synohet të pastrohet sektori i ndërtimit nga abuzuesit dhe më gjerë pastrimi i ekonomisë nga qarkullimi i parave i të pista.

Eliminimi i monopolizimit të sektorit të ndërtimit

Sot sektori i ndërtimit është kapur në duart e një grupi të vogël kompanish ndërtimi të cilat kanë krijuar rrjetën e vet të lidhjeve dhe kontakteve për realizimin e punëve të caktuara, ku është e pamundur të hyjnë subjekte të reja me kapital të vogël. Përmes luftës ndaj pastrimit të parave, nxitjes së konkurrencës së ndershme dhe politikave të ndershme fiskale që ua lehtësojnë barrën fiskale grupeve të vogla të punëtorëve që kryejnë pjesë të punës në këtë sektor, Lëvizja BASHKË do ta çlirojë sektorin e ndërtimit nga monopoli i oligarkëve.

Lufta ndaj abuzimit me fondet publike

Abuzimi me fondet publike ka favorizuar subjekte ndërtuese dhe mbikëqyrëse punimesh nga njëra anë dhe ka dëmtuar shtetin dhe qytetarët nga ana tjetër. Objektet kryesore ndërtimore që realizohen sot me fonde publike janë rrugët dhe autostradat. Më të pakta janë investimet që realizohen në rrjetet inxhinierike (ujësjellës, kanalizime, ndriçim etj.). Dy janë arsyet kryesore që kanë mundësuar këto abuzime. E para është mungesa e kontrollit serioz të organeve dhe individëve që kanë qenë të përfshirë në procesin e kontrollit dhe përfshirja e tyre në skemën e abuzimit. E dyta është mungesa dhe hapësira që ka lënë vetë sektori i ndërtimit dhe MIE në realizimin e punimeve ndërtimore për objektet publike.

Për të luftuar abuzimin që bëhet me fondet publike dhe për të ndëshkuar abuzimin me fondet publike në sektorin e ndërtimit propozojmë të merren masat e mëposhtme:

1. Veting i të gjitha projekteve të realizuara me fonde publike dhe, në rastet ku vërehen abuzime, edhe të të gjithë aktorëve pjesëmarrës.

Propozojmë që radha e projekteve që do të kalojnë në veting të diktohet nga vlera e projektit. Në rastet ku do të vërehen abuzime me fondet e projekti, do të kontrollohen të gjithë aktorët që kanë qenë pjesë e projektit.

2. Përditësimi në mënyrë periodike i manualeve të çmimeve të ndërtimit.

Përditësimi i vetëm në dhjetë vitet e fundit është fokusuar kryesisht në aspektin ekonomik të zërave të punës ekzistues në manual duke shtuar shumë pak zëra të rinj në manual në krahasim me ato që nevojiten. Kjo mungesë e zërave të punës në manual dhe mungesa e përditësimit të çmimeve lënë të hapur një derë të madhe për abuzime në dy mënyra. E para, duke lëvizur me sasi të punimeve, por kjo gjatë procesit të vetingut është lehtësisht e kontrollueshme sepse pjesa më e madhe e punimeve të kryera janë aty dhe sasi mund të kontrollohen edhe tani. E dyta, duke manovruar me çmimet e punimeve që duhen kryer, por nuk janë parashikuar në situacion. Në mungesë të një manuali çmimesh të përditësuar, përcaktimi i çmimit mbetet në dorë të kompanisë zbatuese të punimeve e cila duhet të bëjë një analizë çmimi për këtë punim dhe në duart e mbikëqyrësit dhe entit që ka tenderuar projektin. Hapësira për marrëveshje në dorë është e mjaftueshme për të pasur dakordësi në abuzim. Duke pasur një manual çmimesh të përditësuar rregullisht, si në çmime dhe tipologji punimesh, kjo hapësirë

do të reduktohet sepse për çdo punim shtesë të paparashikuar në projekt do të kemi gati zërin e punës në manual.

Pasi të jetë hartuar manuali bazë që të përfshijë të gjitha punimet ndërtimore, çmimet në të do të përditësohen në një interval 1-vjeçar duke qenë gjithmonë sa më afër realitetit të tregut.

3. Qasje publike në manualet e çmimeve të ndërtimit

Ndryshe nga manualet e çmimeve të ndërtimit të vitit 2015 të cilat shkarkoheshin kollaj në format Excel, manualet e vitit 2023 gjenden vetëm në E-Albania dhe janë të aksesueshëm vetëm nga subjekte të pajisura me NIPT. Kjo gjë e bën të vështirë përdorimin e tyre nga persona që duan të bëjnë studime të ndryshme dhe nga ata që dyshojnë që në një projekt të caktuar ka pasur abuzime si gjatë fazës së projektimit, por dhe asaj të zbatimit. Gjithashtu lënia e manualeve të çmimeve të ndërtimit të aksesueshme do t'u krijonte lehtësira edhe qytetarëve që mendojnë të kryejnë riparime të vogla në shtëpi për të krijuar një ide se sa mund të shkojnë përafërsisht kostot e punimeve.

4. Standardizimi aty ku është e mundur i detajeve teknike për veprat publike kryesisht atyre të infrastrukturës

Kjo është një praktikë e përdorur në shumë vende të BE veçanërisht në Spanjë dhe në vendet Skandinave. Në qoftë se u referohemi rrugëve, detajet kryesore që diktojnë paketën e shtresave rrugore janë tipi i rrugës, bazamenti, sizmiciteti i zonës dhe ngarkesa e mjeteve që parashikohen të kalojnë në të. Duke standardizuar për aq sa të jetë e mundur paketën e shtresave rrugore në varësi të tipit të rrugës, bazamentit dhe ngarkesave që parashikohen të kalojnë në to, do të kemi të paktën tre përfitime kryesore.

- Do të ishte një lehtësi e madhe për kompanitë që merren me projektim.
- Më e rëndësishmja, kompanitë që duan të abuzojnë me punimet e nëntokës, ku është më e lehtë të abuzosh, do ta kishin thuajse të pamundur pasi do të ishin të detyruara të përdornin një paketë të caktuar shtresash. Në këtë mënyrë, përgjegjësia e drejtpërdrejtë do të binte mbi institucionet përgjegjëse për cilësinë e punimeve.
- Përmirësimi i ndjeshëm i cilësisë së punimeve rrugore.
- I njëjti parim mund të përdoret edhe për veprat e tjera infrastrukturore si ujësjellës, kanalizime etj.

Rritja e investimit në infrastrukturë

Sot në Shqipëri kemi një rrjet infrastrukturor të pamjaftueshëm edhe në rang kombëtar, edhe në zonat e mbi-populluara. Sot kemi akoma fshatra të lidhura me qytetin më të afërt me rrugë cakulli ose zhavorri, dhe ato në gjendje të mjerueshme, duke sjellë zbrazjen e tyre. Kemi zona urbane të mbipopulluara pa sisteme infrastrukturore funksionale, me trafik të mbirënduar, ujëra që marrin rrugët në rast shirash, mungesë korsish funksionale për emergjenca etj. Sot jemi vendi që konsumojmë më pak energji elektrike nga sa prodhojmë dhe prapëse-prapë importojmë më shumë nga ajo që eksportojmë. Sot kërkojmë me të drejtë nga hotelet dhe bizneset që të trajtojnë ujërat e ndotura përpara se t'i shkarkojnë në dete apo lumenj, por nga ana tjetër thuajse të gjitha qytetet e fshatrat e Shqipërisë i shkarkojnë ujërat e ndotura pa u trajtuar. Për të dalë nga ky realitet absurd do të duhet kohë, por nëpërmjet ndërhyrjeve me investime të caktuara situata do të mund të normalizohet pak nga pak.

1. Ndalimi i ndërtimeve industriale në zonat e mbipopulluara dhe rikonceptimi i rrjetit inxhinierik infrastrukturor në këto zona

Duke ndaluar ndërtimet rezidenciale në zonat e mbipopulluara dhe lejimin e tyre vetëm në zonat me përqendrim normal të popullsisë, do të kemi mundësi të studiojmë të gjitha defektet infrastrukturore në zonat e mbipopulluara. Të fokusohemi te zgjidhjet e problemeve të trafikut e ndotjes që vijnë prej tij. Të zgjidhet problem i mungesës së dedikuar të emergjencave dhe të transportit publik. Të zgjidhet problemi i furnizimit me ujë 24 orë për këto zona pa pasur nevojë për depozita individuale. Të zgjidhen problemet e lidhura me kanalizimet e ujërave të ndotura dhe të shiut.

2. Ndërtimi i korsive të dedikuara FUNKSIONALE për emergjencat dhe për transportin urban në të gjitha qytetet kryesore.

Sot në Shqipëri ekzistojnë *de jure* korsi të dedikuara emergjencash dhe të transportin publik, por shumë pak prej tyre janë realisht funksionale. Pasja e një korsie të dedikuar funksionale për emergjencat dhe transportin urban do të ndikonte pozitivisht në disa aspekte të jetës së banorëve të zonës: a. Shpejtësi më e madhe veprimi e shërbimeve të emergjencave. b. Efektivitet më i madh i shërbimit të transportit publik i cili do të çonte në rritje të numrit të qytetarëve që zgjedhin transportin publik përpara makinave personale. Kjo gjë do të sillte me vete uljen e trafikut dhe uljen e ndotjes së ajrit në këto qytete dhe përmirësim të standardeve të jetesës.

3. Lidhja e të gjitha fshatrave me qendrën urbane më të afërt me rrugë të asfaltuar sipas standardeve me të paktën një kors, dhe me hapësirë të mjaftueshme shkëmbimi të automjeteve.

Sot në Shqipëri ka ende fshatra të palid-

hura me qytetet më të afërta me rrugë automobilistike sipas kërkesave minimale. Vazhdojnë të përdoren rrugë të shtruara në rastin më të mirë me zhavorr e cakull duke vështirësuar shumë lidhjen e këtyre fshatrave me qytetet. Realizimi i një lidhjeje, ndonëse si fillim me kushte minimale, mes fshatrave të palidhura me qytetet do të mundësonte një lehtësi të madhe për banorët. Duke pasur të sigurt lidhjen me qytetin, banorët nuk do të ishin më të detyruar të zbraznin fshatrat, por do të kultivonin produktet vendase dhe falë sistemit rrugor të kishin më të aksesueshëm tregun për të shitur këto produkte.

4. Lidhja e Tiranës me sistem hekurudhor modern me sa më shumë qytete/fshatra të Shqipërisë dhe vende kufitare

Rrjeti aktual hekurudhor i Shqipërisë është tejet i ngushtë dhe i amortizuar. Mes qyteteve dhe fshatrave të vendit është thuajse e pamundur të udhëtosh me tren, çka sjell pasoja të rënda për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm dhe mjedisin. Intensiteti i lidhjeve të brendshme hekurudhore do të nxiste zhvillimin e qëndrueshëm, lëvizjen e shpejtë dhe të sigurt të qytetarëve dhe do të kontribuonte ndjeshëm në reduktimin e ndotjes së mjedisit.

Nga ana tjetër, vendi ynë nuk është i lidhur me rrjet hekurudhor me asnjë nga vendet e rajonit. Lidhja e saj me rrjet hekurudhor me vendet kufitare të rajonit do të sillte përfitime si për qytetarët, por dhe për ekonominë. Gjithashtu do të kishte impakt pozitiv dhe në turizëm pasi turistët nga vendet kufitare do të kishin një alternativë tjetër transporti më ekonomike për të vizituar Shqipërinë. Kjo e fundit do të sillte më shumë gjallëri nëpër zonat ku do të kalojë hekurudha pasi edhe zona që tani kanë aktivitet të vogël turistik do të mund ta zhvillojnë atë në përmasa të ndryshme. Po ashtu qytetarët, përveç uljes së çmimeve të

produkteve të importit, do të kishin një opsion tjetër më ekonomik për të udhëtuar drejt vendeve fqinje.

5. Investime të programuara në infrastrukturën nëntokësore të furnizimit me ujë, kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave

Ndërmarrjet rajonale të ujësjellës-kanalizimeve kanë kapacitet njerëzor dhe financiar vetëm për mirëmbajtjen e sistemeve të kanalizimeve dhe furnizimit me ujë. Investimet kryesore në këtë sektor realizohen nëpërmjet kredive dhe granteve të siguruar nga institucione bankare të huaja; në një masë më të vogël nga shteti dhe akoma më të vogël nga Bashkia. Megjithatë investimet kryesore në këto sisteme kryhen nëpërmjet kredive nga institucione bankare të huaja dhe kthimi mbrapsht i këtyre parave do të jetë me interes, kjo do të rëndojë kryesisht mbi qytetarët. Nga ana tjetër sot vetëm gjashtë qytete mbulohen plotësisht 24 orë me furnizim me ujë dhe vetëm tre prej tyre kanë të përfshirë edhe fshatrat në këtë mbulim. Për më tepër cilësia e ujit që u ofrohet qytetarëve nuk është e duhura, duke i shtyrë qytetarët që përveç faturës së ujit, të blejnë ujë të pijshëm të ambalazhuar në tregun privat.

Sot në Shqipëri sistemi kryesor i kanalizimeve është sistem i kombinuar që grumbullon si ujërat e ndotura dhe ato të shiut. Kjo çon në disfunkcion të rrjetit në periudha shirash dhe shkaktohen përmytje. Në zona të caktuara nuk ka fare rrjet kanalizimesh dhe shkaktohen ujërave të ndotura bëhen drejtpërdrejt në lumenj ose përdoren gropat septike. Të treja rastet shkaktojnë ndotje dhe kushte anormale të jetës së qytetarëve.

Ndaj duke u nisur nga sa më sipër për këtë pike propozohen marrja e masave të mëposhtme:

- Themelimi i fabrikave publike të prodhimit dhe ambalazhimit të ujit për tregtim

Kjo masë ka për qëllim kryesor tregtimin e burimit tonë kryesor në raport me vendet e tjera. Të ardhurat e përfituara nga kjo tregti do të shërbejnë në radhë të parë për pagesën e kredive të marra aktualisht dhe të mos kemi rritje të vazhdueshme të çmimit të ujit. Futja e faktorit publik në tregun vendas do të çonte në ulje çmimeve të produkteve të tjera të ujit të ambalazhuar duke ulur koston e ujit të blerë për konsum nga qytetarët.

- Rritja e numrit të kampionëve të marrë për testime laboratorike për cilësinë e ujit dhe ushtrimi i kontroleve të rrepta si gjatë marrjes së mostrave si gjatë testimeve për ujin e rrjetit dhe për ujin e ambalazhuar

Jo pak herë ka ndodhur që uji i rrjetit në rubinet vjen me ngjyrë ose ka erë. Madje ka ndodhur që uji i ambalazhuar kur hapej vinte erë. Për të evituar këto situata që rrezikojnë shëndetin e qytetarëve kërkohen masa si të mësipërmet, shoqëruar me një strategji të komunikimi publik për ditët dhe rastet kur uji i rubinetit ose i ambalazhuar do të jetë i papërdorshëm dhe i dëmshëm për banorët.

- Realizimi i një studimi në rang kombëtar me qëllim evidentimin e zonave problematike, arsyet e problemeve në rrjetet e furnizimit me ujë, kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe atyre të shiut dhe mundësinë reale të trajtimit të ujërave të ndotur

Nëpërmjet realizimit të këtij studimi do të kemi mundësinë për të vlerësuar situatën reale, kostot e ndërhyrjeve për përmirësimin e saj dhe prioritizimin e ndërhyrjeve.

6. Investime në infrastrukturën e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike

Sektori i prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike sot ka shumë

probleme. Sipas të dhënave nga viti 2015 deri në vitin 2023 sasia e energjisë elektrike që prodhohet nga HEC publike në krahasim me ato private ka ardhur gjithmonë në rënie, me një difference totale në fund të vitit 2023 prej 17% në favor të HEC private. Me gjithë shtimin e HEC private nëpërmjet koncesioneve, sot Shqipëria është shtet që më shumë importon sesa eksporton energji elektrike. Ka një difference totale prej afërsisht 7.5 milionë MWh përgjatë periudhës 2015-2023 në favor të importit. Ndonëse sasia e humbjeve në rrjetin shpërndarës ka ardhur duke u zvogëluar, ajo mbetet ende e lartë. Në vitin 2023 ka qenë gati 20%. Për t'u theksuar është dhe fakti i mungesës së prodhimit të energjisë elektrike nga burime të tjera alternative si dielli dhe era. Vetëm në vitin 2023 sasia e energjisë elektrike të prodhuar nga këto dy burime arriti në 1%. Nga sa më sipër, për të përmirësuar sektorin e prodhimit të energjisë elektrike propozojmë:

- Rritja dhe përqendrimi i investimeve në rrjetin shpërndarës të energjisë elektrike

Të dhënat e viteve të fundit tregojnë qartë që në Shqipëri sasia e energjisë elektrike të prodhuar është më e lartë se ajo e kërkuar. Duke fokusuar investimet në përmirësimin e rrjetit shpërndarës së energjisë elektrike, do të bëhet e mundur arritja e furnizimit me energji elektrike pothuajse tërësisht vendase duke zvogëluar ndjeshëm sasinë e energjisë elektrike të importuar.

- Investime në prodhimin e energjisë elektrike nëpërmjet burimeve të tjera natyrore të rinovueshme (era, dielli), me punime që kanë si përfitues shtetin

Duke investuar në burime të tjera natyrore të rinovueshme veçanërisht diellin (panele fotovoltaike), do të kemi mundësi që në periudhat e thata të verës një pjesë e mungesës së energjisë elektrike të

prodhuar nga HEC të zëvendësohet nga energjia elektrike e prodhuar nga panelet fotovoltaike.

- Ndalimi i ndërtimit me shumicë të HEC-eve të vogla

Praktika e ndërtimit të HEC-eve të vogla për prodhim të vogël energjie elektrike është provuar që nuk është efektive në termat e furnizimit me energji elektrike. Pothuajse të gjitha vendet e rajonit e kanë ndaluar tashmë si praktikë pasi nuk sjell asnjë përfitim real për shoqërinë, por vetëm për investitorin privat. Sot Shqipëria është vendi i parë në rajon për numër HEC-esh të vogla që janë në shfrytëzim ose priten të vihen në shfrytëzim.

- Ndërtimi i digës së Skavicës me kusht që përfitues dhe shfrytëzues të jetë shteti shqiptar dhe jo kompani koncesionare

Ndërtimi i digës së Skavicës do të rriste kapacitetin e kaskadës së Drinit dhe njëkohësisht vetë diga do të shërbente si rregullator për kaskadën duke bërë të mundur ruajtjen e vëllimeve të caktuara të ujit për periudhat e thata.

Kontratat dhe koncesionet PPP

Kontratat dhe koncesionet PPP kanë prodhuar vetëm rritje kostosh për shoqërinë dhe shtetin, ndërsa përfituesit kryesorë mbeten oligarkët. Lëvizja BASHKË propozon:

- Ndalimin e dhënies së projekteve infrastrukturore me PPP
- Kontrollin e gjithë dokumentacionit që nga momenti i tenderimit duke vazhduar me fazën e ndërtimit dhe të shfrytëzimit për të gjitha kontratat që janë dhënë tashmë me PPP. Në rastet ku do të vihet re shkelje e kontratës ose abuzim me procedurat, do të bëhet prishje e njëanshme e

marrëveshjes dhe kompania koncesionare do të duhet të dëmshpërblejë shtetin shqiptar.

Ligji i Investimeve Strategjike

Ligji i investimeve strategjike nuk ka prodhuar asgjë strategjike, por vetëm pasurimin e oligarkëve "strategjikë". Ndaj Lëvizja BASHKË propozon:

- Abrogimin e ligjit të investimeve strategjike.
- Rishikimin e procedurave të zbatuara për dhënien e statusit të investitorit strategjik për të gjitha subjektet e deritanishme fituese.

Përmirësimi i kushteve të punës të stafit të përfshirë në sektorin e ndërtimit

Sot mbi 100,000 vetë janë të punësuar si punëtorë zbatimi, inxhinierë, arkitektë, ekonomistë e juristë në sektorin e ndërtimit. Kushtet e punës për ata që punojnë në kantier, stafin që punon në zyrë dhe për profesionistët e lirë nuk janë nga më të mirat.

E nisim me punëtorët e zbatimit. Ndonëse pagat ditore janë rritur vitet e fundit, punëtorët nuk paguhen për ditët që nuk punojnë jo për faj të tyre, por për shkak të dinamikave të kantierit. Rastet në të cilat punojnë jashtë orarit janë të shumta dhe në shumicën e tyre jo vetëm që nuk marrin pagesë sipas Kodit të Punës për orët shtesë, por nuk paguhen fare. Kushtet e sigurisë në punë dhe shpeshherë të higjienës në vendet ku punojnë janë skandaloze.

Vazhdojmë me stafin teknik që punon në kantier dhe në zyrë, për të cilët orët jashtë orarit nuk paguhen gjithmonë dhe janë të mbingarkuar në punë sepse kompanitë kërkojnë të punojnë me staf më pak se ai i nevojshmi për të mos

harxhuar. Nuk duhen harruar as mënyrat e pagesës, ku një pjesë e pagës jepet në bankë, kurse tjetra në dorë.

Së fundmi, nëpërmjet projektligjeve për krijimin të Urdhrit të Inxhinierit dhe Urdhrit të Inxhinierit Hidroteknik, të iniciuara nga deputetë të qeverisë dhe që ka gjetur mbështetjen e një numri shumë të vogël inxhinierësh, po synohet monopolizimi i tregut të punës së inxhinierëve. Treg ky i rregulluar prej vitesh me ligj.

Për përmirësimin e kushteve të punës në këtë sektor, propozojmë:

1. Hartimi e një VKM që të vendosë numrin minimal të stafit teknik në zyrë dhe në kantier, të përcaktuar nga xhiroja vjetore e kompanisë. Në rastin e kantierëve të shtrira në sipërfaqe të madhe, përveç xhiros vjetore të kompanisë duhet të jetë kriter edhe shtrirja e objektit.

Nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje synohet të evitohet mbingarkesa e stafit teknik të punësuar në këtë sektor.

2. Hartimin e një VKM të veçantë për punëtorët e zbatimit për të përmirësuar kushtet e punës, ku të specifikohet që punëtori të paguhet me 80% të pagës ditore kur puna ndalet jo për shkak të tij, por prej dinamikës së punës në kantier.

Meqenëse paga mujore e punëtorëve të zbatimit nuk është, nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje synohet kompensimi i punëtorëve të ndërtimit kur nuk mund të punojnë për shkak të dinamikave të kantierit, si dhe lehtësimi i punës së tyre në periudhën më të nxehtë të vitit kur temperaturat kalojnë 40 gradë.

3. VKM që specifikon në kërkesat e domosdoshme për hartimin dhe miratimin e procesverbalit të ngritjes së kantierit, lidhjen me ujë të pijshëm dhe tualetet për punëtorët.

Nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje synohet që punëtorëve të ndërtimit t'u sigurohen të paktën kushtet minimale që në momentin e fillimit të punës.

4. Kundërshtimi ose eventualisht anulimi i projektligjit për krijimin e Urdhrit të Inxhinierit dhe të Inxhinierit Hidroteknik

Përveç kontradiktave që mbart në vete, ky projektligj monopolizon strukturën e dhënies së licencave në një grup të vogël inxhinierësh. Procesi i licencimit të inxhinierëve sot është funksional. MIE kërkon të dalë mbi Universitetin Politeknik të Tiranës dhe universitete të tjera të cilët kanë diplomuar dhe dhënë titullin Inxhinier afro 14,000 inxhinierëve që sot janë në treg, duke u kërkuar testim periodik të njohurive. Vështirëson procesin e hyrjes në tregun e punës së inxhinierëve të rinj pasi kërkon një periudhë praktike 3-vjeçare, krahasuar me 3-mujorin që ofron shkolla.

IV. Konkretizimi

Më poshtë po paraqesim mënyrën si do të konkretizohen propozimet e mësipërme:

1. Hartimi i ligjit për vetingun e të gjitha subjekteve ndërtuese në Shqipëri, si për ato subjekte që operojnë në sektorin privat nëpërmjet ndërtimit të objekteve rezidenciale, ashtu edhe për ato subjekte që operojnë kryesisht në kontrata për punë publike.
2. Hartimi dhe miratimi i ligjit që ndalon marrëdhëniet e kleringut në sektorin e ndërtimit.
3. Riorganizim i departamenteve në MIE duke shtuar një departament që do të merret me përditësimin e Manualeve të Çmimeve të Ndërtimit.
4. Ndalimi i dhënies së lejeve të ndërtimit për hidrocentrale të vogla.

5. Nxitja e kompanive për të investuar në prodhimin e energjisë së rinovueshme prej diellit dhe erës.
6. Ndalimi i dhënies së punimeve me PPP.
7. Abrogimi i ligjit të investimeve strategjike.
8. Përditësimi i Kodit të Punës duke pasur parasysh gjithë problematikat ekzistuese për të punësuarit në sektorin e ndërtimit.
9. Ndryshimi i përmbajtjes minimale për miratimin e proves verbalit të ngritjes së kantierit me ligj
10. Realizimi i të paktën tri projekteve të mëdha të nevojshme për përmirësimin e sektorit të ndërtimit dhe infrastrukturës inxhinierike:
 - Projekt për standardizimin e elementëve të ndryshëm inxhinierikë me fokus te ndërtimet publike.
 - Projekt studimor për mundësinë e lidhjes së Tiranës me rrjet hekurudhor me sa më shumë qytete vendase dhe shtete kufitare dhe lidhjen e fshatrave të palidhur me qytetin më të afërt me rrugë të asfaltuar.
 - Projekt për ngritjen e ndërmarrjeve publike të marrjes dhe ambalazhimit të ujit për ta tregtuar me jashtë.

V. Kostot financiare

Buxheti total i Republikës së Shqipërisë për vitin 2024 ishte 735.9 miliardë lekë

Buxheti për infrastrukturën dhe energjinë: 52.7 miliardë lekë = 0.07 (7%)

89% shpenzime kapitale (mbështetje direkte)

11% shpenzime korrente (për administratën)

Lëvizja BASHKË planifikon një rritje të përshkallëzuar të buxhetit deri në 10% në vitin e katërt sipas shkallës së mëposhtme:

Viti 1 – 7.5% : 0.075×735.9 miliardë lekë = 55.2 miliardë lekë

Viti 2 – 8.0% : 0.08×735.9 miliardë lekë = 58.9 miliardë lekë

Viti 3 – 9.0% : 0.09×735.9 miliardë lekë = 66.2 miliardë lekë

Viti 4 – 10% : 0.1×735.9 miliardë lekë = 73.6 miliardë lekë

Deri në vitin e katërt raporti i shpenzimeve kapitale me ato të administratës do të shkojnë në raportin e mëposhtëm:

95% shpenzime kapitale (mbështetje direkte).

5% shpenzime korrente (për administratën).

1.4 TURIZMI

Shqipëria ka parë një rritje të ndjeshme të numrit të turistëve dhe interesit për destinacionet e saj natyrore dhe kulturore. Strategjia e qeverisë shqiptare për turizmin (2019-2023) vendosi disa objektiva kryesore për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit, si për shembull nxitja e investimeve private, konsolidimi i produkteve turistike, përmirësimi i shërbimeve, riorientimi i promovimit dhe mbështetja për menaxhimin e destinacioneve turistike. Këto objektiva janë kryesisht të përgjithshme dhe kanë një fokus të fortë në politika të masivitetit dhe maksimizimin e fitimit të shpejtë të disa duarve. Nga ana tjetër janë favorizuar ndjeshëm oligarkët vendas, duke sjellë një mbyllje të tregut për investime të huaja me një eksperiencë mbi këtë sektor. Investimet pa kriter dhe për fitime të shpejta kanë sjellë ndërhyrje dhe cenim në zonat e mbrojtura, çka përbën një dëm të parikuperueshëm mjedisor dhe cenon njëkohësisht parimet e turizmit të qëndrueshëm.

1. Problemet kryesore

Ndërsa strategjia e qeverisë përqendrohet në nxitjen e investimeve nga oligarkët vendas, nuk ka politika të mirëfillta që të mbështesin në mënyrë të qëndrueshme profesionistët dhe sektorin publik në zhvillimin e turizmit. Punëtorët e sektorit turistik përballen me mungesë trajnimi dhe kualifikimesh të duhura, duke e ulur kështu cilësinë e shërbimeve turistike dhe identitetin tonë mikpritës.

Strategjia e qeverisë aktuale inkurajon zhvillimin e shpejtë të investimeve pa kriter, duke prishur pikërisht arsyen pse turistët e vizitojnë vendin tonë: natyrën. Këto investime shpeshherë nuk marrin

parasysh ndikimin afatgjatë në mjedis dhe komunitetet lokale. Një shembull tipik është ndërtimi i resorteve turistike që operojnë në stilin “ndërto-shit-ik”, ku qëllimi kryesor është fitimi i shpejtë, ndërsa dëmtimi i natyrës dhe komuniteteve lokale mbetet i lartë. Ky zhvillim spekulativ sjell urbanizim të pakontrolluar, që çon në humbjen e mikpritjes tradicionale shqiptare dhe traditave lokale.

Një problematikë mjaft e përhapur është edhe zaptimi i plazheve publike me shezlongët e resorteve të mëdha apo e bizneseve lokale në shkelje flagrante të ligjit. Çmimet e caktuara për përdorimin e tyre janë stratosferike dhe shumë herë ato janë bërë burim konfliktesh mes pushuesve dhe bizneseve. Legjislacioni shqiptar parashikon që: për çdo 1 kilometër vijë bregdetare, 300 metra duhet të jenë të dedikuara për plazh publik; duhet të lihet një hapësirë prej 2.5 metrash përpara rreshtit të parë të çadrave, e cila të jetë e lirë për përdorim publik; hapësira midis çadrave nuk duhet të jetë më e vogël se 3 metra në linjë horizontale me vijën e ujit dhe jo më e vogël se 2.5 metra në linjë vertikale me vijën e ujit. Asnjë nga këto vendime nuk respektohet.

Nga ana tjetër, Shqipëria ka një sezon të shkurtër turistik, dhe strategjia e qeverisë nuk ka arritur të adresojë këtë problem. Pa politika për zgjerimin e sezonit turistik dhe promovimin e turizmit gjatë gjithë vitit, potenciali i vendit mbetet i pazhvilluar plotësisht. Turrja e sezonit bën që të ketë periudha të zgjatura me mungesë të aktivitetit turistik, duke e kufizuar rritjen ekonomike të sektorit dhe të rajoneve turistike.

Shumë destinacione turistike në Shqipëri vuajnë nga mungesa e infrastrukturës së përshtatshme, siç janë rrugët, shërbimet bazë dhe standardet sanitare. Kjo përkeqëson përvojën e turistëve dhe dobëson konkurrencën e Shqipërisë

përballë vendeve fqinje, si Greqia apo Mali i Zi.

Qeveria mbështetet kryesisht në të dhënat e INSTAT dhe Bankës së Shqipërisë për matjen e numrit të turistëve, por këto institucione nuk kanë kompetenca specifike për këtë sektor. Nuk ka një institucion të dedikuar për matjen dhe analizën e fluksit të turistëve, siç ndodh në vendet e tjera të BE-së, si për shembull Greqia. Kjo çon në pasiguri dhe spekulime mbi të dhënat zyrtare, duke e vështirësuar formulimin e politikave të bazuara në të dhëna të sakta.

Nga pikëpamja e strukturave pritëse të turistëve, Shqipëria ka 2,437 struktura akomoduese; hotelet përbëjnë rreth 65% të totalit, ndërsa pjesa tjetër janë shtëpi dhe dhoma. Sipas të dhënave të QKB-së, në vend janë licencuar 75 operatorë turistikë, 322 agjenci udhëtimi dhe 306 udhërrëfyes. Sipas vlerësimeve të WTTC, kontributi direkt i turizmit në PBB-në e vendit ka qenë 8.5% në vitin 2017. Nuk ka të dhëna zyrtare për vitet në vazhdim. Po sipas parashikimeve të WTTC, kjo shifër do të arrijë në 9.1% të kontributit direkt në PBB.

Paqëndrueshmëria e turizmit duket edhe në faktin se ky sektor nuk po shërben si lokomotivë zhvillimore e sektorëve të lidhur në mënyrë organike me të si bujqësia apo industria. Pavarësisht se në Shqipëri shtohet çdo vit numri i turistëve dhe konsumi i tyre, por edhe shtohen strukturat akomoduese, bujqësia dhe blegtoria vendase e ulin prodhimtarinë. E njëjta gjë vlen edhe për industrinë. Kësisoj nga zhvillimi i paqëndrueshëm i turizmit në Shqipëri përfitojnë bujqit e vendeve fqinje dhe industrialistët e vendeve të tjera.

Shqipëria ka një numër prej 278,100 punonjësish në këtë sektor, por nëse llogaritet në kuptimin e ngushtë direkt, arrijnë deri në 4.2% të tregut të punës gjithsej. Problemi më i madh i punës në

këtë sektor është informaliteti tejet i lartë dhe puna sezonale. Një pjesë e konsiderueshme e punëtorëve të sektorit të turizmit punojnë deri në 16 orë në ditë, shtatë ditë në javë, duke mos gëzuar as minimumin e të drejtave të njohura nga Kodi i Punës.

Një tjetër problem madhor është paqëndrueshmëria e turizmit në aspektin e efekteve shkatërrimtare në natyrë. Ndryshimi i ligjit për zonat e mbrojtura do të cenojë biodiversitetin e Shqipërisë dhe do t'i hapë zonat e mbrojtura natyrore ndaj investimeve. Këto zhvillime nuk merren në konsideratë në strategjinë afatgjatë të qeverisë, duke e lënë mjedisin të ekspozuar ndaj dëmtimeve të mëdha që mund të kenë pasoja të pakthyeshme për natyrën dhe turizmin ekologjik.

II. Alternativa e Lëvizjes BASHKË

Turizmi gjatë gjithë vitit

Përmes politikave të zhvillimit të qëndrueshëm – që ruajnë natyrën, evidentojnë më së miri trashëgiminë kulturore të Shqipërisë dhe promovojnë bashkëjetesën në lokalitete, përmirësojnë infrastrukturën – Shqipëria ka potencialin të ketë turizëm gjatë gjithë vitit. Një transformim i tillë do të sillte përdorimin më të qëndrueshëm të burimeve ekonomike dhe do të siguronte të ardhura dhe marrëdhënie pune më të qëndrueshme për sipërmarrjet dhe punonjësit e këtij sektori.

Çlirimi i plazheve publike

Lëvizja BASHKË zotohet të zgjerojë ndjeshëm hapësirën e plazheve publike, si dhe të zbatojë me përpikmëri normat e reja të respektimit të karakterit dhe sipërfaqes publike të plazheve. Ne do të

inkurajojmë përdorimin e përkohshëm të çadrave vetjake nga qytetarët.

Ndryshimet në kuadrin ligjor

Lëvizja BASHKË do të abrogojë të gjitha ndryshimet e bëra së fundit në ligjin për zonat e mbrojtura, duke ofruar siguri për ruajtjen e paprekshme të natyrës sonë dhe të raporteve tradicionale të popull-sive lokale me këto zona.

Nga ana tjetër do të ndërhyhet në ligjin nr. 93/2015 për të rritur profesionalizmin dhe cilësinë e shërbimeve turistike. Këto ndryshime do të mundësojnë që licencimi i profesionistëve të kualifikuar për auditim të kufizohet në tre sipërmarrje. Kësisoj në një afat kohor 4-vjeçar auditimi u kalon profesionistëve, duke synuar që të ngushtohet rrethi i operatorëve të papërgatitur dhe të garantohet një standard më i lartë i cilësisë. Për më tepër, do të kushtëzohet që marrëdhëniet kontraktuale midis investitorit dhe auditorit të jenë të vlefshme vetëm pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR), për të garantuar një qasje transparente dhe formale ndaj sipërmarrjeve turistike. Kjo politikë do të ketë synim motivimin e profesionistëve për t'u trajnuar dhe certifikuar, duke u krijuar atyre mundësinë për të ardhura më të larta në momentin që do të krijohet tabela e tarifimit të auditimit.

Ngritja e strukturave të forta mbikëqyrëse të impaktit në natyrë

Forcimi i Policisë Pyjore dhe i institucioneve të tjera mbikëqyrëse do të sigurojë që sipërmarrjet që veprojnë në sektorin e turizmit të zbatojnë detyrimet e tyre ligjore, do të ulë ndjeshëm rrezikun nga zjarret dhe do të kontribuojnë në pas-trimin dhe ruajtjen e zonave të gjelbra.

Formalizimi i marrëdhënieve të punës

Konsolidimi i turizmit gjatë gjithë vitit do të ndikojë drejtpërdrejt në kalimin e një pjese të konsiderueshme të punonjësve nga puna sezonale në punë të qëndrueshme. Lëvizja BASHKË do të veprojë energjikisht përmes institucioneve të respektimit të të drejtave në punë që të gjithë punëtorët e sektorit të turizmit – si ata që punojnë gjatë gjithë vitit, edhe për punëtorët sezonalë – që të gjithë të pajisen me kontrata pune, duke nxitur njëkohësisht organizimin sindikalist të punëtorëve të turizmit dhe hartimin e kontratave kolektive të punës. Do të zbatohet me rreptësi Kodi i Punës edhe për numrin e orëve maksimale të punës në javë, si dhe pagesat shtesë për punën jashtë orarit dhe kohëzgjatjes normale të punës. Të vetëpunësuarit në sektorin e turizmit, nëse nuk kryejnë punë tjetër të siguruar, do të nxiten të sigurohen në skemën e sigurimeve shoqërore.

Për punëtorët dhe të vetëpunësuarit që nuk do të arrijnë ta kenë 12-mujore veprimtarinë në sektorin e turizmit, do të jepet një bonus tremujor prej 310 eurosh në muaj (totali 930 euro) dhe do të sigurohen trajnime në muajt janar-shkurt. Ndërsa, në muajin nëntor-dhjetor, agjencitë turistike, në bashkëpunim me sindikatat e shërbimit, duhet të ofrojnë për punonjësit me kontrata kolektive paketa me oferta turistike, kështu që profesionisti gëzon ditët e tij të pushimit, por edhe pasurohet me eksperiencë në destinacione të huaja.

Nga ana tjetër, sipërmarrjet e mëdha turistike do të paguajnë tarifa për analizat e personelit, duke u pajisur me vërtetim shëndeti. Ky vërtetim përfshin analiza për sëmundjet që mund të transmetohen përmes ushqimeve dhe pijeve, si dhe seminarët për higjienën e organizuara nga Agjencia e Formimit Profesional, të cilat do të zgjasin për një periudhë

afatshkurtër prej 120 orësh. Trajnimi dhe rikualifikimi i punonjësve në sektorin e turizmit do të jetë një prioritet, duke u mundësuar atyre të marrin certifikime profesionale dhe të rrisin aftësitë e tyre në përputhje me kërkesat e tregut dhe standardet ndërkombëtare.

Formimi i Agjencisë së Formimit Profesional

Kjo strukturë do të jetë vendimtare për trajnimin dhe certifikimin e profesionistëve të rinj në sektorin e turizmit, duke garantuar cilësi dhe profesionalizëm të lartë në të gjitha hallkat e këtij sektori. Afrimi i profesionistëve vendas për mësimdhënie dhe kurrikula do ta orientojnë më mirë dhe më shpejt studentin me tregun e punës. Afrimi i profesionistëve që ushtrojnë punën e tyre njëkohësisht do të krijonte mundësinë që kjo Agjenci të mblidhte informacion direkt dhe të etiketonte problematikat në kohë reale.

Futja e shërbimit në faturë (bakshishi, pastrimi i dhomës, ciceroni, transporti) do të sillte vëmendjen e profesionistëve në rajon, duke e bërë Shqipërinë vend unik dhe tërheqës. Kësisoj do të shkurajohet ikja masive sezonale në vendet fqinje, por edhe rritet kërkesa.

Krijimi i Observatorit

Observatori do të mbikëqyrë zbatimin e politikave në sektorin e turizmit dhe për të monitoruar zhvillimin e sektorit. Observatori do të marrë përsipër disa nga funksionet e Agjencisë Kombëtare të Turizmit, duke përfshirë mbledhjen e të dhënave dhe monitorimin e trendeve të sektorit.

Brenda Observatorit do të krijohet një strukturë e posaçme e matjes reale të dimensioneve të turizmit në Shqipëri. Qëllimi është të maten me vërtetësi numri i turistëve dhe shpenzimet e tyre

në Shqipëri. Do të hartohet një formular për shtetasit e huaj që vizitojnë Shqipërinë, i cili do të përfshijë informacion mbi vendqëndrimin, numrin e ditëve të qëndrimit, arsyen e vizitës dhe faturën e pagesës së udhëtarit. Kjo metodë do të kontribuonte edhe në formalizimin e punës dhe sipërmarrjes në sektorin e turizmit. Për çdo formular të plotësuar do të aplikohet një kupon prej 9 eurosh.

Për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit, janë propozuar disa masa të rëndësishme: Observatori do të ketë për detyrë të monitorojë zhvillimet në sektor, të përpilojë strategji afatgjata dhe të krijojë identitetin e turizmit shqiptar, duke përfaqësuar alternativën shqiptare në tregun ndërkombëtar. Ky institucion do të mundësonte hartimin e politikave mbështetëse, si mbështetje për agjencitë turistike për të krijuar paketa rinore në muajt prill-maj. Do të mbështeten strukturat akomoduese me një financim prej 1200 euro për strukturë, duke krijuar hapësira për studentët në grupe sipas degëve për të frekuentuar zonat turistike. Po ashtu, bashkëpunimi me rininë e diasporës do të ngrinte një valë paketash për studentët e universiteteve fqinje dhe të huaja në tërësi.

Muajt shtator-tetor do të shfrytëzohen për mbështetjen e agjencive vendase sa herë që do të krijonin paketa turistike për pensionistët. Kësisoj do të kishim një zgjatje domethënëse të sezonit, por edhe fillimin e përfshirjes në masë të popullsisë vendase në shijimin e natyrës shqiptare. Po ashtu, mbështetja për konsolidimin e turizmit mjekësor do të ishte një politikë që do të ndihmonte në betejën ndaj tkurrjes së sezonit.

Bashkëpunimi me diasporën

Lëvizja BASHKË do të nxisë rritjen e bashkëpunimit me diasporën shqiptare që angazhohet në sektorin e turizmit, duke ndihmuar kësisoj në rritjen e

profesionalizmit dhe promovimin e alternativës turistike shqiptare. Diaspora mund të ofrojë njohuri dhe përvoja ndërkombëtare që do të rrisin standardet e shërbimeve turistike në Shqipëri.

Strategji afatgjatë për zhvillimin e turizmit

Shqipëria duhet të kalojë nga modeli i turizmit masiv në atë alternativ, duke promovuar destinacione autentike dhe mbrojtur mjedisin dhe traditat lokale. Kjo do të mundësojë një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe një përvojë më të mirë për turistët.

Financimi i programit për turizmin

Mbështetja e strukturave akomoduese, të punësuarve dhe të vetëpunësuarve në këtë sektor do të kishte një kosto të përballueshme nga buxheti i shtetit, sidomos në kushtet e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm dhe rritjes së produktivitetit të punës.

Më konkretisht, mbështetja tremujore për punëtorët e turizmit do të kishte një kosto prej 51,559,200 eurosh në vit. Subvencionet për 2,437 struktura akomoduese që do të mirëpresin të rinjtë dhe pensionistët do të jenë 2,924,400 euro në vit.

Nga ana tjetër, të ardhurat nga tarifat e hyrjes për turistët për efekt matës mund të parashikohen në 53,341,226 euro, duke marrë për bazë raportet e qeverisë aktuale për 5,926,803 turistë jorezidentë.

1.5 TË ARDHURAT E BUXHETIT DHE TAKSIMI

1. Gjendja aktuale

Ndonëse ekonomia e Shqipërisë është rritur ndjeshëm në terma të PBB-së nominale në dhjetë vitet e fundit, niveli i të ardhurave të buxhetit të shtetit ka ndryshuar me një shkallë shumë më të ulët. Në vitin 2014 niveli i të ardhurave për buxhetin e shtetit, duke përfshirë edhe ndihmat, ka qenë 26.3% e PBB, në vitin 2023 ka arritur në 27.2% e PBB dhe parashikimet e qeverisë e projektojnë në 29.2% në vitin 2027. Një analizë krahasuese me vende të tjera në rajon tregon se Shqipëria është në vendin e fundit sa i takon mbledhjes së të ardhurave, ndërsa mesatarja e vendeve të OECD është 34%. Ndër faktorët thelbësorë për këtë situatë janë niveli i lartë i evazionit fiskal, informaliteti në punë dhe në paga, ulja e tatimit të dividendit, përjashtimet tatimore etj. Shpesh dëgjohet në diskutimin publik për nevojën e pasjes së një shteti të vogël, por të paktën nga pikëpamja e të ardhurave shteti ynë është shteti më i vogli në rajon.




Figura 11: Të ardhurat si % e PBB për vitin 2022 për disa shtete. (Burimi: Fondi Monetar Ndërkombëtar)

Në figurat e mëposhtme jepen në mënyrë më të detajuar përqindja e grumbullimit të të ardhurave për vitin 2023. Siç shihet nga këto të dhëna, TVSH-ja zë gati 30% të të ardhurave, pasuar nga sigurimet shoqërore (19%), ndërsa tatim fitimi, akcizat dhe të ardhurat personale janë midis 9 dhe 10%. Sa i takon TVSH-së, nëse shikojmë strukturën e taksave sipas raportit më të fundit të OECD (Revenue Statistics 2024, f. 15), pesha mesatare e TVSH-së në vendet e OECD-së është 20.8%, dhe vetëm disa vende janë mbi 30%, si për shembull Kili (39%) dhe Kolumbia (31.8%).




Figura 12: Përqindja e të ardhurave për vitin 2023 sipas 6 kategorive. (Burimi: përpunuar nga të dhënat e Ministrisë së Financave - Statistika fiskale në vite 2023)

TVSH	29.88
Sigurimi shoqëror	19.36
Tatim fitimi	10.03
Akciza	9.07
Të ardhurat personale	8.99
Taksat nacionale dhe të tjera	6.24
Taksa lokale	3.95
Ndihmat	3.48
Sigurimi shëndetësor	2.95
Institucione buxhetore	2.05
Taksa doganore	1.42
Tatimi mbi pasurinë (ndërtesat)	0.96
Të tjera	0.96
Tarifat e shërbimeve	0.50
Kompensim pronarëve	0.13
Tatimi i thjeshtuar biznes i vogël	0.01
Dividenti	0.01

Figura 13: Përqindja e të ardhurave për vitin 2023 të detajuara sipas kategorive. (Burimi: përpunuar nga të dhënat e Ministrisë së Financave - Statistika fiskale në vite 2023).

Një dallim tjetër i shumë i madh në strukturën e taksave është pesha që zë tatimi mbi të ardhurat personale, e cila për Shqipërinë është 9%, ndërsa mesatarja e vendeve të OECD-së është 23.6 %. Për disa vende të rajonit është si më poshtë: Serbia (15%), Maqedonia e Veriut (15%), Kroacia (25%), Sllovenia (14%) dhe Greqia (15%). Ndërsa pesha e të ardhurave personale në strukturën e taksave për vendet më të zhvilluara të Evropës, si Gjermania, Italia, Suedia, Norvegjia, është midis 25 dhe 28%. Nga kjo analizë duket qartë që në vendin tonë taksat indirekte (TVSH-ja) zënë një vend dukshëm më të madh sesa taksat direkte (të ardhurat personale dhe të kapitalit).

Sa i takon taksimit të të ardhurave personale në Shqipëri, ai është progresiv për të ardhurat nga puna (nga 0-13-23%), i sheshtë për të ardhurat nga tatimi në burim (15%) dhe dividendi (8%).

Në përfundim të kësaj analize të shkurtër dalin në pah dy probleme themelore:

- Niveli i ulët dhe i pamjaftueshëm i të ardhurave që grumbullohen për shpenzimet publike;
- Një strukturë e deformuar e grumbullimit të taksave.

Shkaqet kryesore të kësaj gjendje janë evazioni fiskal, informaliteti në punë dhe në paga në njërin anë, dhe një model taksimi jo i drejtë në anën tjetër.

II. Alternativa e Lëvizjes BASHKË

Parimet e taksimit

Parimi themelor i taksimit që Lëvizja BASHKË përqafton është parimi i taksimit të ndershëm: sistemi i taksimit të jetë dhe të shihet si i ndershëm – trajtim i njëjtë i atyre që janë në rrethana të ngjashme, dhe vendosja e taksave më të larta karshi atyre që mund ta përballojnë më mirë barrën e taksimit. Në këtë kuptim, Lëvizja BASHKË mbështet një model progresiv të taksimit. Më tej, krahas parimit të ndershmërisë, do të kihet parasysh edhe parimet e tjera të taksimit si nxitja e investimeve që rrisin produktivitetin e punës dhe vlerën e shtuar, efienca ekonomike, thjeshtësia administrative dhe transparenca.

Objektivi

Objektivi i Lëvizjes BASHKË do të jetë rritja e të ardhurave të buxhetit në nivelin e 33% të PBB-së brenda katër viteve, nisur nga rreth 28% që është sot. Kjo duhet realizuar për të përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme cilësinë e shërbimeve publike bazike si shëndetësia dhe arsimi, mbrojtjen sociale, rritjen e solidaritetit dhe kohezionit social

(pensionet dhe ndihmën ekonomike të shtresave në nevojë), për të mbështetur gjithashtu një rritje ekonomike më të lartë, bujqësinë dhe industrinë për-punuese, investimet në teknologji të reja etj. Në projektbuxhetin e vitit 2025 janë parashikuar 754.7 miliardë lekë të ardhura në total (28.8% e PBB), ndërsa PBB parashikohet 2,620.7 miliardë lekë. Lëvizja BASHKË do të synojë rritjen e buxhetit me 1% të PBB për çdo vit, dhe në këtë mënyrë deri në vitin 2029 të ardhurat do të arrijnë në 33% të PBB. Shtesa e buxhetit të shtetit në vlerë absolute e fituar nga rritja e përqindjes varet edhe nga shkalla e rritjes së ekonomisë kombëtare. Kështu, me një normë konservatore të rritjes ekonomike me 3% në vit, shtesa mesatare në buxhet për çdo vit do të jetë rreth 55 miliardë lekë, dhe në krye të katër viteve në total rreth 220 miliardë lekë krahasuar me vitin 2025. Po vendi ynë e ka të gjithë potencialin, nëse qeveriset me politika zhvillimore nxitëse në bujqësi dhe industri, për një rritje ekonomike mbi 5% në vit. Në këtë rast, shtesa mesatare në buxhet do të jetë 74 miliardë lekë në vit dhe në total rreth 296 miliardë lekë më shumë deri në vitin 2029.

Masat konkrete që propozojmë janë si më poshtë:

1. Do të luftojmë evazionin fiskal, informalitetin në punë, informalitetin në paga dhe shmangiet tatimore:

a) Do të rriten kapacitetet e administratës tatimore.

b) Duke aplikuar modele të vendeve të tjera që kanë eliminuar gati 100 për qind paranë CASH, brenda vitit të parë do të rishikojmë dhe përmirësojmë legjislacionin që lehtëson formalizimin e ekonomisë dhe penalizon evazorët e mëdhenj. Do të bazohemi te nxitja e formalizimit me politika lehtësuese.

c) Brenda vitit të parë do të rishikojmë legjislacionin për përgjegjësitë administrative dhe penale që duhet të kenë kontabilistët, audituesit dhe audituesit ligjorë, bazuar në praktikën më të mirë evropiane.

2. Do të rishikohen me themel përjashtimet tatimore, si për shembull në sektorin e turizmit (hotelet dhe resortet me 4 dhe 5 vje me status special), ashtu edhe përfitues të tjerë, duke vendosur një barrë tatimore të ndershme dhe të drejtë për sipërmarrësit.

3. TVSH dhe mbështetja sociale

Lëvizja BASHKË do të rimbursojë TVSH-në për kategoritë në nevojë dhe pensionet e ulëta. Nisur nga nivelet shumë të ulëta të pensioneve në Shqipëri, krahas objektivit madhor të Lëvizjes BASHKË për vendosjen e minimumit jetik dhe rritjen e pensioneve mbi nivelin e minimumit jetik, ne do të hartojmë një skemë të rimbursimit të TVSH për pensionet e ulëta dhe mesatare, si dhe për përfituesit e ndihmës ekonomike dhe atyre me aftësi të kufizuar.

4. Tatimi i të ardhurave personale të punës

Lëvizja BASHKË mbështet parimin e tatimit progresiv të të ardhurave personale. Bazuar në modele të ngjashme të tatimit progresiv, si për shembull Sllovenia, ne propozojmë 5 fasha të tatimit, si më poshtë:

Paga minimale bruto 60,000 lekë – tatimi 0%;

Nga 60,001-100,000 lekë – tatimi marginal 10%;

Nga 100,001-200,000 lekë – tatimi marginal 15%

Nga 200,001-400,000 lekë – tatimi marginal 25%

Nga 400,001 lekë e sipër – tatimi marginal 35%

Aplikimi i këtij modeli progresiv të tatimit në raport me tatimin aktual do të sjellë ulje të tatimit për pagat bruto deri në pagën 400,000 lekë, dhe rritje të tatimit për pagat mbi këtë vlerë. Më konkretisht, pagat deri në 100,000 lekë do të përfitojnë një ulje të ndjeshme të tatimit (nga 56-78%), pagat deri në 200,000 ulje deri në 14%, ndërsa për pagat mbi 200,000 ulja vjen duke u zvogëluar në mënyrë graduale.

Paga bruto në lekë	TAP aktual në lekë/muaj	TAP, propozimi i Lëvizjes BASHKË, lekë/muaj	Fasha %
60,000	3,250	0	0
70,000	4,550	1,000	10%
80,000	5,850	2,000	10%
90,000	7,150	3,000	10%
100,000	9,100	4,000	10%
150,000	15,600	11,500	15%
200,000	22,100	19,000	15%
250,000	33,600	31,500	25%
300,000	45,100	44,000	25%
400,000	68,100	69,000	25%
500,000	91,100	114,000	35%
600,000	114,100	149,000	35%

Figura 14: Ndryshimi i tatimit të të ardhurave personale nga puna

5. Deklarim vjetor dhe me njësi familjare

Krahas deklaramit mujor të të ardhurave personale nga punësimi, Lëvizja BASHKË do të zbatojë një deklaram vjetor të të ardhurave personale në tërësi, e cila do të mbështet në njësinë familjare të deklaruesit kryesor në një të anë, si dhe do të marrë në konsideratë nivelin e minimumit jetik të familjes në anën tjetër. Kombinimi i të ardhurave vjetore/familjare dhe minimumit jetik do të shërbejë për të bërë korrigjimet përkatëse të nivelit të tatimit.

6. Tatimi i dividendit

Krahasimisht me modelin aktual, ku dividendi është ulur padrejtësisht në nivelin 8%, Lëvizja BASHKË do e vendosë tatimin e dividendit në masën 15%.

7. Tatimi i biznesit/korporatës

Sot shteti shqiptar aplikon një tatim të sheshtë të korporatës në nivelin 15%, dhe aplikon një sërë përjashtimesh si për investitorët në sektorin e turizmit, apo aplikon tatim të diferencuar në normën 5% në agroturizëm, shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, zhvillimin e software-ve dhe industrinë automotive.

Lëvizja BASHKË – me synimin e rritjes së të ardhurave buxhetore për të mbështetur shtetin zhvillimor dhe social dhe vendosjen e një tatimi sa më të drejtë – do të vendosë një skemë të diferencuar të tatimit të fitimit. Së pari, për investimet që rrisin ndjeshëm kapacitetin teknologjik, produktivitetin e punës dhe ngjitin ekonominë vendase në zinxhirin global të vlerës, do të aplikohet një normë tatim fitimi prej 3% (sot është 5%). Për investimet e tjera, do të aplikohen tri shkallë tatimore, përkatësisht 10, 15 dhe 20%. Aplikimi i këtyre shkallëve do të mbështetet në 1) shkallën e fitimit të tatueshëm dhe 2) tipin e sektorit. Sektori financiar dhe spekulativ, si sektori i ndërtimit, do të kenë normë më të lartë të tatim fitimit.

8. Taksa e pronës

Taksa e pronës, për apartamentet e treta e me radhë, do të përdoret si instrument rregullator për të siguruar të drejtën e banesës. Për një shtjellim të hollësishëm shiko kreun e strehimit.

2. SHTETI SOCIAL

zhvillimit ekonomik dhe social vuajnë nga zbatimi i modeleve të shpërfytyruara të shtetit social, të cilat ndërthurin nivelin shumë të ulët të mbështetjes sociale me logjikën klienteliste të shpërndarjes së kësaj mbështetjeje. Programi qeverisës i Lëvizjes BASHKË synon të integrojë në mënyrë organike aspektet më përparimtare të tri modeleve të mësipërme të shtetit social.

Shteti social është një prej arritjeve më të mëdha të njerëzimit, i cili është bërë i mundur nëpërmjet ndërthurjes së zhvillimit të hovshëm ekonomik dhe politikave rishpërndarëse që trajtojnë me përparësi më të varfrit dhe shtresat e marginalizuara në tërësi. Rëndësia e shtetit social shkon përtej luftës ndaj varfërisë dhe mbështetjes së njerëzve në nevojë. Sigurimi i të drejtave sociale është parakusht i gëzimit të barabartë të të drejtave civile dhe politike të qytetarëve dhe, rrjedhimisht, një prej shtyllave më të rëndësishme të demokracisë.

Modelet e shtetit social janë të larmishme, duke nisur nga ai i shteteve të Evropës veriore. Në to shteti social shtrihet në dimensionet e veta më të mëdha, duke përfshirë edhe politikat shëndetësore, arsimore, të strehimit etj., dhe nga ana tjetër përfituesit e këtij modeli janë shumica dërrmuese e shoqërisë, duke përfshirë edhe shtresën e mesme. Modeli i vendeve të Evropës qendrore dhe perëndimore mbështetet më shumë në kontributet e sigurimeve shoqërore dhe politikat e kujdesit social reflektojnë forcën e shtresave të organizuara të punëtorisë. Ndërkohë që modeli i vendeve anglo-saksone është më i kufizuar në përkrahjen e shtresave të marginalizuara dhe sheh me përparësi integrimin e shpejtë të të marginalizuarve në tregun e punës. Afërmendsh, vendet me probleme më të mëdha të

2.1 PENSIONET

1. Gjendja e përgjithshme dhe problemet

Pensionistët janë shtresa më e persekutuar ekonomikisht në Shqipërinë e sotme. Niveli i pensioneve është shumë i ulët. Nëse pensionistët nuk do të kishin të ardhura shtesë prej solidaritetit familjar, sot mbi 520,000 pensionistë do të jetonin për bukën e gojës. Për të mos përmendur pastaj kostot domethënëse të trajtimit shëndetësor dhe të mirave të tjera bazike.

Në Shqipërinë e arritjeve ekonomike imagjinare, pensioni minimal i qytetarëve që kanë punuar një jetë të tërë është rreth 9,710 lekë. Kjo shumë të ardhurash është 11,458 lekë më e vogël se dyshemeja e minimumit jetik e llogaritur nga Avokati i Popullit. Çka e bën edhe më shqetësues këtë nivel pensioni është raporti me shtete të tjera të Ballkanit Perëndimor. Për shembull, pensioni minimal në Republikën e Kosovës është 120 euro, domethënë rreth 24% më i lartë se në Shqipëri, pavarësisht se Prodhimi i Brendshëm Bruto për frymë i Kosovës është 540 dollarë më i ulët se PBB e Shqipërisë.

Tejet i ulët është edhe niveli i pensionit mesatar. Sipas “Statistikave të Sigurimeve Shoqërore 2023” të botuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në fund të vitit 2023 niveli i pensionit mesatar në fshat ishte 11,051 lekë dhe pensioni mesatar në qytet ishte 18,341 lekë. Nëse shtojmë indeksimin prej 4.1% që qeveria kreu në tetor të vitit 2024 dhe i vendosim pensionet rurale dhe urbane në proporcionet e tyre, sot në Shqipëri pensioni mesatar është 17,954 lekë.

Kjo masë pensioni është 3214 lekë më e ulët se niveli i minimumit jetik. Edhe në këtë rast, krahasimi me vendet e Ballkanit Perëndimor është domethënëse. Shqipëria ka pension mesatar 48 euro më të ulët se Republika e Kosovës, 160 euro më të ulët se Bosnje Hercegovina, 225 euro më të ulët se Maqedonia e Veriut, 260 euro më të ulët se Serbia dhe 270 euro më të ulët se Mali i Zi. Në një tjetër këndvështrim, hendeku në pensione midis Shqipërisë dhe këtyre vendeve nuk u përgjigjet dallimeve në stadin e zhvillimit ekonomik, të matur me Prodhimin e Brendshëm Bruto për frymë, por edhe nivelit të çmimeve të produkteve ushqimore.

Për shkak të punës informale që mbi-zotëron prej tri dekadash dhe vazhdon të ketë një shtrirje tejet shqetësuese, me kalimin e viteve shtohet numri i pensionistëve që nuk kanë vitet e mjaftueshme të siguruara (rreth 38 vjet) për të përfutur pension të plotë. Kësisoj pensioni mesatar për të moshuarit e dalë në pension në vitin 2023 ishte 15,569 lekë. Numri i pensionistëve që në vitin 2023 përfitonin pensione të pjesshme ishte 50% e totalit të pensionistëve. Nëse nuk kemi ndryshime strukturore, ky problem do të përkeqësohet vit pas viti duke i zhytur pensionistët gjithnjë e më thellë në varfëri.




Figura 15: (Burimi: Revista Monitor)

Për ta kuptuar më mirë kontekstin e nivelit shumë të ulët të pensioneve në Shqipëri, është e udhës të krahasojmë pensione me pagën mesatare bruto. Të dhënat e fundit nga INSTAT-i tregojnë

se në Shqipëri paga mesatare bruto është 77.669 lekë. Rrjedhimisht pensioni mesatar është rreth 22% e vlerës së pagës mesatare bruto. Për krahasim, ky raport në Republikën e Kosovës është 31.3%. Një tjetër tregues i varfërisë relative është raporti i pensionit minimal me pagën mesatare bruto. Në Shqipëri ky raport është 12.5%. Në Kosovë është 16.4%, kurse në vendet e Bashkimit Evropian shkon nga 20% deri në 30%.

Çka e bën veçanërisht të thellë varfërinë e pensionistëve në Shqipëri është jo vetëm niveli tejet i ulët i pensionit minimal (i llogaritur mbi bazën e pensionit social), por edhe mosha e përfitimit të pensionit social. Përfituesit e pensionit social duhet të kenë mbushur moshën 70 vjeç. Kjo do të thotë se qytetarët midis moshës zyrtare të pensionit dhe moshës së përfitimit të pensionit social duhet të vazhdojnë të punojnë. Deri më sot numri i pensionistëve që përfitojnë pension social është mjaft i ulët, rreth 2300 qytetarë në vitin 2023. Mirëpo në vitet e ardhshme pritet që të rritet numri i pensionistëve të cilët, duke mos pasur vite të mjaftueshme pune gjatë sistemit të kaluar, nuk do të kenë arritur pragun e 15 viteve kontribute në skemën e sigurimeve shoqërore. Paaftësia 12-vjeçare për të zgjidhur problemin e punës në të zezë, po e shtyn qeverinë drejt rritjes së moshës së përfitimit të pensionit social në 75 vjeç. Një moshë e tillë jo vetëm do të rriste në rreth 10 vjet numrin e viteve kur një qytetar do të ishte pa të ardhura pas mbushjes së moshës zyrtare të daljes në pension, por edhe do ta prishte krejt logjikën e pensionit social duke marrë në konsideratë jetëgjatësinë mesatare të popullsisë. Një tjetër problem me politikat aktuale të përcaktimit të pensionit social është se prej tij përjashtohen qytetarët që kanë në pronësi tokë bujqësore, qoftë kjo edhe e papunuar. Ky kriter përjashton nga të ardhurat pensionistët e fshatit.

Duke marrë në konsideratë përmasat katastrofike të informalitetit në punë në Shqipërinë e dekadave të fundit, një faktor shtesë për varfërimin e pensionistëve është pragu 15-vjeçar i kontributeve të sigurimeve shoqërore për të përfituar pension minimal. Një prag i tillë do të bëhet vështirësisht i arritshëm në vitet e ardhshme, kur të shtohet përqindja e viteve të punës gjatë dekadave të tranzicionit. Për krahasim, vendet e zhvilluara të OECD, mes të cilave informaliteti në punë është marginal, kanë një mesatare prej 13 viteve si prag për marrjen e pensionit minimal. Nga ana tjetër, në Shqipëri është i lartë edhe numri i viteve të punës që duhen për të përfituar pension të plotë: rreth 38 vjet dhe me kalimin e kohës ky numër viteve pritet të shkojë deri në 40 vite kontribute. Për krahasim, në vendet e OECD mesatarja e viteve të punës për pension të plotë është 34 vite.

Struktura ekonomike e prapambetur e Shqipërisë ndikon gjithashtu në nivelin mjaft të ulët të pensioneve. Sipas studimit "Tregu i punës 2023" të INSTAT-it, nga 1,327,042 të punësuar, 676,875 (rreth 51% e të punësuarve) konsiderohen të vetëpunësuar dhe punëtorë pa pagë në biznesin familjar. Kjo formë e organizimit të punës është veçanërisht e përhapur në bujqësi. Në këtë fashë të punësuarish gjendet edhe përqindja më e lartë e informalitetit në punë. Kjo shkaktohet jo vetëm nga marzhet e vogla të fitimit në biznese familjare, por edhe nga normat e larta të përqindjes së kontributeve shoqërore. Kështu për të vetëpunësuarit urbanë, norma e kontributit të sigurimeve shoqërore është 23% (e llogaritur mbi bazën e pagës minimale). Një pjesë syresh hyjnë te profesionet e lira të mirëpaguara. Në këtë rast problemi i llogaritjes së kontributeve mbi bazën e pagës minimale zyrtare jo vetëm që i bën këta profesionistë të kenë një pension mjaft më të ulët se të ardhurat e tyre mesatare gjatë punës (sa

gjysma e pensionit të të punësuarve që kontribuojnë në bazë të pagës maksimale), por edhe të kontribuojnë më pak në skemën e sigurimeve shoqërore.

Të vetëpunësuarit në bujqësi, nga ana tjetër, duhet të paguajnë norma më të ulëta prej 7.6% deri në 10% në varësi të zonave malore e fushore (edhe këtu e llogaritur mbi bazën e pagës minimale). Problemi me të vetëpunësuarit në bujqësi është se produktiviteti i ulët i punës në këtë sektor, të braktisur nga subvencionet shtetërore dhe me një kapacitet të ulët teknologjik, bën që një normë e tillë të jetë e papërbalueshme për bujqit. Kësisoj numri i të vetëpunësuarve në fshat që paguajnë sigurimet shoqërore mund të mbështesë vetëm rreth $\frac{1}{4}$ e pensionistëve të fshatit. Nga ana tjetër, niveli i pensioneve në fshat është mjaft më i ulët se në qytet. Argumenti i qeverive të derisotme se pensionistët e fshatit kanë tokë ose bagëti për t'u vetëmbështetur sa vjen e bëhet më i paqëndrueshëm për shkak të braktisjes së fshatit nga forcat ekonomiksht aktive, lënia djerrë e tokave bujqësore në mjaft fshatra dhe pakësimi i bagëtive për vetushqim.




Figura 16: (Burimi: INSTAT: Tregu i punës 2023)

Varfëria e pensionistëve të sotëm dhe të nesërm bëhet edhe më e ndjeshme prej vendosjes së raporteve të fiksuara midis kontributeve të sigurimeve shoqërore për pagën minimale dhe pagën maksimale. Sipas legjislacionit në fuqi, në vitin 2023 paga maksimale mbi të cilën paguhen kontributet e sigurimeve shoqërore është 176,416 lekë. Sipas ligjit për sigurimet shoqërore, raporti midis pensionit minimal për vite të plotë kontributesh dhe pensionit maksimal për të njëjtat vite pune të jetë 4.4. Nëse vendosja e një raporti në përfitim mund të justifikohet me parimet e drejtësisë shoqërore (ndonëse ky raport mund të ishte pak më i lartë), nuk mund të thuhet e njëjta gjë për nivelin e kontributeve. Nuk ka asnjë arsye sociale dhe ekonomike që punëmarrësit me paga shumë të larta të mos paguajnë kontributet për sigurimet shoqërore bazuar mbi pagën e tyre reale. Kjo masë do të shtonte të ardhurat në buxhetin e sigurimeve shoqërore dhe do të mundësonte rritjen e pensioneve më të ulëta.

Faktori ligjor kryesor që përcakton nivelin tejet të ulët të pensioneve në Shqipëri është mungesa e standardit të minimumit jetik. Qeveria nuk ka bërë asnjë hap drejt njohjes së kësaj të drejte bazike shoqërore dhe llogaritjes së saj. Në mungesë të një ligji të minimumit jetik, pensioni bazë, ose pensioni social, nuk përcaktohet nga llogaritja e nevojave bazike të pensionistit. Sot pensionistët marrin pension minimal 11,458 lekë më të vogël se niveli i minimumit jetik i llogaritur nga Avokati i Popullit, ndërsa pensionistët me pension mesatar marrin 3214 lekë më pak se ky nivel. Ndryshimi i vitit 2014 i ligjit për sigurimet shoqërore ka hequr çdo lidhje midis pensionit minimal dhe standardit minimal të jetesës. Për shembull, në ndryshimet ligjore të vitit 2005 kishte vend për një fjali të tillë: "Shuma bazë e pensionit që u jepet gjithë personave të siguruar, duhet të sigurojë të paktën një standard jetese minimal..."

Niveli mjaft i ulët i të ardhurave po shtyn një numër të konsiderueshëm pensionistësh të vazhdojnë marrëdhëniet e punës edhe pas arritjes së moshës për të dalë në pension. Sipas INSTAT-it, në vitin 2023 ka pasur rreth 71,000 pensionistë në marrëdhënie pune, ose 15.6% të popullsisë mbi 65 vjeç. Ndarja gjinore mes pensionistëve të punësuar është 6.4% gra dhe 20% burra. Këto përqindje rriten vit pas viti. Nëse marrim për krahasim vendet e zhvilluara të OECD, përqindja e popullsisë në moshë pensioni që punon është 14% për burrat dhe 7% për gratë. Gjithsesi përqindja e pensionistëve që punojnë hamendësohet më e lartë. Nëse marrim në konsideratë normën zyrtare të punës informale, 44.4%, atëherë përqindja reale e pensionistëve në marrëdhënie pune duhet të jetë rreth 28%. Në këto përqindje nuk futet puna e papaguar intensive familjare e pensionistëve të cilët, në mungesë të shërbimeve publike cilësore si shkolla me afat të gjatë, kryejnë një pjesë të konsiderueshme të punëve të kujdesit në familjen e tyre më të madhe (edukimi i nipave dhe mbesave).

Për të inkurajuar punën e pensionistëve, ligji i sigurimeve shoqërore parashikon një shtesë prej 0.5% të pensionit për çdo muaj që i moshuari, i cili e ka mbushur moshën e pensionit, e shtyn datën e daljes në pension. Kjo masë, tregues i problemit të thellë të pamjaftueshmërisë së pensionit, nuk është serioze nëse e krahasojmë me nevojat e pensionistëve. Në një vend me standard mjaft më të lartë jetese si Spanja, prej dhjetorit të vitit 2021 ligji u siguron pensionistëve që vazhdojnë të punojnë një rritje mujore pensioni prej 4%.

Përtej nivelit të varfërisë absolute të pensionistëve, shqetësues është edhe fakti që mes kategorive të veçanta që përfitojnë nga skemat suplementare të pensioneve nuk njihet siç duhet kontributi i minatorëve. Prej dekadash

minatorët luftojnë për njohjen e statusit të tyre sipas parametrave evropianë. Duhet pasur parasysh që kemi të bëjmë me një kategori punëtorësh të cilët, për shkak të punës tejet të rrezikshme dhe ekspozimit të fortë ndaj ndotjes, kanë një jetëgjatësi më të ulët se pjesa tjetër e popullsisë. Ndonëse mund të dalin në pension në moshën 55-vjeçare, shtesat që u takojnë sipas veçorisë së kategorisë së tyre të punës nisin dhjetë vjet më pas, kur mbushin moshën e daljes në pension kategoritë e tjera të pensionistëve. Për krahasim, në vendet e zhvilluara, si p.sh. Spanja, për kategoritë e punëtorëve që kryejnë punë të rrezikshme moshë e daljes në pension reduktohet deri në 50% (minatorët) krahasuar me moshën e zakonshme të pensionimit. Vende të tjera si Çekia marrin në konsideratë si vështirësi në punë edhe nivelin e zhurmës, kurse në Francë kushtet e veçanta të punës përfshijnë edhe kategori si shoferët e autobusëve, të cilëve pas njëfarë moshe u sigurohen detyra më të thjeshta.

II. Shkaqet strukturore dhe mënyra e qeverisjes

Për të kuptuar shkaqet e nivelit tejet të ulët të pensioneve në Shqipëri duhet të analizojmë një sërë faktorësh historikë, strukturorë dhe specifikisht politikë të keqzhvillimit të Shqipërisë në dekadat e fundit. Një prej këtyre shkaqeve është ndryshimi i strukturës demografike të shoqërisë shqiptare. Çka vihet re në vitet e fundit është shtimi i numrit të qytetarëve në moshë pensioni në raport me popullsinë e vendit dhe, mbi të gjitha, me popullsinë në moshë pune. Sipas Censit të vitit 2023, qytetarët nga moshë 65 vjeç e lart përbëjnë 19.7% të popullsisë. Kjo pjesë popullsie ka qenë dukshëm më e ulët në vitet 2011 (11.3%) dhe 2001 (7.5%). Kjo prirje bëhet edhe më shqetësuese prej faktit që qytetarët 60 vjeç e sipër përbëjnë sot 28% të popullsisë.

Nga ana tjetër, është rritur numri i qytetarëve në moshë pensioni në raport me popullsinë në moshë pune. Ky raport varësie ka shkuar nga 16.7% në vitin 2011 në 30.4% në vitin 2023, duke iu afruar shqetësueshëm shifrave të vendeve të zhvilluara (31% në vendet e OECD). Shqipëria po merr simptomat e krizës demografike të vendeve të zhvilluara, pa iu afruar fare nivelit të zhvillimit teknologjik, produktivitetit të punës dhe forcës së institucioneve të kujdesit social të këtyre vendeve.

Një prej faktorëve kryesorë në plakjen e popullsisë vazhdon të jetë rënia e lindshmërisë. Në vitin 2023 lindshmëria ishte në normën 1.2 për një grua. Çka e bën edhe më të rëndë këtë normë është krahasimi me vendet e zhvilluara. Vendet e Bashkimit Evropian, mjaft më të përparuara se Shqipëria në aspektet e emancipimit dhe barazisë gjinore, prapëseprapë kanë një normë lindshmërie 1.46 për një grua. Të dhënat e Censusit të vitit 2023 na tregojnë se për shkak të uljes së lindshmërisë, por edhe faktorëve të tjerë që do të analizohen më poshtë, ka rënë edhe numri i anëtarëve të njësive ekonomike familjare: nga 3.9 anëtarë në vitin 2011 në 3.2 anëtarë në vitin 2023.

Dritëshkurtësia e qeverisë aktuale del në pah në faktin se nxitjen e lindshmërisë e sheh të lidhur vetëm me një bonus që familjet e marrin një herë kur lindin fëmijën e parë, të dytë dhe të tretë. Ka plot indicie që tregojnë se në Shqipëri lindshmëria nuk lidhet vetëm me pagën, ndonëse varfëria mbetet një prej shkaqeve kryesore që i shkurajojnë familjet të planifikojnë të lindin fëmijë. Çka mungojnë janë kushtet e punës së dinjitetshme, sidomos të drejtave në punë të grave, që do t'u mundësonin prindërve të kishin kohë të mjaftueshme për të ndenjur me fëmijët e tyre. Po ashtu ka mangësi të theksuara në institucionet arsimore. Mungesa e kushteve të edukimit dhe

argëtimit të fëmijëve në shkollë pas orarit të mësimi bën që prindërit ta kenë më të vështirë planifikimin e lindjes së fëmijëve. Nuk duhen harruar as kushtet e përgjithshme të korrupsionit dhe padrejtësive sociale që e shkurajojnë planifikimin familjar afatgjatë. Në vendet e zhvilluara të OECD llogaritet se, për të mbajtur konstant numrin e popullsisë, nevojitet një normë lindshmërie prej 2.1 fëmijësh për një grua. 75% më e lartë se norma aktuale e lindshmërisë në Shqipëri.

Çka e deformon edhe më raportin e qëndrueshëm midis numrit të qytetarëve në moshë pensioni dhe pjesës tjetër të popullsisë, sidomos popullsisë në moshë pune, është norma shumë e lartë e emigracionit të vazhdueshëm nga Shqipëria. Sipas Censusit 2023, nga Shqipëria largohen çdo vit mesatarisht 50,000 qytetarë, një pjesë e konsiderueshme e tyre qytetarë në moshë pune. Kjo zbrazje demografike është njëkohësisht edhe dobësim i forcave produktive dhe intelektuale të vendit, si dhe përbën një pengesë gjithnjë e më të lartë në qëndrueshmërinë e skemës së pensioneve në Shqipëri. Diaspora shqiptare, nga ana tjetër, mbetet dyshemeja sociale jozyrtare që mban në jetë një pjesë të konsiderueshme të pensionistëve në Shqipëri. Është llogaritur që në vitin 2020 remitancat që sjellin emigrantët shqiptarë arrinin në 1.5 miliardë dollarë, ose 10% të PBB së kohës.

Sikur të mos mjaftonin ulja e lindshmërisë dhe norma e lartë e emigrimit, Shqipëria vuan edhe nga raporti mjaft i ulët midis të punësuarve për të cilët paguhen kontributet e sigurimeve shoqërore dhe përfituesve të pensionit. Kjo normë e varësisë sistimore ka pësuar një rënie të fortë ndër vite. Për shembull, në vitin 1990 në Shqipëri kishte 4.5 kontribuues të sigurimeve shoqërore për 1 pensionist. Në vitin 2023 kjo normë varësie ka rënë në 1.17 kontribuues të sigurimeve shoqërore për 1 pensionist.

Vendet e zhvilluara të OECD, pavarësisht plakjes së popullsisë, kanë ende një normë varësie prej 2 kontribuuesish për 1 pensionist. Sipas të dhënave të para pak viteve, mesatarja evropiane është 3.3 kontribuues për 1 pensionist. E njëjta gjë vlen edhe për SHBA e pak viteve më parë, me 3 kontribuues për 1 pensionist. Edhe krahasuar me vendet e rajonit, Shqipëria mbetet mbrapa. Jo vetëm shumë më pas Kosovës, e cila në vitin 2018 kishte 7.8 kontribuuese për 1 pensionist, por edhe Serbisë e cila sot ka 1.32 kontribuues për 1 pensionist.

Përveç plakjes së popullsisë dhe shkallës së lartë të emigracionit, një faktor shumë përcaktues për këtë normë të ulët varësie sistemore është informaliteti në punë. Nëse kryqëzojmë të dhënat e studimit “Tregu i Punës 2023” të INSTAT-it dhe të “Statistikave të Sigurimeve Shoqërore 2023” të botuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, rezulton se 44.4% e të punësuarve në Shqipëri punojnë në të zezë, duke mos paguar ose mos iu paguar kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Sipas llogaritjes së disa viteve më parë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (2019), informaliteti në punë në Shqipëri arrin deri në 56.7%. Më e udhës do të ishte të hamendësonim se norma reale e informalitetit në punë në Shqipërinë e sotme është diku rreth 50% e të punësuarve.

Kjo normë e ulët varësie sistemore bëhet edhe më e ndjeshme nga fakti se për një pjesë jo të vogël të të punësuarve nuk bëhet deklarimi i plotë i pagës. Rreth 1\3 e të punësuarve merr pagë reale më të lartë se paga e deklaruar (zakonisht paga minimale) mbi të cilën llogaritet kontributi i sigurimeve shoqërore. Kjo do të thotë se ata vetë do të marrin një pension më të ulët kur të mbushin moshën dhe kontributet e munguara të sotme ulin nivelin e pensionit që marrin të moshuarit e sotëm.

Nga ana tjetër, në buxhetin e sigurimeve shoqërore ka gjithnjë një boshllëk që vjen prej borxheve të papaguara të bizneseve dhe administratës publike (në kuptimin e vonesave ose mosderdhjes së kontributeve për punonjësit e tyre). Kësisoj në vitin 2023 ky borxh arrinte në 214 milionë euro. Përmasat e këtij borxhi rriten vit pas viti, duke kontribuar në nivelin tejet të ulët të pensioneve të sotme.

Pavarësisht problemeve të mësipërme, varfëria e pensionistëve aktualë lidhet edhe me strukturën e punësimit në Shqipërinë e sotme. Në vitin 2023 popullsia ekonomikisht joaktive në vendin tonë, qytetarëve të moshës 15 deri 64 vjeç që nuk janë në marrëdhënie pune dhe nuk po kërkojnë punë, ishte 24.3% (ose 832,674 vetë). Afërmendsh një pjesë e mirë e tyre (39.7%) përbëhet nga nxënësit dhe studentët. Por pjesa tjetër ka mundësi të përfshihet në marrëdhëniet e punës, por nuk mundet, duke reduktuar realizimin e potencialeve ekonomike të vendit dhe mos dhënë kontributin e vet në shëndoshjen e skemës së sigurimeve shoqërore. Mes popullsisë ekonomikisht joaktive, sipas parametrave të punës produktive që nuk e njeh dhe vlerëson financiarisht punën e papaguar të kujdesit në familje, mbizotërojnë gratë. Sipas raportit të janarit 2024 të Fondit Monetar Ndërkombëtar, pjesëmarrja e grave në forcat e punës është 13% më e ulët se ajo e burrave. Për shkak të mungesës së politikave dhe institucioneve publike të kujdesit për fëmijët, një numër jo i vogël grash janë të shtrënguara të kryejnë punë brenda shtëpisë, të cilat nuk njihen nga ligji dhe nuk prodhojnë efekte financiare në PBB dhe në skemën e sigurimeve shoqërore.

Nga ana tjetër, mes personave ekonomikisht aktivë futen edhe të papunët, pra qytetarët në moshë pune, që po kërkojnë punë ose janë të gatshëm të pranojnë një vend pune nëse u ofrohet. Prej vitesh Shqipëria ka një shkallë papunësie prej

rreth 11%, shkallë e cila arrin deri në 25% në grupmoshën 15 vjeç deri në 24 vjeç (ku futen të rinjtë që nuk vazhdojnë shkollën). Impakti i papunësisë përkeqësohet kur del në pah fakti se në vitin 2023 është rritur me 4.3% numri i të papunëve afatgjatë në mes të tërësisë së të papunëve. Ky nivel papunësie, që nuk reduktohet ndjeshëm pavarësisht normës së lartë vjetore të emigrimit dhe deklaratave të qeverisë se Shqipëria po vuan nga mungesa e forcës punëtore, ndikon në reduktimin e kontributeve për sigurimet shoqërore dhe masën e pensionit të sotëm.

Një faktor tjetër me ndikim në nivelin e ulët të pensioneve janë pagat që marrin të punësuarit në Shqipëri. Vendi ynë ka një nivel zyrtar të pagës minimale bruto prej 40,000 lekësh. Shumë të punësuar informale marrin një pagë më të ulët se ky nivel. Gjithsesi edhe mes punëtorëve të formalizuar, niveli i pagave është mjaft i ulët nëse krahasohet me nevojat e jetës dinjitoze dhe kërkesave të sistemit të sigurimeve shoqërore. Sipas studimit “Tregu i punës 2023” të INSTAT-it, 57.9% e të punësuarve marrin pagë bruto deri në 60,000 lekë (të reja). Në programin e Lëvizjes BASHKË, paga 60,000-lekëshe duhet të bëhet niveli i dinjitetshëm i pagës minimale në ekonominë e sotme shqiptare. Gjithsesi niveli aktual i pagave, ku shumica e punëtorëve marrin një pagë që mezi u del për të plotësuar nevojat më bazike, është i pamjaftueshëm për të mbajtur një sistem të qëndrueshëm pensionesh.

FIG. 10 SHPËRNDARJA E KONTRIBUESVETË PUNËSUAR ME PAGË SIPAS GRUPIMEVE TË PAGËS MESATARE MUJORE BRUTO, 2023

Distribution of employee contributors by average monthly gross wage intervals, 2023





Figura 17: (Burimi: INSTAT: Tregu i punës 2023)

Ky nivel i ulët pagash është sa shkak, aq edhe pasojë e nivelit të ulët të produktivitetit të punës në ekonominë shqiptare. Për shkak të emigracionit, prapambetjes teknologjike, korrupsionit, kapjes së shtetit, monopoleve, mangësive në sistemin arsimor, mungesës së të drejtave në punë, hendekut gjinor në punësim etj., sot ekonomia shqiptare mbetet në bisht të vendeve të rajonit e më gjerë për sa i përket produktivitetit të punës. Në tabelën e mëposhtme, të botuar në raportin e janarit 2024 nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, vihet re niveli tejet i ulët i produktivitetit të punës dhe i pagave në Shqipëri.

Wage and Labor Productivity, 2022

(US \$, x axis; PPP adjusted international \$, y axis)



Sources: Haver Analytics and IMF staff calculations.

Figura 18: (Burimi: IMF Country Report No. 24/7, Albania, January 2024)

Një pjesë e konsiderueshme e ekonomistëve ortodoksë shprehen se produktiviteti i punës duhet të rritet më parë dhe më shpejt se niveli i pagave. Kjo çështje është e diskutueshme edhe teorikisht, pasi një punëtor i mirëpaguar dhe me më shumë të drejta në vendin e punës është më i motivuar që të punojë dhe cilësia e produktit të punës së tij rritet. Sidoqoftë, Shqipëria e sotme vuan nga urgjenca e largimit masiv të forcës punëtore. Një pjesë e bizneseve prodhuese nuk arrijnë të gjejnë mjaftueshëm punëtorë ose të zëvendësojnë ata që largohen në

emigracion. Prandaj për të mbajtur në këmbë dhe zhvilluar ekonominë shqiptare, si dhe për të rritur produktivitetin e punës, është e nevojshme rritja e pagave. Kjo rritje, afërmendsh, duhet të shoqërohet me rritjen e kualifikimit të forcës punëtore, por edhe me zhvillim teknologjik, çka do të rriste seriozisht produktivitetin e punës. Kombinimi i rritjes së produktivitetit të punës dhe pagave do të ishte faktor përcaktues në rritjen e kontributeve për skemën e sigurimeve shoqërore.

Një tjetër problem i strukturës së pensioneve në Shqipëri është niveli i shpërpjesëtuar i kontributeve për skemën e sigurimeve shoqërore. Shqipëria ka një përqindje relativisht të lartë të kontributeve për çdo të punësuar në skemën e sigurimeve shoqërore: 24.5% (ku 15% paguhen nga punëdhënësi dhe 9.5% nga punëmarrësi – ndonëse ekonomistë si Joseph Stiglitz mendojnë se nuk ka rëndësi ndarja punëdhënësi-punëmarrës në kontribute, pasi praktikisht shuma e kontributit duhet konsideruar si taksë mbi punën). Ka vende të zhvilluara, si për shembull Italia, që kanë një përqindje edhe më të lartë, 33%. Gjithsesi mesatarja e vendeve të OECD është 18.2%. Problemi me një normë standarde të kontributeve (nëse i konceptojmë si taksa mbi punën) është karakteri i tyre i sheshtë. Kësisoj edhe një punëtor me pagë minimale, edhe një i punësuar me pagë shumë të lartë këtë aspekt të taksave mbi punën e kanë në të njëjtin nivel.

Një tjetër problem i lidhur me nivelin e pensioneve në Shqipëri është modelimi i rritjes së pensioneve si indeksim që përputhet me inflacionin vjetor. Në botën e sotme indeksimi vjetor mbi bazën e inflacionit është masa më e përhapur. Sidoqoftë, nëse u referohemi vendeve të zhvilluara, niveli i pensioneve mbetet në nivele të larta. Kësisoj indeksimi në bazë të inflacionit nënkupton ruajtjen e

një standardi të mirë jetese. Problemi me Shqipërinë është se duke pasur një nivel jashtëzakonisht të ulët të pensioneve, ndër më të ulët në Evropë, indeksimi mbi bazën e inflacionit vetëm sa riprodhon vit pas viti mjerimin e pensionistëve. Po ashtu në vendin tonë indeksimi lidhet më normën e përgjithshme të inflacionit, ndërkohë që inflacioni për ushqimet dhe pijet joalkoolike, që përfshijnë shumicën dërrmuese të shpenzimeve të pensionistëve, ndër vite ka qenë më i lartë se inflacioni i përgjithshëm.

Nga ana tjetër, një pjesë e vendeve të zhvilluara zgjedhin një model tjetër të indeksimit, atë që lidhet me rritjen e pagave – pensionet rriten me të njëjtin ritëm si pagat – ose me një kombinim të rritjes së pagave dhe inflacionit. Kësisoj tetë nga vendet e OECD për rritjen e pensioneve marrin në konsideratë jo vetëm rritjen e pagave, por edhe rritjen e PBB. Sikur të përdorëshin këto modele në Shqipëri, rritja e përvitshme e pensioneve do të ishte më e lartë dhe e drejtë nga pikëpamja sociale.

Problem tjetër i indeksimit aktual të pensioneve në Shqipëri është që të gjitha pensionet indeksohen në të njëjtën përqindje. Në tetor të 2024 qeveria shqiptare i indeksoi të gjitha pensionet me 4.1%. Ky indeksim uniform është jo vetëm qesharak për pensionistët që marrin pensione nënmesatare, por edhe zgjeron hendekun midis shumicës dërrmuese të pensionistëve që marrin pensione tejte të ulëta dhe pakicës që përfiton pensione të kënaqshme. Ekspertët vendas propozojnë që indeksimi i pensioneve të bëhet me disa fasha dhe pensionet e ulëta të indeksohen më shumë se pensionet e mesme dhe të larta, ndërkohë që pensionet e mesme të indeksohen në një përqindje më të lartë se pensionet e larta.

Mungesa e një pjese të rëndësishme të marrëveshjeve të njohjes së pensioneve

për emigrantët shqiptarë që kanë punuar një pjesë të jetës në Shqipëri dhe një pjesë të saj jashtë Shqipërisë ndikon për keq në përjashtimin e shumë emigrantëve nga e drejta për të gëzuar pension në Shqipëri (dhe/ose në vendin/vendet ku kanë punuar). Vitin e kaluar është nënshkruar një marrëveshje për njohjen reciproke të kontributeve pensionale midis Shqipërisë dhe Italisë, me gjasë si “shpërblim” për tjetërsimin e sovranitetit territorial të Republikës së Shqipërisë për menaxhimin e refugjatëve që nisen nga vendet e Afrikës për në Itali. Sidoqoftë kjo marrëveshje dhe të tjera pararendëseve, kryesisht me vende ku nuk ka një numër domethënës emigrantësh shqiptarë, është tejte e pamjaftueshme nëse marrim në konsideratë shumësinë e vendeve ku shqiptarët kanë emigruar dhe vazhdojnë të emigrojnë (Greqi, Mbretëria e Bashkuar, SHBA etj.). Në mungesë të marrëveshjeve me të gjitha shtetet ku ka një prani domethënëse të emigrantëve shqiptarë, këta të fundit mund të gëzojnë vetëm pension social në Shqipëri pasi të mbushin moshën 70 vjeç, madje një pjesë syresh rrezikon edhe që të mos përmbushë vitet e duhura të punës për të përfituar pension në vendet ku kanë emigruar (kjo edhe për shkak të punës në të zezë që një pjesë e konsiderueshme e shqiptarëve janë shtrënguar të bëjnë gjatë viteve të para të emigrimit të tyre).

Një tjetër faktor që ndikon në varfërinë e pensionistëve është korrupsioni dhe shpërdorimet e buxhetit të shtetit. Buxheti i shtetit subvencionin 17.6% të shpenzimeve për pensionet, ndërkohë që pjesa tjetër vjen nga kontributet e sigurimeve shoqërore. Në këtë kuptim, niveli i korrupsionit dhe shpërdorimeve në buxhet ka efekte të drejtpërdrejta në masën e transfertave drejt skemës së sigurimeve shoqërore. Shumëkush shtron sot pyetjen se sa është niveli i korrupsionit në Shqipëri. Renditja e Transparency International përcakton perceptimin e qytetarëve për korrupsionin, por jo për-

masat e tij. Nëse i referohemi qendrës studimore Altax, në vitin 2023 kostoja e korrupsionit ka qenë 575 milionë euro. Kjo shumë thuhet se dyfishohet nëse abuzimeve në prokurimet publike dhe shpenzimet qeveritare, u shtojmë edhe shkeljet e disiplinës financiare në tatime, dogana dhe administrimin e kompanive publike. Në këtë këndvështrim më të gjerë të abuzimeve, Kontrolli i Lartë i Shtetit në vitin 2022 e ka llogaritur dëmin financiar në 122 miliardë lekë (rreth 1.04 miliardë euro, nëse i referohemi kursit të këmbimit të kohës).




Figura 19: (Burimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore: Statistika të Sigurimeve Shoqërore, viti 2023)

Ndonëse qeveria mburret se i rrit çdo vit shpenzimet për pensionet (ku mblidhen bashkë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe subvencionin nga buxheti i shtetit), sërish Shqipëria mbetet mbrapa jo vetëm vendeve të zhvilluara, por edhe vendeve të rajonit. Ndër vite Shqipëria ka shpenzuar midis 6% dhe 7% të PBB për pensionet. Në vitin 2025 vetë qeveria parashikon që ky shpenzim do të shkojë në 7.3% të PBB, çka është sërish më e ulët se vendet e rajonit (të cilat e kanë 9% e sipër) apo vendet e Bashkimit Evropian (ku arrihet në nivelin e rreth 13% të PBB).

Expenditure on Pensions
(Percent of GDP)




Figura 20: (Burimi: IMF Country Report No. 24/7, Albania, January 2024)

III. Alternativa e Lëvizjes BASHKË

Shqipëria ka nevojë për reforma ekonomike, sociale dhe institucionale të gjithanshme për të zgjidhur një herë e mirë plagën sociale të pensioneve të mjerueshme dhe për t'u siguruar pensionistëve të ardhura të mjaftueshme dhe dinjitetin e munguar në gjithë këto vite. Lëvizja BASHKË angazhohet që me të gjitha kapacitetet e veta politike të jetësojë politikat e mëposhtme.

Mbështetje e familjeve të reja dhe rritje e lindshmërisë

Nuk mund të ketë ardhmëri të pensioneve dinjitoze nëse nuk rivendosen raportet e shëndosha demografike midis popullsisë ekonomikisht aktive dhe qytetarëve në moshë pensioni. Që të vendoset ky ekuilibër afatgjatë nevojiten masa mbështetëse për familjet e reja që shkojnë mjaft më larg sesa thjesht bonuset njëherëshe për fëmijë të lindur. Vendet e zhvilluara që i zbatojnë këto politika e shtrijnë mbështetjen financiare disa vite rresht. Për shembull, Gjermania (viti 2015) u siguronte mbështetje tre vjet çdo fëmije prej 184 eurosh në muaj.

Gjithsesi përparësi e qasjes së Lëvizjes BASHKË do të jenë përmirësimi dhe zbatimi rigoroz i legjislacionit të punës për gratë shtatzëna. Siguria në punë e grave jo vetëm do të rrisë numrin e grave që janë në marrëdhënie pune, por edhe do t'u krijojë kushtet ekonomike për të lindur fëmijë nëse dëshirojnë. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar, mbyllja e hendekut gjinor në punësim do ta rriste nivelin e PBB me rreth 5%, duke shtuar kështu edhe të ardhurat e sigurimeve shoqërore.

Lëvizja BASHKË zotohet gjithashtu se do të rrisë financimin publik për çerdhe e kopshte cilësore në zonat urbane dhe rurale, ku fëmijët mund të rriten shëndetshëm, duke u mundësuar prindërve të hyjnë në marrëdhënie pune produktive.

Nga ana tjetër, programi ynë arsimor i shkollimit me afat të gjatë – ku fëmijët mund të qëndrojnë në shkollë pas orës së mësimi, duke ngrënë një vakt të ngrohtë, bërë detyrat dhe duke u angazhuar në kurse sportive dhe artistike brenda mjediseve të shkollave publike – do t'u sigurojë prindërve të tyre kushtet e nevojshme ekonomike e sociale për të menduar për lindjen e fëmijëve.

Zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm

Shqipëria ka nevojë urgjente të nisë procesin e transformimit ekonomik drejt modelit të zhvillimit të qëndrueshëm. Mbështetja e bujqësisë, industrisë dhe shërbimeve të kualifikuara – duke nxitur eksportet dhe thithjen e investimeve të huaja direkte në sektorë produktivë – jo vetëm do të mundësonte ngjitjen e Shqipërisë në zinxhirin ndërkombëtar të vlerës, por edhe do të rriste produktivitetin e punës dhe pagat. Nga ana tjetër, këto politika do të mundësojnë uljen e ndjeshme të papunësisë dhe integrimin në marrëdhëniet e punës produktive të një pjese të rëndësishme të popullsisë joaktive ekonomikisht. Zhvillimi i hov-

shëm ekonomik do të shkurajonte emigracionin nga Shqipëria drejt vendeve të zhvilluara dhe njëkohësisht do të jepte sinjale inkurajuese për emigrantët shqiptarë që të mendonin kthimin e tyre në Shqipëri si investitorë ose punëtorë.

Në vendet e zhvilluara të Evropës ekonomistët llogarisin që nevojitet një rritje vjetore e produktivitetit të punës prej 1.5% në vit për të mbajtur nivelin aktual të pensioneve në vite. Vendi ynë, i cili e nis rrugëtimin zhvillimor nga një stad dukshëm më i prapambetur, ka nevojë për një rritje më të shpejtë të produktivitetit të punës dhe të pagave të lidhura me të. Mirëpo potencialet e vendit tonë – nëse merren seriozisht politikat zhvillimore, të cilat do të nxisnin edhe kualifikimin e vazhdueshëm të forcës punëtore – janë të realizueshme në afatmesëm.

Kësisoj, rritja e punësimit dhe rritja e pagave do të sillte më shumë të ardhura në buxhetin e sigurimeve shoqërore, duke mundësuar rritjen e pensioneve për pensionistët e sotëm dhe siguruar një nivel të mirë pensionesh për pensionistët e ardhshëm.

Lufta ndaj informalitetit në punë e paga dhe ndaj evazionit fiskal

Lëvizja BASHKË ka vullnetin politik dhe kapacitetet qeverisëse për të ndërmarrë politika që luftojnë abuzimet në punë, por edhe nxisin formalizimin e të punësuarve. Përmes rimëkëmbjes së Inspektoratit të Punës dhe politikave nxitëse të formalizimit në punë, duke nisur nga nxitja e krijimit të Shoqërive të Bashkëpunimit Bujqësor si mënyra më efikase e rritjes së produktivitetit bujqësor dhe e formalizimit të punës në bujqësi, shumë shpejt Shqipëria mund ta përgjysmojë numrin e të punësuarve për të cilët nuk paguhen sigurimet shoqërore, duke arritur të paktën nivelin e vendeve fqinje. Nëse në afatshkurtër përgjysmojmë informalitetin në punë, kjo do të thotë

se do të fusnim në rrjedhat e të drejtave në punë 298,584 të punësuar. Nëse i hamendësojmë punëtorët e formalizuar sikur të gjithë marrin pagë (ose të ardhura nga vetëpunësimi) sa paga aktuale minimale bruto prej 40,000 lekësh (të reja), në buxhetin e sigurimeve shoqërore (pa sigurimet shëndetësore) do të shtoheshin rreth 354,896,942 euro në vit. Nëse marrim si pikë referimi pagën e re minimale që propozon Lëvizja BASHKË në këtë program prej 60,000 lekësh (të reja), shtesa në buxhetin e sigurimeve shoqërore do të ishte 532,363,328 euro në vit. Nëse në afatgjatë mundësohet formalizimi i thuajse të gjithë personave në marrëdhënie pune, shtesa në buxhetin vjetor të sigurimeve shoqërore do të arrinte në 1,064,726,657 euro në vit. Po ashtu, zhvillimi ekonomik do të sillte rritjen e pagës mesatare, çka do të rriste edhe më nivelin e kontributeve në skemën e sigurimeve shoqërore.

Shifrat e mësipërme nuk janë abstrakte. Ato mbështeten në politikat zhvillimore të Lëvizjes BASHKË, të cilat do të nxisin punësimin me pagë dinjitoze në kushtet e një ekonomie që rritet shpejt dhe në mënyrë të qëndrueshme. Sidoqoftë struktura ekonomike e Shqipërisë do të karakterizohet edhe në të ardhmen e parashikueshme nga një numër jo i vogël i të vetëpunësuarve dhe të punësuarve në biznese të vogla ose familjare. Si biznese të vogla, të cilat nuk kanë tiparet e ekonomisë së shkallës, ato vuajnë nga një masë dhe normë e ulët fitimi. Kësisoj nevojiten politika mbështetëse publike në mënyrë që të punësuarit në bizneset e vogla dhe familjare të kenë të paguara sigurimet shoqërore pa vënë në rrezik mbijetesën e këtyre bizneseve.

Një shembull të mirë në këtë rast na japin politikat që janë zbatuar mbi një dekadë më parë në Turqi, e cila vuan nga probleme strukturore të ngjashme me Shqipërinë e sotme. Studimet për Turqinë tregojnë se subvencionet

shtetërore mbuluan rreth 25% të kostos së sigurimeve shoqërore dhe rreth 6% të kostos tërësore të punës. Të tilla masa ia kanë dalë ta ulin me 17 pikë përqindjen totale të informalitetit të punës në Turqi. Ngjashëm edhe në Shqipëri mund të aplikohen politika të tilla. Në njërin anë subvencionimi i bizneseve të vogla dhe nga ana tjetër zbatimi rigoroz i ligjit për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha kur vjen puna te pagesa e sigurimeve shoqërore, do të mundësonte një ulje domethënëse që në afatshkurtër të informalitetit në punë.

Një tjetër masë që do të ndreqte padrejtësitë e shkuara në raport me punëtorët të cilët janë detyruar të punojnë në informalitet ose shteti u ka humbur dokumentacionin që vërteton vitet dhe masën e kontributeve të tyre në skemën e sigurimeve shoqërore, do të ishte themelimi i një dhome të posaçme në Gjykatën Administrative që merret me çështjet e pensioneve dhe lehtësimi i procedurave për të vërtetuar vitet e punës. Masa të tilla do të përshpejtonin kohën kur gjykata do të njihte vitet e punës dhe kështu do t'u siguronte sa më parë pensionistëve pensionin që meritojnë në bazë të punës së tyre.

Ndryshimi i masës së kontributit

Një mënyrë për të rritur nivelin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe vendosur drejtësi shoqërore midis pensionistëve të së ardhmes do të ishte heqja e tavanit të pagës maksimale për të cilën paguhen kontributet, duke e shoqëruar këtë të fundit me një normë më të lartë të kontributeve për pagat shumë të larta dhe duke rritur përqindjen e kontributit të punëdhënësit për punëmarrësin. Propozimi ynë është që për punëmarrësit me paga shumë të larta, të cilët në pjesën më të madhe janë edhe të punësuar në kompani të mëdha, të rritet me 2% niveli i kontributit për

sigurimet shoqërore dhe 3.5% të tjera të paguhen shtesë nga punëdhënësi.

Vendosja e minimumit jetik

Masat e mësipërme do të mundësonin edhe vendosjen e minimumit jetik. Ky nivel bazik jetese do të përcaktojë nivelin e pensionit minimal dhe do të vendosë bazën mbi të cilën do të llogariten të gjitha pensionet. Në vitin 2019 një studim i Avokatit të Popullit e ka llogaritur minimumin jetik për familjen me një person në vlerën 17,875 lekë (të reja) në muaj. Nëse marrim në konsideratë vlerat e inflacionit në pesë vitet e fundit, minimumi jetik në Shqipërinë e sotme duhet të jetë 21,168 lekë të reja. Kjo masë do të sigurojë pensione të jetueshme për çdo pensionist, duke nisur nga mbi 520,000 pensionistët që sot marrin pensione më të ulëta se minimumi jetik. Rritja e pensioneve të tjera, që sot janë mbi nivelin e minimumit jetik, do të kryhej në një masë më të vogël duke garantuar qëndrueshmërinë e skemës së sigurimeve shoqërore dhe jetësimin e parimeve të drejtësisë shoqërore.

10 vite kontribute për të përfituar pension kontributiv

Duke marrë në konsideratë faktin se në tri dekadat e fundit një pjesë shumë e madhe e të punësuarve kanë punuar tërësisht ose pjesërisht në kushte informaliteti, ose kanë punuar në dy ose më shumë shtete për shkak të emigracionit, është shumë e rëndësishme që të vendoset një minimum i ri vitesh për të përfituar pension minimal në moshën zyrtare të daljes në pension. Duke marrë në konsideratë edhe përvojën e vendeve të tjera, Lëvizja BASHKË propozon që kohëzgjatja e nevojshme e punës për të përfituar pension kontributiv të jetë 10 vite dhe pensioni kontributiv të jetë më i lartë se niveli i pensionit social. Kjo

masë do të nxirrte nga pasiguria një numër të konsiderueshëm pensionistësh. Afërmendsh, me lidhjen e marrëveshjeve të njohjes së kontributeve pensionale me shtetet ku kanë emigruar shqiptarët dhe reduktimin e ndjeshëm të nivelit të informalitetit në punë, ky prag mund të rimendohet në afatmesëm për të rivendosur ekuilibrat midis kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe masës së përfitimeve nga pensionet.

Ulje e moshës së përfitimit të pensionit social

Masa e mësipërme nuk do të mund të zgjidhte krejt problemin e shkaktuar nga informaliteti i dendur dhe masiv në punë i dekadave të fundit. Sërisht do të kishim një masë pensionistësh të cilët nuk do të arrinin sot dhe pak vitet e ardhshme numrin e viteve të mjaftueshme për të përfituar pension minimal. Sikundër ekziston sot një numër grash të cilat për shkak të pasigurisë ekonomike të familjes dhe kulturës patriarkale kanë shumë pak, në mos aspak, vite pune jashtë shtëpisë. Kësisoj është e domosdoshme që të ulët mosha e përfitimit të pensionit social. Qeveria aktuale po mendon ta rrisë nga 70 vjeç në 75 vjeç, duke e kotësuar logjikën e pensionit social. Propozimi i Lëvizjes BASHKË është që mosha e përfitimit të pensionit social të jetë 65 vjeç për gratë dhe 67 vjeç për burrat. Një mënyrë tjetër për të garantuar pensione dinjitoze për gratë do të ishte llogaritja e viteve të punës së papaguar të kujdesit në familje si punë kontributive, ku buxheti i shtetit do të kompensonte financiarisht vitet për të përfituar pension mbi nivelin e pensionit social.

Kur shtrojmë çështjen e moshës së daljes në pension, ligji aktual duhet reformuar duke vendosur kategorizime më të imta të llojeve të punës bazuar në efektet e punës në shëndetin dhe jetëgjatësinë

mesatare të punëtorëve. Nga ana tjetër duhet kuptuar se rritja e vazhdueshme e moshës së pensionit përbën një pengesë për integrimin e të rinjve në tregun e punës, të cilët kanë një potencial më të madh produktiv.

Rritja e përvitshme e pensioneve

Për të pasur pensione dinjitoze dhe vendosur raporte të drejta midis zhvillimit ekonomik, pagave dhe pensioneve është i nevojshëm ndryshimi i logjikës së indeksimit të pensioneve. Sipas ligjit të sigurimeve shoqërore, sot pensionet indeksohen mbi bazën e normës së përvitshme të inflacionit. Ky indeksim nënkupton riprodhim të varfërisë dhe nuk i lidh pensionet me kushtet e përgjithshme të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit, duke riprodhuar statusin e pensionistëve si të marginalizuar.

Duke marrë përvojën më të mirë botërore, Lëvizja BASHKË zotohet që rritja e përvitshme e pensioneve (pas vendosjes së minimumit jetik) do të ndjekë logjikën e rritjes së pagës mesatare dhe çmimeve, duke përzgjedhur vit pas viti normën më të lartë të njërës prej të dyjave. Kësisoj nëse norma vjetore e inflacionit do të jetë 3% dhe rritja e pagës mesatare 6%, pensionet do të rriten me 6%.

Në kushtet aktuale ku masa e pensioneve është tejet e ulët dhe derisa të vendoset përfundimisht standardi i minimumit jetik, rritja e pensioneve duhet të jetë e diferencuar. Ekspertët vendas propozojnë tri shkallë progresive të indeksimit të pensioneve, që reflektojnë ndarjen aktuale të pensionistëve që marrin pensione të ulëta, pensione mesatare dhe pensione të larta. Pensionet e të parëve do të indeksoheshin me një përqindje më të lartë, e të dytëve me një përqindje pak më të ulët, dhe e të tretëve me një përqindje më të ulët.

Pikësnyimi afatgjatë i politikave të rritjes së pensioneve (të shoqëruara nga masat për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë dhe sigurimin e të drejtave në punë) është që të kemi një normë të zëvendësueshmërisë së pensioneve rreth 70% të të ardhurave mesatare të mëparshme. Studiuesit e çështjeve ekonomiko-shoqërore mendojnë se kjo normë u mundëson pensionistëve të ruajnë të njëjtin nivel jetese dhe pavarësie ekonomike krahasuar me kohën kur kanë qenë në marrëdhënie pune.

Marrëveshje të reja të njohjes së kontributeve pensionale

Një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve shqiptarë në vend dhe diasporë vuajnë nga mosnjohja e kontributeve të punës së tyre në vendet ku kanë punuar. Për shembull, një qytetar shqiptar që ka punuar 10 vjet në Shqipëri dhe nga 10 vjet në dy ose tri vende të tjera (nuk po marrin parasysh këtu faktin që një pjesë jo të vogël të viteve të punës emigrantët shqiptarë kanë qenë të detyruar t'i bëjnë në të zezë), nuk përfiton dot pension as minimal në asnjërin prej këtyre vendeve. Kjo e bën të domosdoshme lidhjen e marrëveshjes së njohjes së kontributeve pensionale me të gjitha vendet ku punojnë shqiptarët. Lëvizja BASHKË do të punojë me përparësi për të lidhur marrëveshje të tilla me vende si Greqia, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Franca, Holanda, Spanja, Malta, shtetet skandinave etj.

Miratimi i Statusit të Minatorit

Lëvizja BASHKË zotohet që do të miratojë Statusin e Minatorit, një prej shtyllave të të cilit është përmirësimi i ndjeshëm i masës së pensioneve dhe kushteve të daljes në pension të minatorëve dhe ish-minatorëve. Mosha për gëzimin e plotë do të përshkallëzohet

sipas kërkesave të kahershme të minatorëve dhe ish-minatorëve.

Punë në nëntokë	Punë gjithsej	Mosha e pensionit të plotë
11 vite	25 vite	53 vjeç
10.5 vite	25 vite	54 vjeç
10 vite	25 vite	55 vjeç

Pensioni minimal për minatorët duhet të jetë të paktën sa 135% e pagës minimale zyrtare. Nëse i referohemi pagës minimale të sotme prej 40,000 lekësh (të reja), pensioni minimal i minatorit duhet të jetë 54,000 lekë (të reja). Nga ana tjetër pensionet e minatorëve do të shtohen me 1% për çdo vit pune nëntokë mbi 11 vite. Afërmendsh, këto ndryshime do të përfshijnë edhe minatorët aktualë, edhe minatorët e dikurshëm.

Reformimi i skemave private të sigurimit

Në vitin 2023 Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar një ligj të ri për fondet e pensionit privat. Pikësnyimi formal i këtij ligji do të ishte të nxiste punëmarrësit dhe punëdhënësit që të kontribuonin edhe në skemat private pensionale (në pronësi të bankave private dhe kompanive private të sigurimit) për të mundësuar një nivel më të lartë pensionesh në të ardhmen. Vetë ekzistenca e skemave të tilla private është pranim i dështimit të skemës publike të detyrueshme të kontributeve. Në një pjesë të vendeve të zhvilluara prej vitesh është bërë një ndarje në tri shtylla e skemës pensionale. Shtylla e parë zakonisht është publike, financohet nga shteti dhe siguron pension social ose minimal. Shtylla e dytë është e detyrueshme, bazohet në të ardhurat e punëmarrësve dhe mund të jetë në pronësi dhe administrim publik ose privat. Shtylla e tretë zakonisht është private dhe ka karakter vullnetar. Ligji aktual në Shqipëri siguron një bashkërendim të brishtë të këtyre shtyllave.

Lëvizja BASHKË shprehet kundër tentativave për ta bërë të detyrueshme shtyllën e dytë (private) të pensioneve, sipas modelit të vendosur në Kili gjatë diktaturës së Augusto Pinochet-it dhe që promovohet sot nga bankat private dhe kompanitë e sigurimit në pronësi të oligarkëve. Një reformë e tillë do të sillte me vete një kosto tejet të lartë të tranzicionit nga skema publike drejt skemës private, do të zhyste edhe më shumë në mjerim pensionistët e sotëm dhe do të sillte pasiguri për pensionet e ardhshme në varësi të luhatjes së bursave financiare.

Lëvizja BASHKË beson se fuqizimi i skemës (bismarkiane) Pay-As-You-Go të pensioneve e cila – e kombinuar me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, përmirësimin e raporteve demografike, formalizimin e marrëdhënieve të punës dhe luftën ndaj korrupsionit – do të mundësonte qëndrueshmërinë e skemës pensionale.

Skemat private të pensioneve mund të vazhdojnë punën për t'u siguruar anëtarëve të tyre të ardhura më të larta kur dalin në pension. Sidoqoftë këto skema aktualisht vuajnë nga fakti që në Shqipëri nuk ka ende bursë financiare. Po ashtu, kuadri ligjor i këtyre skemave diskriminon punëmarrësin që bëhet pjesë e këtyre skemave dhe privilegjon kompanitë themeluese të fondeve të investimit privat. Fitimet e këtyre të fundit nuk tatohen, ndërkohë që të ardhurat e anëtarit të fondit privat (pensionistit) janë të tatueshme. Lëvizja BASHKË zotohet që ky diskriminim në trajtim të marrë fund dhe fondet e investimit privat të tatohen njëjloj si korporatat e tjera. Nga ana tjetër, fonde të ngjashme të sigurimit mund të themelohen edhe si publike në pronësi dhe administrim, sipas modelit të Fondit Shtetëror të Naftës në Norvegji.

IV. Përfundim

Propozimet e mësipërme shoqërohen pa diskutim me një kosto financiare. Rritja e çdo pensioni me të njëjtën masë sa pensioni minimal për të arritur nivelin e minimumit jetik do të kërkonte një shtesë në buxhet prej 1,023,658,548 eurosh. Nëse marrim në konsideratë faktin që pensionet e mesme dhe të larta do të rriten me një normë më të ulët – duke synuar një nivel pensioni mesatar prej 33,000 lekësh (të reja) – kostoja do të zbriste me disa qindra milionë euro çdo vit. Kjo kosto do të përballohet pjesërisht nga rreth midis 350 milionë deri në 500 milionë euro që do të shtoheshin në buxhetin e sigurimeve shoqërore prej luftës ndaj informalitetit në punë dhe rritjes së pagës minimale, nga njëra anë, dhe rikuperimit të të paktën diç më shumë se 500 milionë eurove në vit nga kostoja e korrupsionit shpërdorimeve dhe mosrealizimit të objektivave të miradministrimit dhe eficiencës financiare të institucioneve publike. Duhet shtuar, nga ana tjetër, se politikat e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik – të shoqëruara me rritjen e ndjeshme të punësimit dhe zvogëlimin e popullsisë ekonomiksht joaktive, si dhe rritjen e produktivitetit të punës dhe pagave – jo vetëm do të siguronin fondet e nevojshme për rritjen e qëndrueshme të pensioneve, por edhe do të garantonin të ardhurat për politika të tjera sociale dhe përmirësimin e shërbimeve publike.

Lëvizja BASHKË zotohet që, në rast të fitimit të mbështetjes së shumicës së qytetarëve, të vërë në jetë në katër vitet e ardhshme të gjitha premtimet e mësipërme. Në çdo rrethanë përfaqësuesit e Lëvizjes BASHKË në Kuvendin e Shqipërisë do të luftojnë politikisht për vendosjen në qendër të diskutimeve parlamentare të programit tonë për pensionet, duke ushtruar trysinë e nevojshme politike dhe qytetare ndaj të gjitha institucioneve publike.

2.2 KUJDESI SOCIAL

Shqipëria mbetet një prej vendeve më të varfra të Evropës. Varfëria është e shtrirë dhe e thellë, duke privuar një pjesë të konsiderueshme të shoqërisë nga mundësitë ekonomike dhe gëzimi i plotë i të drejtave civile e politike.

Problemet dhe shkaqet e tyre

A. Varfëria dhe ndihma ekonomike

Në vendin tonë 30% e popullsisë jeton me 6.85 dollarë (e më pak) në ditë, krahasuar me 2% të kësaj shifre në vendet e Bashkimit Evropian. Sipas të dhënave nga Anketa e Buxhetit të Njësive Ekonomike familjare, shpenzimet mesatare të një familjeje prej 3.7 personash janë 88,367 lekë. Çka do të thotë se niveli mesatar i shpenzimeve ditore për një person është 796 lekë. Edhe në treguesit e tjerë të varfërisë Shqipëria lëngon. Për shembull, në vendin tonë numri i qytetarëve që jetojnë nën kufirin e rrezikut për të qenë të varfër është 576.316. Qytetarët thellësisht të privuar materialisht – kriter që mat mungesat e katër nga nëntë kategoritë e privimit material – përbëjnë 33.2% të shoqërisë, kurse qytetarët thellësisht të privuar nga ana materiale dhe sociale – ku përfshihen shtatë mungesa nga 13 kategori të privimit material – përbëjnë 37% të shoqërisë. Nëse përdoren kriteret më të përparuara të rrezikut për të qenë të varfër ose përjashtimit social (të përcaktuara sipas objektivave të BE 2030: privimi i thellë material, rreziku për të qenë i varfër dhe intensiteti shumë i ulët i punësimit), atëherë shifra arrin në nivelin tejet shqetësues të 44.5%.

Ky nivel varfërie ka shkaqe të thella, që nisin me modelin e keqzhvillimit të deri-

tanishëm, i cili sjell papunësi dhe popullsi ekonomikisht joaktive, intensitet shumë të ulët punësimi, mungesë të investimeve në sektorët produktivë, nivel të ulët të produktivitetit të punës, korrupsion të thellë e kapje të shtetit dhe pamjaftueshmëri të politikave të mbështetjes sociale.

Një nga treguesit e pamjaftueshmërisë së politikave sociale është modeli dhe niveli i ndihmës ekonomike që institucionet e sotme publike japin për më të varfrit. Niveli maksimal i ndihmës ekonomike për familjet në Shqipëri – ku përfshihen familjet me dy të rritur dhe tre fëmijë – është 5760 lekë. Pra 1152 lekë në muaj (ose 38,4 lekë në ditë) për frymë njeriu. Në këto kushte varfërie ekstreme jetojnë 56,528 familje në Shqipëri.

Politikat e integritit në punë të anëtarëve në moshë pune të kësaj kategorie shoqërore kanë mbetur në letër. Shumë pak syresh janë të integruar në programet e punës publike dhe thuajse nuk ekzistojnë të punësuar të kësaj kategorie në kompanitë që fitojnë prokurime publike. Sikundër ka një hendek të madh midis pretendimeve të qeverisë për kurse të arsimimit dhe kualifikimit profesional dhe përfshirjes së të varfërve nga familjet me ndihmë ekonomike në këto programe.

Niveli shumë i lartë i informalitetit në punë, nga njëra anë, rrit artificialisht numrin e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike (sipas legjislacionit në fuqi), duke reduktuar nivelin mesatar të ndihmës ekonomike. Po në një këndvështrim tjetër, çka vihet në dukje edhe nga institucionet ndërkombëtare që studiojnë politikat sociale në vende si Shqipëria, logjika e sotme e politikave të ndihmës ekonomike përjashton nga kjo ndihmë familjet ku një prej të rriturve është i punësuar. Kjo e nxit edhe më shumë informalitetin në punë pasi të punësuarit janë të interesuar të fshehin

faktin që punojnë. Alternativa e Lëvizjes BASHKË, e mbështetur në modelin e minimumit jetik, kërkon që mbështetja ekonomike e familjeve të lidhet me nivelin e të ardhurave të mjaftueshme për të jetuar. Kësisoj kjo mbështetje mund të vazhdojë edhe nëse një ose më shumë anëtarë të familjes janë në marrëdhënie pune, por familja në tërësi ka një nivel të ardhurash më të ulëta se minimumi jetik i llogaritur në bazë të anëtarëve të familjes.

B. Papunësia dhe nxitja e punësimit

Shqipëria e viteve të fundit vazhdon të ketë një shkallë të lartë papunësie, midis 10% dhe 11%. Pavarësisht se nga vendi ynë largohen çdo vit rreth 50,000 qytetarë, shkalla e papunësisë mbetet e pandryshueshme, çka tregon për shkaqet e thella strukturore të papunësisë në Shqipëri. Turizmi mbetet një sektor me punësim të përkohshëm dhe pasiguri në të ardhura. Përveç Tiranës dhe disa qyteteve bregdetare (gjatë verës), anekënd Shqipërisë është e vështirë të gjesh investime produktive dhe gjallëri ekonomike, çka shoqërohet me papunësi të gjatë dhe shkurajim për të kërkuar punë.

Papunësia e gjatë dhe shkurajimi për të kërkuar punë tregohet dhe nga numri tejet i kufizuar i qytetarëve që përfitojnë nga pagesa e përkohshme e papunësisë. Në tremujorin e vitit 2022 numri i përfituesve të pagesës së papunësisë ishte vetëm 2587 vetë, ndërkohë që pagesa mujore e papunësisë ishte mjaft më poshtë nivelit të minimumit jetik, 16,330 lekë. Raporti ndër vite midis pagesës së papunësisë dhe pagës mesatare në Shqipëri mbetet mjaft i ulët, 37%. Vende të rajonit si Serbia e kanë këtë raport 57%. Vendet me politika të zhvilluara sociale si Suedia e kanë këtë raport 80% të pagës për shtatë muajt e parë, kurse më vonë përfitimi arrin në 70% të pagës.

Nga ana tjetër, legjislacioni për nxitjen e punësimit mbetet në letër dhe i mungojnë mekanizmat institucionalë dhe vullneti politik për t'u zbatuar. Sipas ligjit të nxitjes së punësimit (2019), firmave që përfitojnë fonde publike (kryesisht me pronarë oligarkë) u kërkohet që të punësojnë një numër të caktuar të papunësh të regjistruar si të tillë në zyrat vendore, përndryshe do të gjobiteshin. Gjithsesi ky parim mbetet në letër dhe të papunët afatgjatë dhe grupet e veçanta vazhdojnë të mbeten jashtë vëmendjes së shtetit dhe përfitimeve nga politikat sociale. E njëjta gjë vlen edhe për kurset e formimit profesional të cilat, edhe kur funksionojnë, më së shumti përgatitin punëtorë për emigracion.

Mbështetja e mirëfilltë e të papunëve për të jetuar denjësisht disa muaj pasi kanë humbur vendin e punës do t'u mundësonte atyre të kërkonin me më shumë vëmendje punë të përshtatshme për kualifikimin e tyre dhe të mos binin menjëherë në dëshpërimin e papunësisë permanente. Po ashtu do t'u mundësonte më shumë kohë për të kryer kurse profesionale, të cilat duhet të jenë të lidhura me zhvillimin ekonomik të vendbanimeve të tyre dhe projektet zhvillimore të nxitura prej institucioneve publike.

C. Personat me aftësi të kufizuara

Personat me aftësi të kufizuara janë shtresa shoqërore që vuan më së shumti nga politikat e mangëta mbështetëse të institucioneve publike. Sipas të dhënave zyrtare, numri i përgjithshëm i personave me aftësi të kufizuara, ku përfshihen edhe invalidët e punës, ishte 163,298 në vitin 2023. Diskriminimi i kësaj shtrese shoqërore vihet re edhe në mundësinë për t'u arsimuar. 31.9% është përqindja e personave me aftësi të kufizuara që kanë përfunduar arsimin e mesëm ose të lartë, krahasuar me 56.6% për pjesën

tjetër të popullsisë. Nëse marrim në konsideratë vetëm arsimin e lartë, hendeku është edhe më i dukshëm: 6.1% mes personave me aftësi të kufizuara përkundër 21.2% i pjesës tjetër të popullsisë.

Një nga pengesat më të mëdha që ndeshin personat me aftësi të kufizuara është niveli tejet i ulët i mbështetjes ekonomike që marrin nga shteti. Kjo pagesë është rreth 14,500 lekë në muaj (150% e pensionit social), ku futen edhe personat në familje që u shërbejnë personave me aftësi të kufizuara, dukshëm nën nivelin e minimumit jetik që zakonisht llogaritet për qytetarë që nuk kanë të njëjtin nivel vështirësish si bashkëqytetarët e tyre me aftësi të kufizuara. Edhe më e rëndë është gjendja e fëmijëve me aftësi të kufizuara, të cilët vetëm për trajtimin me terapi në institucionet private u duhen rreth 365 euro në muaj, shumë më pak nga niveli i mbështetjes ekonomike që u jep shteti.

Nga ana tjetër, shteti shqiptar nuk ka të dhëna për numrin e personave me aftësi të kufizuara që janë në marrëdhënie pune. Vendet e zhvilluara, si ato të OECD, llogarisin se përqindja e punësimit të personave me aftësi të kufizuara është pak mbi 40%, ndërsa për pjesën tjetër të popullsisë arrin në 75%. Në Shqipëri, me gjasë, niveli i punësimit të personave me aftësi të kufizuara është mjaft më i ulët, por shteti ynë nuk mban statistika për këtë pjesë të rëndësishme të shoqërisë.

Pavarësisht se kuadri ligjor parashikon mbështetje të veçanta për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, këto politika kanë mbetur në letër. Sipërmarrjet e mëdha private nuk i përmbushin detyrimet e tyre ligjore për të siguruar punë për këta qytetarë. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për një pjesë të konsiderueshme të institucioneve publike. Fondi Social i Punësimit nuk është vënë

ende në zbatim. Po ashtu nuk funksionojnë politikat më të gjera të nxitjes së punësimit mes personave me aftësi të kufizuara. Sipas statistikave zyrtare të viteve të fundit, numri i personave me aftësi të kufizuara që regjistrohen si punëkërkues të papunë ishte 542 (viti 2019), ndërsa personat me aftësi të kufizuara që janë bërë pjesë e programeve të nxitjes së punësimit ishte 111 (në të njëjtin vit). Kjo tregon se personat me aftësi të kufizuara nuk kanë shpresë se përmes legjislacionit dhe institucioneve të mbështetjes sociale do të mund të gjejnë punë të përshtatshme për ta.

Nga ana tjetër, për disa kategori të personave me aftësi të kufizuara, si për shembull të verbrit, kuadri ligjor kërkon që të ndërtohen dy qendra pushimi në bregdet dhe në mal për të pushuar këta qytetarë. Afërmendsh diçka e tillë nuk është zbatuar kurrkund. Madje në Shqipëri mungon thuajse tërësisht infrastruktura rrugore që të verbrit të mund të lëvizin në mënyrë autonome.

Po ashtu kuadri ligjor parashikon që shteti t'u mbulojë të sëmureve paraplegjikë dhe tetraplegjikë kostot financiare të materialeve të veçanta higjieno-sanitare. Kjo mbështetje financiare aktualisht është e pamjaftueshme për të mbuluar shpenzimet reale. Po ashtu vetë institucionet publike pranojnë se kanë dështuar politikat e tyre të sigurimit të ortezave dhe protezave për personat me aftësi të kufizuara, duke pamundësuar lehtësimin e lëvizshmërisë së tyre.

Ç'është edhe më e rëndë, institucionet publike nuk sigurojnë ende standardet e mjaftueshme për lehtësinë e lëvizjes dhe aksesit të personave me aftësi të kufizuara. Sipas të dhënave zyrtare, vetëm 34% e objekteve në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes sociale kanë infrastrukturë që u ofron akses personave me aftësi të kufizuara. Po ashtu vetëm 42% e shkollave janë të

pajisura me rampë që mundëson lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara.

Një tjetër problem është shpërfillja e problemeve të personave që vuajnë nga diabeti. Për shembull mungon një regjistër i personave me diabet, ndërkohë që këtyre qytetarëve u mungon mbështetja financiare për blerjen e fishave. Edhe për këta qytetarë mungojnë politikat e nxitjes reale të punësimit. Po ashtu nuk zbatohet modeli bio-psiko-social, për të vlerësuar ndikimin e diabetit, jo vetëm në aspektin mjekësor, por edhe në atë social dhe psikologjik.

Ç'është edhe më problematike, ndryshimet pozitive që hasen herë pas here në legjislacion apo strategji, që vijnë si rezultat i nënshkrimit të konventave ndërkombëtare për mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara, nuk janë shoqëruar me ngritjen e strukturave mbikëqyrëse të zbatueshmërisë së tyre. Kësisoj të gjitha arritjet mbeten në letër, ndërkohë që personat me aftësi të kufizuara nuk gëzojnë shumicën e të drejtave që u takojnë me ligj.

D. Komuniteti rom dhe egjiptian

Ndër komunitetet më të marginalizuara dhe të diskriminuara në Shqipëri janë romët dhe egjiptianët. Për shkak të varfërisë së thellë, këto komunitete janë ndër përfituesit kryesorë (rreth 11,000 qytetarë) të ndihmës (së pamjaftueshme) ekonomike. Një pengesë e madhe në përfitimin e kësaj ndihme nga të gjithë nevojtarët është fakti që një pjesë e anëtarëve të komunitetit rom dhe egjiptian kanë probleme me dokumentacionin ligjor dhe, në kushtet e analfabetizmit, e kanë të pamundur të plotësojnë pa asistencën e duhur formularët e aplikimit për ndihmë ekonomike. Mungesa e dokumenteve dhe regjistrimit (edhe si shtetas në disa raste) e pengon një pjesë të anëtarëve të këtij komuniteti edhe nga gëzimi i të drejtave të tjera ligjore. Prob-

lemt me dokumentet dhe regjistrimin e pronave ka bërë që ky komunitet të jetë veçanërisht i ekspozuar ndaj shpronësimeve dhe dëbimeve, kur u është hapur rruga ndërtimit të kullave apo veprave infrastrukturore, duke mos garantuar për asnjë rast të drejtën e strehimit dhe sigurinë e pronës.

Veçanërisht të vështira janë kushtet e jetesës së anëtarëve të komunitetit rom. Vetë Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë (2021-2025) na thotë se "84% e komunitetit Rom kanë akses në elektricitet dhe 50% e anëtarëve të minoritetit Rom kanë akses në ujin e pishëm në banesat e tyre krahasuar me shifrën 89% që i takon fqinjëve jo-Romë".

Diskriminimi social del në pah edhe në arsim. Sipas të dhënave zyrtare, ka 31% më pak fëmijë të komunitetit rom që ndjekin arsimin parashkollor krahasuar me pjesën e tjetër të shoqërisë. Po aq problematike është edhe ndjekja e arsimit të detyrueshëm, ku vetëm 31% e fëmijëve të komunitetit rom ndjek shkollën, krahasuar me 66% të pjesës tjetër të shoqërisë.

Problemet e thella në arsimim të përgjithshëm e profesional dhe diskriminimi social kanë sjellë një nivel mjaft të ulët të punësimit formal të qytetarëve romë, sidomos të të rinjve. Për shembull, mes 18-24-vjeçarëve, vetëm 22% e të rinjve romë janë në punë, ndjekin shkollën ose një trajnim. Kjo shifër është 58% për pjesën tjetër të shoqërisë. Qytetarët romë janë jo vetëm pak të përfshirë në tregun formal të punës, ku edhe aty për ta zakonisht paracaktohen punët më pak të paguara, por njëkohësisht kryejnë punë të vështira dhe të paqëndrueshme si ajo e riciklimit të mbetjeve.

Deri më sot planet dhe strategjitë qeveritare kanë plotësuar shumë pak nga

nevojat e vërteta të komunitetit rom dhe egjiptian, duke riprodhuar varfërinë dhe segregimin social.

IV. Alternativa ekonomike dhe sociale

Baza e mbështetjes financiare për të varfrit dhe shtresat e marginalizuara do të jetë njohja dhe vendosja me ligj e minimumit jetik i cili, sipas llogaritjeve të derisotme, duhet të jetë 21,168 lekë (të reja). Vendosja e nivelit të minimumit jetik do të rrisë nivelin e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë. Niveli i ndihmës ekonomike për familje do të llogaritet në bazë të numrit të anëtarëve, të ardhurave të tyre dhe masës së mbështetjes shtesë të nevojshme në mënyrë që e gjithë familja të jetojë mbi këtë nivel të ardhurash. Minimumi jetik do të rriste edhe pagesën e papunësisë. Po, ç'është më e rëndësishmja, kjo masë mbështetjeje do të ndikonte pozitivisht mbështetjen ekonomike dhe pensionet për personat me aftësi të kufizuara, por edhe për kujdestarët e tyre. Fatkeqësisht, minimumi jetik nuk përmendet askund në Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024-2030 të hartuar nga qeveria aktuale.

Lëvizja BASHKË do të çojë përpara politika të forta të nxitjes së punësimit, duke synuar integrimin në tregun e punës jo vetëm të të papunëve dhe personave ekonomikisht joaktivë në moshë pune, por edhe një numri të konsiderueshëm të personave me aftësi të kufizuara. Përveç nxitjes së kualifikimit të vazhdueshëm, edhe me shpërblim financiar, Lëvizja BASHKË do të përmirësojë standardet e ligjit të nxitjes së punësimit dhe do të vërë në fuqi të plotë fondin social të punësimit. Çdo kompani e madhe që nuk punëson një person me aftësi të kufizuar dhe grupet e tjera të marginalizuara, do të paguajë në fondin social të punësimit pagën mesatare që do t'i paguante një punëtori të tillë. Po ashtu

do të përmirësohet punësimi i personave me aftësi të kufizuara në administratën publike.

Lëvizja BASHKË do të përmirësojë ndjeshëm investimet në infrastrukturën fizike për të lehtësuar lëvizjen autonome të personave me aftësi të kufizuara përmes rampave, aksesit në ndërtesa, transportin publik, semaforë akustikë etj. Do të rrisim ndjeshëm gjithashtu sasinë dhe cilësinë e karrocave, ortezave dhe protezave për të lehtësuar lëvizjen e bashkëqytetarëve tanë, si dhe do të subvencionohen plotësisht nevojat e qytetarëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë me materiale higjieno-sanitare.

Një kujdes i veçantë do të tregohet për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke rritur masën e mbështetjes financiare për ta dhe përmirësuar ndjeshëm rolin edukativ dhe shëndetësor të institucioneve publike.

Kujdes në rritje do të ketë edhe për qytetarët me diabet, duke subvencionuar fishat për ta dhe përmirësuar ndjeshëm kujdesin spitalor. Do të sigurohet falas arteriografia e syrit me kontrast dhe do të përmirësohen shërbimet dietologjike në spitalet rajonale. Po ashtu do të vendoset regjistri kombëtar i personave me diabet dhe do të mundësohet vlerësimi bio-psiko-social i tyre.

Masa të veçanta do të merren për integrimin në shkollë dhe punë të anëtarëve të komunitetit rom dhe egjiptian. Pjesë e përparësive për këtë komunitet do të jetë siguria e tyre juridike, duke regjistruar dhe pajisur me dokumente të gjithë qytetarët dhe, ç'është më e rëndësishmja, duke njohur juridikisht pronën faktike të anëtarëve të këtij komuniteti. Nga ana tjetër, përmirësimi i shërbimeve të strehimit social dhe ndërhyrjet përmirësuese të strehëve aktuale do të përftojnë kushte më dinjitoze jetese për anëtarët e këtij komuniteti.

Nuk do të lihet pas dore edhe themelimi i institucioneve mbikëqyrëse brenda Ministrisë së rithemeluar të Punës dhe Çështjeve Sociale, të cilat do të kenë për detyrë të kontrollojnë zbatimin e legjislacionit social dhe jetësimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe shtresave të marginalizuara.

2.3 SHËNDETËSIA

E drejta për kujdes shëndetësor është një nga parimet themelore të shtetit social dhe një prej arritjeve më të mëdha të njerëzimit. I konsideruar deri vonë si një e mirë që mund t'u sigurohej me cilësi vetëm atyre që kishin mundësi të paguanin, kujdesi shëndetësor ka bërë hapa të jashtëzakonshëm në vendet e zhvilluara. Në Shqipërinë e dekadave të fundit, fatkeqësisht, pavarësisht frymës kushtetuese të objektivave sociale që flasin për standardin më të lartë shëndetësor, kujdesi shëndetësor konsiderohet si një mall i çfarëdoshëm, për “konsumin” cilësor të të cilit qytetarët duhet të paguajnë mbi dorë dhe nën dorë gjithnjë e më shtrenjtë.

Lëvizja BASHKË frymëzohet nga arritjet më të rëndësishme të sistemit shëndetësor publik në vendet e zhvilluara dhe sociale të Evropës, sidomos prej parimeve themeltare të Shërbimit Shëndetësor Kombëtar (NHS) në Mbretërinë e Bashkuar, në Statutin e të cilit që prej vitit 1948 shkruhet se sistemi shëndetësor duhet “të plotësojë nevojat e gjithkujt, të jetë falas në pikën e përfitimit dhe duhet të bazohet në nevojën mjekësore dhe jo në aftësinë e qytetarit për të paguar.”

1. Gjendja dhe problemet e sistemit shëndetësor në Shqipëri

Nga pikëpamja e rregullimit ligjor dhe institucional, sistemi shëndetësor në Shqipëri ngërthen parimet e mbulimit pjesërisht universal të qytetarëve dhe të kontributeve të sigurimeve shëndetësore nga të punësuarit. Kjo ndërthurje parimesh reflektohet edhe në modelin e financimit, ku një pjesë e kostos së

shërbimeve shëndetësore në institucionet publike mbulohet drejtpërdrejt nga buxheti i shtetit, kurse pjesa tjetër vjen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Pavarësisht dy burimeve të financimit, niveli i përgjithshëm i financimit publik të kujdesit shëndetësor është mjaft më i ulët se nevojat e shoqërisë dhe akoma më i ulët nëse krahasohemi me vendet e zhvilluara ose me vendet e tjera të rajonit. Në vitin 2024 Shqipëria harxhoi 3.42% të Prodhimit të Brendshëm Bruto për shëndetësinë, e cila është shumë e ulët krahasuar me vendet e zhvilluara të OECD (8.8% të PBB që përpara pandemisë). Edhe vendet e rajonit kanë një nivel shpenzimesh për shëndetësinë mbi dyfishin e Shqipërisë. Një nga shkaqet e këtij niveli tejet të ulët të shpenzimeve për shëndetësinë vjen nga informaliteti në punë, ku rreth gjysmës së forcës punëtore në Shqipëri nuk u paguhen as sigurimet shoqërore, as sigurimet shëndetësore. Këto të fundit zënë vetëm 23% të buxhetit që shpenzohet për shëndetësinë publike.

Sipas Open Data Albania, një punonjës me pagë mesatare paguan detyrime të sigurimeve shëndetësore dhe taksa që shkojnë për shëndetësinë publike 3600 lekë në muaj, por merr në këmbim shpenzime publike për shëndetësinë vetëm 2300 lekë, shenjë kjo e një padrejtësie sociale.

Data.AL: Employed Person's Mandatory Healthcare Contribution and Charges, Average Per Capita Expenditure




Figura 21: (Burimi: Open Data Albania)

Pavarësisht nivelit të ulët të financimit publik të shëndetësisë, qeveria aktuale ka zgjedhur që një pjesë të rëndësishme të buxhetit ta shpërdorojë në katër koncesione korruptive. Kostoja për buxhetin e këtyre koncesioneve (sterilizimi, hemodializa, kontrolli mjekësor bazë dhe shërbimet laboratorike) për vitin 2023 arriti në 5.3 miliardë lekë, ose 9.3% të Fondeve të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor. Sipas studimeve kritike, edhe në vendet me shërbim shëndetësor dhe institucione mbikëqyrëse shumë më të forta se Shqipëria (p.sh. Mbretëria e Bashkuar), versioni i PPP në shëndetësi rezultoi më i shtrenjtë (+2% deri në +3.75%) se mënyrat normale të financimit publik të shërbimeve shëndetësore. Po ashtu partneri privat në këto koncesione ka pozitë shumëvjeçare monopoli dhe kontrata nuk mund të rinegociohet pavarësisht problemeve që mund të dalin në zbatimin e saj.

Në investimet publike, përveç koncesioneve, mbizotërojnë shpenzimet në infrastrukturë. 85% e investimeve publike për kujdesin shëndetësor parësor dhe 56% e investimeve për kujdesin shëndetësor dytësor shkojnë për ndërtim dhe rikonstruktiv godinash, duke lënë pas dore investimet në aparatura moderne dhe të mjaftueshme ekzaminuese. Niveli tejte i ulët i këtyre të fundit, prishjet e shpeshta dhe abuzimet nga punonjës të papërgjegjshëm kanë sjellë radhë të gjata në spitalet publike, çka i shtyn pacientët të kërkojnë shpëtim në spitalet tejte të shtrenjta private.

Kohët e fundit qeveria po synon të zbatojë një model të ri të financimit publik të shëndetësisë. Ky model do ta thellojë praktikën e koncesioneve, ku buxheti i shtetit blen shërbime shëndetësore afatgjata nga sipërmarrjet private. Edhe më skandaloz pritet të jetë financimi i drejtpërdrejtë i spitaleve fitimprurëse

private, sipas modelit famëkeq “paraja ndjek pacientin”, çka do të sillte shkatërrimin përfundimtar të spitaleve publike. Sipas këtij modeli, të zbatuar në disa vende të tjera, do të krijoheshin dy nivele spitalesh: (i) spitale publike që do të ofronin shërbim bazik të një cilësie të ulët për qytetarët që nuk kanë mundësi të paguajnë dhe (ii) spitale private ku qytetarët me të ardhura më të larta do të merrnin shërbim cilësor. E ashtuquajtura autonomi spitalore do të sjellë pasigurinë financiare të spitaleve publike, do t’i nxiste spitalet të mbitrajtonin të sëmurët dhe t’i mbanin sa më gjatë të shtruar për të përfituar sa më shumë fonde publike dhe do të legalizonte korrupsionin e punonjësve të shëndetësisë, duke u mundësuar të merrnin pagesa të drejtpërdrejta nga pacientët kur t’u ofronin atyre shërbim shëndetësor jashtë (!) orarit të punës brenda mjediseve të spitaleve publike.

Pagesat nga xhepi dhe barnat

Për shkak të korrupsionit, financimit të pamjaftueshëm të shëndetësisë publike dhe abuzimeve të shumanshme, qytetarët shqiptarë duhet të paguajnë nga xhepi për kujdesin shëndetësor më shumë se shoqëritë e tjera evropiane. Shëndetësia falas mbetet një parullë propagandistike, pa lidhje me pagesat reale dhe gjendjen ekonomike të shoqërisë shqiptare. Sipas të dhënave të fundit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, pagesat nga xhepi mbulojnë 59.7% të shpenzimeve shëndetësore të qytetarëve shqiptarë. Sipas një tjetër metodologjie, që nuk konsideron si shpenzime nga xhepi pagesën e sigurimeve shëndetësore, pagesat nga xhepi të qytetarëve shqiptarë llogariten nga 40% deri në 44% të shpenzimeve shëndetësore. Në të gjitha rrethanat, shifra të tilla janë mjaft më të larta se ato që paguajnë qytetarët e vendeve mjaft më të begata të OECD, ku pagesat nga xhepi sillen

rreth 20%. Në vendet më të zhvilluara, si p.sh. në Francë apo në Holandë niveli i pagesave nga xhepi është 10%.

Për shkak të nivelit tejet të lartë të punëtorëve të pasiguruar dhe të papunëve, një pjesë e konsiderueshme e popullsisë duhet të paguajë edhe formalisht për analizat diagnostike, kujdesin e specializuar dhe barnat mjekësore. Po të shtojmë edhe koston e korrupsionit dhe disfuksionalitetit të spitaleve publike, barra bëhet edhe më e rëndë. Edhe të siguruarit duhet të bashkëpagojnë 50% të barnave me recetë ambulatorie. Bashkëpagesat janë të pashmangshme edhe për personat që jetojnë në kushte varfërie (nuk ka përjashtime për familjet me ndihmë ekonomike) dhe për të sëmurët kronikë.

Në këtë kontekst, pjesa më e madhe e pagesave nga xhepi vjen prej blerjes së ilaçeve. Për shembull në vitin 2022 qytetarët shqiptarë paguan nga xhepi 61% të çmimit të barnave të importuara. Pavarësisht nevojave në rritje të një popullsie në plakje të vazhdueshme për shkak të emigrimit masiv dhe uljes së lindshmërive, nga 4067 ilaçe të përdorshme zyrtarisht në Shqipëri vetëm rreth 30% e tyre përfshihen në listën e barnave të rimbursueshme për kategori sociale si pensionistët. Ky problem është mjaft më i rëndë në trajtimin e sëmundjeve kancerogjene. Për shembull, sipas statistikave të IQVIA-s, në listën e barnave të rimbursueshme të onkologjisë janë vetëm 3 barna nga 46 të mundshme.

Në listën e barnave të rimbursueshme shumë rrallë gjen barna cilësore të prodhuara në vitet e fundit. Muajt e fundit barnat e prodhuara në vendet e zhvilluara perëndimore janë zëvendësuar në listën e rimbursueshme nga barna më të lira të prodhuara në Turqi. Ligji aktual për barnat dhe shërbimin farmaceutik rrit riskun për falsifikime të barnave të

importuara paralelisht si dhe importin e barnave të pasigurta. Gjithashtu duhet theksuar se mungesa e strukturave monitoruese efektive të farmako-vigjilencës vështirëson vlerësimin e sigurisë së barnave të importuara.

Gjatë viteve të fundit janë ulur relativisht edhe shpenzimet buxhetore për rimbursimin e barnave. Sipas revistës Monitor, në vitin 2013 shpenzimet për rimbursimin e barnave ishin sa 2,1% e shpenzimeve totale buxhetore. Në vitin 2024 ky raport u përkeqësua në vetëm 1,6%. Edhe këto shifra tregojnë për neglizhencën qeveritare ndaj shëndetësisë publike.

Nga ana tjetër, mungesa e një pjese të barnave në spitalet publike i shtrëngon mjekët që të mos i respektojnë gjithmonë protokollet e trajtimit mjekësor.

Infrastruktura spitalore

Gjendja e infrastrukturës shëndetësore është gjithashtu përplot me probleme. Nëse marrim në konsideratë numrin e shtretërve në spitalet për 100,000 banorë, Shqipëria ka 340 shtretër të tillë. Vendet e Bashkimit Evropian kanë 516 shtretër për të njëjtin numër banorësh. Ky hendek është edhe më problematik nëse mendojmë se popullsia e Shqipërisë bie me dhjetëra mijëra banorë çdo vit për shkak të emigracionit.

Nga ana tjetër, mungojnë në masë të konsiderueshme aparaturat moderne mjekësore në spitalet publike. Sipas organizatës RAD-AID International, "Shqipëria ka boshllëqe të mëdha të diagnostifikimit sipas imazherisë dhe skanimit për shkak të aparaturave të pamjaftueshme dhe trajnimit të paplotë të personelit mjekësor. Në të gjithë vendin ka rreth 30 radiologë... Spitali Nënë Tereza, i cili trajton 90% të rasteve të kancerit, është i vetmi spital publik që siguron terapi radiologjike." Gjendja

është edhe më e rëndë se ç'tregojnë statistikat. Për shkak të numrit të pamjaftueshëm dhe mbingarkimit të aparaturave ekzaminuese dhe korrupsionit të një pjese të personelit mjekësor, aparaturat ekzaminuese dëmtohen shpesh, ose të paktën deklarohen të tilla. Çka i detyron pacientët me sëmundje të rënda të shkojnë drejt spitaleve fitimprurëse dhe të shtrenjta private.

Mangësi të mëdha ka edhe shërbimi i transportit të shpejtë të të sëmurëve drejt urgjencave. Aktualisht ka vetëm një helikopter, në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, që mund të përdoret për transport të sëmurësh vetëm ditën. Nga ana tjetër, vihet re një degradim i autoambulancave si për sa u përket mjeteve, ashtu edhe medikamenteve që mbajnë me vete. Problemet në mirëmbajtjen e autoambulancave dhe mungesa e koordinimit midis autoriteteve qendrore dhe lokale sjell vonesa dhe mangësi në ofrimin e shërbimit të urgjencës kombëtare, veçanërisht në zonat rurale. Ka mangësi të rëndësishme edhe në autoambulancat ndërsptalore, ku nuk kryhet sipas modaliteteve të veçanta transporti i pacientëve që kanë nevojë për kujdes intensiv, foshnjave (mungojnë tërësisht autoambulancat neonatale) dhe fëmijëve.

Personeli mjekësor

Shqipëria ka numrin më të ulët të mjekëve për numër popullsie në të gjithë Evropën. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, në vendin tonë ka 18.8 mjekë për 10,000 banorë. Për krahasim, vendet e BE kanë 41 mjekë për 10,000 banorë. Edhe vende të rajonit si Serbia kanë thujse dyfishin e mjekëve për të njëjtin numër banorësh krahasuar me Shqipërinë: 36.7.

Arsyeja kryesore e kësaj gjendjeje të patolerueshme është emigrimi masiv i mjekëve, sidomos në moshë të re, nga

Shqipëria. Sipas studimeve, mbi 1000 mjekë të diplomuar në Shqipëri janë larguar nga vendi gjatë viteve të fundit. Po ashtu, ekspertët e fushës (Gëdeshi, King) tregojnë se pas anketave me personelin mjekësor që punon sot në Shqipëri, 40% e tyre duan të largohen nga Shqipëria. Kjo përqindje është më e lartë se mjekët në moshë të re dhe, midis tyre, ka një dëshirë më të madhe për t'u larguar mes mjekëve që paguhen më pak.

Arsyeja kryesore që i shtyn mjekët drejt largimit janë pagat ende të ulëta të personelit mjekësor në Shqipëri. Për shembull, paga bruto e një mjeku specialist në Gjermani (ku synojnë të emigrojnë pjesa më e madhe e mjekëve shqiptarë) është 7.4 herë më e lartë se paga bruto e kolegut të tij që punon në Shqipëri. Nga ana tjetër, edhe raporti i pagave të mjekëve me pagën mesatare është më i favorshëm në vendet e zhvilluara. Paga bruto e një mjeku specialist në Shqipëri është 2.3 herë më e lartë se paga mesatare bruto. Në Gjermani ky raport është 3.1.

I njëjti problem është edhe me mjekët e përgjithshëm dhe infermierët. Paga mesatare e një mjeku të përgjithshëm në Shqipëri është 5.3 herë më e ulët se në Francë. Edhe krahasuar me pagën mesatare bruto në Francë, mjekët e përgjithshëm paguhen 2.1 herë më shumë se paga mesatare bruto e atij vendi. Në Shqipëri paga bruto e mjekëve të përgjithshëm është 1.7 herë më e lartë se paga mesatare bruto në ekonominë e vendit. Po të marrim pagën mesatare të infermierëve, këta të fundit paguhen 3.4 herë më pak se në një vend të zhvilluar si Gjermania.

Në vendet e rajonit spikatin për paga dinjitoze vende si Rumania, Mali i Zi, Sllovenia dhe Kroacia, të cilat mund të merren si objektiva të një politike të re pagash dhe shërbimi mjekësor për vendin tonë.

Plotësimi i nevojave shëndetësore

Për shkak të problemeve të mëdha infrastrukturore dhe korrupsionit, kujdesi shëndetësor që marrin qytetarët në Shqipëri lë shumë për të dëshiruar. Një nga treguesit e cilësisë së kujdesit shëndetësor është numri i vizitave mjekësore që kryen mesatarisht një qytetar gjatë një viti. Sipas të dhënave zyrtare, në Shqipëri qytetari ka mesatarisht 3 kontakte me mjekët në vit. Në vendet e zhvilluara të OECD kjo shifër është 6. Për shkak të varfërisë (pamundësi për të paguar taksën e korrupsionit) dhe numrit të pamjaftueshëm të mjekëve, qytetarët u drejtohen farmacistëve si konsulentë mjekësorë. Në raste të tjera i referohen mjekësisë popullore. Ndërkohë që nuk janë të pakta rastet ku qytetari në nevojë u dorëzohet sharlatanëve.

Nga ana tjetër, shërbimi dentar në Shqipëri është thuajse tërësisht i pambuluar nga institucionet publike. Kostot e larta të kurimit të dhëmbëve bëjnë që shumë qytetarë, sidomos më të varfrit, të kenë një shëndet dentar të degraduar.

Cilësia e shërbimit shëndetësor në Shqipëri del në pah edhe prej numrit të qytetarëve që raportojnë se nuk arrijnë dot t'i plotësojnë nevojat e tyre për kujdes shëndetësor. Në anketat e fundit të realizuara në Shqipëri, mbi 20% e qytetarëve janë përgjigjur se nuk kanë arritur dot t'i plotësojnë nevojat e tyre për kujdes shëndetësor. Për krahasim, në vendet e zhvilluara të OECD numri i qytetarëve që raportojnë nevoja të pa-plotësuara është 2.3%.

II. Alternativa e Lëvizjes BASHKË

Lëvizja BASHKË synon ta shndërrojë kujdesin shëndetësor nga një mall gjith-

një e më të papërballueshëm në një të drejtë themelore të njeriut, e cila duhet të gëzohet në nivelin më të lartë të mundshëm të cilësisë nga të gjithë qytetarët. Për pasojë, kujdesi shëndetësor në të gjitha nivelet do të përfshijë të gjithë qytetarët (parimi i universalitetit), pa lënë pas dore as ata që nuk janë të përfshirë në skemën e detyrueshme të pagesës së sigurimeve shëndetësore.

Parandalimi i sëmundjeve

Rëndësi parësore ka parandalimi i sëmundjeve dhe nxitja e një jete sa më të shëndetshme nga qytetarët, duke mundësuar, ndër të tjera, edhe reduktimin e kostove që mban shoqëria për mbajtjen në këmbë të një sistemi shëndetësor cilësor dhe gjithëpërfshirës. Në këtë kuadër është e rëndësishme që zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm të ndërthuret me mbrojtjen e mjedisit dhe reduktimin e ndotjes. Nuk duhet harruar se mijëra qytetarë vdesin çdo vit vetëm në Tiranë nga sëmundjet e shkaktuara nga ndotja e ajrit. Ky problem ndihet edhe në rrafsh global, duke pasur, ndër të tjera, edhe një kosto ekonomike prej 1% të PBB global në terma të kujdesit shëndetësor, produktit bujqësor dhe ditëve të munguara të punës. Nga ana tjetër, duke marrë shembullin e vendeve të përparuara të Evropës, Lëvizja BASHKË do të vendosë një taksë sheqeri (për produkte që përmbajnë më shumë se 8 gramë sheqer), e cila do të ketë për qëllim të kufizojë konsumin e produkteve të pashëndetshme për qytetarët.

Rritja dhe ribalancimi i shpenzimeve për shëndetësinë

Objektivi i Lëvizjes BASHKË është që niveli i shpenzimeve për shëndetësinë të arrijë në 6% të Prodhimit të Brendshëm Bruto, duke iu afruar kështu mesatares së shpenzimeve për shëndetësinë të

vendeve të rajonit. Rritja e shpenzimeve për shëndetësinë publike do të mundësohet nga lufta e paepur ndaj korrupsionit (shih më poshtë qëndrimin ndaj koncesioneve!) dhe shpërdorimeve, por edhe duke nxitur formalizimin e marrëdhënieve të punës dhe pagesën e sigurimeve shëndetësore.

Në këtë kuadër do të hetohen me imtësi dhe anulohen sa më parë të jetë e mundur koncesionet korruptive në shëndetësi. Qëllimi është kursimi dhe fuqizimi i institucioneve shëndetësore publike të cilat, me cilësi dhe transparencë, do të japin shërbimet mjekësore që deri më sot i kanë dhënë kontraktorët korruptues privatë.

Rrjedhojë e fuqizimit të institucioneve shëndetësore publike është edhe zmbarsja e politikave privatizuese financiare aktuale, të cilat synojnë të rrisin llojet dhe nivelin e financimit nga buxheti i shtetit për sipërmarrjet shëndetësore private.

Nga ana tjetër zotohemi për një ribalancim të shpenzimeve buxhetore. Investimet e deritanishme janë përqendruar kryesisht në infrastrukturë dhe rikonstruktionet e objekteve, por mjaft më pak në pajisje mjekësore dhe teknologji të reja që përmirësojnë drejtpërdrejt cilësinë e kujdesit shëndetësor. Për të zgjidhur këtë, nevojitet një ribalancim i buxhetit, duke rritur ndjeshëm fondet për pajisje mjekësore, inovacion teknologjik dhe përmirësimin e shërbimeve që u përgjigjen nevojave të qytetarëve.

Barna cilësore dhe të përballueshme

Rritja e rëndësishme e buxhetit për shëndetësinë do të ketë si një prej objektivave të saj mbulimin sa më të madh të nevojave shoqërore me barna cilësore dhe të përballueshme. Në këtë kuadër do të shtohet ndjeshëm numri i barnave cilësore të rimbursueshme (të prodhuara në vende dhe kompani

me reputacion global), duke u dhënë përparësi sëmundjeve onkologjike. Në listën e rimbursueshme do të futen edhe ilaçet me përdorim akut. Në kategoritë sociale që do të përfitojnë falas barna do të futen edhe përfituesit e ndihmës ekonomike, grupet e marginalizuara, të gjithë personat me aftësi të kufizuara, si dhe pacientët me sëmundje të rënda.

Do të ulen gjithashtu në 30% bashkëpagesat për qytetarët me të ardhura të mesme e të ulëta që paguajnë sigurimet shëndetësore. Masa mbështetëse në bashkëpagesa do të ketë edhe për ata qytetarë të cilët nuk janë të përfshirë në skemën e pagesës së sigurimeve shëndetësore. Përqindje të ulët bashkëpagesash do të kenë gjithashtu pacientët që vuajnë nga sëmundje kronike, e cila do të ndryshojë në varësi të rëndësisë së barit thelbësor ose opsional.

Nga ana tjetër, Lëvizja BASHKË do të mundësojë fuqizimin e kontrolleve laboratorike dhe të farmako-vigjilencës, duke i dhënë përparësi importimit të barnave patentë të prodhuara në vendet e Bashkimit Evropian.

Pagat dhe kushtet e punës së personelit mjekësor

Emergjenca kombëtare e largimit të mjekëve dhe infermierëve mund të përballohet vetëm përmes shtimit të numrit të mjekëve e infermierëve, rritjes serioze të pagave të punonjësve të mjekësisë dhe përmirësimit të kushteve të punës së tyre.

Shqipëria ka nevojë t'u afrohet standardeve të vendeve të tjera për sa i përket numrit të mjekëve dhe infermierëve në raport me popullsinë. Kjo mund të arrihet jo vetëm me shtimin e kuotave në Universitetin Mjekësor të Tiranës, por edhe përmes rritjes së numrit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike. Po mbi të gjitha duhet frenuar emigrimi

masiv i mjekëve dhe infermierëve, duke përmirësuar kushtet e punës së tyre. Një nga masat që do të merren është pagesa e stazhit 1-vjeçar për studentët e mjekësisë. Po ashtu do të vendoset drejtësi në kriteret me anë të të cilave zgjidhen specialistët dhe bëhet shpërndarja territoriale e mjekëve. Merita dhe korrektesa në ushtrimin e profesionit do të jenë kriteret e vetme të specializimit dhe punësimit të mjekëve.

Rritja e numrit të mjekëve dhe infermierëve do t'u mundësojë punonjësve të shëndetësisë të kenë një barrë më të përballueshme të punës në orar dhe intensitet.

Duke marrë shembujt më të mirë të vendeve të Evropës dhe të rajonit, Lëvizja BASHKË zotohet që të përmirësojë raportet midis pagave të mjekëve dhe infermierëve dhe pagës mesatare në vend. 3:1 për mjekët specialistë, 2.2:1 për mjekët e përgjithshëm dhe 1.5:1 për infermierët. Propozojmë që paga bruto e mjekut specialist të jetë 225,342 lekë në muaj; paga mujore e mjekut të përgjithshëm të jetë 165,250 lekë; paga e infermierit të jetë 112,671 lekë në muaj.

Përmirësimi i ndjeshëm i kriterëve të rekrutimit, i kushteve të punës dhe i pagave të mjekëve dhe infermierëve do të shoqërohet me rritjen e kërkesës së llogarisë për kujdes cilësor dhe të përku-shtuar ndaj pacientëve, duke luftuar pa asnjë kompromis korrupsionin dhe abuzimet me pacientët.

Nga ana tjetër është e nevojshme mbështetja financiare publike për studiuesit e mjekësisë, duke nisur nga doktorantët të cilët detyrohen ta mbajnë vetë barrën financiare të studimeve të tyre. Po ashtu Lëvizja BASHKË do të shtojë numrin dhe do të vendosë rregulla të forta meritokratike për specialistët e mjekësisë, duke nxitur njëkohësisht rritjen e përgjegjësisë nga ana e profesorëve që drejtojnë specialistët.

Përgjegjësia dhe pjesëmarrja

Sistemi shëndetësor në Shqipëri ka nevojë për një reformim të thellë të mënyrës së qeverisjes së institucioneve shëndetësore dhe një ndryshim të fortë të etikës dhe përgjegjësisë përpara qytetarëve. Burokracia e korruptuar dhe klienteliste që administron sot spitalet publike duhet të zëvendësohet nga trupa administrative që reflektojnë frymën e qeverisjes në rrjet. Specialistët e administrimit dhe njohurive mjekësore duhet të ndërtojnë marrëdhënie bashkëvendim-marrëse dhe konsultative me përfaqësues të shoqërisë, duke nisur nga ata që e pësojnë më shumë: pacientët. Një vend të rëndësishëm në bashkëvendimmarrje, monitorim dhe vlerësim duhet të zënë edhe përfaqësuesit e institucioneve të tjera të pavarura dhe autonome, duke nisur nga universitetet dhe vazhduar me përfaqësuesit e organizmave sociale që lidhen me shëndetin, mjedisin, mbrojtjen e konsumatorit, të drejtat e njeriut etj. Po aq e rëndësishme është ngritja e mekanizmave të mbledhjes së shqetësimeve, monitorimit dhe vlerësimit nga familjarët e pacientëve.

Nga ana tjetër, Ministria e Shëndetësisë do të fuqizojë ndërveprimin me institucionet e tjera publike, si për shembull Ministria e Mjedisit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, pushteti vendor etj., për të parandaluar sëmundjet dhe përmirësuar shërbimet shëndetësore.

Politikat për shëndetin mendor

Lëvizja BASHKË njeh rëndësinë gjithnjë e më të madhe të problemeve të shëndetit mendor. Në këtë fushë synojmë integrimin e programeve të promovimit dhe parandalimit të problemeve të shëndetit mendor, duke filluar me vizitat në shtëpi dhe në qendrat ambulatorë të kujdesit të nënës dhe fëmijës, si dhe duke hartuar programe të dedikuara për promovimin e shëndetit mendor

pozitiv të fëmijëve dhe adoleshentëve në shkolla. Nga ana tjetër, do të përfshihen shërbime të dedikuara për shëndetin mendor në universitete dhe vende pune, si dhe rifuzimi i rolit të mjekut të familjes në këtë fushë. Një tjetër masë do të jetë ngritja e qendrave të specializuara për hartimin e politikave, zhvillimin e studimeve kërkimore si dhe monitorimi për shërbimet e shëndetit mendor. Po ashtu do të mundësohet ristrukturimi i shërbimit psikiatrik drejt rehabilitimit të pacientit dhe përfshirja e tij në shoqëri përtej thjesht trajtimit medikamentoz. Koncepti i spitalit psikiatrik si burg duhet t'i lërë vendin shërbimeve të specializuara për shëndetin mendor.

Lëvizja BASHKË propozon gjithashtu shtimin e Qendrave Komunitare të Shëndetit Mendor, duke mundësuar një shpërndarje më të ekuilibruar gjeografike. Po ashtu duhet të krijohen kushtet që mjekët që t'i ndjekin pacientët e tyre në spitalet ku shtrohen. Është e domosdoshme njëherazi edhe rekrutimi i mjekëve psikiatër të specializuar për trajtimin e problemeve të fëmijëve dhe adoleshentëve.

2.4 ARSIMI

Arsimi është drita që një shoqëri të dalë nga marrëdhëniet anakronike për të hyrë në modernitet; është domosdoshmëria për zhvillimin e arsyes kritike, e novacionit teknologjik dhe e ideve emancipuese për kultivimin e rezistencës ndaj padrejtësive sociale; është lokomotiva për zhvillimin social dhe ekonomik të një vendi bazuar te merita.

Që nga periudha e iluminizmit kanë ekzistuar dy qasje në lidhje me konceptimin e asaj që duhet të jetë arsimi dhe kujt duhet t'i përkasë. A është arsimi privilegji i një elite që përgatitet për të qenë klasë sunduese në shoqëri, apo e drejta e çdo qytetari për ta marrë dijen si një e mirë publike, si një vlerë në vetvete që krijon një shoqëri më të mirë?

Çfarë janë nxënësit në raport me dijen dhe me mësuesin? A janë ata vazo të zbrazëta që duhen mbushur nga mësuesi i cili mban në dorë monopolin e dijes, apo ky i fundit është një udhërrëfyes që nxënësit i dëfton shtegun e mundimshëm drejt dijes, në rrugëtimin drejt të cilit ai zbulon me mënyrën e vet pasionin dhe kërkimin për dijen?

Cili është misioni i arsimit në shoqëri? A duhet të mjaftohet një nxënës apo student me njohuritë teknike që do t'i nevojiten në profesionin që do të bëjë në të ardhmen, apo misioni i arsimit është edhe të edukojë dhe të formojë karakterialisht nxënësin si një qytetar të ndërgjegjshëm, të aftë për të menduar në mënyrë kritike?

Vizioni i Lëvizjes BASHKË, i ngritur ndër shumë vite aktivizmi në botën universitare, e konsideron arsimin një të mirë publike dhe një të drejtë që i takon çdo qytetari; e sheh studentin si një bashkudhëtar në rrugën drejt dijes

të cilit i duhet mësuar metoda e kërkimit shkencor; e konsideron shkollën dhe universitetin jo vetëm si burime të dijes teknike, por edhe si tempujt e skalitjes së ndërgjegjes qytetare, e njohjes së etikës dhe edukimit qytetar, duke ndihmuar të rinjtë të kuptojnë rolin e tyre në shoqëri.

Ky vizion është shumë larg gjendjes në të cilën është harruar e braktisur arsimi në Shqipëri. Bashkë do ta ndryshojmë!

1. Gjendja aktuale

Emigrimi masiv i dekadave të fundit dhe braktisja e shkollës nga fëmijët shqiptarë po e zhytin arsimin në një krizë të thellë. Prej vitit 2000 janë mbyllur 42% e shkollave 9-vjeçare në rang vendi, teksa vetëm në dekadën e fundit janë mbyllur 295 (ose 22%) institucione të arsimit të detyrueshëm dhe janë regjistruar 125 mijë nxënës më pak. Në vitin shkollor 2024-25 do të ketë 20 mijë (ose 7.8%) nxënës më pak se një vit më parë. Një projeksion i ngjashëm në rënie të përvitshme (7.4%) vihet re edhe për shkollat e mesme. 6.6% e djemve dhe 5.5% e vajzave nga familje të varfra në zonat urbane e braktisin shkollën, me arsye kryesore pamundësinë e përballimit të shpenzimeve nga familjet e tyre.

Nga ana tjetër, përqendrimi i popullsisë në Tiranë ka evidentuar problemin e kundërt: pamjaftueshmërinë e shkollave 9-vjeçare. Sipas të dhënave të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, 30 shkolla në kryeqytet e zhvillojnë mësimin me dy turne. Edhe pse që prej vitit 2016 kryetari i Bashkisë së Tiranës propozoi vendosjen e një takse të përkohshme për infrastrukturën arsimore – taksë që u kushton familjeve të Tiranës 1,800 lekë/vit dhe bizneseve deri në 37,000 lekë/vit – vetëm 9 nga 17 shkollat e parashikuara janë ndërtuar përmes Partneritetit Publik Privat (PPP).

Rezultatet e dobëta të nxënësve në sistemin parauniversitar u dëshmuar në testin ndërkombëtar PISA 2022: të rinjtë shqiptarë shënuan rënien më të madhe krahasimisht me rezultatet e viteve të mëparshme në të gjithë historinë e PISA-s. Nga viti 2018 në 2022 Shqipëria pësoi një rënie prej 69 pikësh, e cila është rënia më e fortë nga 80 vendet e testuara. 84% e nxënësve shqiptarë (rezultati më negativ nga të gjitha shtetet e tjera) nuk kaluan Nivelin 3 për të menduarit në mënyrë krijuese dhe aplikimin e tij në kontekste të zgjidhjes së problemave me natyrë shkencore.

Për vitin 2022-23, paga e një mësuesi shqiptar ishte më e ulëta në Evropë, në rreth 7600 euro/vit. Për krahasim, Mali i Zi e ka rreth 12.000 euro/vit, Bosnjë-Hercegovina rreth 9000 euro/vit. Gjithashtu, edhe sipas faktorit të Standardit të Fuqisë Blerëse (PPS), që pasqyron të njëjtën fuqi blerëse nëpër vende të ndryshme, paga e një mësuesi shqiptar renditej e fundit në Evropë. Në korrik të vitit 2024 pagat e mësuesve u rritën nga 8000 deri në 14.000 lekë/muaj sipas kategorive, duke bërë që pagat neto të mësuesve të gjimnazit të luhaten nga 63.000 në 86.000 lekë/muaj. Me gjithë rritjen, pagat e mësuesve shqiptarë mbeten nën pagat e vendeve të rajonit, ndërkohë që qeveria ka vendosur që të ulë me 10.000 lekë/muaj pagat e rreth 6500 mësuesve të ciklit të ulët.

Universitetet publike, gjithashtu, humbasin rreth 3000 studentë në vit duke lënë bosh kuotat e regjistrimit në universitetet kryesore: Universiteti i Tiranës (UT) për vitin 2024-25 plotësoi vetëm 60% të kuotave të lira, Universiteti Politeknik (UPT) vetëm 64% dhe Universiteti Bujqësor (UBT) vetëm 43%. Në universitetet publike janë mbyllur deri tani 24 degë studimi dhe rrezikojnë të mbyllen edhe 15 të tjera. Sipas një projekcioni në bazë të të dhënave aktuale, brenda vitit 2030 në universitetet publike do të studiojnë 41% më pak studentë.

Degët më të kërkuara janë mjekësia, infermiera dhe inxhinieria informatike, të cilat tërheqin studentë me perspektivën për t'u punësuar jashtë vendit. Ndërkohë, dega e mësuesisë – dega më e rëndësishme për përgatitjen e mësuesve të cikleve parauniversitare – është ndër degët më pak të kërkuara: prej vitit 2019 deri në vitin 2023 numri i diplomave bachelor në mësuesi ka rënë me 79%.

Financimet në fushën e arsimit kanë ardhur drejt rënies në pesë vitet e fundit. Për vitin 2025 fondet buxhetore për arsimin parashikohen të jenë 55 miliardë lekë, ose sa 7.1% e buxhetit. Ndërkohë, një vit më parë ato zinin 9.7% të buxhetit dhe 11.7% të buxhetit në vitin 2019. E njëjta tendencë vërehet edhe në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB), ku fondet për arsimin zënë 2.9% të PBB nga 3.3% që ishin në vitin 2020. Mesatarja e vendeve të BE për arsimin shkon te 5% dhe në rajon luhaten te 4%. Familjet shqiptare detyrohen të kontribuojnë në mënyrë thelbësore në kostot e shkollimit të fëmijëve të tyre nëpër institucionet publike të arsimit, ku rreth 70% e kostove mbulohet nga shteti ndërsa 30% nga familjarët.

II. Problemet kryesore

Problematika më bazike që haset në të gjitha nivelet e arsimit e që lidhet me aspektet më elementare të mësimdhënies, ka të bëjë me mungesën e infrastrukturës së nevojshme. Sipas dëshmive të vetë mësuesve, në shumicën e shkollave të zonave periferike mungojnë kushtet bazë si ndriçimi, sistemi i ngrohjes dhe i ftohjes, uji i rrjedhshëm. Ndërkohë edhe në shkollat dhe gjimnazet e zonave urbane vërehet një mungesë totale e infrastrukturës dhe e pajisjeve laboratorike për fushat e fizikës, kimisë, biologjisë etj., ashtu si edhe e bibliotekave apo e sallave me kompjuterë. Njëkohësisht, mungojnë

tërësisht (ose keqfinancohen) muzetë e ndryshëm, që do mund të vizitoheshin edhe nga publiku i gjerë, si për shembull ato të botanikës, paleontologjisë, arkeologjisë, gjeologjisë, astronomisë etj.

Rezultatet e dobëta në testet kombëtare dhe ndërkombëtare lidhen me mënyrën e vjetruar të mësimdhënies dhe me kurrikulat e papërshtatshme. Të mësuarit në mënyrë mekanike dhe shpeshherë përmendësh, e kufizon jashtëzakonisht shumë mendimin krijues të nxënësve. Nga ana tjetër, sipas mësuesve kurrikulat bazohen vetëm në teori dhe jo në praktikë, janë të përkthyer shabllon nga vendet e huaja – nga tekste të vitit 2007 – dhe nuk u përshtaten kushteve sociale, mentalitetit dhe kontekstit shqiptar.

Në shkollat e Tiranës fëmijët nuk kanë mundësi t'i përdorin mjediset e shkollës për t'u edukuar me orar të zgjatur përmes aktiviteteve të ndryshme jashtëshkollore, siç ndodh në vendet e përparuara të Evropës. Kjo mangësi e infrastrukturës arsimore i shtyn prindërit që të harxhojnë një pjesë jo të vogël të të ardhurave të tyre për t'i dërguar fëmijët në qendra kursesh me pagesë, të cilat në të shumtën e rasteve funksionojnë si vende thjesht të mbajtjes së fëmijëve derisa prindërit të mbarojnë punën. Familjet me më pak të ardhura janë të detyruara t'ua ngarkojnë mbajtjen e fëmijëve pas shkollës gjysheve e gjyshërve, që jo gjithmonë kanë fuqinë fizike t'u përgjigjen nevojave të fëmijëve.

Ç'është edhe më e rëndë, në disa zona të populluara të Tiranës nuk ka fare infrastrukturë arsimore. Për shembull në zonën e Astirit, e cila banohet nga rreth 70.000 qytetarë, nuk ka asnjë çerdhe, kopsht e shkollë publike, duke i shtrënguar prindërit të paguajnë institucione arsimore private ose t'i dërgojnë fëmijët në shkolla publike shumë larg vendbanimit të tyre.

Shkollat e mesme po e humbasin rolin e tyre si hallka arsimore në të cilën nxënësin marrin një formim të përgjithshëm e shumëpërmasor, formohen intelektualisht si qytetarë dhe bëhen të aftë për të zgjedhur fushën e studimit që do të ndjekin në universitet. Profilizimi i hershëm i gjimnazit në degë ngushtësisht shkencore apo shoqërore, ka krijuar një hendek në formimin e përgjithshëm që duhet të marrë nxënësi në këto vite të shkollimit të tij/saj, duke e bërë gjimnazin fort të ngjashëm me shkollat profesionale.

Sa i përket cilësisë së mësimdhënies, infrastrukturës mësimore dhe përgatitjes së maturantëve, vihet re një disbalancë e thellë mes gjimnazeve në periferi dhe atyre në qendrat urbane. Kjo disbalancë, megjithatë, nuk evidentohet në vlerësimin me notë për shkak se pranimi në degët universitare të studimit bëhet vetëm përmes mesatares së gjimnazit. Lidhjet personale, e ndonjëherë edhe ndikimet politike, bëjnë që shumë nota në gjimnaz (sidomos në periferi) të jenë fiktivisht të larta.

Politizimi i institucioneve arsimore është një ndër problematikat qendrore të sistemit. Ky fenomen manifestohet si në emërimin e drejtorëve, ashtu edhe në presionin që i ushtrohet trupës së mësuesve për të bërë fushatë përmes rrjeteve sociale për partinë në pushtet (në janar të këtij viti, 36 institucione arsimore u kallëzuan në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se kishin shpërndarë nga faqet zyrtare postime në mbështetje të fushatës elektorale të ministres së Arsimit). Një praktikë e tillë e ka denigruar figurën e mësuesit në shoqërinë shqiptare, një figurë qendrore në rolin që ka në edukimin e brezave, duke e kthyer atë në një militant partiak ose në një nëpunës që rri kokulur përballë presionit të pushtetit.

Denigrimi i figurës së mësuesit për shkak të presionit politik, i kombinuar me pagat e ulëta, mungesën e infrastrukturës së mësimdhënies, si dhe me trajnimet fiktive që ofrohen për mësuesit e që nuk shërbejnë realisht për aftësimin e tyre dhe avancimin në karrierë, ka bërë që dega e mësuesisë sot të jetë ndër degët më pak të lakmuara nga të rinjtë shqiptarë, duke shkaktuar një situatë emergjence sa i përket edukimit të brezave që do të vijnë. Ekspertët kanë vënë alarmin se niveli i studentëve që zgjedhin mësuesinë është gjithnjë e më i dobët.

Cilësia e teksteve shkollore prej vitesh tashmë është vënë në pikëpyetje nga prindër dhe nga ekspertë të fushës së arsimit. Nuk ekziston një shtëpi botuese e librit shkollor me një bord redaktorësh nga Ministria e Arsimit. Shkollat i përzgjedhin tekstet shkollore që do të përdorin gjatë vitit nga ofertat që vijnë nga subjekte private. Prej shumë kohësh tregu i librit shkollor dominohet nga vetëm dy shtëpi botuese.

Edhe më katastrofike paraqitet situata me arsimin e lartë në vend. Reforma tregtarizuese e miratuar nga qeveria në vitin 2015 ka dështuar katërçipërisht. Në themel të kësaj reforme qëndronte logjika e heqjes së përgjegjësisë nga shteti për financimin e universiteteve publike dhe sigurimi i fondeve të domosdoshme përmes tarifave studentore. Por me tkurrjen e numrit të studentëve, këto të ardhura nuk mund të vijnë përveçse nga komercializimi i mëtejshëm i ambienteve universitare. Trupa pedagogjike po shndërrohet gradualisht në një agjenci marketingu që duhet të tërheqë sa më shumë studentë. Nëse sinjeriteti intelektual dhe ndjenja e qytetarisë i shtyn pedagogët që të jenë kritikë ndaj problematikave të institucionit publik ku ata punojnë, pasiguria financiare e institucionit i detyron ata të mbyllin gojën.

Nuk ekzistojnë më standarde institucionale të vlerësimit objektiv të studentëve

duke u bazuar te merita: cedimi i korrektesës akademike nga ana e pedagogëve vjen jo për arsye të përfitimit personal (ndonjëherë edhe për këtë shkak), por për arsye të mbijetesës financiare të institucionit. Nëse studentët i ndërpresin studimet, institucioni publik rrezikon falimentin. E njëjta logjikë e "shtyn" studentin nëpër nivelet e studimit, duke nisur që nga diploma bachelor, në master, e deri në doktoratë. Në një situatë të tillë, pajisen me diploma praktikisht të gjithë studentët që hyjnë në universitet, duke krijuar kaos edhe për punëdhënësit që kërkojnë nivele të caktuara njohurish nga studentët e diplomuar që duan të hyjnë në tregun e punës.

Logjika tregtarizuese e ndjekur nga qeveria ka bërë që kostot e studimit për një student, sidomos në Tiranë, të jenë të papërballueshme. Tarifat e studimit në nivelin master luhaten në disa mijëra euro, duke u krahasuar me tarifat e universiteteve private brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, kostot e strehimit nëpër kampuset studentore shkojnë nga 5.000 deri në 7.000 lekë të reja në muaj për një krevat. Mungojnë tërësisht sallat e studimit me orar të zgjatur që ofrojnë kushte normale studimi si ngrohja, ndriçimi, interneti; mungojnë bibliotekat universitare që do të ofronin literaturën e duhur studimore vendase dhe sidomos atë të huaj; mungojnë mensat universitare që do të mund të siguronin ushqim cilësor dhe të përballueshëm për studentët; mungojnë laboratorët për plotësimin e njohurive teorike me aplikimin praktik; në shumicën e fakulteteve nuk mund të sigurohet një periudhë stazhi për studentët që pritet të diplomohen; mungon një shtëpi botuese e librit universitar, me një bord redaktorësh, duke bërë që jo rrallëherë pedagogë të caktuar të abuzojnë me tekste të përkthyer keq e që mbajnë emrin e tyre, që shiten në auditorët universitare me çmime marra-mendëse.

Degradimi i jetës akademike është projektuar edhe te feudalizmi në marrëdhëniet e pushtetit brenda universiteteve publike. Për hir të parimit të vetëqeverisjes, universitetet publike janë kapluar nga klientelizmi që mundëson rizgjedhjen në detyrë të atyre që mbajnë postet drejtuese. Në vitet e fundit ka pasur një seri skandalesh, kryesisht të lidhura me praktikën e plagjiaturës për fitimin e titujve akademikë, por që nuk ka arritur të zgjojë indinjatën e trupës së gjerë akademike, ca nga frika e ca nga konformizmi për hir të karrierës. Ndërkohë, pesha e votës studentore në zgjedhjen e drejtuesve të universiteteve publike është e papërfillshme: vetëm 10%.

Plagjiaturat në botën akademike dhe në rangjet politike drejtuese janë një fenomen i përhapur. Si ministrja aktuale e Arsimit, Ogerta Manastirliu, ashtu dhe paraardhësja e saj, Evis Kushi, janë denoncuar publikisht për plagjiaturë të punimit të doktoratës. Po njësoj edhe rektori aktual i Universitetit të Tiranës, Artan Hoxha. Nuk ekziston një kriter apo procedurë e qartë për kontrollin kundër plagjiaturës të punimeve shkencore me software të posaçëm. Mbrojtja e një punimi shkencor dhe fitimi i gradës Doktor i Shkencave është kthyer në një procedurë formale. Ka një mungesë të theksuar të filtrave sa i përket punës akademike të aspirantëve për këtë gradë, punë e cila nuk këqyret nën lupën kritike të komunitetit akademik. Për më tepër, procedurat për fitimin e titujve akademikë profesor apo profesor i asociuar janë lehtësuar maksimalisht, duke hequr kriteret e cilësisë që kanë ekzistuar më parë dhe duke vendosur si kriter shkrimin e një monografie.

Nga ana tjetër, kushtet dhe mundësitë për kryerjen e kërkimit shkencor në Shqipëri janë të mjerueshme. Studentët e shkollës së doktoratës jo vetëm që nuk mbështeten financiarisht nëpërmjet

bursave, si në mbarë botën e zhvilluar, por ata duhet të paguajnë edhe një tarifë për regjistrimin në këtë nivel studimi në vlerën 2.000 euro. Fondet e buxhetit të shtetit për kërkimin shkencor kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë në nivele qesharake. Infrastruktura laboratorike për kërkimin shkencor është inekzistente. E vetmja mënyrë financimi për kërkuesit e rinj është fitimi i projekteve kërkimore të financuara nga vendet e Bashkimit Evropian, por mungesa e infrastrukturës kërkimore bën që Shqipëria të jetë vendi që aplikon më pak për projektet evropiane të kërkimit shkencor. Ndërsa ligji aktual për kërkimin shkencor ua vështirëson pambarimisht punën kërkuesve të rinj për shkak një vargu procedurash burokratike për lëvrimin e fondeve që vijnë nga BE, ligji i ri që propozohet nga kjo qeveri ka për synim që ta ruajë të njëjtën strukturë burokratike, me dallimin që do ta zhvendosë atë nga universitetet në duart e një konsorci-umi me në krye kryeministrin e vendit.

III. Alternativa e Lëvizjes BASHKË

Vizioni i Lëvizjes BASHKË në ndërtimin e një shteti social është një sistem arsimor publik cilësor dhe i përballueshëm nga të gjithë qytetarët. Në këtë vizion, institucionet publike të arsimit duhet të gjejnë te shteti shqiptar themelin tek i cili do të mbështeten. Prandaj çdo hap përpara drejt këtij vizioni do duhet të nisë me rritjen substanciale të financimeve të shtetit për arsimin. Lëvizja BASHKË propozon rritjen nga 2.9% të PBB që është sot, në të paktën 4% të PBB që është edhe mesatarja e vendeve të rajonit. Këto të ardhura do të shërbenin, në radhë të parë, për të plotësuar nevojat infrastrukturore nga të cilat vuajnë institucionet e arsimit në vend, e më tej për të ofruar arsim publik cilësor e të përballueshëm për të gjithë qytetarët.

Sfidat me të cilat përballlet arsimit nisin që nga sistemi parauniversitar. Prandaj Lëvizja BASHKË, frymëzuar nga modeli finlandez, për rimëkëmbjen e tij mbështetet në dy shtylla qendrore: reformimi i arsimit parauniversitar nga poshtë dhe rritja e përgatitjes së mësuesve.

1. Reforma që nis nga baza

Reformimi rrënjësor që i nevojitet sistemit arsimor të ciklit të ulët dhe të mesëm në Shqipëri do të ketë për synim rikonceptimin e themeleve teorike dhe metodologjike të arsimit. Në vizionin e Lëvizjes BASHKË reformimi duhet të nisë nga një cikël i gjerë konsultimesh në të gjitha qytetet e vendit ku do të bëhen bashkë me qindra mësues, prindër, ekspertë të arsimit dhe drejtues lokalë për të diskutuar:

a) Nevojat konkrete infrastrukturore, problematikat dhe sfidat me të cilat përballlet trupa e mësuesisë në çdo rajon.

b) Ndryshimin e qasjes në mësimdhënie që aktualisht përqendrohet te mësimi përmendësh, drejt diskutimit në klasë për të nxitur të menduarit në mënyrë kritike dhe të pavarur të nxënësve.

c) Ndryshimin e kurrikulave të studimit duke synuar njëkohësisht arsimimin dhe edukimin e të rinjve si individë të vërtetshëm dhe shumëpërmasorë, të motivuar për të ndjekur arsimin e mëtejshëm.

d) Diskutimin e vështirësive me të cilat përballen familjet shqiptare për shkolimin e fëmijëve të tyre dhe lehtësimet që duhet të sigurojë pushteti lokal. Përfshirjen e komunitetit të prindërve duke u caktuar një shkallë vendimarrjeje në shkolla.

e) Ngritjen e një rrjeti kombëtar komunikimi dhe bashkëpunimi mes shkollave, prindërve, bizneseve dhe OJF-ve.

2. Përgatitja e mësuesve

Nuk mund të ketë nxënës të përgatitur pa pasur mësues të përgatitur. Njëkohësisht, nuk mund të ketë të rinj shqiptarë të talentuar që zgjedhin të ndjekin degën e mësuesisë pa i rikthyer figurës së mësuesit dinjitetin profesional, konsideratën shoqërore dhe autonominë krijuese në vendin e punës që meriton. Sa më sipër mund të arrihen duke e nisur me:

a) Rritjen thelbësore të cilësisë së degës së mësuesisë përmes afrimit të ekspertëve të huaj dhe vendas, që do t'i kushtojnë vëmendje të veçantë trajnimit të mësuesve të rinj që e shohin profesionin edhe si një detyrë morale e sociale. Diploma në mësuesi do duhet të hapë rrugën për studime të mëtejshme dhe avancimin në karrierë në nivelet drejtuese të sistemit arsimor. Tarifat e studimit për këtë degë do të mbulohen 100% nga shteti.

b) Mësuesve u duhet dhënë mundësia e zhvillimit profesional përmes përditësimit të vazhdueshëm me zhvillimet e fundit në kërkimin shkencor dhe në teknologji në fushën e tyre të kompetencës. Kjo do të realizohet përmes trajnimit falas të mësuesve.

c) Mësuesit duhet të kenë një shkallë të caktuar autonomie për ta përshtatur kurrikulën dhe metodikën e mësimdhënies sipas nevojave specifike të nxënësve dhe kontekstit social. Objektivi i mësuesve është që të inkurajojnë analizën dhe krijimtarinë të nxënësit. Në vend se nxënësit të përqendrohen vetëm te mësimi i teksteve, ata do të angazhohen në projekte praktike duke nxitur të menduarit në mënyrë autonome.

d) Shteti duhet të sigurojë kushte të përshtatshme pune për mësuesit dhe infrastrukturën e mësimdhënies, duke nisur nga laboratorët, sallat e kompjuterëve dhe bibliotekat.

e) Shteti duhet të sigurojë paga të djathtë – jo vetëm përmes rritjes së pagave të mësuesve në nivelet e rajonit në rreth 100.000 lekë/muaj, por edhe përmes një bonusi mirënjohjeje që fitohet me mbështetjen e prindërve, kolegëve dhe drejtuesit të institucionit (por që nuk ndikohet nga notat e nxënësve).

f) Forcimi i rolit të sindikatave të mësuesve është mënyra e duhur për të garantuar depolitizimin e shkollave e gjimnazeve, pavarësinë dhe pacenueshmërinë e figurës së mësuesit nga ndikimet e politikës dhe nga padrejtësitë brenda institucionit.

Ndër objektivat e tjerë për reformimin e sistemit arsimor parauniversitar, përmendim:

• Ndërtimi i shkollave të reja në qendrat urbane

Për shkak të përqendrimit të popullsisë, Tirana ka nevojë emergjente për ndërtimin e 20 shkollave të reja, duke ndërtuar me përparësi shkolla në lagjet në të cilat mungojnë tërësisht. Fondet për ndërtimin e këtyre shkollave do të vijnë nga menaxhimi i ndershëm dhe rigoroz i parave publike dhe politikatat tatimore progresiste. Standardi që synohet të arrihet për një mësimdhënie më cilësore është që në çdo klasë të zhvillojnë mësim maksimumi 20 nxënës dhe të ketë nga një mësues ndihmës për çdo dy klasa, materiale të përshtatura dhe trajnime për stafin mbi edukimin gjithëpërfshirës.

• Shkollimi me orar të zgjatur

Shkollat në mbarë Shqipërinë do të shndërrohen në mjedise të edukimit me orar të zgjatur, ku fëmijët do të kenë mundësi që, pas orës së mësimi, t'i përdorin mjediset shkollore për të bërë detyrat, për të punuar në grup dhe për t'u argëtuar në mënyrë të shëndetshme me aktivitete sportive, artistike etj. Qëllimi ynë është që fëmijët të qëndrojnë në shkollë deri në orën 17:00, duke u shkarkuar prindërve barrën financiare e të tjera angari. Pas orës 17:00 mjediset e jashtme të shkollës mund të shërbejnë si qendra komunitare, ku banorët e lagjes mund të përdorin me kujdes dhe nën mbikëqyrje infrastrukturën sportive të shkollave ose kapacitetet e saj për veprimtari kulturore.

• Ushqimi i shëndetshëm në shkolla

Edukimi me orar të zgjatur kërkon që mjediset shkollore t'u sigurojnë fëmijëve ushqim dhe vende të përshtatshme të të ngrënit. Përmes zbatimit të politikës "Nga ferma në shkollë", ne do t'u mundësojmë nxënësve ushqim të shëndetshëm në shkolla kundrejt një pagese modeste nga familjet. Për fëmijët që vijnë nga familje në kushte varfërie, bashkitë e rretheve do ta sigurojnë falas ushqimin e tyre. Dy masat e fundit kërkojnë një shtim të stafit të shkollave, sidomos të numrit të mësuesve, çka do të kërkonte nxitjen e bashkëpunimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

• Zvogëlimi i hendekut të cilësisë në mësimdhënie mes periferisë dhe qendrës

Kjo arrihet duke vendosur standarde kombëtare për mësimdhënien, duke investuar në infrastrukturë dhe duke ofruar bonuse mujore për mësuesit që pranojnë të punojnë në zona të largëta. Një faktor i rëndësishëm është përdorimi

i teknologjisë: përmes platformave online dhe programeve të shkëmbimit mes shkollave, nxënësit e zonave rurale mund të marrin të njëjtën cilësi arsimimi si ata në qytete.

• **Themelimi i shtëpisë botuese të librit shkollor**

Cilësia e librave shkollorë dhe sigurimi i tyre për nxënësit me kosto të ulët duhet të jetë përgjegjësi e shtetit shqiptar. Shtëpia botuese e librit shkollor do të afrojë ekspertë të fushave të ndryshme shkencore dhe shoqërore për t'u bërë pjesë e bordit redaktues të librave shkollore, me qëllim që të garantohet cilësia e literaturës së mësimdhënies. Për të nxitur leximin, dy libra jashtëshkollorë do të ofrohen falas për çdo nxënës dhe do të krijohen klubet e leximit në çdo shkollë.

• **Provim hyrës për shkollën e lartë**

Për t'u përballur me problematikën që lidhet me notat fiktivisht të larta të gjimnazit, pranimi në degët e studimit universitare nuk do të bazohet vetëm te mesatarja e shkollës së mesme, por edhe te një provim i posaçëm pranimi. Provim hyrës për shkollën e lartë do të testojë në masën 60% njohuritë e përgjithshme të nxënësve dhe pjesa tjetër do varet nga zgjedhja që bën nxënësi mes fushave shkencore apo shoqërore. Vlerësimi në provim, së bashku me mesataren e gjimnazit, do të jenë kriteret për pranimin në universitet.

• **Ngritja e zyrave të karrierës**

Orientimi i karrierës duhet të jetë pjesë e detyrueshme e aktivitetit shkollor. Të gjithë nxënësit do të marrin një orientim të vazhdueshëm mbi zgjedhjet që i presin në avancimin e tyre në gjimnaz, në shkollat profesionale apo në tregun e punës. Pjesë e aktivitetit do të jenë edhe

praktika brendashkollore për nxënësit nga klasa e 7-të deri në të 9-të për të nxitur mes tyre shprehje të punës praktike dhe krijuese.

• **Kontrolli mjekësor ndaj nxënësve**

Kontrolli mjekësor që do t'u ofrohet nxënësve në çdo shkollë do të jetë falas dy herë në vit për të gjithë nxënësit deri në moshën 18 vjeç dhe do të përfshijë kontrollin e shëndetit dentar, fizik dhe mendor përmes mjekëve, psikologëve dhe punonjësve socialë.

Prej shumë vitesh ne, aktivistët e Lëvizjes BASHKË, jemi angazhuar jo vetëm në kundërshtimin e reformës privatizuese të Edi Ramës, por edhe për t'i dhënë zë reformës alternative për demokratizimin dhe rritjen e cilësisë së arsimit të lartë në Shqipëri. Reformimi i universitetit duhet të nisë nga poshtë, me bërjen bashkë të universitarëve – studentëve dhe pedagogëve – për të evidentuar nevojat akute të arsimit të lartë sot në vendin tonë. Ky është vizioni ynë:

• **Arsim publik falas**

Arsimi i lartë cilësor duhet të jetë një e drejtë themelore që gëzohet nga çdo qytetar shqiptar, pavarësisht mundësive financiare. Prandaj hapi i parë drejt këtij vizioni do të jetë ulja progresive e tarifave të studimit në nivelet bachelor dhe master, me synimin afatmesëm të zerimit të tyre. Kjo masë do të shoqërohet me rritjen e shpenzimeve shtetërore për nevojat që kanë sot universitetet publike, duke e hequr barrën financiare nga institucionet e arsimit dhe duke i çliruar pedagogët nga presioni për të siguruar mbijetesën financiare të universitetit duke ceduar në ndershmërinë intelektuale dhe akademike.

- **Ngritja dhe forcimi i unioneve studentore**

Organizimi studentor, si garantuesi më i mirë i ruajtjes së demokracisë brenda universitetit, nuk do të vazhdojë të monopolizohet brenda Këshillave Studentorë, por institucioni arsimor do të njohë edhe organizimet e pavarura studentore në formën e unioneve. Ato do të jenë zëri i studentëve të vetorganizuar brenda universitetit që ngrihet kundër çdo padrejtësie, abuzimi me rolin e pedagogut apo të drejtuesit të institucionit, abuzimit me orët e mësimet etj.

- **Rritja e peshës së votës studentore në 50%**

Roli i trupës studentore në vendim-marrjen për zgjedhjen e drejtuesve të institucioneve të arsimit të lartë sot është në nivele të papërfillshme, vetëm 10%. Studentët e diplomuar janë produkte të këtij institucionit publik, rrjedhimisht të interesuar drejtpërdrejt që ai të drejtohet nga njerëz të aftë e të ndershëm. Prandaj propozimi i Lëvizjes BASHKË është që pesha e votës studentore të rritet në 50%.

- **Rritja e rolit të Asamblesë së Pedagogëve**

Asambleja e Pedagogëve është një organ i cili mbledh bashkë mbarë trupën pedagogjike të një fakulteti apo universiteti për të diskutuar dhe debatuar mbarëvajtjen e institucionit. Edhe pse ligji e njeh si të tillë, ky organ nuk vihet kurrë në lëvizje. Lëvizja BASHKË do të mbështesë rritjen e kompetencave të Asamblesë së Pedagogëve si një lloj parlamenti demokratik ku debatohen dhe miratohen politikat që ndjek institucioni.

- **Vendosja e standardeve institucionale**

Bota akademike universitare duhet të udhëhiqet nga parimi i meritokracisë. Për realizimin e këtij parimi, universitetet duhet të përcaktojnë standarde institucionale. Ato kanë të bëjnë me: a) vlerësimin objektiv të studentëve nga ana e pedagogëve, ku nota e vendosur do të jetë mund të apelohej dhe të rishqyrtohet nga komisione të posaçme dhe të pavarura, në mënyrë që studenti as të mos mbivlerësohet për hir të njohjeve personale, korrupsionit të pedagogut etj., as të mos nënvlerësohet padrejtësisht nga pedagogu; b) luftimin e praktikës së të kopjuarit nëpër auditorët universitarë, si një praktikë që gërryen nga poshtë themelet ku mbështetet parimi i meritokracisë dhe deformon moralisht studentët në rrugën profesionale që do të ndjekin; c) publikimin e leksioneve online, në shembullin e universiteteve më prestigjioze në botë, është mënyra më e mirë për aplikimin e transparencës, ndershmërisë akademike dhe të drejtës për akses në njohuri për mbarë shoqërinë; d) organizimin e anketave studentore të përvitshme mbi vlerësimin që studentët u bëjnë fakulteteve ku studiojnë dhe publikimin e rezultateve të anketave si një mënyrë e drejtë për të orientuar maturantët në zgjedhjen e degës ku do të ndjekin studimet.

- **Ngritja e infrastrukturës universitare**

Shteti shqiptar, edhe me mbështetjen e projekteve që vijnë nga Bashkimi Evropian, do të investojë në ngritjen e bibliotekave universitare moderne në çdo fakultet, të pajisura me literaturë vendase dhe të huaj, të cilat do të shërbejnë edhe si ambiente studimi me orar të zgjatur. Gjithashtu do të ngrihen laboratorë të certifikuar me të gjitha pajisjet bashkëkohore për qëllime të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore, por që njëkohësisht mund të ofrojnë shërbime

për palë të treta kundrejt pagesës. Do të hapen salla kompjuterësh që mund të përdoren nga studentët e të gjitha degëve universitare, me prioritet studentët e teknologjisë së informacionit. Çdo kampus universitar do të pajiset me mensa që ofron ushqim cilësor e të lirë për studentët.

• **Themelimi i shtëpisë botuese të librit universitar**

Libri universitar është një vlerë e çmuar në komunitetin shkencor të së tashmes dhe për brezat e studiuesve që vijnë më pas. Prandaj ai nuk mund t'i vihet përpara një studenti në auditorët universitarë pa kaluar përmes një recense rigoroze shkencore dhe gjuhësore. Prandaj Lëvizja BASHKË propozon themelimin e shtëpisë botuese të librit universitar, në bordin redaktues të së cilës do të ulen personalitete të botës akademike dhe kulturore vendase dhe të huaj.

• **Kontrolli i rreptë i punimeve shkencore**

Plagjiatura është vjedhja e punës akademike të dikujt tjetër, është pandershmëri dhe mashtrim. Nuk ka turp më të madh në botën akademike sesa plagjiatura. Pa një kontroll të imët të punës kërkimore-shkencore të çdo kandidati për një gradë apo titull shkencor, delegjitimohet e gjithë ngrehina akademike në vend. Lëvizja BASHKË propozon sanksionimin e qartë në ligj të procedurës për kontrollin e pavarur të punës kërkimore-shkencore, sidomos për rastet e plagjiaturës, si dhe kalimin në filtër të veçantë të të gjitha punimeve dhe publikimeve shkencore të drejtuesve të universiteteve publike të çdo niveli. Njëkohësisht nevojitet rritja e kriterëve për fitimin e titujve akademikë.

• **Mbështetja financiare dhe lehtësimi burokratik për kërkimit shkencor**

Lëvizja BASHKË do të zerojë tarifat për shkollën e doktoratës dhe do të lehtësojë procedurat burokratike për përdorimin e fondeve të projekteve evropiane nga kërkuesit shkencorë, duke ndjekur modelin italian të financimit. Menaxhimi i fondeve për projektet shkencore që vijnë nga BE – brenda të cilave do të mund të financohen edhe studimet e doktoratës të kandidatëve të rinj – do t'i lihet në dorë grupit të kërkuesve shkencorë që e kanë fituar projektin. Shpenzimet që kryhen në kuadër të çdo projekti do të kontrollohen imtësisht nga administrata financiare e çdo universiteti publik dhe nga komisionet e posaçme ministrore.

2.5 STREHIMI

Në Shqipërinë e sotme strehimi nuk është një e drejtë shoqërore themelore, por një mall gjithnjë e më i shtrenjtë, nga gëzimi i të cilit po privohen shumë qytetarë. Problemet e papërballueshmërisë së strehimit ndihen veçanërisht në Tiranë dhe qytetet bregdetare, aty ku janë përqendruar proceset e pastrimit të parave, kapjes së shtetit dhe spekulimit imobiliar. Lëvizja BASHKË e konsideron përparësi social-ekonomike përbalueshmërinë e qirave dhe blerjes së një apartamenti.

1. Gjendja dhe problemet

Analiza e kërkesës dhe ofertës në tregun e strehimit është thelbësore për të kuptuar disbalancat që ndikojnë në përbalueshmërinë dhe qasjen në strehim, duke pasur parasysh se rritja e popullsisë urbane, migrimi i brendshëm dhe ndryshimet demografike rrisin kërkesën, ndërsa çmimet e larta të qirave dhe blerjes kufizojnë aksesin për shumicën e popullsisë. Nga ana tjetër, oferta ndikohet nga politikat qeveritare, aktivitetet e sektorit privat dhe rregulloret urbanistike, shpesh duke favorizuar ndërtimin e banesave të luksit dhe neglizhuar nevojat për strehim të përbalueshëm për shtresat e mesme dhe të ulëta, duke thelluar kështu disbalancat ekzistuese.

Ndryshimet demografike

Shqipëria po përjeton një urbanizim të shpejtë dhe të pakontrolluar, duke rritur ndjeshëm popullsinë urbane nga 35.5% në 1989 në 64% në 2023, me një parashikim për të arritur 70% pas vitit 2030. Ky zhvillim është përqendruar kryesisht

në Tiranë dhe zonën Tiranë-Durrës. Pjesa tjetër e vendit, sidomos rajonet më të varfra, mbetet e izoluar nga këto ndryshime. Ndërkohë, emigracioni ka ndikuar ndjeshëm në uljen e popullsisë, me rreth 490 mijë shqiptarë që janë larguar në 12 vitet e fundit. Struktura demografike ka ndryshuar, me rritje të varësisë nga të moshuarit dhe largim të të rinjve, çka reflekton sfida të mëdha sociale dhe ekonomike.

Në Tiranë rritja e popullsisë ka qenë shumë më e ulët se projeksionet. Kjo ka bërë që një pjesë e madhe e lejeve të ndërtimit, përfshirë 1.8 milionë m² të miratuara në 2022, të mbeten të pajustificuara nga kërkesa reale. Ndërtimet e tepërta dhe projeksionet e pasakta kanë krijuar një disbalancë mes ofertës dhe kërkesës, duke theksuar nevojën për planifikim më realist dhe të qëndrueshëm urban në kryeqytet.

Pronësia, kushtet e banimit dhe informaliteti

Pavarësisht ndërtimeve të shumta, vetëm 82.5% e familjeve kanë pronësi mbi banesën e tyre, një ulje nga 89% e regjistruar në Censusin e vitit 2011. Ndërkohë, rreth 132 mijë familje jetojnë me qira ose në banesa me pronësi të tjetërkujt (një në çdo gjashtë familje jeton me qira), një rritje prej 87% krahasuar me një dekadë më parë. Familjet pa pronësi ndahen në dy kategori: 67 mijë familje jetojnë me qira dhe 65 mijë të tjera jetojnë në banesa të dhëna në përdorim nga pronarët pa pagesë. Megjithatë ka shumë banesa të lira, shumë familje përballen me mbipopullim ekstrem, ku 51 mijë familje me katër anëtarë jetojnë në dy dhoma dhe 21 mijë familje me gjashtë ose më shumë anëtarë ndahen në një hapësirë.

Kushtet e jetesës në disa raste mbeten shqetësuese: 9,563 familje jetojnë në banesa me vetëm një dhomë, 29 mijë

familje ende nuk kanë banjë brenda banesës dhe 103 mijë familje nuk kanë ujë të rrjedhshëm. Ndërsa 57% e familjeve jetojnë në zonat urbane dhe 43% në zonat rurale, këto sfida tregojnë disbalancën mes stokut të banesave dhe nevojave reale të familjeve, duke theksuar urgjencën për zgjidhje më të qëndrueshme.

Në Shqipëri situata e strehimit është e karakterizuar nga informaliteti dhe mungesa e një sistemi të fortë të strehimit social. Vlerësohet se ekzistojnë rreth 550,000-600,000 shtëpi private monofamiljare dhe afërsisht 300,000 shtëpi private multifamiljare, nga të cilat vetëm 350,000 janë të legalizuara. Përveç këtyre, ka rreth 650,000 njësi banimi të periudhës së socializmit. Nga miratimi i planeve rregullatore në vitin 2005 janë shtuar edhe afërsisht 1 milion njësi të ndërtuara me leje. Totali i banesave të paregjistruara arrin rreth 1 milion njësi banimi. Një nga shkaqet kryesore të kësaj situatë është mospërputhja e hartave ndërmjet bashkive, zyrave kadastrale dhe ALUIZNI-t, e cila pengon proceset e legalizimit dhe regjistrimit të pronave.

Banesa bosh

Në Shqipëri ka një disbalancë të theksuar në sektorin e strehimit, **ku 33% e banesave**, ose rreth 327,000 nga gjithsej 1.08 milionë, **janë të pabanuara**. Sipas të dhënave nga INSTAT-i, 756,000 familje janë regjistruar, ndërkohë ka 2.5 banesa bosh për çdo familje pa strehim. Në Tiranë stoku i banesave bosh është 17.4%, pa përfshirë ato në ndërtim, dhe numri i apartamenteve që nuk konsumojnë energji elektrike ka arritur në 51,129, krahasuar me 14,991 në vitin 2018. Sipas gazetarëve të emisionit “Kronos”, këto banesa bosh janë rritur me 3.4 herë në pesë vitet e fundit, duke theksuar se për të populluar këto prona do të duheshin 45 vjet.

Të dhënat e Censit 2023 pasqyrojnë qartë se Tirana ka një stok të mjaftueshëm banesash që nuk do të shterohen për dekada, duke e bërë ndërtimin e ri të panevojshëm për momentin. Ky problem kërkon një vëmendje të menjëhershme nga politikëbërësit për të adresuar sfidat dhe për të siguruar një të ardhme më të qëndrueshme për qytetarët.

Lejet e ndërtimit

Sektori i ndërtimit në Shqipëri ofron mundësi fitimi të jashtëzakonshme për kompanitë, pasi kostoja e ndërtimit për një apartament është shumë më e ulët se çmimi i shitjes. Kostoja mesatare, pa trullin e ndërtimit, shkon në 800 euro për metër katror, kurse çmimi mesatar i shitjes është 1500 euro metri katror. Norma e lartë e fitimit, e kombinuar me mundësitë e pastrimit të parave, krijojnë kushtet për akumulim të mëtejshëm të kapitalit nga një grup i vogël aktorësh.




Figura 22: (Burimi: Euronews Albania)

Sipas Bankës së Shqipërisë, shumica e **transaksioneve për pasuri të paluajtshme** në Shqipëri kryhen pa ndërmjetësimin e kredive bankare. Kjo nxit shqetësime serioze për origjinën e fondeve, duke nxjerrë në pah përfshirjen e mundshme të aktiviteteve kriminale në sektor. Shumë kompani që marrin leje ndërtimi nuk kanë kapacitetet financiare për të përfunduar projektet, ndërsa praktika e shitjes paraprake të apartamenteve përdoret për të siguruar fonde. Çdokush që paguan taksat paraprake dhe nis punimet mund të hyjë në treg, pavarësisht mungesës së kapaciteteve ose garancive financiare.

BASHKIA TIRANË dhe lejet e ndërtimit:

Në shtatë vitet e fundit Bashkia Tiranë ka dhënë mbi 8,133 leje ndërtimi, duke bërë të mundur një bum të sektorit të ndërtimit, i cili tani mbulon pjesën kryesore të të ardhurave të buxhetit të qytetit. Sektori ka përjetuar një rritje të vazhdueshme, me një sipërfaqe rekord të lejeve të ndërtimit prej 1.8 milionë m² në vitin 2022 dhe investime që arritën 1.8 miliardë euro në vitin 2021. Pavarësisht këtyre zhvillimeve, numri i qytetarëve që migrojnë në kryeqytet është ulur ndjeshëm, nga 21,000 në vitin 2019 në 5,700 në vitin 2023. Sipas një raporti të Nismës Globale kundër Krimin të Organizuar Ndërkufitar, theksohet se “Rreth 60% e firmave të ndërtimit që kanë marrë leje në periudhën 2017-2019 në kryeqytet, nuk justifikojnë burimet e tyre financiare, ndërsa vlerësohet se për këtë periudhë 3-vjeçare janë pastruar në ndërtim rreth 1.6 miliardë euro”.

Ligji Nr. 22/2018 u hartua për të siguruar strehim të përbalueshëm, duke kërkuar që ndërtuesit privatë të kontribuojnë për banesa sociale me 3% të sipërfaqes ndërtimore për ndërtime që kanë një sipërfaqe totale mbi 2,000 m². Fillimisht ky mekanizëm synonte të përmirësonte aksesin në strehim për grupet vulnerabël. Megjithatë, ndryshimet e vitit 2022 e reduktuan ndjeshëm kontributin, pasi tashmë detyrimi i ndërtuesit është vetëm për sipërfaqen e mbetur pas 2500 m² fillestar. Për shembull, një ndërtim prej 2,500 m² që më parë ofronte 75 m², tani kontribuon vetëm me 15 m² për fondin e banesave sociale, duke ulur ndjeshëm përfitimet sociale të këtij ligji.

Në vitin 2019, Këshilli Bashkiak i Tiranës miratoi një vendim që lejonte ndërtuesit të shlyenin detyrimin prej 3% për strehimin social në formë monetare në vend të sipërfaqeve ndërtimore. Kjo politikë reduktoi numrin e banesave sociale të disponueshme, pasi shumica e

ndërtuesve preferuan pagesën në para. Në vitin 2023 të ardhurat nga ky kontribut ishin 893,830,000 lekë. Megjithëse gjenerohen fonde, ulja e sipërfaqeve reale ndikon negativisht në përmbushjen e nevojave për strehim social.

Përgjatë periudhës 2019–2023, mekanizmi i taksës për strehimin social në Tiranë ka pasur vështirësi në mbledhjen e plotë të detyrimit 3% nga subjektet ndërtuese. Një analizë e shifrave tregon se jo të gjitha lejet e ndërtimit kanë kontribuar plotësisht në këtë taksë, me përqindje të ndryshme për secilin vit. Për më tepër, Bashkia Tiranë nuk ka dhënë asnjë shpjegim për arsyet e mosmbledhjes së plotë të taksës, as për mënyrën se si janë përdorur të ardhurat nga kjo taksë. Kjo mungesë transparence ka krijuar dyshime për menaxhimin e fondeve dhe shpërndarjen e tyre për ndërtimin e banesave sociale.

Ja një përmbledhje më e detajuar për secilin vit nga 2019 deri në 2023, për sa i përket përqindjes së lejeve të ndërtimit që kanë shlyer taksën e strehimit social në Tiranë:

• Viti 2019:

- Numri i lejeve të ndërtimit mbi 2,000 m²: **73**
- 32% e këtyre lejeve kanë shlyer taksën e strehimit social në vlerë monetare.

• Viti 2020:

- Numri i lejeve të ndërtimit mbi 2,000 m²: **62**
- 29% kanë shlyer taksën e strehimit social në vlerë monetare.
- 6% kanë shlyer taksën në mënyrë të kombinuar me sipërfaqe banimi dhe diferencën monetare.

• Viti 2021:

- Numri i lejeve të ndërtimit mbi 2,000 m²: **81**
- 35% kanë shlyer taksën e strehimit social në vlerë monetare.
- 9% kanë shlyer taksën në mënyrë të kombinuar me sipërfaqe banimi dhe diferencën monetare.

• Viti 2022:

- Numri i lejeve të ndërtimit mbi 2,000 m²: **77**
- 69% kanë shlyer taksën e strehimit social në vlerë monetare.
- 3% kanë shlyer taksën në mënyrë të kombinuar me sipërfaqe banimi dhe diferencën monetare.

• Viti 2023:

- Numri i lejeve të ndërtimit mbi 2,000 m²: **62**
- 65% kanë shlyer taksën e strehimit social në vlerë monetare.
- 2% kanë shlyer taksën në mënyrë të kombinuar me sipërfaqe banimi dhe diferencën monetare.

Shit-blerja dhe qiratë e pronave në Shqipëri

Nga viti 2022 e në vazhdim tendenca e indeksit Fischer të çmimit të banesave në Shqipëri ka qenë e karakterizuar nga luhajtje të dukshme. Në vitin 2022 çmimet u rritën me 39.2% në krahasim me vitin e kaluar. Pas kësaj periudhe, tregu pësoi një rënie prej 9.1% në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2022, por çmimet gjithsesi shënuan një rritje prej

16.6% krahasuar me vitin e kaluar. Gjatë vitit 2023 çmimet vazhduan të luhaten, me një rritje prej 11.6% në fillim të vitit dhe një rënie më pas. Në fillim të vitit 2024, tregu tregoi një rikthim të fortë me një rritje prej 16.9%, edhe pse numri i pronave të shitura ra në krahasim me gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023.

Sipas Bankës së Shqipërisë, mesatarisht mbi 50% e blerjeve të banesave financohen me kredi bankare. Në shumicën e rasteve këto hua mbulojnë vetëm 60% të vlerës së apartamentit.

Sipas televizionit Euronews, rritja më e lartë e çmimeve të apartamenteve është në zonën e Shqipërisë së mesme dhe të jugut. Në zona pranë resorteve, si Palasë, Orikum dhe Sarandë, çmimi maksimal i shitjes së apartamenteve ka arritur në 4000 euro për m², ndërsa në Lungomaren e Vlorës po shiten deri në 3500 euro m². Ndërkohë, në Golem çmimi maksimal i shitjes arriti 1,500 euro m² dhe në Gjirin e Lalëzit vlerat shkojnë nga 2,400 deri në 3,300 euro m².

Në pesë vitet e fundit, sipas Bankës së Shqipërisë, blerjet e pronave nga shtetas jorezidentë shqiptarë patën një kulm prej 36% në 2020, ranë në vitet 2021, 2022 dhe gjysmën e parë të 2023, dhe më pas u rritën përsëri me rreth 26-27% në fund të 2023 dhe fillim të 2024. Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë deklaroi se kërkesa për prona në bregdet është rritur me 20% deri në 30%, krahasuar me vitin e kaluar dhe zonat më të preferuara janë Vlora, Palasa e Saranda.

Shit-blerja e apartamenteve në Tiranë

Rritja e çmimeve të pasurive të paluajtshme në Tiranë gjatë periudhës 2022-2024 ka pasur ndikime të dukshme mbi përballueshmërinë e banesave, veçanërisht për shtresat e mesme dhe të ulëta të popullsisë. Disa nga faktorët kyç që kanë kontribuar në këtë zhvillim janë:

1. Rritja e çmimeve të pronave:

- Në vitin 2022, çmimi për metër katror në Tiranë pati një rritje të jashtëzakonshme, duke u rritur me 39.5% në gjysmën e parë të vitit dhe me një rritje vjetore prej 13.9% pas rënies në gjysmën e dytë.
- Çmimet kanë pasur një rritje të vazhdueshme edhe në vitin 2023 dhe në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, ku u regjistrua një rritje prej 23.5%, me një fokus të veçantë në zonat qendrore të Tiranës, në të cilat shitjet u rritën me 46%.

2. Pagat dhe inflacioni:

Ndërkohë, paga mesatare në Tiranë në vitin 2022 u rrit vetëm me 7.72%, ndërsa inflacioni arriti në 6.7%, më i larti në 24 vitet e fundit. Ky hendek mes rritjes së pagave dhe çmimeve të pasurive të paluajtshme ka thelluar përbalueshmërinë e banesave.




Figura 23: (Burimi: Vjetari Rajonal Statistikor 2019-2023", Instituti i Statistikave)

Në vitin 2023 paga mesatare rritej me vetëm 9.44%, ndërkohë që çmimi i metrit katror u rrit me 20.90%, duke krijuar një hendek të mëtejshëm.

3. Çmimet mesatare për apartamentet:

- Sipas të dhënave të Homezone, çmimi mesatar për një apartament 1+1 (60 m²) në Tiranë arrin në €84,539.84, për një apartament 2+1 (78 m²) në €109,901.79 dhe për një apartament 3+1 (120 m²)

në €169,079.68. Këto çmime janë ndjeshëm më të larta se në qytetet e tjera të Shqipërisë dhe janë një reflektim i tendencës së përgjithshme të tregut të pasurive të paluajtshme.

4. Rritja e çmimeve dhe sfidat për përbalueshmërinë:

- Sipas statistikave, çmimi mesatar për metër katror në Tiranë arrin afërsisht 1,500 euro në vitin 2023, ndërkohë që paga mesatare është pak mbi 700 euro. Ky hendek është rritur edhe më tej me rritjen e inflacionit prej 4.8% gjatë vitit 2023, duke shtuar presionin mbi fuqinë blerëse të qytetarëve dhe e bërë tregun e pasurive të paluajtshme gjithnjë e më të vështirë për t'u aksesuar nga familjet me të ardhura të kufizuara.




Figura 24: (Burimi: Homezone.al, Statistika të tregut të pasurive të patundshme në Shqipëri)

5. Subvencionimi i interesave të kredisë nga Bashkia Tiranë:

Ky program është zbatuar në vitet 2018, 2020 dhe 2022. Gjatë 3 viteve ka ndihmuar një përqindje të **kufizuar të aplikuesve (34%)**, duke treguar një mbështetje të pamjaftueshme për ata që kanë nevojë për ndihmë financiare për të paguar kreditë e strehimit.

Rritja e çmimeve të pasurive të paluajtshme në Tiranë ka vazhduar në vitet e fundit, me një bum të madh në vitin 2022 dhe një tendencë të qëndrueshme rritjeje në vitin 2024. Kjo ka krijuar një hendek të madh midis çmimeve të banesave dhe pagave, duke bërë që shumë

qytetarë të kenë vështirësi në përballimin e kostos së jetesës. Zhvillimi i infrastrukturës dhe investimet në periferitë e qytetit kanë ndihmuar në rritjen e kërkesës për prona jashtë zonës qendrore, por ndihma për shtresat e mesme dhe të ulëta mbetet një sfidë e vazhdueshme.

Qiratë në Tiranë

Çmimi i qirave në Tiranë ka pasur një rritje të vazhdueshme, e cila ka ndikuar jo vetëm në kërkesën për strehim, por edhe në ndryshimet sociale dhe ekonomike të qytetit.

1. **Rritja e çmimeve të qirave:** Në një studim të Bankës së Shqipërisë të vitit 2023, çmimet e qirave në Tiranë kanë njohur një rritje të vazhdueshme, duke u rritur me 12% deri në vitin 2020 dhe 13.4% më tej në vitin 2022. Kjo ka ndodhur pas tërmetit të vitit 2019 dhe periudhës së pandemisë, të cilat kanë rritur kërkesën për strehim.
2. **Urbanizimi dhe rritja e kërkesës për qira:** Urbanizimi intensiv dhe migrimi i qytetarëve nga zonat rurale kanë shtuar kërkesën për qira në Tiranë, duke pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në çmimet e qirave. Pasojat e tërmetit të vitit 2019 dhe pandemisë kanë ndikuar në rritjen e kërkesës për strehim, duke sjellë kështu një rritje të çmimeve.
3. **Zona të shtrenjta dhe diferencimi i çmimeve:** Zona të tilla si stadiumi "Air Albania" dhe ish-Blloku kanë qira shumë të larta dhe tërësisht të papërballueshme për shumicën. Çmimet në këto zona janë rritur me më shumë se 35% gjatë vitit të kaluar.
4. **Çmimet dhe kostoja për qytetarët:** Për qytetarët, mundësitë janë të kufizuara mes mundësisë për të

paguar qira të larta në qendër ose për të jetuar më larg në zona me kosto më të ulëta, por që kërkojnë më shumë kohë për transport apo kanë mungesë shërbimesh. Ky balancim është një sfidë e vazhdueshme për qytetarët.

5. **Rritja e qirave ditore dhe Airbnb:** Shfrytëzimi i platformave si Airbnb ka nxitur rritjen e tregut të qirave ditore, duke sjellë një konkurrencë të fortë për qiratë afatgjata dhe rritur çmimet. Ky fenomen gjithashtu ka rritur informalitetin.
6. **Subvencionimi i qirasë nga Bashkia Tiranë:** Nga viti 2018 deri në vitin 2024 Bashkia Tiranë ka pranuar gjithsej 4,350 aplikime për programin e subvencionimit të qirasë. Nga këto aplikime, 2,146 janë miratuar, pra 49% të aplikuesve. Ky program është kryesisht i orientuar për të mbështetur familjet me të ardhura të ulëta. Megjithatë, individët që jetojnë afër ose nën kufirin e varfërisë shpesh nuk kanë mundësi të përfitojnë për shkak të kërkesave të tjera të programit. Po ashtu, programi nuk merr parasysh nevojat e personave me aftësi të kufizuara, duke lënë një boshllëk në mbështetje për këtë grup.

II. Alternativa e Lëvizjes BASHKË

Lëvizja BASHKË synon ta kthejë strehimin në një të mirë të përballueshme për të gjithë. Për arritjen e këtij objekti, planifikojmë marrjen e një sërë masash të karakterit fiskal, ekonomik, social dhe ligjzbatues.

1. Taksimi progresiv i apartamenteve të treta, të katërta e me radhë

Kuadri ligjor aktual vendos vetëm dy shkallë taksimi vjetor për banesat: 0.1% deri në 0.2%. Sipas kësaj logjike, i vetmi dallim në taksim është mes të varfërve që kanë një apartament dhe shtresës së mesme profesionale, e cila mund të ketë në pronësi një apartament të dytë. Të gjitha pronat e tjera rezidenciale, sado të shumta qofshin dhe pavarësisht nëse përdoren ose jo, kanë të njëjtin nivel taksimi.

Qëllimi i Lëvizjes BASHKË është drejtësia sociale në taksim dhe nxitja e futjes në tregun e shit-blerjes dhe qirave të apartamenteve të pabanuara. Prandaj ne propozojmë këto nivele të taksimit:

- **Apartamentet e treta:** Për të gjitha njësitë e ndërtesave që përfshihen në kategorinë e pronave rezidenciale, shkalla e taksës vjetore do të jetë 0.4%
- **Apartamentet e katërta:** Për të gjitha njësitë e ndërtesave që përfshihen në kategorinë e pronave rezidenciale, shkalla e taksës do të jetë 0.8%.
- **Apartamentet e pesta, gjashta e kështu me radhë** do të kenë një shkallë taksimi që nis nga 1.2% dhe rritet për çdo pronë rezidenciale shtesë.
- **Për apartamentet e pabanuara prej dy vitesh,** do të zbatohet një shkallë vjetore taksimi prej 1%.
- **Rregullimi i qirave ditore:** Për të nxitur qiradhënien afatgjatë, është i nevojshëm një sistem progresiv taksimi ku qiradhënia ditore taksohet sa dyfishi i qiradhënies afatgjatë. Ndërkohë qiradhënësit ditore duhet të regjistrohen pranë autoriteteve lokale.

2. Rritja e numrit të banesave të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave

Kjo masë do të sjellë më shumë banesa në treg me çmim të përballueshëm. Rritja e kapaciteteve të këtij enti për ndërtimin dhe menaxhimin e banesave sociale, si dhe dhënia e më shumë fondeve të drejtpërdrejta nga shteti do të mundësonte përfshirjen e një aktori që nuk është tradicionalisht pjesë e tregut. Ky aktor do të ofronte qira më të ulëta sesa tregu privat, duke ndihmuar qytetarët të shmangin kostot e larta të tregut të lirë.

Në këtë kuadër, Lëvizja BASHKË synon që përmes një Enti të riorganizuar të vendosë standarde ndërtimi për të ulur koston e ndërtimit të banesave sociale. Ky Ent do të themelojë një zyrë projektimi dhe do të nxisë edhe projektet konkurruese ndërkombëtare për të realizuar tipologji ndërtimi me kosto më të lirë, duke u bërë motor i inovacionit teknologjik të qëndrueshëm.

Nga ana tjetër do të hartohet programi “Shtëpia me një ndalesë”, i cili do të ketë për qëllim lehtësimin e procedurave burokratike dhe uljen e kostove për ndërtimin vetjak të banesës së sigurt (shtëpi njëkatëshe ose dykatëshe), bazuar në projekte-tip të hartuara nga ekspertë të kontraktuar nga Enti Kombëtar i Banesave dhe nën mbikëqyrjen e profesionistëve të pushtetit lokal. Ky program do të shkurtojë kohën dhe ulë kostot e fshehura të marrjes së lejes së ndërtimit dhe do të garantojë kontrollin e procesit nga fillimi punimeve deri në përfundim pa rrezikuar jetën e punëtorëve në fillim dhe të banorëve më pas. Përfitues të këtij programi do të jenë qytetarët me të ardhura të ulëta dhe të mesme.

3. Luftimi i pastrimit të parave dhe evazionit fiskal

Reformimi meritokratik dhe fuqizimi i institucioneve ligjzbatuese do të luftojë

me shumë më tepër efikasitet krimin e organizuar dhe pastrimin e parave në sektorin e ndërtimit. Nga ana tjetër, reformimi i institucioneve tatimore dhe politikat e reja fiskale do të luftojnë evazionin fiskal dhe do të shërbejë si kufizuese e ndjeshme e praktikave të rritjes spekulative (jashtë logjikës së tregut) në sektorin imobiliar.

4. Rishikimi i vlerës së çmimit të referencës

Ky proces duhet të bazohet në analizën e të dhënave kombëtare, si për shembull: numri i të pastrehëve, grupet vulnerabël, të ardhurat mesatare familjare dhe aksesit në shërbime kryesore si shëndetësia, arsimi, transporti etj.

5. Fuqizimi i institucioneve sociale

Nevojitet ngritja e një sistemi që lejon zbatimin efektiv të programeve sociale të strehimit. Kjo përfshin përdorimin e teknologjive dixhitale për regjistrimin dhe ndarjen e të dhënave të aplikantëve dhe përfituesve, duke lehtësuar procesin e aplikimit dhe shpenzimet për grupet vulnerabël, si dhe përmirësimin e monitorimit.

6. Rritja në 5% e sipërfaqes së dhënë për strehim social për çdo objekt të ndërtuar mbi 2000 m²

Fondi publik i banesave sociale do të përfitojë sipërfaqe banimi funksionale 5% e sipërfaqes së ndërtimit. Kjo sipërfaqe do të llogaritet mbi sipërfaqen e plotë të ndërtimit dhe jo, si deri më sot në Bashkinë Tiranë, mbi sipërfaqen e mbetur pas zbritjes së 2000m² të parë. Po ashtu ky detyrim do të merret drejtpërdrejt në ndërtesë dhe jo në vlerë monetare apo në ndërtesa të tjera si kompensim. Për ta bërë efektive këtë masë, ndërtuesit do të përjashtohen

nga mundësia për të aplikuar për leje të reja ndërtimi nëse nuk e kanë shlyer këtë detyrim në ndërtesat e mëparshme. Përparësi në përfitim të këtyre banesave do të kenë çiftet e reja.

7. Zgjerimi i zonave me interes social

Zgjerimi i sipërfaqes së këtyre zonave do të mundësonte investime më të mëdha publike për ndërtimin e banesave sociale, si dhe do të përmirësonte cilësinë e jetesës dhe shërbimet publike për shtresat shoqërore me të ardhura më të ulëta.

2.6 MJEDISI

Problemet mjedisore, veçanërisht në dekadat e fundit, kanë arritur përmasat e një krize mjedisore globale të shumanshme, e cila ka të bëjë me ndryshimet klimatike, biodiversitetin, burimet natyrore, cilësinë e ajrit, ujit, tokës, shpyllëzimin, ndotjen, zhurmën etj. Ndërhyrja pa asnjë kriter për devijimin e rrjedhës së lumenjve kryesorë të vendit dhe shfrytëzimin e tyre për hidrocentrale me kapacitete të vogla, që nuk i sjellin ndonjë përfitim qytetarëve nga pikëpamja energjetike, është një dëshmi e qartë e kësaj tendence. Për më tepër, dhënia me koncesion për ndërtim të ishullit të Sazanit dhe zonës së Zvërnecit, të dyja parqe kombëtare në Shqipëri, ashtu si dhe me dhjetëra gurore që shkatërrojnë natyrën dhe ndotin ambientin, shërbejnë si shembuj të një dëmi të parikuperueshëm që po i bëhet natyrës shqiptare.

Shqipëria, gjithashtu, shfaq një radhë problemesh mjedisore, të cilat duhen përballur për të ruajtur cilësinë e mjedisit dhe mirëqenies shoqërore në afatgjatë. Në anën tjetër prej dekadash, shumë institucione ndërkombëtare, shtete dhe agjenci prestigjioze kanë ngritur në nivelin më të lartë të politikëbërjes një sërë parimesh mjedisore, si parimi i zhvillimit të qëndrueshëm, parimi ndotësi paguan, parimi i masave parandaluese, parimi i barazisë dhe drejtësisë mjedisore, informimi i publikut dhe palëve të interesuara etj. Në këtë kuadër, edhe vendi ynë në dekadat e fundit në tërësi ka përparuar dukshëm me miratimin e një legjislacioni mjedisor gjithnjë e më të pasur dhe të përafëruar me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Pavarësisht kësaj, gjendja e mjedisit në Shqipëri mbetet mjaft problematike dhe rrezikon të përkeqësohet nëse nuk zbatohen politikat e duhura, ligji të mbetet në letër

dhe praktikat grabitqare dhe korruptive vazhdojnë të pashqetësuara.

1. Gjendja dhe problemet kryesore

Problemet dhe sfidat më të mprehta mjedisore janë shtjelluar shkurtimisht edhe në raportin e vitit 2024 të Bashkimit Evropian për Shqipërinë. Vendi ynë përballet me një sërë problemesh mjedisore, nga të cilat më kryesoret:

Zonat e mbrojtura

Mjediset natyrore tokësore dhe ujore, veçanërisht në zonat turistike, rrezikohen nga tjetërsimi dhe fragmentimi i habitatëve, rrjedhimisht me humbje të biodiversitetit dhe shërbimeve të ekosistemeve. Sa i takon humbjes së biodiversitetit, nga ekspertët vlerësohet se numri i kafshëve dhe bimëve të rralla apo të rrezikuara ka ardhur duke u rritur. Megjithatë, duhet theksuar se proceset e inventarizimit dhe monitorimit të biodiversitetit janë ende shumë larg standardeve të pritshme. Po ashtu mbishfrytëzimi i burimeve natyrore është një problem i mprehtë. Për shembull mungon kontrolli rigoroz për grumbullimin e bimëve mjekësore, gjuetinë, peshkimin, akuakulturën etj.

Shqipëria ka një mjedis natyror mjaft të pasur, i cili duhet të mbrohet për të siguruar integritetin ekologjik të tyre, por edhe për të siguruar mirëqenien shoqërore të brezave të tashëm dhe të ardhshëm. Sistemi i Zonave të Mbrojtura në Shqipëri mbulon sot rreth 22% të territorit, me 12 Parqe Kombëtare (tokësore) dhe 1 PK Detar (Kategoria II e IUCN), 719 Monumente Natyrore (Kategoria III), 34 Rezerva Natyrore të Menaxhuara & Parqe Natyrore Bashkiake (IV), 5 Peizazhe të Mbrojtura (V) dhe 4 Burime të Menaxhuara (VI). Për më tepër, sistemi ZM-ve përfshin 4 zona të

Trashëgimisë Botërore dhe 1 Rezervë Biosfere (UNESCO), 4 zona Ramsar, 45 Zona të Rëndësishme Bimore (IPAs) dhe 16 Zona të Rëndësishme Shpendësh (IBAs). Megjithatë, është tepër shqetësues ndryshimi i ligjit për Zonat e Mbrojtura në shkurt 2024 nga Kuvendi i Shqipërisë (Ligji nr. 21/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 81/2017 Për Zonat e Mbrojtura”). Ky ligj është kundërshtuar nga mjaft ekspertë të mjedisit, organizata mjedisore, por edhe institucione ndërkombëtare. Ndryshimi më domethënës i ligjit është fakti se të gjitha kategoritë e Zonave të Mbrojtura, edhe në zonat e tyre qendrore, mund të zhvillohen për ‘aktivitete infrastrukturore dhe mikpritëse, me standardet më të larta arkitekturore dhe mjedisore për mbështetjen e turizmit të ekselencës (me 5 yje) dhe infrastrukturës përkatëse’ (të njohura si investime strategjike). Por kjo ngre shqetësime për mbrojtjen e biodiversitetit, pasi mund të lejojë investime të mëdha turistike dhe industriale brenda zonave të mbrojtura. Neni 13 i Ligjit 81/2017 për zonimin e ZM-ve është anuluar. Edhe autoriteti i institucionit të sotëm drejtues, Agjencisë Kombëtare të ZM-ve (AKZM), është zbehur. Më shumë autoritet i besohet Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), i cili është një organ kolegjal në varësi të Këshillit të Ministrave, i kryesuar nga kryeministri. Ligji 21/2024 e centralizon qartë procesin e mbrojtjes në një organ joprofesional, në kundërshtim me misionin e ligjit 81/2017, por edhe me direktivat e BE dhe standardet e IUCN. Lëvizja BASHKË do të rishikojë ligjin për Zonat e Mbrojtura duke u mbështetur në praktikën më të mira të Bashkimit Evropian.

Menaxhimi i mbetjeve urbane, inerte dhe industriale

Në Shqipëri nuk bëhet ndarja e diferencuar në burim e mbetjeve urbane, ndërsa riciklimi i mbetjeve është në nivele të

ulëta. Në anën tjetër trajtimi i mbetjeve mbështetet gjerësisht në depozitim në landfille, praktikë kjo më pak e dëshiruar në hierarkinë e trajtimit të mbetjeve; për më tepër, një numër i konsiderueshëm landfillesh operojnë jashtë standardeve mjedisore duke përbërë rrezik për shëndetin e komuniteteve që jetojnë pranë tyre. Për shembull, një raport i fundit i Kontrollit të lartë të Shtetit – i cili ka marrë në analizë katër bashki, Durrës, Vlorë, Korçë dhe Shkodër – del në përfundim se këto bashki nuk kanë përmirësuar situatën e menaxhimit të mbetjeve dhe nuk kanë siguruar qëndrueshmërinë financiare, pasi të ardhurat e grumbulluara nga tarifat e pastrimit nuk mbulojnë kostot e nevojshme. Po ashtu vlen të theksohet se në shumë zona rurale shumë mbetje depozitohen në vende të paligjshme. Ndërsa projektet e incineratorëve nuk kanë prodhuar asgjë më shumë sesa megaskandale korruptive. Menaxhimi i mbetjeve duhet trajtuar si emergjencë kombëtare.

Ndotja e ajrit

Ndotja e ajrit është një problem i madh mjedisor për disa qytete të mëdha të vendit si Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Fier dhe Shkodër. Sipas Agjencisë Evropiane të Mjedisit, çdo vit në Shqipëri vdesin 5,410 qytetarë nga sëmundje të shkaktuara prej ndotjes së ajrit. Kjo vdekshmëri është 2.6 herë më e lartë se mesatarja e vendeve të Evropës. Përmasat e këtij krimi urban janë më të theksuara në Tiranë. Lëvizja BASHKË e ka pasur në qendër të vëmendjes dhe të aksionit të saj politik këtë çështje, si në programin për zgjedhjet vendore në Tiranë në vitin 2023, por veçanërisht me fushatën “Po na marrin frymën” e ndërmarrë në pranverën e shkuar dhe nënshkrimin e peticionit prej mbi 10 mijë qytetarësh.

Burimet ujore

Vendi ynë është i pasur me burime ujore të shumta si lumenj, liqene, ligatina dhe ujëra nëntokësorë të cilat kërkojnë një qasje strategjike për t'i menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme për të përballur si efektet e ndotjes në cilësinë e tyre, ashtu edhe ndryshimet klimatike të cilat do të sjellin pasoja në sasinë e ujërave në dekadat e ardhshme, në rrezikun e përmbytjeve dhe thatësirave, si dhe mbishfrytëzimin. Me mbështetjen e BE përmes Agjencisë Austriake të Zhvillimit (ADA), Shqipëria ka miratuar së fundmi një ligj të ri (Nr. 29/2024) për burimet ujore. Në relacionin shoqërues të projektligjit theksohet se “Në procesin e integritimit evropian arritja e standardeve të BE-së në sektorin e ujit konsiderohet si një nga proceset më të vështira dhe të kushtueshme”.

Ndryshimet klimatike

Ndryshimet klimatike që kanë prekur edhe vendin tonë janë qartazi të dukshme, për shembull janë shtuar valët e të nxehtit në verë, periudha të zgjatura të thatësirës, reshje në formë shtrëngatash etj. Edhe pse vendi ynë nuk është “fajtor” për ndryshimet klimatike në nivel global, pashmangshmërisht do të vuajë pasojat e tyre, si rreziku i përmbytjeve, reduktimi i rezervave ujore, rritja e kostove ekonomike etj. Prandaj është e domosdoshme që ndryshimeve klimatike t'u kushtohet vëmendja e duhur, si për të ulur shkarkimet e gazeve serë, por edhe për të rritur përshtatshmërinë në të ardhmen.

II. Alternativa e Lëvizjes BASHKË

Lëvizja BASHKË përqafon një model zhvillimi ekonomik, i cili është i qëndrueshëm. Në këtë kuptim, ruajtja e mjedisit

është një e mirë publike e cila do të jetë prioritet në vizionin tonë për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Lëvizja BASHKË do të sendërtojë një etikë mjedisore që ndërthur dhe ekuilibron interesat social-ekonomike në njërën anë, me shëndetin dhe qëndrueshmërinë e ekosistemeve në anën tjetër, duke pranuar në këtë mënyrë parimet ekologjike të kapacitetit mbajtës dhe asimilues. Balanëqimi dhe parandalimi i problemeve mjedisore duhet të jetë gjithmonë një qasje e integruar dhe holistike e shumë komponentëve ndërveprues. Për këtë qëllim një sërë objektivash të përgjithshme dhe afatgjata do të marrin angazhimin maksimal:

1. Fuqizimi i institucioneve që kanë përgjegjësi mbrojtjen, kontrollin dhe monitorimin e burimeve natyrore dhe gjendjes së mjedisit. Në këtë kuadër do të rritet mbështetja financiare për të siguruar kapacitetet logjistike dhe njerëzore të nevojshme për Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Agjencinë Kombëtare të Ujës-jellës-Kanalizime etj. Pa institucione të fuqishme ligjzbatuese mbrojtja e mjedisit dhe parandalimi i përkeqësimit është i pamundur.
2. Rishikimi i kontratave koncesionare: përfitimi ekonomik i atypëratyshëm nga turizmi masiv, i cili shkakton një dëm të parikuperueshëm në natyrë dhe i zhvlerëson zonat turistike nga pikëpamja ekonomike në afatgjatë, nuk mund të jetë rruga e duhur për zhvillimin e turizmit në vend. Ne nuk mund të lejojmë që betonizimi që i ndodhi plazhit të Durrësit, zaptimi i rërës nga mega-resorte luksoze, t'i ndodhë edhe bregdetit të Jonit, Thethit, Valbonës, Nartës, Zvërnecit, e të gjitha mrekullive natyrore të vendit tonë. Guroret që kanë mbirë nga të katër anët nuk mund të vazhdojnë

të kafshojnë pafundësisht peizazhin e kodrave, kanioneve e luginave të Shqipërisë. Prandaj Lëvizja BASHKË zotohet se do të rishqyrtojë të gjitha lejet e dhëna në trajtë koncensionesh apo PPP të cilat potencialisht shkaktojnë dëm mjedisor. Nga ana tjetër, do të rriten subvencionet për zhvillimin e turizmit lokal tradicional, që i jep përparësi zhvillimit të kapacitetit të komuniteteve lokale dhe ruajtjes së traditës së mikpritjes që është endemike në shoqërinë tonë.

3. Mbështetur në parimin ndotësi paguan, Lëvizja BASHKË do të shqyrtojë me kujdes dhe do të vendosë modelet më të drejta të taksave mjedisore. Shpenzimet e Shqipërisë për mbrojtjen e mjedisit janë sa 0.33% e PBB-së së vitit 2022. Ndërsa mesatarja e vendeve të rajonit për këtë shpenzim është sa 0.63% e PBB-së. Shqipëria shpenzon për mbrojtjen e mjedisit 0.30% më pak se mesatarja e vendeve të rajonit. Taksat mjedisore të aplikuara në Shqipëri do të alokohen ekskluzivisht për rritjen e buxhetit të mjedisit.
4. Rritja e performancës mjedisore të kompanive private dhe institucioneve publike të cilat kanë ndikim negativ në mjedis. Për këtë do të përmirësohet kuadri ligjor për të bërë të detyrueshëm menaxhimin mjedisor të aspekteve mjedisore mbështetur në praktikat më të mira të Bashkimit Evropian, si uljen e mbetjeve, të shkarkimeve, përmirësimin e praktikave të riciklimit, uljen e shfrytëzimit të burimeve dhe energjisë.
5. Do të përmirësohet zbatueshmëria e legjislacionit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor në të gjitha hallkat e këtyre proceseve komplekse dhe të vështira, të cilat deri më sot kanë shfaqur problematika serioze. Duke njohur konfliktin ekonomi-mjedis, Lëvizja

BASHKË do të aplikojë konceptin e kosto-përfitimit total. Në këtë kuptim, do të peshohen me kujdes përfitimet ekonomike (zakonisht private) karshi kostove (zakonisht publike) për të gjetur baraspeshën e duhur të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm. Kjo kërkon gjithashtu që të përdoren metodat bashkëkohore të vlerësimit monetar të shërbimeve të ekosistemit dhe të eksternaliteteve negative të agjentëve ekonomikë.

6. Etika mjedisore: Për t'u përballur me krizën mjedisore është e domosdoshme që qytetarët të kenë një formim të etikës mjedisore të shëndoshë, duke synuar jo vetëm një etikë të re të sjelljes konsumatore, por mbi të gjitha pjesëmarrjen e gjerë të shoqërisë në njohjen, vlerësimin dhe vendimmarrjen mjedisore. Për këtë arsye duhet kultivuar një etikë mjedisore e fortë në formimin qytetar. Lëvizja BASHKË do të mbështesë një kurrikulë të vazhduar dhe të fuqishme të edukimit mjedisor në të gjitha nivelet e edukimit parauniversitar, si dhe do të mbështesë projekte kulturore, mediatike dhe të organizatave mjedisore që kontribuojnë në këtë drejtim.
7. Rishikimi dhe përditësimi i strategjive ekzistuese të sektorëve të rëndësishëm të ekonomisë me qëllimin e vendosjes së qëllimeve mjedisore në vëmendjen e duhur.

Krahas këtyre masave të përgjithshme, Lëvizja BASHKË do të ketë prioritet:

1. Zonat e Mbrojtura

Zonat e Mbrojtura janë në presionin e aktivitetit ekonomik, veçanërisht nga sektori i turizmit, për këtë arsye do të rishikohet ligji nr. "81/2017 Për Zonat e Mbrojtura", duke ndjekur praktikat më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian.

2. Menaxhimi i Mbetjeve

Lëvizja BASHKË do të mbështesë projekte të reduktimit, ripërdorimit, ndarjes në burim dhe riciklimit të mbetjeve përpara incinerimit dhe depozitimit në landfille. Riciklimi i mbetjeve do të jetë një aktivitet ekonomik i rëndësishëm dhe fitimprurës, si dhe do të nxiten projekte për një ekonomi qarkulluese.

3. Kontrolli i ndotjes/Reduktimi i ndotjes të ajrit, ujit dhe tokës.

4. Ekosistemet detare

Megjithëse vitet e fundit ka rritje dhe përmirësim të dukshëm në studimet e ekosistemve ujore, përsëri shkalla e njohjes së biodiversitetit ujor, sidomos atij detar, është mjaft e kufizuar. Biodiversiteti në ekosistemin detar, në liqene dhe lumenj paraqet vështirësi studimi për vetë kushtet e veçanta në terren që kërkojnë këto studime, por edhe për shkak të traditës së kufizuar në këto lloj studimesh në Shqipëri, si dhe kufizimeve të mëdha financiare. Në Shqipëri nuk ka një institucion kërkimor të posaçëm për studimet detare, inventarizimet dhe monitorimet shkencore për mjedisin detar janë shumë të varfra, të rralla dhe të kryera vetëm për zonën bregdetare. Të dhënat për detin e hapur dhe thellësitë detare janë sporadike dhe informacioni ekzistues është shumë i pakët. Në anën tjetër, ekosistemet detare, përtej ndryshimeve klimatike, gjenden në një kërcënim të shtuar si rrjedhojë e urbanizimit intensiv në zonat bregdetare, turizmit masiv, peshkimit, transportit detar dhe ndotjes së lumenjve. Lëvizja BASHKË do të hedhë hapa konkretë më ngritjen e kapaciteteve për njohjen dhe mbrojtjen e ekosistemeve detare.

5. Ndryshimet klimatike

Do të mbështetet dekarbonizimi i ekonomisë, veçanërisht në sektorin e transportit, por edhe duke u dhënë mbështetje projekteve të prodhimit të energjisë së gjelbër, eficiencës energjetike, kursimit të energjisë etj. Më tej do të synohet ulja e shkarkimeve të gazeve serë. Po ashtu do të mbështeten projekte kërkimore që hulumtojnë dhe përgatisin shoqërinë rreth rritjes së përshtatshmërisë prej ndryshimeve klimatike.

2.7 SPORTI

1. Gjendja e përgjithshme e sportit në Shqipëri

Përveçse aktivitet fizik individual e kolektiv, në ditët e sotme sporti është kthyer edhe në pasion për masat e mëdha të njerëzve. Po kështu, në një botë ku obeziteti dhe izolimi social janë shndërruar në shqetësime serioze, sporti është nevojë elementare për një jetë të shëndetshme. Praktikimi i sporteve mund të bëjë më të shëndetshëm dhe më të lumtur për shkak të aktivitetit fizik. Marrja me sport kontribuon në zhvillimin e muskujve, koordinimin, shëndetin kardiovaskular dhe përfitime të shumta të tjera që lidhen me parandalimin e sëmundjeve; aktiviteti fizik mund të ndihmojë reduktimin e sëmundjeve kronike, përfshirë sëmundjet kardiovaskulare, diabetin, kancerin, hipertensionin, mbipeshën, depresionin dhe osteoporozën. Të qenët aktiv fizikisht si fëmijë e bën më të predispozuar të vazhdojë të luajë sporte si i rritur, duke promovuar shëndetin e përjetshëm. Në fakt, nuk është vetëm trupi që përfiton nga sportet. Ato kontribuojnë në shëndetin mendor, duke ndihmuar në parandalimin e depresionit dhe rritjen e vetëvlerësimit. Individët që marrin pjesë në ekipe sportive mund të përfitojnë gjithashtu nga aspekti shoqëror, duke zhvilluar miqësi me shokët e ekipit dhe duke u ndier pjesë e një grupi. Fëmijët mund të mësojnë aftësi pozitive të shëndetit mendor, duke përfshirë përgjegjshmërinë, udhëheqjen dhe përkushtimin.

Në përgjithësi numri i fëmijëve që merren me sport në Shqipëri është rritur kohët e fundit. Kjo vjen kryesisht sepse prindërit janë ndërgjegjësuar për përfitimet e sportit në një botë që po bëhet gjith-

monë e më shumë virtuale. Në krahun tjetër, mungesa e terrreneve sportive dhe e klasave sportive e bën pothuajse të detyrueshëm regjistrimin e fëmijëve në kurse sportive private qoftë edhe për të kaluar kohën. Po ky numër i lartë fëmijësh nuk përkthehet në numër më të lartë sportistësh të regjistruar në ekipe profesionale. Kjo pasi kur këta fëmijë rriten dhe vihen përballë vështirësive të jetës, si rritje e kostos së jetesës dhe e shpenzimeve për arsim, nuk e kanë më mundësinë të ndjekin sportet me apo pa pagesë. Pra, një studenti që në moshën 18 vjeçare duhet të shpërthejë në sport, mospagesa, apo pagesat që ai merr nga klubi (përfshijë futbollin e kategorisë superiore) janë aq të ulëta sa nuk i sigurojnë dot as kostot minimale të jetesës. Duke mos pasur rrugëzgjdhje tjetër, sportistët në formim detyrohen të braktisin sportin për të punuar në çfarëdo lloj pune.

2. Problemet kryesore

Historia e sportit shqiptar krahas vështirësive financiare është e mbushur me plot momente historike. Dikur, sportet e peshëngritjes, mundjes, volejbollit e basketbollit kanë arritur rezultate të paimagjinueshme sot. Kjo ka ndodhur pasi sporti ishte masiv dhe shihej si një rrugë e cila mund të bënte diferencën me profesionet e tjera.

Fatkeqësisht, sporti në Shqipëri prej vitesh po kalon një krizë të thellë në të gjitha aspektet si pasojë e shumë faktorëve që ndërthuren me njëri-tjetrin duke e bërë situatën shumë të rëndë. Investimet shumë të kufizuara nga ana e qeverisë në infrastrukturë, mungesa totale e financave sidomos në sportet e lojërave me dorë apo në sportet individuale, mbajtja e sportit jashtë vëmendjes së politikave zhvilluese dhe më kryesorja mungesa e një ligji të sponsorizimit në sport janë faktorët kryesorë të situatës ku ndodhemi.

Mjaft specialistë kanë lëshuar alarmin për atë që po ndodh në sport sepse të rinjtë gjithmonë e më shumë po largohen nga sporti duke e braktisur atë në mënyrë fatale. Sporti ynë është gjithmonë e më pak konkurrues apo fitues në sporte të veçanta, madje duke humbur terren dhe në ato disiplina ku kemi pasur një lloj tradite dhe kemi lënë gjurmë. Padyshim kriza më e madhe me të cilën ballafaqohet sporti në këtë moment është financimi. Shteti vijon të mbështesë me shifra minimale federatat sportive, fonde këto që nuk mjaftojnë për të mbajtur zyrtarët me paga për të mos përmendur financimin që bëjnë bashkitë me taksat e taksapaguesve shqiptarë që lëshohen si lëmoshë në klubet përkatëse.

Në krahun tjetër, mungesa e terreneve sportive me kushtet e duhura është një gangrenë e cila ka ndikim të madh në zhvillimin e sportit. Dhënia si troje për ndërtimin e pallateve shumëkatëshe e hapësirave dhe fushave sportive, privatizimi i pallateve të sportit, investimet e pakta publike u kanë dhënë fund shumë disiplinave në të cilat shkëlqenim dhe ekipet sportive janë shpërfytyruar në deri në inekzistencë.

Edhe pse qeveria nisi rreth katër vite më parë projektin e klasave sportive, duket se ky program ka pasur një ndikim të kundërt duke reduktuar numrin e ekipeve zinxhirë në lojërat me dorë. Specialistët mendojnë se kjo vjen nga mungesa e pagesave në sportin profesionist dhe mospasja e shembujve. Në vendet e zhvilluara, sportistët elitarë ndiqen si shembuj dhe fëmijët arrijnë të kuptojnë se sakrificat në sport sot, mund të të bëjnë një shembull nesër. Krejt e kundërta ndodh në vendin tonë: kur një i ri (12-15 vjeç) vjen në një ekip zinxhir moshash dhe kupton se lojtarët profesionistë të ekipit paguhen poshtë rrogës minimale (kryesisht 25.000 lekë në muaj), i gjithë pasioni i tij dhe dëshira për të punuar në stërvitje minimizohet. Në vazhdim, kur

sportisti arrin moshën 18-19 vjeç dhe do ti duhet të përballet me kostot e jetesës në rritje dhe me shpenzimet për shkollim, do të detyrohet të punojë pasi sporti nuk arrin ti sjellë mjaftueshëm të ardhura. Kjo çon dëm 5-6 vite punë intensive si të lojtarit edhe të trajnerit e klubit.

III. Alternativa e Lëvizjes BASHKË për sportin

Duke qenë se sporti ka përfitime të mëdha në shoqëri dhe në shëndetin publik, ai duhet mbështetur. Lëvizja Bashkë ka në plan një program tejet ambicioz për zhvillimin e sportit dhe masivizimin e tij.

Miratimi i ligjit të sponsorizimeve

Siç e përmendëm më sipër, mungesa e financave është thembra e Akilit e sportit shqiptar sot. Shteti, në pamundësi për të financuar federatat sportive apo klubet me buxhetin e duhur, duhet të lehtësojë mundësinë e financimit nga bizneset. Miratimi i Ligjit të Sponsorizimeve do të bënte të mundur zgjidhjen afatgjatë të këtij problemi. Në këtë rast, një kompani e regjistruar mund të sponsorizojë një klub sportiv me shuma deri në 30% të tatimit mbi fitimin vjetor që ajo paguan, dhe kjo shumë i zbritet kompanisë nga detyrimet që i jepen shtetit.

Ky ligj ka disa vite që aplikohet me sukses në Republikën e Kosovës dhe duket se kjo po sjell frytet e para; masivizimin e sportit dhe arritjet e disa rezultateve shpresëdhënëse në arenën ndërkombëtare. Kjo nuk do të sillte thjesht zhvillim në sport, por do të krijonte hapësira për vende të reja pune për njerëzit më të kualifikuar, do të rriste investimet në infrastrukturë dhe do zgjeronte bazën e atyre që do merreshin me sport.

Investime në infrastrukturën sportive

Në pamje të parë, rikonstruktimi i disa stadioneve dhe ngritja tek-tuk e ndonjë pallati sporti vënë në dukje një interesim të shtetit për infrastrukturën sportive. Por në fakt, e vërteta është totalisht e kundërta. Shumë pallate sporti, palestra sportive dhe fusha futbolli janë lënë në harresë. Nëse në sportet e tjera është bërë ndonjë investim sa për të "larë gojën", fushat e futbollit për sportistët e moshave dhe kategorive të ulëta janë zhdukur në favor të pallateve dhe ndërtimeve të cilat sjellin të ardhura për investitorin. Vetëm në Tiranë janë të panumërta fushat sportive të kthyer në beton nga qeveritë e mëparshme. Palestarat që janë rikonstruktuar kanë pasur kosto të frikshme dhe paratë nuk kanë shkuar për zgjidhjen e problematikës, por në fasada dhe teknologji e cila mund të konsiderohet luks për momentin.

Ekipet profesionale të volejbollit dhe basketbollit dhe ekipet zinxhirë të moshave hasin vështirësi në gjetjen e ambienteve sportive. Pallatet e sportit janë të amortizuara aq sa shpesh herë ndodhin lëndime të sportistëve për shkak të dëmtimit të parketit. Ngrohja me kalidajë e këtyre ambienteve konsiderohet luks dhe shpesh herë në dimër sportistët vuajnë nga kushtet duke u sëmurë. Ekipet zinxhirë nuk sigurojnë dot ambiente për stërvitje dhe pagesat e trajnerëve janë qesharake ndaj në shumë raste fëmijët paguajnë për stërvitje.

Edhe mundja, e cila solli për herë të parë medalje nga dy shtetas rusë të natyralizuar si shqiptarë, ka problematika të theksuara të ambienteve të trajnimit. Nga një vëzhgim i muajve të fundit, ekipet profesionale të mundjes po kalojnë një situatë të vështirë. Konkretisht, ekipi i Tiranës i bën stërvitjet në një godinë afër një kishe, me një tavan të rënë. Palestra e Durrësit të kthen prapa në mesjetë, e parregulluar, me

suva të rënë dhe e pa lyer e me tapet të prishur. E njëjta situatë në Shkodër, ku palestra është vetëm 35 metra katrorë dhe me tapet të çarë ku sportistët rrezikojnë dëmtime; tualet shumë të vogël dhe të parregulluar. Elbasani dhe Korça nuk kanë fare ekip mundjeje. Mungesa e investimeve dhe kushtet e mjerueshme kanë bërë që këto ekipe të zhduken nga qarkullimi.

Lëvizja BASHKË do të investojë në krijimin e kushteve të përshtatshme në palestrat e amortizuara dhe gjithashtu do të tentojë rikuperimin apo shndërrimin e hapësirave të pashfrytëzuara në fusha sportive. Fondet e destinuar do të përdoren me efektshmëri duke mos fryrë kostot me lukse të panevojshme, por duke përdorur me efikasitet buxhetin e dedikuar për këtë infrastrukturë.

Rijetëzimi i klasave sportive

Përpyekjet e fundit të qeverisë për të bashkëpunuar me Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) dhe federatat përkatëse **të Volejbollit dhe Basketbollit për ngritjen e ekipeve sportive në shkollë dhe masivizimin e sporteve, kanë dështuar.**

Në vitin 2022, me një fond total prej 5 milionë eurosh, nisi projekti i sipërpërmendur me objektiv krijim e 700 ekipeve të basketbollit dhe volejbollit me nxënës të shkollave 9-vjeçare në të gjitha bashkitë e vendit. Pretendohet se rreth 10 mijë fëmijë u pajisën me uniformë dhe atlete sportive. Shumica e fondit ka shkuar për këtë zë, **çka lë dyshime të forta se paratë kanë përfunduar në xhepat e zyrtarëve me tendera të fryra.**

Nga bisedat me specialistët e kontraktuar për të trajnuar fëmijët, u theksua se ata paguheshin me pagesa të ulëta 190 mijë lekë për një vit shkollor, për 90 minuta në ditë, gjashtë ditë në javë (pra 19 mijë lekë në muaj), ndërsa koordina-

torët për qarkun (shpesh herë pa asnjë lidhje me sportet dhe të dyshuar për lidhje me partinë në pushtet) merrnin rroga të majme (65 mijë lekë në muaj) për punën që bëjnë.

Sipas tyre, arsyet e dështimit të projektit ishin:

1. Pagesat shumë të ulëta të specialistëve të trajnimit e cila nuk sillte nxitje për të punuar.
2. Kërkesa me detyrim për të marrë pjesë jashtë orarit të punës në mbledhje me funksionarë politikë bëri që shumë prej specialistëve të hiqnin dorë nga programi.
3. Mungesa e materialeve bazë për trajnimin: mungesë e koshave të basketbollit, e rrjetës, piketave apo materialeve të tjera me të cilët specialistët ishin trajnuar paraprakisht.
4. Mungesa e trajtimit të sportistëve të talentuar që evidentoheshin si premtues për të ardhmen bëri që shumë prej tyre në pamundësi ekonomike ta braktisnin sportin. Duhet pasur parasysh se një nxënës që stërvitet duhet të ushqehet më mirë se të tjerët.

Në përfundim, nuk ka asnjë raport të detajuar si të shpenzimeve dhe të arritjeve për sportet përkatëse **për të bërë bilancin. Gjithsesi, ekziston një perceptim i përgjithshëm se numri i fëmijëve që vazhdojnë trajnimin është shumë më i ulët se 10 mijë. Kjo vërtetohet nga zvogëlimi i numrit të ekipeve zinxhir në sportet përkatëse.** Ndërkohë që pas 2 vitesh e gjysmë, sportistët e shkollave duhet të ishin transferuar në ekipet zinxhirë të klubeve sportive dhe për pasojë duhet të kishte një rritje në numrin e këtyre të fundit, vitin e fundit është vënë re e kundërta: numri i ekipeve është zvogëluar.

Në fakt, rasti i financimit me shifra tejet të larta i sportit amator vështirë se gjen precedent në vendet e tjera. Është pa mend mbështetja e sportit amator, kur nuk mbështet sportin profesionist. Ideja është se fëmija apo prindi i fëmijës që i ke falur uniformën dhe supozohet se do të trajnohet në shkollë, kur merr vesh se si paguhet sportisti profesionist, dekura-johet, ndaj edhe fëmija e braktis stërvitjen. Logjikisht, duhet mbështetur sporti profesionist, që të luajë rolin e modelit dhe të jete nxitje edhe për fëmijët.

Lëvizja BASHKË ka në programin e saj rijetëzimin e klasave sportive. Për këtë duhen korrigjuar gabimet e qeverive të kaluara. Fillimisht, specialistëve të trajnuar paraprakisht duhet ti sigurohet një pagesë e denjë për punën që kryejnë dhe infrastruktura e nevojshme për trajnim. Ky program shkon në të njëjtën linjë me propozimet e Lëvizjes Bashkë për shkollimin me orar të zgjatur. Presioni për të marrë pjesë në mbledhjet e partisë është totalisht abuzues në një vend demokratik. Më tej, paratë që qeveria aktuale i çon në uniforma me çmime të fryra do të shkojnë për trajtimin minimal ushqimor për nxënësit që ushtrojnë aktivitete fizik dhe do të nxitet lidhja e sportistëve me premtues me ekipet zinxhirë të sporteve të ndryshme.

IV. Implementimi

Lëvizja BASHKË sheh te sporti një fushë e cila mund të ndikojë pozitivisht në shëndetin fizik dhe mendor të fëmijëve dhe tek brezat e ardhshëm. Sporti profesionist duhet të promovohet me pagesa të denja dhe ai amator duhet të masivizohet te fëmijët.

Për zhvillimin e sportit duhen marrë masat e mësipërme:

1. Miratimi i ligjit të sponsorizimeve duke i ulur deri në 30% të tatimit mbi fitimin kompanive që investojnë në të.
2. Rehabilitimi dhe ndërtimi i palestrave sportive dhe fushave të futbollit si për ekipet profesioniste dhe të moshave.
3. Rijetëzimi i klasave sportive në shkolla.
4. Pagesave dinjitoze dhe ofrimi i kushteve optimale për specialistët që do të punojnë në këto projekte.
5. Stimulimi me bazë materiale dhe ushqim i sportistëve në shkolla dhe lidhja me ekipet zinxhir.

3.

SHTETI I SË DREJTËS

Shteti i së drejtës, i bazuar në parimet kushtetuese të ndarjes dhe drejtpeshimit të pushteteve, është një prej arritjeve më të mëdha të njerëzimit. Ky shtet bazohet në një kushtetutë demokratike, mbi bazën e të cilës ngrihen institucione llogaridhënëse ndaj shoqërisë, të cilat respektojnë frymën e ligjit të drejtë dhe arrijnë të sigurojnë të drejtat e njeriut dhe të qytetarit.

Një prej kushteve themelore të shtetit të së drejtës është pavarësia dhe efektiviteti i pushtetit gjyqësor. Lëvizja BASHKË ka vullnetin dhe idetë për të forcuar këto parime dhe për të ngritur institucione të tjera të pavarura që ndihmojnë në sundimin e ligjit dhe luftën efikase kundër korrupsionit.

3.1 SISTEMI I DREJTËSISË

Drejtësia sociale i referohet konceptit të krijimit të një shoqërie ku të gjithë individët kanë të drejta, mundësi dhe akses të barabartë në burime, pavarësisht nga faktorë të tillë si raca, gjinia, moshë, pozita socio-ekonomike, feja ose karakteristika të tjera. Drejtësia sociale kërkon të adresojë dhe korrigjojë pabarazitë dhe padrejtësitë sistematike që i pengojnë njerëzit të arrijnë potencialin e tyre të plotë.

Një nga parimet kryesore të drejtësisë sociale është respektimi i të drejtave dhe llogaridhënia. Avancimi dhe përkrahja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut duhet të shoqërohet me mbajtjen e individëve, organizatave, si private ashtu dhe publike përgjegjëse në rastet kur nuk arrijnë të nxisin respektimin dhe avancimin e të drejtave dhe të drejtësisë sociale.

Në këtë kuadër, gjykatat luajnë një rol të pazëvendësueshëm, pasi ato sigurojnë zbatimin dhe interpretimin e ligjeve, garantojnë të drejtat e individëve dhe zgjidhin konfliktet ndërmjet palëve të ndryshme. Pushteti gjyqësor përbën parakushtin e sigurisë juridike dhe gëzimit dhe cenimit të të drejtave, në bazë të një procesi të rregullt ligjor. Gjykatat janë organet kompetente që, nëpërmjet një procesi të drejtë e publik, gjykojnë faktet e veprimet që konsiderohen se kanë shkelur interesat të ligjshme të qytetarit ose të subjekteve të tjera dhe mbi bazën e tij japin drejtësi. Sistemi i drejtësisë në Shqipëri në përgjithësi dhe gjykatat në veçanti kanë njohur problematika të shumta, të cilave Shqipëria ka tashmë disa vite që po u bënë ballë, me dëshirën për të pasur një drejtësi të pavarur dhe me identitet të fortë.

Parimet dhe alternativa e Lëvizjes BASHKË për sistemin e drejtësisë

1) Pavarësia

Në përditshmërinë e saj, qytetarët shqiptarë dëshmojnë mënyrat direkte ose indirekte me anë të të cilave funksionaret e lartë qeverisë ose të varur prej tyre, ushtrojnë presion mbi eksponentët të drejtësisë. Kësisoj ligji dhe i gjithë sistemi i gjyqësorit shndërrohet në një mjet ekstrapolitik, ku vënia e drejtësisë ka kaluar në plan të dytë.

Lëvizja BASHKË i dënon rëndë këto norma sjelljesh që kanë kapluar institucionet tona. Vizioni ynë është ai respektimit të parimit kushtetues të ndarjes së pushtetit. Po ashtu, ne e konsiderojmë si bazament bashkëpunimin me institucionet e drejtësisë, duke pasuruar akoma dhe më tej kuadrin ligjor dhe krijuar kushtet optimale, sa në prizëm politik, ku përfshijmë mospërdorimin e influencës në proceset gjyqësore, aq edhe në prizëm administrativ. Thënë këtë, Lëvizja BASHKË, duke njohur arritjet e deritanishme të institucioneve të reja të drejtësisë, shpreh mbështetjen e plotë për fuqizimin e sistemit të drejtësisë në përputhje me aspiratat e popullit shqiptar për drejtësi.

2) Rritja e aksesueshmërisë dhe eficiencës në gjykim

Sot qytetari shqiptar ballafaqohet me një sistem me normë nën standard të likuidimit të çështjes dhe eficiencës ekonomike gjyqësore dhe me mungesën e hapësirave për t'iu drejtuar gjykatave si pasojë e hartës së re të gjyqësorit.

Reduktimi i gjykatave, duke e ofruar si shërbim publik në mënyrë aq të koncentruar në 13 rrethe gjyqësore (gjykata të shkallës së parë), 6 Apelit, 6 Administrative të Shkallës së Parë dhe vetëm një për Apel Administrativ, ka ndikuar

drejtpërsëdrejti në rritjen e kostove të qytetarëve të cilët jetojnë në zona të largëta dhe ka bërë pothuajse të pamundur aksesin në drejtësi.

Propozimet e bëra nga Grupi i Punës për Hartën e Re Gjyqësore pranë KLGJ më 2021 reflektojnë pjesërisht vlerësimin e kriterëve dhe objektivave të domosdoshëm, duke mos reflektuar një vlerësim të njëjtë të secilit prej tyre, por të fragmentarizuar. Si rrjedhojë e kësaj metodologjie të përdorur nga grupi i punës dhe uljes drastike të numrit të gjykatave, krijohen premisa serioze për cenimin e aksesit në drejtësi.

Lëvizja BASHKË propozon rishikimin e Hartës Gjyqësore. Sipas Ligjit nr. 98/2016 (neni 13), harta gjyqësore rishihet çdo pesë vjet ose kur në funksionimin e saj nuk respektohen më parashikimet e nenit 14 dhe 15. Duke u bazuar në nenin 13, K.L.GJ dhe Ministria e Drejtësisë propozojnë një strukturim të ri për gjyqësorin, ku pasi konsultohen me institucione të tjera, si K.L.P, Prokurorinë e Përgjithshme dhe Ministrinë e Financave, e depozitojnë pranë Këshillit të Ministrave, për miratim. Përveçse me institucionet e lartpërmendura, Lëvizja BASHKË do të ftojë për konsultim edhe grupet e interesit me qëllim ngritjen e një sistemi sa më gjithëpërfshirës. Të gjitha fazat e konsultimit do të karakterizohen nga transparenca.

Një tjetër propozim është vazhdimi i logjikës së reformimit pjesor të Kodit të Procedurës Civile, duke riparë përbërjen e trupit gjykues në raport me natyrën e çështjes dhe llojin e objektit të mosmarrëveshjes. Kjo sugjerohet dhe nga akti i majit të 2024, përpiluar nga një grup ekspertësh pranë K.L.GJ-së, titulluar « Strategjia kombëtare e uljes së numrit të çështjeve të prapambetura në gjykatë ». Ndërhyrja në fjalë bazohet në rolin që ne do të kemi në Kuvend si ligjvënës.

Duke u bazuar tek i njëjti dokument, ndërhyrja e ekzekutivit qëndron dhe në financimin e bashkëpunimit për automatizimin e proceseve të ndryshme. Pra duke ndërtuar një sistem kompjuterik për regjistrimin e çështjeve, dokumenteve tip për çështje me natyrë të përshpejtuar dhe jo komplekse etj. I gjithë ky automatizim do të ndikonte në aksesueshmëri dhe respektimin e afateve ligjore. Financimi do të shkojë edhe në ngritjen e një sistemi ku procesi gjyqësor mund të zhvillohet në hapësirën online, siç është praktika tashmë dhe e vendeve perëndimore.

Po ashtu, një nevojë tjetër për sistemin gjyqësor është edhe mirëkualifikimi i ndihmësve gjyqësorë. Për këtë pozicion mund të zhvillohen politika nxitëse, që të rritet numri i tyre si personel asistues dhe të zotërojnë mjaftueshëm kapacitete që të lehtësojnë gjyqtarët në kryerjen e veprimeve të ndryshme procedurale, në funksion të administrimit të drejtësisë, për çdo çështje individuale.

Lëvizja BASHKË propozon edhe ndërhyrje në organikën e gjyqësorit, duke zbatuar një nga alternativa e mëposhtme:

I. Për procedurat e shqyrtimit të padive për shuma të vogla, nëse gjykata e çmon të nevojshme që palët të jenë të pranishme, të organizojë një seancë në rrethin gjyqësor më të afërt me palët; ose

II. Të krijohet degë e çdo Gjykate të Juridiksionit të Përgjithshëm në rrethet gjyqësore që ato përfaqësojnë për të gjykuar vetëm këto lloj padish.

Të gjitha këto masa do të kontribuojnë në rritjen e cilësisë së gjyqësorit, duke plotësuar të gjitha kriteret e një sistemi të aksesueshëm dhe që mbron në mënyrë të pavarur të drejtat dhe interesat legjitime që për qytetarët janë ende aktuale.

3) Profilizimi i gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm

Ne shohim nevojën për të profilizuar më shumë sistemin e Gjykatave të Juridiksionit të Përgjithshëm. Lëvizja BASHKË, e shqetësuar për nivelin e drejtësisë sociale në Shqipëri, është e mendimit se në këto gjykata duhet të krijohet një seksion i veçantë (ose dhomë) që të shqyrtojë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës. Një seksion i tillë do të krijonte një profil gjyqtari të aftë për të gjykuar çështjet e marrëdhënieve të punës të cilat, përveç zbatimit të saktë të normës ligjore, kërkojnë edhe një analizë më të thelluar të fakteve dhe rrethanave, të cilat në një ambient pune përmbajnë një kompleksitet shumë të madh, që shpeshherë mund të rezultojë gabimisht në dëm të punëtorëve ose punonjësve në përgjithësi.

Lëvizja BASHKË nuk është kundër as krijimit të dhomave paragjyqësore të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mes punonjësve dhe punëdhënësve, por këto modele mund të funksionojnë vetëm në vende ose rrethana ku sindikatat ose, në përgjithësi, përfaqësitë e punonjësve kanë peshë në jetën sociale. Kjo është e nevojshme për shkak se këto dhoma kanë gjithmonë një përbërje të përzier.

4) Prioritet për çështjet administrative mbi kontributet shoqërore dhe pensionet

Një nga problematikat që përndjek edhe sot e kësaj dite shoqërinë shqiptare është njohja e viteve të punës dhe kontributeve shoqërore të derdhura në skemën e pensioneve. Përgjatë viteve punëmarrësit shqiptarë janë ndeshur me institucione të papërgjegjshme, në rastin më të mirë, dhe kryekëput të korrupsionit, në rastin më të keq, të cilat kanë pamundësuar njohjen e viteve të plota të punës, duke i detyruar t'u drejtohen gjykatave, me gjithë vonesat e pajustificueshme në rastin e të moshuarve.

Lëvizja BASHKË e sheh të udhës që të gjithë qytetarët të cilët kanë probleme me njohjen e viteve të punës dhe kontributeve në skemën e pensioneve të ndihmohen, duke ngritur zyra të posaçme pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të cilat do të luajnë një rol orientues mbi dokumentacionet që qytetarët duhet të depozitojnë si dhe me ç'Veprime administrative duhet t'i shoqërojnë.

Përveç kësaj ndihme, Lëvizja BASHKË do të advokojë për krijimin e një korridori prioriteti që të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me skemën e pensioneve dhe I.S.SH. t'u jepet zgjidhje brenda një afati të arsyeshëm. Ky propozim vjen si pasojë e gjendjes anormale që pensionistët shqiptarë jetojnë dita-ditës. Ne besojmë te drejtësia sociale, subjektet të së cilës duhet të jenë dhe ata të cilët kanë kontribuar çdo ditë të jetës së tyre, që vendi ynë të jetë sado më i mirë.

Shqipëria duhet të jetë një shtet ku zhvillimi ka konture të qarta të drejtësisë sociale, kryefjala e së cilit është respektimi i të drejtave e lirive themelore të qytetarëve dhe qëllimi përfundimtar nuk është abuzimi me ta, por krijimi i kushteve më optimale për mirëqenie dhe barazi.

3.2 ANTIKORRUPSIONI DHE SUNDIMI I LIGJIT

Lëvizja BASHKË mbështet një ndarje të qartë mes interesave private dhe publike në ushtrimin e pushtetit politik. Ne do të punojmë që shteti të veprojë në mënyrë të paanshme, me një administratë të pavarur nga interesat private, e cila trajton çdo qytetar në mënyrë të barabartë dhe siguron që vendimet të merren për mirëqenien e përbashkët dhe shpërndarjen e drejtë të pasurive dhe burimeve publike.

Ne e shohim korrupsionin jo vetëm si shkelje ligjore, por konsiderojmë korrupsion çdo akt që dëmton parimin e mundësive të barabarta nga ata që kanë besimin për të ushtruar pushtet publik. Çdo keqpërdorim i pushtetit për të favorizuar disa individë ose grupe të caktuara në dëm të drejtësisë është korrupsion.

I. Gjendja dhe problemet

Në Shqipërinë e sotme korrupsioni ka arritur në nivelin e kapjes së shtetit. Oligarkët ekonomikë dhe organizatat kriminale kontrollojnë përditë e më shumë vendimmarrjet publike, duke shpërfytyruar rendin kushtetues demokratik, tjetërsuar parimet e një ekonomie të shëndetshme tregu dhe përvetësuar të mirat publike.

Ligje si ai i arsimit të lartë dhe i investitorëve strategjikë, kontratat koncesionare në shëndetësi dhe ndërtimin e infrastrukturës publike, shkatërrimi për interesa private i porteve të Durrësit dhe Vlorës, lejet e ndërtimit jashtë çdo logjike të shëndoshë urbanistike në Tiranë dhe qytetet bregdetare, skandalet e incen-

eratorëve të Tiranës, Elbasanit e Fierit, grabitja e burimeve ujore e natyrore të fshatrave anembanë Shqipërisë për interesat private të njerëzve me pushtet ekonomik dhe kriminal janë shembujt më të prekshëm të kapjes së shtetit.

Lëvizja BASHKË vlerëson pozitivisht punën e deritanishme të institucioneve të reja të drejtësisë. Po lufta e gjithanshme ndaj korrupsionit kërkon jo vetëm fuqizimin e mëtejshëm të institucioneve aktuale, por edhe hartimin e ligjeve dhe ngritjen e institucioneve të reja që do të mbështetin aktualet në zhbërjen e kapjes së shtetit dhe çrrënjosjen e korrupsionit në Shqipëri.

II. Alternativa e Lëvizjes BASHKË

Lëvizja BASHKË propozon masa që forcojnë aftësinë e shoqërisë për të parandaluar që ata që janë ngarkuar me pushtet publik të shfrytëzojnë pozitën e tyre për përfitime private.

• Themelimi i Agjencisë Kombëtare për Integritet dhe Antikorrupsion

Parandalimi i korrupsionit nuk mund të lihet në dorë të qeverisë, veçanërisht kur qeveria vetë perceptohet gjerësisht si e korruptuar. Kuadri institucional antikorrupsion ka të meta. Besimi te një ministri për të drejtuar këtë agjendë është shqetësues, meqenëse udhëheqja dhe buxheti i saj varen nga qeveria, ndërkohë që veprimtaria e saj diktohet nga agjenda politike e pushtetmbajtësve. Kjo cenon zbatimin e qëndrueshëm dhe të paanshëm të politikave.

Lëvizja BASHKË propozon themelimin e një **agjencie për parandalimin e korrupsionit dhe garantimin e integritetit publik**, me një mandat të qartë për të vepruar në mënyrë të pavarur dhe trans-

parente. Agjencia do të hartojë strategji parandaluese, do të mbikëqyrë zbatimin e politikave antikorupsion nga institucionet publike, do të sigurojë transparencën në qeverisje dhe do të promovojë një kulturë etike në administratën publike.

Përveç hartimit të politikave, agjencia do të verifikojë pasuritë e zyrtarëve publikë dhe do të trajtojë konfliktet e mundshme të interesit – detyra që tani i përkasin ILDKPKI-së, por që çalojnë në zbatim. Agjencia do të ketë kompetenca rregullatore, mbikëqyrëse, këshilluese dhe sanksionuese. Ajo do të raportojë në Kuvendin e Shqipërisë dhe do të ketë të drejtën të rekomandojë ndryshime ligjore.

Agjencia do të krijohet në përputhje me parimet e përcaktuara në Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, duke përmblusur kështu një detyrim të kahershëm për vendin.

E pajisur me burimet dhe autoritetin e nevojshëm, kjo agjenci do të zhvillojë një luftë të qëndrueshme kundër korrupsionit, duke garantuar integritet dhe përgjegjëshmëri në qeverisje.

• **Zhbërja e kapjes së shtetit**

Proceset legjislative dhe vendimmarrëse në Shqipëri shfaqin prova të qarta të kapjes nga interesa politike dhe korporativë. Kjo është bërë gjithnjë e më e dukshme vitet e fundit përmes praktikave si miratimi i ligjeve të krijuara për t'u shërbyer interesave të ngushta private, ndikimi i paligjshëm i aktorëve privatë mbi vendimet e qeverisë, gjyqësorit dhe administratës publike, si dhe përdorimi i hileve procedurale për të anashkaluar transparencën dhe konsultimin publik.

Vizioni ynë është i qartë: të përmbysim këtë tendencë duke garantuar integritetin e procesit të ligjvënies. Ne synojmë të forcojmë kuadrin ligjor për hartimin,

amendimin dhe miratimin e legjislacionit, në mënyrë që t'u shërbejë qytetarëve dhe jo agjendave të pushtetmbajtësve.

Transparenca do të jetë një parim thelbësor. Çdo projektligj do të shoqërohet nga një raport mbi “gjurmën legjislative”, i cili do të dokumentojë procesin e hartimit, duke shënuar propozuesit dhe institucionet e përfshira, konsultimet, opinionet e ekspertëve, historikun e amendamenteve dhe ndikimin e grupeve të interesit. Të gjithë ligjvënësit dhe zyrtarët do të deklarojnë pjesëmarrjen e tyre, si dhe do të publikohen emrat e individëve ose aktorëve privatë që përfshihen në hartimin e projektligjeve. Raportet do të jenë të aksesueshme në faqen zyrtare të Kuvendit, duke përfshirë dokumentet përkatëse si versionet e projektligjit, amendamentet dhe propozuesit e tyre, të dhënat nga konsultimet dhe mënyra e votimit të secilit deputet. Do të heqim të drejtën e deputetëve për të propozuar amendamente të pakonsultuara 24 orë përpara votimit të projektligjeve në seanca plenare.

Konsultimi publik do të ngrihet në një standard të ri. Përmes ndryshimeve ligjore, do të bëjmë të detyrueshëm konsultimin për vendimet e Këshillit të Ministrave dhe do të njohim të drejtën e qytetarëve për t'u ankuar për procesin e konsultimit publik përpara hyrjes në fuqi të aktit ligjor. Për të forcuar mbikëqyrjen e pavarur të konsultimit publik, do të rrisim rolin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit, duke i dhënë kompetenca për të vendosur sanksione administrative dhe për të urdhëruar përsëritjen e procesit të konsultimit në rast të shkeljeve. Do të përforcojmë proceset e planifikimit të konsultimit publik, transparencën e procesit, raportimin mbi rezultatet e konsultimit dhe vlerësimin e performancës së institucioneve.

Kufijtë midis institucioneve publike dhe

aktorëve privatë janë të mjegullt. Ne do të propozojmë një **ligj për të rregulluar aktivitetet e përfaqësimit etik të interestave**. Ky ligj do të garantojë transparencë të plotë në ndërveprimet mes zyrtarëve publikë dhe aktorëve të organizuar privatë përmes krijimit të një regjistri publik të përfaqësuesve të interesave privatë dhe hartimit të një kodi sjelljeje, në mënyrë që vendimet politike të merren hapur, jo pas dyerve të mbyllura. Po ashtu, ligji do të rregullojë në mënyrë transparente aksesin e aktorëve të organizuar privatë në mjediset e institucioneve publike. Agjencia Kombëtare për Integritet dhe Antikorrupsion do të jetë përgjegjëse për zbatimin e ligjit dhe administrimin e regjistrit.

• **Heqja e privilegjeve ligjore**

Për vite me radhë qeveria ka dhënë privilegje ligjore që kanë favorizuar padrejtësisht aleatët e saj dhe interesat e fuqishëm biznesorë në dëm të publikut të gjerë. Këto privilegje kanë krijuar një terren të pabarabartë ekonomik, kanë penguar konkurrencën dhe i kanë mundësuar një pakicë të pasurohet dhe të fitojë ndikim, ndërsa qytetarët dhe bizneset e zakonshme përballen me pengesa burokratike.

Ne jemi të përkushtuar ta çmontojmë këtë sistem favorizimi duke eliminuar privilegjet ligjore në ekonomi dhe shërbimet publike. Lëvizja BASHKË do të shfuqizojë ligjin për investimet strategjike dhe ligjin për koncesionet dhe partneritetin publik-privat. Nga ana tjetër do të hartojmë mekanizma ligjorë për të rishikuar koncesionet e deritanishme, duke u udhëhequr gjithmonë nga parimet e transparencës, konkurrencës së ndershme dhe trajtimit të barabartë për të gjithë aktorët ekonomikë.

• **Integriteti i procesit zgjedhor**

Partitë politike kanë funksionuar për një kohë të gjatë si entitete të mbyllura, duke operuar jashtë vëmendjes së publikut dhe pa llogaridhënie për veprimet dhe financat e tyre. Reforma zgjedhore shpesh ka kaluar në tregti politike mes partive tradicionale. Perceptimi i publikut, i mbështetur nga raporte të ndryshme, tregon se partitë politike janë ndër aktorët kryesorë që nxisin dhe prodhojnë korrupsion. Prandaj ne synojmë të reformojmë aspekte kyçe të mënyrës se si financohen partitë politike.

Ne propozojmë një ligj që do të rregullojë **financimin e partive politike**, duke siguruar transparencë në veprimtaritë e tyre dhe ndaluar çdo financim nga burime të paligjshme.

Hapësirat ligjore kanë lejuar aktorët politikë të anashkalojnë rregullat, të krijojnë avantazhe të padrejta dhe të fshehin aktivitete të paligjshme. Ligji për financimin e partive politike do të rregullojë kush mund të dhurojë, sa mund të dhurohet dhe në çfarë forme, si dhe mënyrën se si regjistrohen dhe shpenzohen financat. Po ashtu, ligji do të rregullojë financimin personal të fushatave të kandidatëve dhe dhurimet përmes palëve të treta. Dhurimet në para do të duhen të depozitohen në llogaritë bankare të partive politike brenda pak ditësh nga marrja, ndërsa palët e treta do të detyrohen të raportojnë aktivitetet dhe shpenzimet e fushatave për llogari të kandidatëve apo partive politike.

Përveç kësaj, do të forcojmë kapacitetet e institucioneve shtetërore përgjegjëse për monitorimin e shpenzimeve të partive politike, veçanërisht gjatë fushatave zgjedhore, me një theks të fortë në shqyrtimin e shpenzimeve në rrjetet sociale. Sanksionet aktuale për shkeljet do të rishikohen dhe forcohen në mënyrë që të shkurajojnë keqbjerrjet.

• **Konflikti i interesit dhe deklarimi i aseteve**

Në këtë kuadër ne do të jemi të vëmendshëm ndaj lëvizjeve të individëve midis shërbimit publik dhe sektorit privat. Situata të tilla të konfliktit të interesit rrisin shqetësimet për atë që quhet kapje e proceseve rregullatore, ku institucionet rregullatore dominohen nga vetë industritë që ato duhet të mbikëqyrin. Për të luftuar këtë, do të zbatojmë periodha të rrepta shkëputjeje (*cool-off period*) që u ndalojnë individëve të pranojnë pozita specifike në sektorin privat për një periudhë të caktuar pas largimit nga detyra publike.

Sa u përket deklaratave të pasurive, do të sigurojmë që këto të dhëna të jenë lehtësisht të aksesueshme për publikun, në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave të ndjeshme personale. Do të fuqizojmë autoritetin përkatës duke e pajisur me burimet e nevojshme për të verifikuar deklaratat e pasurive dhe do të garantojmë që sanksionet për mosrespektim të jenë domethënëse.

• **Sinjalizuesit**

Denoncimi i praktikave të paligjshme përmes sinjalizimit ka dështuar të arrijë qëllimet e tij, pasi numri i rasteve të raportuara mbetet zhgënjyes. Kjo mangësi ka ardhur nga autocensura e nëpunësve dhe mungesa e thellë e besimit në mekanizmat mbrojtës.

Ne do të forcojmë ndjeshëm mbrojtjen ligjore dhe masat e konfidencialitetit për sinjalizuesit për të parandaluar çdo ekspozim që mund të rrezikojë sigurinë ose karrierën e tyre. Këto masa mbrojtëse do të përshtaten me realitetin e dinamikës së vendit të punës, duke garantuar që të mos kompromentohen nga praktikat abuzive në terren të zyrtarëve të lartë.

Do të hartojmë një Kod të Etikës për trajtimin e raporteve të sinjalizuesve. Ky kod do të përcaktojë qartë përgjegjësitë e atyre që marrin dhe menaxhojnë këto raporte. Do të prezantojmë programe trajnimi të dedikuara për zyrtarët përgjegjës për menaxhimin e rasteve të denoncimit në mënyrë që të jenë të pajisur me aftësitë për të trajtuar informacionet e ndjeshme dhe për të mbrojtur të drejtat e sinjalizuesve. Gjithashtu, do të nisim fushata ndërgjegjësimi në shkallë të gjerë për të informuar zyrtarët publikë për të drejtën e sinjalizimit.

• **Dëmet e korrupsionit**

Ne kemi detyrimin moral për të mbështetur ata që janë dëmtuar nga korrupsioni. Do të marrim nisma ligjore për të forcuar rolin e organizatave të shoqërisë civile, gazetarëve dhe qytetarëve në luftën kundër korrupsionit, duke forcuar pozitën e tyre ligjore në çështjet që lidhen me korrupsionin. Këto masa do të sigurojnë që ata të mund të marrin pjesë në mënyrë aktive jo vetëm si denoncues dhe monitorues, por edhe si palë të treta, ekspertë në proceset gjyqësore, si dhe të mbrojnë interesat e komuniteteve duke u legjitimuar si përfaqësues ligjorë në fushat e tyre të ekspertizës.

Po ashtu, do të ndërtojmë instrumente ligjore që u mundësojnë komuniteteve të prekura të ngrenë padi kolektive dhe të kërkojnë kompensim të dëmeve, veçanërisht në rastet që lidhen me dëmet mjedisore ose abuzimet e mëdha financiare. Këto nisma do t'u japin aktorëve shoqërorë mjetet e nevojshme për të vënë përpara përgjegjësisë autorët e korrupsionit dhe për të siguruar që paditë në interes publik të jenë efektive.

Përpyekjet frymëzuese të komuniteteve lokale kundër projekteve të mëdha infrastrukturore që kërcënojnë jetesën e tyre, siç janë hidrocentralet, ofrojnë një orientim të mirë për arritjen e këtij qëllimi.

Këto grupime qytetare tregojnë fuqinë e veprimit kolektiv dhe theksojnë nevojën për t'u dhënë zë atyre që preken drejt-përdrejt nga korrupsioni dhe abuzimi i sektorit privat.

• **Përpjekja kundër korrupsionit si normë**

Korrupsioni nuk është vetëm çështje lakmie apo përfitimi personal. Ai ndikohet edhe nga normat shoqërore, zakonet dhe mënyra se si njerëzit e perceptojnë sistemin përreth tyre. Deri më tani lufta kundër korrupsionit është përqendruar në forcimin e ligjeve dhe shtimin e kontrolleve, por këto masa nuk kanë arritur të ndryshojnë sjelljet e rrënjësura thellë.

Ne do të ndjekim një qasje novatore, duke vënë në punë njohuritë nga shkencat e studimit të sjelljes për ta trajtuar korrupsionin edhe si problem shoqëror dhe kulturor. Shumë njerëz përfshihen në praktika korruptive sepse i shohin të tjerët duke bërë të njëjtën gjë ose nuk besojnë se ekzistojnë alternativa të ndershme. Ne do të bashkëpunojmë me ekspertë dhe institucione për të hartuar dhe testuar zgjidhje praktike që ndryshojnë këto modele, duke e bërë korrupsionin më pak të pranueshëm dhe duke nxitur ndershmërinë në jetën e përditshme.

Si hap të parë do të zbatojmë programe pilot në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë, dy fusha ku korrupsioni prek drejt-përdrejt jetën e qytetarëve. Duke nxitur ndryshimin e sjelljes, synojmë të sjellim ndryshim afatgjatë që shkon përtej burokracisë dhe rregullave.

• **Sektori privat**

Korrupsioni në sektorin privat është neglizhuar në masë të madhe nga qeveria, pavarësisht ndikimit të tij të thellë në ekonomi dhe shoqëri. Ne propozojmë një

sërë masash që synojnë të promovojnë transparencën, llogaridhënien, praktikën etike dhe një mjedis sipërmarrjeje më të përgjegjshëm.

Do të nxisim sektorin privat të vërë në zbatim programe të forta etike dhe integriteti. Këto programe do të promovojnë një kulturë përgjegjshmërie, duke u kërkuar bizneseve të zbatojnë masa kundër korrupsionit, mbrojtje për sinjalizuesit dhe politika për shmangien e konfliktit të interesit.

Do të përforcojmë auditimet publike dhe do vendosim mbikëqyrje të shtuar mbi kompanitë e mëdha që operojnë në sektorë strategjikë. Këto auditime do të vlerësojnë përputhshmërinë me standardet ligjore dhe etike, duke siguruar që sipërmarrjet e mëdha të kontribuojnë për të mirën publike dhe të mos shfrytëzojnë pozicionet e tyre në treg për përfitime të padrejta. Rezultatet e këtyre auditimeve do të bëhen publike për të nxitur llogaridhënie të shtuar.

Do të vendosim sanksione të rrepta për profesionistët që mundësojnë praktika korruptive, përfshirë noterët, avokatët, kontabilistët dhe profesionistë të tjerë që lehtësojnë aktivitete të paligjshme. Duke i vënë lehtësuesit e korrupsionit përpara përgjegjësisë, ne do të mbyllim vrimat ligjore që lejojnë përhapjen e korrupsionit në sektorin privat.

4.

PJESËMARRJA DEMOKRATIKE

Lëvizja BASHKË sheh te shtrirja dhe thellimi i demokracisë politike e shoqërore vetëpërmbyshjen historike të popullit shqiptar.

Demokracia është e vetmja mënyrë e ndershme dhe efikase qeverisëse. Lëvizja BASHKË, duke respektuar karakterin modern të institucioneve përfaqësuese, është e mendimit se demokratizimi i plotë i një shoqërie kërkon një pjesëmarrje sa më të gjerë dhe cilësore të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes politike, duke zbatuar kështu elementë të demokracisë së drejtpërdrejtë.

Demokracia nuk është vetëm një sistem politik. Ajo ka nevojë të shtrihet edhe në aspekte të rëndësishme të jetës shoqërore, duke nisur nga vendi i punës. Pa sigurimin e të drejtave të punëtorëve dhe pa ngritur nivelin e përfaqësimit të punëtorëve në vendin e punës dhe institucionet publike, demokracia do të mbetet e gjymtuar dhe në rrezik shpërbërjeje.

Demokracia fuqizohet përmes zhvillimit të një kulture politike që bazohet te kërkesa e llogarisë ndaj institucioneve, pjesëmarrja aktive, respektimi i lirisë e dinjitetit të çdo njeriu, mbrojtja e të drejtave të qytetarëve e komuniteteve dhe barazia gjinore.

Demokracia e njëmendtë ka nevojë për edukim të shëndoshë qytetar, fuqizim të institucioneve dhe jetës kulturore, si dhe media të pavarura e të përgjegjshme.

4.1 DEMOKRATIZIMI POLITIK

Politika është arti i menaxhimit të konflikteve shoqërore që burojnë nga nevoja për bashkekzistencë në komunitet në kushtet e një konflikti të vazhdueshëm interesash për shkak të raportit të pamjaftueshëm mes burimeve dhe nevojave; është përpjekja e vazhdueshme për koordinim mes këtyre interesave përmes normave, institucioneve dhe praktikave që konfliktet të mos degradojnë në përplasje të dhunshme mes grupeve shoqërore. Këto norma, institucione dhe praktika kontestohen vazhdimisht, qoftë në aspektin subjektiv nga agjentët politikë në kërkim të një ekuilibri më të favorshëm për ta, ashtu edhe në rrafshin objektiv nga ndryshimet teknologjike, ekonomike, shoqërore dhe politike. Sistemi politik është kështu gjithmonë në një proces ekuilibri dinamik, që duhet riprodhuar vazhdimisht në kushte të reja, me agjentë që ndryshojnë në natyrë, përmes proceseve të shumta.

1. Elementët e politikës

Inputet

Agjentët politikë mund të jenë individualë ose kolektivë. Dominimi i qasjes neoliberalë, me origjinë metodologjike të rryma neoklasike në teorinë ekonomike, ka sjellë edhe mes studiuesve dhe praktikanteve të politikës theksin tek agjenti individual si një qenie racionale që zgjedh sjelljen më dobiprurëse në aspektin vetjak. Kjo qasje – që është lehtësisht e kontestueshme në rrafshin teorik qoftë për kompleksitetin e sistemit politik ku individi duhet të orientohet, qoftë për ndikimin e jashtëm të agjentëve të tjerë ose kushteve mbi sjelljen e individit – në planin praktik gjithmonë ka favorizuar

interesat e forta shoqërore në dëm të shtresave të gjera shoqërore. Ndaj edhe politika e shtresave të gjera është shënuar nga format kolektive të veprimit, qofshin ato organizata formale apo informale, bashkime me natyrë bashkëkohore apo tradicionale. Të karakterizuara nga efienca e tyre, bashkësitë politike bashkëkohore kryejnë rolin ndërmjetësues të përfaqësimit në formën e partive politike, shoqatave të bashkuara rreth një interesi të caktuar apo lëvizjeve shoqërore. Këto organizata përfaqësojnë dasitë strukturore shoqërore, ekonomike e ideologjike, si dhe interesat përkatëse. Interesat gjithashtu mund të artikulohen në mënyrë individuale si dhe kolektive, përmes kanaleve informale dhe formale. Edhe procesi i përbashkimit dhe paraqitjes së këtyre interesave mund të jetë individual dhe i veçantë, në formën e kooptimit ose klientelizmit, ose kolektiv dhe i përgjithshëm në formën e programeve politike ose kërkesave me interes sektorial.

Politikëbërja

Institucionet politike kanë funksionin sistemor të konvertimit të interesave të paraqitura nga agjentët politikë në politika publike të mbështetura nga autoriteti shtrëngues. Ky autoritet është i ndarë si horizontalisht: në pushtet qendror dhe vendor, si dhe funksionalisht: në legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.

Produkti politik

Politikat publike që përfaqësojnë produktin e procesit politikëbërës mund të ndahen në rregullative, që synojnë disiplinimin e sjelljes së subjekteve në bazë të një sistemi caktuar normativ; përthithëse dhe shpërndarëse, që synojnë grumbullimin e të mirave materiale dhe shërbimeve nga shoqëria dhe shpërndarjen e tyre në bazë të kriter-

eve politike; si dhe *ideologjike*, përmes formimit të një kulture politike të caktuar që ndikon në masë të madhe sjelljen e agjentëve politikë.

II. Kriza e legjitimitetit demokratik në Shqipëri

Në Shqipërinë bashkëkohore agjenti politik është kryesisht individual, siç e tregojnë edhe statistikat e shumta të anëtarësisë në kolektivitete të natyrës politike. Përveç mungesës historike kulturës veprimit kolektiv, në këtë aspekt luan rol edhe tëhuajësimi theksuar dhe zhgënjimi nga tranzicioni. Sistemi partiak gjithashtu e apelon agjentin kryesisht në rrafshin individual. Ndaj ndryshimi bazik duhet të vijë nga fuqizimi i agjentëve kolektivë. Qasja individuale duket si në aspektin e artikulimit interesave politike, kryesisht në trajtë informale, ashtu edhe në fazën e agregimit përmes kooptimit në rrjetet klienteliste partive tradicionale. Roli përfaqësues i partive tradicionale është i karakterizuar nga natyra e tyre thellësisht primitive, karakteri patrimonial dhe praktika klienteliste. Si të tilla, këto organizma janë kthyer lehtësisht në mjete për kapjen e shtetit nga interesa të veçanta në dëm të interesave kolektive. Ndaj nevojitet një reformim i thellë i sistemit partiak që duhet të synojë modernizimin e tij dhe kthimin në ndërmjetës dhe agregues të interesave të përgjithshme. Kjo mund të realizohet vetëm përmes një mobilizimi të gjerë politik shoqëror në formën e zhvillimit si në numër ashtu dhe në cilësi qoftë të shoqatave të interesave sektoriale, ashtu edhe të kulturës pjesëmarrëse në lëvizje shoqërore mbi çështje caktuara për interes publik.

Institucionet politikëbërëse kanë gjithashtu probleme të theksuara. Këto burojnë si nga kapja e tyre prej interesave të veçanta në dëm të atyre të përgjithshme, ashtu edhe nga mung-

esa historike e kulturës institucionale. Pushteti legjislativ është tredhur duke u kthyer në një veprues me karakter noterial nga një ekzekutiv i karakterizuar nga patrimonializmi i theksuar dhe kapja nga interesa veçanta ekonomike. Aparati burokratik është kthyer në një magazinë klienteliste në shërbim të këtyre interesave, me pasojë inefficiencën e tij dhe karakterin grabitqar në dëm të shoqërisë. Sistemi gjyqësor ende nuk ka dalë nga degradimi korruptiv dhe inefficiencia karakteristike. Ndaj nevojitet një rforcim i legjislativit, një çlirim i ekzekutivit nga kapja si dhe një politikë administrative që të theksojë eficiencën, meritokracinë dhe shërbimin publik. Në sistemin gjyqësor duhet mbështetur reforma e drejtësisë dhe çdo politikë antikorrupsion. Por funksionimi i institucioneve politikëbërëse mund të jete funksional vetëm në saje të një mobilizimi vazhdueshëm politik shoqëror, hallka e vetme historikisht e provuar që nuk lejon degradimin e tyre në mjete në shërbim të pakicës së fuqishme ekonomikisht në dëm të shumicës së qytetarëve.

Dobësitë e theksuara tek agjentët politikë, artikulimi interesave dhe agregimi i tyre, si dhe problemet e institucioneve politikëbërëse shpërfaqen për pasojë te politikat publike. Në aspektin rregullator këto dallohen për rolin e tyre në funksion të interesave veçanta, ku rregullat ose bëhen në shërbim të këtyre interesave, ose nuk zbatohen kur bien në kundërshtim me to. Në aspektin e përthithjes dhe shpërndarjes gjithashtu interesat e veçanta favorizohen në kurriz të atyre të përgjithshme, ku barra fiskale e shtetit bie mbi masën e madhe popullsisë, ndërsa përfituesit e shpenzimeve publike janë vetëm një pakicë. Në rrafshin ideologjik tëhuajësimi dhe fetishizmi luajnë një rol me rëndësi në pamundësinë e agjencisë politike emancipuese të qytetarëve duke ndikuar në riprodhimin e një sistemi politik disfunksional dhe grabitqar. Ndaj me reformimin

e aktorëve politikë dhe procesit politikëbërës duhen synuar politika publike që përfaqësojnë interesat e shumicës si në aspektin rregullator, ashtu edhe në atë rishpërndarës e ideologjik.

III. Demokratizimi i sistemit politik

Lëvizja BASHKË e konsideron me rëndësi të jashtëzakonshme reformimin demokratik të sistemit politik në Shqipëri. Ky demokratizim kërkon angazhimin e shoqërisë, iniciativat qytetare dhe organizimin e shtresave shoqërore sipas vendit të punës, profesionit, vendbanimit dhe botëkuptimeve. Masat konkrete demokratizuese janë si vijon:

1. Reformim i krejt kuadrit ligjor që prek pjesëmarrjen politike, duke fuqizuar aspektet e demokracisë pjesëmarrëse. Ka rëndësi parësore jetësimi i të drejtës për të mbajtur referendume kombëtare dhe lokale afirmative. Për referendumet kombëtare, numri i nënshkruesve duhet të ulët në 30,000 qytetarë.
2. Lehtësim i organizimeve dhe iniciativave që kryejnë rolin e ndërmjetësit politik dhe kontribuojnë në modernizimin e partive politike. Kjo mund të realizohet, ndër të tjera, përmes lehtësimit të iniciativave ligjore të qytetarëve duke ulur në 10,000 numrin e nënshkruesve dhe vendosur në 6 muaj afatin kohor të detyrueshëm të shqyrtimit të projektligjit nga Kuvendi i Shqipërisë.
3. Hartimi një strategjie mbi modernizimin e agjentëve politike dhe tejkalimin e strukturave patrimoniale.
4. Shtim përmes procedurave ligjore të rëndësisë së shoqatave që paraqesin interesa sektoriale, sidomos të sindikatave të punëtorëve, dhe integrimi

i tyre në proceset politike sidomos në fazat e artikulimit interesave dhe agregimit të tyre.

5. Masa që synojnë rikthimin e parimit kushtetues të parësisë së legjislativit mbi ekzekutivin.
6. Reformim i administratës publike me theks meritokracinë dhe eficiencën, dobësimin e praktikave klienteliste dhe korruptive.
7. Mbështetje për vazhdimin dhe intensifikimin e reformës në sistemin gjyqësor.
8. Zotim për politika rregullatore të drejta, efikase dhe në shërbim të shumicës.
9. Politika fiskale dhe rishpërndarjeje progresive që synojnë drejtësinë shoqërore dhe aspiratat zhvillimore
10. Promovim i një kulture politike moderne, demokratike, pjesëmarrëse, institucionale dhe solidare.

4.2 PUNA

Në çdo epokë dhe shoqëri puna është aktiviteti më i rëndësishëm shoqëror. Prej punës fizike dhe mendore, individuale e kolektive, lind çdo produkt dhe e mirë shoqërore. Në këtë kuptim, procesi i shndërrimit të punës fizike e mendore në produkt është tejet i rëndësishëm dhe kërkon rregullim e mbrojtje ligjore.

Sipas statistikave, raporteve të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare dhe vëzhgimeve të drejtpërdrejta në terren, puna në vendin tonë mbetet një aktivitet i karakterizuar nga informaliteti i lartë, pagat e ulëta, vdekjet dhe aksidentet e shpeshta, mungesa e organizimit sindikal, produktiviteti i ulët, mungesa e krahut të punës të kualifikuar, hendeku gjinor në paga etj. Kjo gjendje e vështirë e bën çështjen e punës një emergjencë kombëtare që kërkon ndërhyrje të menjëhershme. Së pari, puna duhet të jetë një aktivitet i sigurt, ku respektohen të drejtat në punë, dhe i cili të mundësojë të ardhura të mjaftueshme për të bërë një jetë të dinjitetshme. E dyta, puna duhet të jetë një aktivitet që e rrit ndjeshëm pasurinë tonë kombëtare dhe mirëqenien individuale e të përgjithshme, e për ta bërë këtë është e nevojshme të kemi një larmi aktiviteteve ekonomike, përparim teknologjik dhe punëtorë të kualifikuar. Lëvizja Bashkë, përmes programit të saj të punës, synon pikërisht realizimin e këtyre pikave.

1. Gjendja e përgjithshme

Zyrtarisht në Shqipëri janë 1,327,042 të punësuar (të punësuar me pagë, të vetëpunësuar, punëtorë pa pagë në sipërmarrjet familjare etj.), dhe 158,801 të papunë. Popullsia jo-ekonomikisht aktive, pra qytetarë që nuk klasifikohen

as të punësuarit as të të papunët, vlerësohet të jetë 832,674 vetë, dhe ekonomikisht aktive rezulton të jetë 1,485,843 vetë. Për vitin 2023 24.3 % e popullsisë që i përket grupmoshës 15-64 vjeç është jo-ekonomikisht aktive.

Sipas statistikave, në Shqipëri, numri i të punësuarve me pagë është 650,167. Nga të punësuarit, vetëm 55% e tyre marrin rrogë mujore, pra janë në skemën e sigurimeve, çka na bën një vend me informalitet të lartë në punë e në paga. Pjesa tjetër prej 393,603 vetësh konsiderohen “të vetëpunësuar” dhe 283,272 si “të punësuar pa pagesë në biznes familjar”, ku përfshihet thuajse e gjithë popullsia në zonat rurale dhe një pjesë e madhe syresh janë gra.

Sipas statistikave të punësimit, bujqësia mbetet punëdhënësi më i madh në vend me 32.3% të totalit të të punësuarve; sektori prodhimit punëson 11.2%; sektori i tregtisë dhe shërbimeve punëson 29.1%; ndërtimi punëson 7.6%; industria punëson 2.2% të totalit; dhe administrata publike kontribuon me 17.6% të totalit, nga 12.2% që ishte në vitin 2022. Shteti mbetet punëdhënësi i tretë më i madh pas bujqësisë dhe shërbimeve të tregut.

FIG. 3 PUNËSIMI (15+) SIPAS AKTIVITETEVE EKONOMIKE, 2023
Employment (15+) by economic activities, 2023




Figura 25: (Burimi: INSTAT – Tregu i punës 2023)

Papunësia

Sipas INSTAT Shqipëria ka rreth 158.801 të papunë. Në tremujorin e katërt 2023 shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri ishte 10,7%. Shkalla e papunësisë për grupmoshën 15-24 vjeç është 25,6 %. Krahasuar me vitin paraardhës, papunësia për këtë grupmoshë u rrit me 0,7 pikë përqindje. Për moshën 15-65 vjeç ajo është 22%; për moshën 15-29 vjeç është 22,0 %.

Personat e papunë, sipas INSTAT-it, prej një viti a më shumë, përbëjnë 71,2 % të të papunëve gjithsej. Krahasuar me vitin e mëparshëm, pesha që zënë të papunët afatgjatë në papunësinë gjithsej është rritur me 4,3 pikë përqindje. Niveli i papunësisë është më i theksuar te personat me arsimim më të ulët, gratë, banorët në zonat rurale dhe qytete të vogla dhe ndër shtresat e tjera vulnerabël të popullsisë duke ndikuar në një masë edhe më të madhe në nivelin e varfërisë së tyre.

Sipas të dhënave, rezulton së në Tr.1 2024 janë të regjistruar pranë Zyrave të Punësimit 75,486 punëkërkuar të papunë. Mes tyre 18,239 janë të rinj të moshës 16-29 vjeç. Nga punëkërkuarët e papunë, 27,088 prej tyre janë me ndihmë ekonomike dhe 3,290 përfitojnë pagesën e papunësisë. Ndërsa më shumë se gjysma e tyre nuk marrin asnjë ndihmë nga shteti.

Produktiviteti i punës

Sipas të dhënave nga Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), Prodhimi i Brendshëm Bruto për orë pune në Shqipëri për vitin 2023 vlerësohet në 16.5 dollarë. Krahasuar me vitin 2022 ka një rritje me 5.8%. Megjithatë hendeuku me vendet fqinje të rajonit mbetet i konsiderueshëm. Mes vendeve të rajonit, Shqipëria paraprihet nga Serbia që e ka 20.6 dollarë, Bosnje Hercegovina 21.5 dollarë, Maqedonia e Veriut 22.7 dollarë

dhe Mali i Zi 25.8 dollarë. Vetëm pak vende të Evropës Lindore, si Moldavia apo Ukraina, kanë produktivitet të punës më të ulët se Shqipëria. Të dhënat (World Development Indicators Database, 2022) tregojnë se gjatë dekadës së fundit niveli mesatar i produktivitetit të ekonomisë shqiptare, i matur në dollarë konstantë (pariteti i fuqisë blerëse) si kontribut në PBB i çdo personi të punësuar, në vitin 2012 ishte sa 31.2% e mesatares së BE, dhe në 2021 arriti në 34.7%.

Në raportin e tij për Shqipërinë, Fondi Monetar Ndërkombëtar thekson se informaliteti i lartë dhe i përhapur, dobësitë në qeverisje dhe në sundimin e ligjit, pabarazia gjinore në pjesëmarrjen në forcën punëtore dhe inaktiviteti i të rinjve janë disa pengesa të mëdha në rritjen e produktivitetit. Nëse shtojmë këtu edhe emigrimin e punëtorëve të kualifikuar dhe plakjen e shpejtë e popullsisë, gjendja është tejet alarmuese për të tashmen e të ardhmen.

Siguria në punë

Shqipëria ka një nivel tejet të ulët të sigurisë në punë. Një prej shkaqeve të kësaj pasigurie ka të bëjë me institucionet që kanë për detyrë të mbikëqyrin respektimin e kushteve të sigurisë në punë. Kësisoj, numri i inspektorëve të punës të Shqipëri është 94 vetë. Kemi 1 inspektor në 10.000 të punësuar (më pak se Maqedonia e Veriut 1.7), dhe 1 inspektor për 1200 sipërmarrje. Kjo mangësi në inspektorë evidentohet edhe në raportin vjetor të punës nga ISHPSHSH, ku theksohet se burimet njerëzore dhe financiare për inspektimin janë të kufizuara për të përmbushur efektivisht objektivat e përcaktuara. Sipas raportit të vitit 2023, Inspektorati i Punës ka inspektuar 9,938 subjekte private e shtetërore dhe 216,594 punëtorë. Në 2023 janë bërë 800 denoncime ose ankesa, mes të cilat

mospagesa e orëve të prapambetura zë vendin kryesor, pastaj vijnë cenimi i marrëdhënieve të punës, heqjet nga puna, mosnjohim të aksidenteve në punë e me radhë.

Nga inspektimet rezulton se informaliteti përbën 32.4% të shkeljeve totale të dispozitave ligjore të legjislacionit të punës. Punësimi informal, sipas ISHPSHSH, ka pësuar një rritje nga viti në vit (1092 ishte në 2021, 1965 në vitin 2023), dhe përqindjen më të lartë të informalitetit sipas inspektimeve e ka ndërtimi dhe pas tij vjen tregtia. Siguria dhe shëndeti në punë përbëjnë 30.8% të shkeljeve totale të dispozitave ligjore të legjislacionit të punës. Kushtet e Punës përbëjnë 24% të shkeljeve totale të dispozitave ligjore të legjislacionit të punës. Nga inspektimet, 1.2% e punëmarrësve janë evidentuar të punojnë pa kontrata individuale pune, 2,502 punëmarrës.

Duke marrë në konsideratë disfunkcionalitetin, korrupsionin dhe nepotizmin e lartë që karakterizon institucionet shtetërore që merren me respektimin e të drejtave në punë, niveli i shkeljes së të drejtave në punë duhet menduar mjaft më i lartë se shifrat zyrtare.

Një shqetësim i madh janë dhe vdekjet në punë. Sipas Institutit të Shëndetit Publik, numri i vdekjeve në punë është rritur ndjeshëm viteve të fundit. Sipas ISHP, gjatë periudhës 2018-2023, kanë humbur jetën në punë 194 punëtorë. Nëse në BE 1 në 1000 aksidente në punë është me pasojë vdekjen, në Shqipëri 1 në 6 aksidente në punë rezultojnë me humbjen e jetës së punëtorit. Në një raport të Organizatës Botërore të Shëndetësisë të vitit 2021, Shqipëria kishte 6.6-7.7 vdekje në punë për 100 mijë banorë, gjë që përbënte një nga nivelet më të larta në Evropë. Për vitin 2023, sipas statistikave zyrtare, kemi 168 aksidente në punë, mes të cilave 30 me pasojë vdekjen. Prej këtyre, shumica

e aksidenteve dhe vdekjeve në punë janë në ndërtim, pastaj vijnë ndërmarrjet prodhuese dhe minierat. Ndërkohë, për vitin 2024 numrin më të lartë të vdekjeve e ka sektori i ndërtimit, ku vetëm në 9 muajt e parë të 2024-s kanë vdekur 14 punëtorë.

Orët shtesë

Sipas një analize mbi orët e punës, rritja e sektorit të shërbimeve dhe punës informale, dy aspekte të ekonomisë së globalizuar, janë shkak i madh i orareve më të gjata të punës. Në rastet e ekonomisë informale, që në vendet në zhvillim (ku bën pjesë dhe Shqipëria) jep afro gjysmën e vendeve të punës, rreth 30% e burrave punojnë mbi 49 orë në javë.

Shqipëria renditet e dyta në Evropë për orët e gjata të punës ndonëse bën pjesë te vendet me pagat më të ulëta. Orët mesatare javore të punës në Shqipëri për 2023 ishin 43.7 orë. Ndërkohë në Evropë mesatarja ishte 36.1 orë në javë. Administrata publike shqiptare punon 3.7 orë më pak se mesatarja e të punësuarve në sektorë të tjerë. Në sektorin e tregtisë, hotelërisë, restoranteve, transportit e komunikacionit oraret priren të jenë të gjata. Në Shqipëri, sipas ISHPSHSH, 10.2% e sipërmarrjeve bëjnë kërkesë për autorizim për të kryer punë në orë shtesë. Por nëse llogarisim numrin e atyre që nuk bëjnë kërkesë por gjithsesi bëjnë orë shtesë (nga bisedat me punëtorët), ky nivel është shumë më i lartë.

Informaliteti

Sipas një analize të revistës Monitor, punësimi informal në vendin tonë është ndër më të lartit në rajon dhe Evropë. Nga kjo analizë del që për vitin 2023 pesha në PBB e arkëtimeve nga sigurimet

shoqërore dhe shëndetësore është 6.2%. Për vendet e rajonit, të ardhurat e arkëtuara nga tatimi i punës zënë 10% të PBB-së, ndërsa mesatarja e BE-së është 14.1%. Pra shihet qartë që arkëtimi nga taksat e punës është më ulët se vendet e rajonit dhe BE-së.

Jo shumë vite më parë Organizata Botërore e Punës (ILO) kishte pohuar se informaliteti në Shqipëri vlerësohej të ishte rreth 56.7% e të punësuarve (përfshirë bujqësinë). Nëse kryqëzojmë të dhënat që na vijnë nga studimi i Tregut të Punës 2023 nga INSTATI dhe studimit mbi pensionet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, niveli i informalitetit në punë në Shqipëri arrin në 44.4%. Me gjasë, niveli real i informalitetit është rreth 50%. Punësimi informal ishte më i lartë në sektorë të ekonomisë si bujqësia, ndërtimi, shërbimet e ushqimit dhe të akomodimit, si dhe te të rinjtë e punëtorët me kualifikim të ulët. Sektori i ndërtimit, po sipas ILO-s, vlerësohet me një nga nivelet më të larta të informalitetit në punësim dhe paga. Informaliteti në këtë sektor arrin në 60%. Pagat në ndërtim vijnë të jenë më të ulëta se paga reale dhe se ajo mesatare, megjithëse pranohej nga të gjithë se kjo është një punë e mirëpaguar.

Sipas një sondazhi të organizuar nga revista Monitor, arsyet kryesore se përse ka informalitet, qytetarët e pyetur rendisin: mungesën e përfitimeve në formë shërbimesh nga ana e shtetit përkundrejt pagesës së kontributeve të sigurimeve dhe tatimeve; shërbimi shëndetësor ofrohet kundrejt pagesës dhe për rrjedhojë nuk ka leverdi në pagesën e sigurimeve; pensionet e ulëta nuk i nxisin ata që të kontribuojnë në pagesën e sigurimeve. Një tjetër arsye se përse informaliteti është në rritje ka të bëjë me konkurrencën e padrejtë nga bizneset informale dhe ato që favorizohen nga administrata shtetërore. Kjo i shtynë shumë biznese të tjera drejt informalitetit duke e futur të gjithë sipërmarrjen në një rreth vicioz.

Mbikualifikimi/mospërputhja e aftësive

Sipas ETF-së (European Training Foundation), në Shqipëri të paktën një në pesë të diplomuar nga arsimit i lartë ka një vend pune që kërkon nivel më të ulët të kualifikimeve formale. Incidenca e mospërputhjes së aftësive për të diplomuarit në arsimin e mesëm është më e ulët se ajo e të diplomuarve nga arsimit i lartë. Në vitet e shkuara rreth 2/3 e të rinjve të diplomuar nga arsimit i lartë ishin të punësuar në pozicione pune që kërkonin nivel më të ulët kualifikimi. Sipas ekspertëve, sfidat e mungesës apo mospërputhjes së aftësive, me shumë gjasa, janë rezultat i sasisë, cilësisë apo rëndësisë së pamjaftueshme të ofertës së arsimit dhe formimit. Pjesëmarrja e ulët në të nxënit gjatë gjithë jetës është identifikuar edhe nga anketa për arsimin e të rriturve, e zhvilluar nga INSTAT-i në vitin 2017.

Paga

Paga minimale zyrtare në Shqipëri është 40.000 lekë. Paga mesatare bruto për një të punësuar me pagë në Shqipëri ishte 77.669 lekë në fund të muajit shtator të 2024. Gjatë vitit 2024, rezultoi se 25% e të punësuarve paguhen nën pagën minimale zyrtare, dhe 20% marrin një pagë 40.001- 50.000 lekë. Pra 45% e të punësuarve paguhen nën 50.000 lekë bruto në muaj. Ndërkohë, 9.4% marrin 50.001- 60.000 lekë, dhe 26.8% marrin 60.001-95.000 lekë dhe i përkasin kryesisht punonjësve të administratës. Dhe vetëm 7% marrin 95.001-120.000 lekë dhe 8.9% marrin mbi 120.000 lekë.

Paga minimale në Shqipëri është me e ulëta në Evropë dhe rajon. Në euro paga minimale është rreth 400 euro (kjo edhe falë ndryshimit drastik të kursit të këmbimit). Mali i Zi e ka 532 euro, Serbia 544 euro, pra 35% më të lartë. Pavarësisht se vendi ynë e ka pagën minimale në

vlerë nominale (jo reale) më të lartë se Maqedonia e Veriut (360 euro), ne sërish mund të blejmë më pak se në MV për shkak të çmimeve të shtrenjta. Edhe për sa i përket pagës mesatare Shqipëria është e fundit në rajon, me 749 euro; Maqedonia e Veriut 985 euro, Mali i Zi 1,042 euro, Bosnje Hercegovina 1,084 euro, Serbia 1200 euro.

Sipas INSTAT, hendeuku gjinor në paga është 6,2 %. Pra burrat kanë një pagë mesatare mujore bruto 6,2 % më të lartë se gratë. Më poshtë gjeni të detajuar sa është paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë sipas grup aktiviteteve ekonomike dhe gjinisë:

Aktiviteti ekonomik sipas NVE Rev2	Gjithsej - Total		Meshkuj - Men		Femra- Women		Economic activity according to NACE Rev2
	2022	2023	2022	2023	2022	2023	
Gjithsej	61 898	70 539	63 773	72 681	59 813	68 183	Total
Bujqësi, Silvikulturë dhe Peshkim	40 531	46 975	41 593	48 377	38 423	44 304	Agriculture, forestry and fishing
Industria nxjerrëse; përpunuese; energjia elektrike, gaz, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar; furnizimi me ujë; aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, rehabilitimit	53 645	61 161	62 499	70 402	45 482	52 352	Mining and quarrying; manufacturing; electricity, gas, steam and air conditioning supply; water supply; sewerage, waste management and remediation activities
Ndërtimi	48 820	55 784	48 076	55 101	52 290	58 848	Construction
Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorçikletave; transporti dhe magazinimi; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor	49 574	56 859	51 940	59 474	46 203	53 304	Wholesale and retail trade; repair of motor vehicles and motorcycles; transportation and storage; accommodation and food service activities
Informacioni dhe komunikacioni	98 943	108 987	102 987	112 336	94 221	105 050	Information and communication
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	126 777	137 473	143 387	155 577	117 211	127 485	Financial and insurance activities
Aktivitete të pasurive të paluajtshme; Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike; aktivitete të shërbimeve administrative dhe mbështetëse	69 115	77 778	68 752	77 867	69 334	77 413	Real estate activities; Professional, scientific and technical activities; administrative and support service activities
Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm; arsimit; shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	70 796	81 926	75 314	88 129	67 587	77 616	Public administration and defence; compulsory social security; education; human health and social work activities
Arte, argëtim dhe lodhje, aktivitetet e prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vet dhe	65 178	71 804	64 459	72 039	65 812	71 601	Arts, entertainment and recreation; repair of household goods and other services

Figura 26: (Burimi: INSTAT, Tregu i Punës, 2023)

Në disa sektorë që kanë barrën më të madhe të punësimit dhe janë strategjike për ekonominë tonë, paga është më e ulët se ajo mesatare. Në tremujorin e fundit të 2023 paga në bujqësi ishte sa 65% e pagës mesatare. Në ndërtim, si pasojë e informalitetit në paga, kemi paga që janë 22% më të ulëta se ajo mesatare. Industria ka pagë 14% më të ulët se ajo mesatare. Edhe tregtia, transporti dhe shërbimet kanë paga që janë 19% më të ulëta se ajo mesatare. E kundërta ndodh me aktivitetet financiare që kanë paga 98% më të larta se mesatarja.

II. Problemet kryesore

Sipas raporteve zyrtare, plakja e popullsisë dhe lëvizjet migratore kanë ulur rritjen e fuqisë punëtore në vend. Kategoritë e personave që vendosin të emigrojnë jashtë vendit kanë ndryshuar në vite duke krijuar mungesë në tregun e punës për profesione të veçanta që janë edhe më të kërkuara në tregjet e huaja.

- Përpos emigrimit, edhe migrimi nga zonat rurale dhe qytetet më të vogla drejt zonave kryesore urbane është një fenomen që ka problemet dhe të mirat e veta.

- Paga minimale dhe ajo mesatare janë më të ulëtat në Evropë dhe rajon.

- Mungesa e krahut të punës të specializuar dhe të paspecializuar. Kjo ka bërë që numri i të huajve që vijnë për të punuar në Shqipëri të jetë në rritje nga viti në vit. Për vitin 2022, për shembull, kanë qenë 8,305 shtetas të huaj (ose 3,271 më shumë se një vit më parë), ndërsa për 2023 janë 9,825 punëtorë të huaj. Megjithatë ky numër mbetet sërish i ulët për të përmbushur nevojat e tregut të punës. Madje shumë prej tyre raportohet se largohen nga vendi ynë për shkak të pagave të ulëta.

- Papunësia e lartë, sidomos mes të rinjve (për grupmoshën 15-24 vjeç është 25,6 %, dhe sa vjen dhe rritet), qytetarëve me arsim të ulët, grave, banorëve të zonave rurale dhe shtresat e tjera vulnerabël.

- Nënpunësimi. Sipas raporteve, në vitin 2019 rreth 2/3 e të rinjve të diplomuar me arsim të lartë ishin të punësuar në pozicione pune, të cilat kërkonin nivel më të ulët kualifikimi.

- Mospërputhja e ofertës dhe kërkesës për punë është e gjithanshme. Numri i ofertave për punë është 52% e numrit të punëkërkuesve të papunë të regjistruar në të gjitha zyrat e punës. Në rajonet Tiranë dhe Fier kjo shifër shkon përkatësisht 86% dhe 62%.

- Popullsia në moshë pune ka një nivel të ulët aftësish. Sipas Anketës së Forcave të Punës (AFP) të vitit 2021, 41.6% e forcave të punës dhe 48.3% e popullsisë në moshë pune në Shqipëri është me arsim bazë (8-/9-vjeçar) ose më të ulët. Një tjetër problem është mungesa e aftësive të kërkuara në tregun e punës.

- Numri i ulët i inspektorëve për ndërmarrje dhe numri i ulët i inspektimeve. Për vitin 2023 nga 209,590 ndërmarrje aktive, vetëm 9,938 ndërmarrje janë inspektuar.

- Mbi 60% e shkeljeve përbëhen nga informaliteti dhe mungesa e sigurisë e shëndetit në punë.

- Rritje e punësimit informal me 9.2% në 2023. Në vitin 2021 rezultonte se vetëm 47.9% e të punësuarve (ose 0.6 nga 1.25 milionë) janë të punësuar me pagë (norma mesatare për vendet e Ballkanit Perëndimor ishte 73%).

- Sipas OBSH-së, Shqipëria në 2021 kishte 6.6-7.7 vdekje në punë për 100 mijë banorë, një nga nivelet më të larta evropiane.

- Numri i lartë i vdekjeve në sektorin e ndërtimit. Në nëntë muaj të 2024 kanë vdekur 14 punëtorë në këtë sektor.
- Orët e gjata të punës: Në shumë raste janë dhe arsyeja e aksidenteve dhe vdekjeve në punë.
- Nga 75,486 punëkërkues të papunë rezulton se 62% e tyre, ose 46,849 të papunë, nuk marrin asnjë ndihmë financiare nga shteti.
- Niveli i pagesës së papunësisë është i vendosur në shkallën 50% të pagës minimale, të paguara përgjatë 3 deri në 12 muajve. Praktika rajonale e lidh nivelin e pagesës me nivelin e pagës gjatë punësimit, e cila ka një nivel zëvendësimi prej 50-90%.
- Sipas të dhënave nga ILO-s, Prodhimi i Brendshëm Bruto për orë pune në Shqipëri për 2023 vlerësohet në 16.5 dollarë ndërkombëtarë. Ky tregues është rritur me 5.8% krahasuar me vitin 2022, por hendeuku me vendet fqinje të rajonit ngelet i konsiderueshëm. Sipas analizës së OECD mbi konkurrencën në Ballkanin Perëndimor të vitit 2024, niveli i produktivitetit në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor është sa 36% e vendeve të BE-së. Për vendin tonë kjo përqindje është më e ulët. Kufizimi detyrues ndaj rritjes së fortë ekonomike në Shqipëri është mungesa e “dijes produktive” (productive know-how), domethënë e njohurive dhe aftësive që kërkohen për të prodhuar mallra dhe shërbime komplekse. Në sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit, sipas të dhënave, produktiviteti i forcës punëtore është shumë i ulët. Ky sektor prodhon 18.6% të PBB-së dhe angazhon 34.93% të popullsisë, çka nënkupton që angazhimi i 1% të popullsisë përkthehet në kontribut për PBB-në vetëm në 0.53%. Sipas të dhënave, 21.4% e PBB-së është kontribut nga sektori i industrisë ku përfshihet po ashtu 21.4% e forcës punonjëse. Kjo tregon që kontributi në këtë rast është 1 me 1, pra 1% e forcës punëtore kontribuon në

1% të PBB-së. Për shkak të investimeve të ulëta në teknologji dhe faktorëve të tjerë kontributi i sektorit të industrisë, duke konsideruar pjesën e punonjësve që punojnë për zhvillim të këtij sektori, është relativisht i ulët për Shqipërinë në krahasim me të gjitha vendet e tjera. Raporti i kontributit në PBB nga 1% e pjesës së forcës punëtore mund të jetë edhe më i lartë për shkak të nivelit të lartë të informalitetit që ka pikërisht sektori i ndërtimit. Kontributi i sektorit të shërbimeve në ekonominë shqiptare është në nivelin 47.35% të PBB-së. Niveli i punëtorëve të angazhuar në këtë sektor rezulton që në Shqipëri është 44%. 1% të forcës punëtore në sektorin e shërbimeve përkthehet në më shumë se 1% kontribut në ekonominë shqiptare. Sipas raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë 2023, konkurrueshmëria e Shqipërisë pengohet nga nivelet relativisht të ulëta të njohurive sipërmarrëse dhe teknologjike, nga nevojat e paplotësuara për investime në kapitalin njerëzor dhe fizik, shpenzimet e vazhdueshme të ulëta për kërkim shkencor dhe zhvillim dhe, gjithnjë e më shumë, nga mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar.

- Mungesa e organizimit sindikal dhe vështirësitë në organizimin e punëtorëve.
- Heqjet arbitrare e të padrejta nga puna.
- Moszbatimi i Kodit të Punës, kontratave individuale të punës dhe legjislacionit të punës.
- Hendeuku gjinor në paga në të gjitha profesionet. Në pjesën e parë të vitit 2023 paga mesatare për burrat ishte 72,681 lekë, ndërsa për gratë 68,183 lekë. Për disa profesione është dhe 25,6 %. Sipas FMN-së, në vendin tonë ka një hendeq gjinor edhe në pjesëmarrjen në tregun e punës. Pjesëmarrja e burrave është 13% më e lartë se e grave. Në vitin 2022 vetëm 66.7% e grave merrnin pjesë në tregun e punës. Dhe ky hendeq lidhet me gratë që kanë arsim fillor ose të mesëm.

III. Alternativa e Lëvizjes BASHKË

- *Themelimi i Ministrisë së Punës dhe fuqizimi i kapaciteteve të saj do t'i vendosë të drejtat e punëtorëve, sigurinë në punë dhe kualifikimin e forcës punëtore si përparësi ekonomike e sociale të zhvillimit të qëndrueshëm të Shqipërisë.*

- *Riorganizim meritokratik i Inspektoratit Shtetëror të Punës, rritje e numrit të inspektorëve në 2 për 10.000 të punësuar dhe shtim i inspektimeve rastësore, sidomos në sektorët me rrezik të lartë si ndërtimi dhe minierat.*

- *Luftë ndaj informalitetit duke rritur inspektimet dhe duke shtuar masën e gjobave nga ana e Inspektoratit të Punës dhe Tatimeve. Luftë informalitetit duke luftuar korrupsionin në administratën shtetërore dhe në biznese. Lëvizja BASHKË do të çojë përpara edhe politika mbështetëse për bizneset e vogla dhe të vetëpunësuarit që të formalizojnë marrëdhëniet e punës. Faktor shtesë i formalizimit të marrëdhënieve të punës në bujqësi do të jetë nxitja e krijimit të Shoqërive të Bashkuara Bujqësore.*

- *Ndryshim i Kodit Penal për rastet e vdekjeve në punë, duke ashpërsuar ndëshkimet në rastet e vdekjeve në punë dhe nxitur hetimin e plotë të përgjegjësisë për vdekjet në punë.*

- *Rritje e pagës minimale në 60,000 lekë, duke shkurajuar kështu emigrimin e forcës punëtore, investimet në teknologji dhe organizimin modern të punës, duke kontribuar kështu edhe në rritjen e produktivitetit të punës.*

- *Rritje e pagesës së papunësisë, nga 50% e pagës minimale që është sot, do të shkojë në 80% të pagës minimale.*

- *Ulje e hendekut gjinor në paga dhe në pjesëmarrjen në tregun e punës deri në barazi gjinore. Rritja e pjesëmarrjes së*

grave në punë do ta rriste nivelin e PBB me 5%, sipas FMN-së. Mbyllja e hendekut në pagave, orëve të punuara dhe dalimeve profesionale do të çonte gjithashtu në rritje të nivelit të PBB-së me 10%. Kjo do të arrihet nëpërmjet politikave të nxitjes së punësimit, edukimit, trajnimeve, e mbi të gjitha nëpërmjet rritjes së pagës minimale.

- *Realizim i politikave të rritjes së produktivitetit nëpërmjet arsimit dhe formimit profesional. Mbështetje dhe nxitje të sipërmarrjeve për t'i trajnuar punëtorët vazhdimisht. Po ashtu mbështetje ndaj sipërmarrjeve prodhuese për të rritur kapacitetet e tyre teknologjike. Nga ana tjetër, rritja e pagës minimale, ulja e orëve të punës, barazia gjinore në paga dhe në pjesëmarrjen në tregun e punës, janë të tjerë faktorë që do ta rrisin produktivitetin në punë.*

- *Përmirësimi i Kodit të Punës:*

- a. Do të sanksionohet në ligj rikthimi i punëtorëve të hequr padrejtësisht nga puna në rast vendimi pozitiv nga gjykata, ashtu siç parashikohet në rastin e nëpunësit civil. Nëse punëtori nuk do të rikthehet, do të marrë si dëmshpërblim 15 paga mujore. Nga ana tjetër, vënia e pengesave ligjore ndaj heqjes së padrejtë nga puna ndihmon në rritjen e produktivitetit sepse ul koston që ka punësimi i punëtorëve të rinj pa eksperiencë, trajnimi i tyre e ambientimi me punën.

- b. Në rast të shkeljes së Kodit të Punës, ligjeve apo kontratës së punës, shpalljen e grevës, përpos sindikatës, mund ta bëjnë dhe vetë punëtorët. Greva do të jetë e ligjshme nëse votojnë pro saj 50% plus 1 e punëtorëve të pranishëm në votim, në kushtet e sigurisë së plotë të mbledhjes, diskutimit dhe vendimmarrjes nga ana e punëtorëve.

- c. Do të ulet nga 20 në 10 numri i punëtorëve që duhen për themelimin e sindikatës (duke parë numrin e lartë të ndërmarrjeve të vogla e të mesme).

ç. Do të ashpërsohen masat ndaj punëdhënësve që do të shkelin të drejtat ligjore të punëtorëve për t'u organizuar në sindikatë.

d. Do të njihet e drejta e punëtorëve besimtarë që të shkëputen përkohësisht nga vendi i punës për të kryer rituale të rëndësishme fetare, kur këto të fundit zhvillohen në ditë pune (si p.sh. e premtja për besimtarët myslimanë apo për besimtarët e krishterë e diela, kur kjo ditë është ditë pune.)

- *Politika mbështetëse, ndërgjegjësuere për organizimin e punëtorëve në sindikata, federata e konfederata pune, dhe për miratimin e kontratave kolektive të punës.*

- Në afatgjatë do të propozohet futja në Kodin e Punës të Këshillave të Punëtorëve në sipërmarrjet e mesme dhe të mëdha, bazuar në modelin gjerman të bashkëmenaxhimit. Këto organizma do të jenë thelbësorë në vendosjen e një ekuilibri mes interesave të sipërmarrjeve dhe interesave të punëtorëve. Ndryshe nga sindikatat, këta këshilla do të përfaqësojnë të gjithë punëtorët e një fabrike ose vendi pune, pavarësisht pjesëmarrjes ose jo të tyre në një sindikatë. Këshillat zgjidhen nga të gjithë punëtorët e një sipërmarrjeje. Sipërmarrja është e detyruar të konsultojë Këshillin për çështjet e rëndësishme si: a) heqjet nga puna dhe marrjet në punë; b) orët e punës dhe pushimet vjetore; c) Shëndeti i punëtorëve dhe kushtet e sigurisë në punë. Këshilli ka për funksion përfaqësimin e interesave të punëtorëve përballë sipërmarrjes; si dhe ndërmjetësimin mes punëtorëve dhe drejtuesve të sipërmarrjes në mënyrë që të parandalohen dhe të zgjidhen konfliktet e brendshme.

- *Miratimi i Statusit të Minatorit sipas kërkesave të mëposhtme të vetë minatorëve dhe ish-minatorëve të organizuar:*

Sigurimi i jetës për minatorët

a) Në raste aksidentesh me pasojë vdekjen:

- 6 milion lekë dëmshpërblim familjarëve (sipas VKM-së Nr.1109, datë 30.07.2008) për të gjithë minatorët që vdesin në vendin e punës;
- Pension familjar në masën 100% të pagës;
- Bursa studimi universitar për fëmijët.

b) Në raste aksidentesh me pasojë pamundësinë për punë:

- Dëmshpërblim për pasojat fizike të shkaktuara (humbje gjymtyrësh, etj.);
- Mbulim i plotë i shpenzimeve mjekësore;
- Pension i parakohshëm i plotë në masën 100% të pagës;
- Bursa studimi universitar për fëmijët.

c) Në raste aksidentesh me rikthim në punë:

- Dëmshpërblim për pasojat fizike të shkaktuara (humbje gjymtyrësh, etj.);
- Pagë e plotë deri në rifillimin e punës;
- Mbulim i plotë i shpenzimeve mjekësore.

Rritja e pagave dhe përfitimeve të tjera për minatorët

a) Paga minimale e minatorëve të mos jetë më e ulët se 235% e pagës minimale zyrtare (llogaritur sot, 94'000 lekë);

b) Pagesë për vështirësi dhe vjetërsi në punë;

c) Pagë të 13-të;

d) Kontrata të rregullta pune për çdo punëtor të këtij sektori;

e) Sigurim nga papunësia:

Në rast të humbjes së vendit të punës, pagesë 100% të pagës minimale zyrtare në muaj (aktualisht 40'000 lekë), deri në 5 vite, e përshkallëzuar sipas viteve të punës në nëntokë dhe gjithsej:

Punë në nëntokë	Punë gjithsej	Pagesë papunësie - 100% të pagës minimale
6 vite	12 vite	5 vite
5 vite	10 vite	4 vite
4 vite	8 vite	3 vite
3 vite	6 vite	2 vite
2 vite	4 vite	1 vit

- Përparësi në punësim e strehim prej institucioneve shtetërore.

f) Rritje të pagave të punëtorëve në miniera në sipërfaqe, në raport me pagat e nëntokës të kërkuara në këtë peticion;

g) Indeksime përvitshëm i shumave të mësipërme me inflacionin.

Rritja e pensioneve për minatorët

a) Mosha e pensionit të plotë, vjetërsia e punës në nëntokë dhe vjetërsia e punës gjithsej, të jenë si më poshtë:

- Mosha e pensionit, e përshkallëzuar, të jetë 53-55 vjeç;
- Vjetërsia e punës në miniera në nëntokë, e përshkallëzuar, të jetë 10-11 vite;
- Vjetërsia e punës në miniera në nëntokë të jetë 25 vjet

Punë në nëntokë	Punë gjithsej	Mosha e pensionit të plotë
11 vite	25 vite	53 vjeç
10.5 vite	25 vite	54 vjeç
10 vite	25 vite	55 vjeç

a) Masa e pensionit të jetë e plotë që në momentin e daljes në pension, duke përfshirë edhe trajtimin financiar suplementar;

b) Pensioni minimal për minatorët, të mos jetë më i ulët se 135% e pagës minimale zyrtare (llogaritur sot, 54'000 lekë);

c) Të ketë shtesë të pensionit të plotë, 1% për çdo vit pune në nëntokë mbi 11 vite;

d) Ndryshimet në masën e pensioneve, të kërkuara sipas këtij peticioni, të reflektohen edhe në pensionet e ish-minatorëve (pensionistët aktualë);

e) Indeksime përvitshëm i shumave të mësipërme me inflacionin.

Garantimi i kujdesit shëndetësor të veçantë për minatorët dhe ish-minatorët

a) Pavion i specializuar spitalor për sëmundjet profesionale;

b) Kontroll i plotë shëndetësor të paktën 2 herë në vit;

c) Kurim falas, brenda dhe jashtë vendit, për sëmundjet profesionale;

d) Barna 100% të rimbursueshme.

4.3 BARAZIA GJINORE

Lëvizja Bashkë qëndron fuqishëm në mbrojtje të të drejtave të njeriut, duke i parë ato si themelin e një shoqërie të drejtë dhe të barabartë. Ne besojmë se liria, dinjiteti dhe barazia nuk janë thjesht parime abstrakte, por vlera konkrete që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së çdokujt. Të drejtat e njeriut janë thelbësore për funksionimin e një shoqërie demokratike sepse sigurojnë që secili individ të ketë mundësi të barabarta për të jetuar me dinjitet, për të marrë pjesë në jetën publike dhe për të ndërtuar një të ardhme më të mirë. Aty ku shkelet barazia dhe liria, lindin padrejtësitë dhe pabarazitë, duke dobësuar kohezionin social dhe besimin tek institucionet.

Pabarazitë nuk kufizohen vetëm në aspektin social dhe ekonomik, por prekin edhe përkatësitë identitare. Në një shoqëri demokratike dhe të drejtë, askush nuk duhet të përjashtohet apo të diskriminohet për shkak të gjinisë, etnisë, besimit fetar, përkatësisë krahinore, orientimit seksual etj. Megjithatë, realiteti tregon se shumë individë dhe komunitete përballen me diskriminim sistematik dhe pengesa serioze për qasjen në shërbime thelbësore si arsimi, shëndetësia, strehimi, punësimi etj.

1. Gjendja dhe problemet

Shqipëria ka bërë pjesërisht përparime në fushën e barazisë gjinore përmes përmirësimeve në legjislacion për kuotat gjinore dhe përmes pjesëmarrjes së lartë të grave në pozita drejtuese, ku një numër i konsiderueshëm i ministrave dhe kryeparlamentarëve janë gra. Megjithatë kjo pjesëmarrje e dukshme e grave në pushtet nuk mjafton për të thënë se Shqipëria ka arritur barazi të

vërtetë gjinore. Ky fenomen mund të konsiderohet si një shembull i feminizmit performativ ku pjesëmarrja e grave përdoret “për sy e faqe” për të projektuar një imazh progresiv, ndërsa pabarazitë strukturore dhe sfidat e mëdha me të cilat përballen shumica e grave në vend mbeten të paadresuara.

Fenomeni i martesave të hershme për vajzat është një aspekt shqetësues. Në vitin 2022, përqindja e vajzave të martuara në moshën 18-19 vjeç është dukshëm më e lartë (6,1% dhe 4,7%) krahasuar me djemtë (nën 1%). Kjo tregon se vajzat janë të prekura në mënyrë shpërpjesëtimore nga normat sociale që i shtojnë të hyjnë në martesë në një moshë kur ende janë në fazën e adoleshencës ose të rinisë së hershme.

Kjo ndarje nuk është thjesht një çështje kulturore, por ka pasoja të rënda ekonomike dhe sociale. Martesat e hershme dhe përqendrimi në detyrat familjare kufizojnë mundësitë e grave dhe vajzave për të arritur pavarësi financiare, për të ndjekur arsim të lartë ose për të zhvilluar karrierën. Nga ana tjetër, kjo përforcon ciklin e varfërisë dhe pabarazisë, duke i lënë gratë të varura ekonomikisht nga partnerët ose familjet e tyre.

Gratë përbëjnë 50,5 % të popullsisë. 100 vajza të lindura, lindin 107 djem dhe ky raport është më i lartë se raporti natyral, i cili është 105 dhe nëse tejkalohet gjinia natyrale dëshmon për praktikën e abortit përzgjedhës, që vazhdon të shkaktojë një çekuilibër në raportin e djemve ndaj vajzave të lindura çdo vit. Në vitin 2022 në Shqipëri u regjistruan 4.199 aborte, me një raport prej 170 aborte për 1.000 lindje të gjalla. Shumica e tyre (83,9%) ishin spontane, ndërsa grupmosha më e prekur ishte 20-34 vjeç, periudha më riprodhuese për gratë.

Vihet re se gratë me arsim më të ulët kryejnë më shumë aborte (29,4% me arsim 9-vjeçar kundrejt 24,6% me arsim

të lartë), çka tregon se mungesa e informacionit dhe edukimit seksual mund të ndikojë në vendimmarrjen riprodhuese. Po ashtu, 71,6% e aborteve janë kryer nga gra të martuara, duke sugjeruar se faktorët ekonomikë dhe socialë, si vështirësitë financiare apo mungesa e mbështetjes për gratë në familje, mund të ndikojnë në këtë zgjedhje. Përvoja e një aborti mund të sjellë pasoja psikologjike afatgjata, si depresioni, ankthi apo ndjenja e fajit, të cilat rëndojnë kryesisht mbi gruan, ndërsa burrat shpesh mbeten jashtë kësaj përvoje, si pasojë e normave shoqërore që i largojnë nga përgjegjësitë riprodhuese. Këto të dhëna tregojnë nevojën për politika të mirëfillta të planifikimit familjar, akses më të madh në kontracepsion dhe edukim seksual për të dyja gjinitë, si dhe mbështetje psikologjike për gratë që përjetojnë abortin.

Në vitin akademik 2022-23, pjesëmarrja në sistemin arsimor në Shqipëri tregoi diferenca gjinore në nivele të ndryshme. Në arsimin parashkollor janë të regjistruar 84,3% e djemve dhe 81,5% e vajzave, ndërsa në arsimin e detyrueshëm, përqindja ishte 96,9% për djemtë dhe 90,4% për vajzat. Arsimi i mesëm gjithashtu kishte më shumë djem (95,7%) sesa vajza (90,2%). Por në arsimin e lartë raporti përmbyset, me 74,7% vajza dhe 51,5% djem të regjistruar. Kjo tendencë pasqyrohet edhe në diplomimet, ku në vitin akademik 2021-22 gratë përbënin 66,3% të të diplomuarve në arsimin e lartë, veçanërisht në fushat e arsimit (80,4%), arteve dhe shkencave humane (80,1%) dhe shkencave sociale (78,8%). Në të kundërt, burrat dominonin në fushat e inxhinierisë (62,9%), teknologjisë së informacionit (58,2%) dhe shërbimeve (64,8%). Pabarazitë në fushat e zgjedhura tregojnë ndikimin e stereotipave gjinorë mbi karrierën. Prania e lartë e grave në mësuesi reflekton tendencën e vazhdueshme të

feminizimit të profesioneve arsimore, ndërsa burrat mbeten të privilegjuar në sektorë strategjikë si inxhinieria dhe teknologjia, ku pagat janë më të larta dhe perspektivat më të favorshme. Kjo nuk është thjesht zgjedhje individuale, por pasojë e strukturave patriarkale që projektojnë role gjinore edhe në tregun e punës, duke i kufizuar gratë në profesione me më pak fuqi ekonomike.

Për grupmoshat më të vjetra, dallimet janë akoma më të theksuara. Në vitin 2022, 73% e grave mbi 65 vjeç kishin vetëm arsim bazë, krahasuar me 53,9% të burrave; vetëm 5,7% e grave kishin arsim të lartë kundrejt 13,1% të burrave. Situata ndryshon te të rinjtë 25-39 vjeç, ku gratë me arsim të lartë (43,8%) tejkalojnë ndjeshëm burrat (29,8%). Po ashtu, gratë përbëjnë shumicën e stafit mësimor në arsimin 9-vjeçar (77,4%) dhe atë të mesëm (69,8%), ndërsa në arsimin e lartë kanë përfaqësim të mirë si doktorë (62,1%) dhe profesorë (45,8%).

Këto të dhëna tregojnë se ndonëse vajzat përballen me sfida në arsimin parauniversitar, ato janë përgjithësisht më të përparuara se djemtë në këtë aspekt. Ama këto arritje nuk reflektohen detyrisht në integrimin e tregut të punës.

Të dhënat mbi punësimin dhe papunësinë në Shqipëri tregojnë një pabarazi të theksuar gjinore, e cila reflekton jo vetëm ndarjen tradicionale të punës mes grave dhe burrave, por edhe mënyrën se si tregu i punës riprodhon dhe përforcon këto pabarazi. Shkalla e punësimit është më e ulët për gratë (58,9%) krahasuar me burrat (71,3%), një tregues i qartë i barrierave strukturore që kufizojnë aksesin e grave në tregun e punës. Këto pengesa përfshijnë ngarkesën e madhe të punës së papaguar në sferën familjare, diskriminimin në punësim dhe mungesën e politikave të mbështetjes sociale, si çerdhet apo lejet prindërore të barabarta.

Një nga aspektet më problematike është pjesa e konsiderueshme e grave që punojnë pa pagesë në bizneset familjare (23,5 %), një normë shumë më e lartë se ajo e burrave (13,2 %). Kjo tregon për një formë të shfrytëzimit ekonomik të grave, të cilat përfshihen në punë prodhuese, por pa të drejta të plota ekonomike dhe pa asnjë garanci për pavarësinë e tyre financiare. Ndërkohë, burrat dominojnë në vetëpunësim (33,1 % krahasuar me 20,4 % të grave), çka lidhet me një akses më të madh të tyre në burimet financiare dhe në tokë, duke forcuar epërsinë e tyre në pronësi dhe kontroll ekonomik.

Edhe pse shkalla e papunësisë është e ngjashme mes burrave dhe grave (10,9 % për burrat dhe 11,7 % për gratë), dallimi real qëndron në faktin se gratë përballen me më shumë vështirësi për t'u riintegruar në tregun e punës. Gratë përfaqësojnë shumicën e pjesëmarrësve në programet e formimit profesional dhe të nxitjes së punësimit, çka tregon se atyre u duhet të kalojnë nëpër më shumë filtra për të gjetur punë, kurse burrat kanë më shumë rrjete informale që i ndihmojnë në punësim.

Numri i grave punëkërkuese të papuna rritet me moshën, ndërsa për burrat ndodh e kundërta. Kjo është një pasojë e drejtpërdrejtë e mungesës së politikave të mirëfillta për të mbështetur gratë pas periudhave të papunësisë së detyruar nga përgjegjësitë familjare. Për më tepër, fakti që rreth gjysma e punëkërkuësve të papunë të regjistruar kanë arsim 8/9-vjeçar tregon se pabarazitë gjinore ndërlidhen ngushtë me pabarazitë klasore, duke e bërë edhe më të vështirë për gratë e shtresave të varfra të arrijnë pavarësinë ekonomike.

Ndarja e pabarabartë e punës shtëpiake, e cila bie kryesisht mbi gratë, është një fenomen i theksuar që reflekton ndikimin e stereotipave gjinorë dhe ndarjes tradicionale të punëve sipas gjinisë. 16,9% e

grave janë të papuna ose jashtë tregut të punës për shkak të përmbushjes së detyrave shtëpiake, ndërsa kjo arsye përbën vetëm 0,8% të rasteve të inaktivitetit të burrat. Një grua në Shqipëri harxhon mesatarisht 25 vjet për punë të papaguar në shtëpi gjatë gjithë jetës së saj.

Kjo ndarje e punës jo vetëm që thekson pabarazitë gjinore, por edhe rrit pabarazitë sociale dhe ekonomike, duke kufizuar mundësitë e grave për t'u zhvilluar në karrierë dhe për t'u përfshirë në tregun e punës.

Puna e kujdesit të papaguar, e cila bie kryesisht mbi gratë, nuk llogaritet në PBB, pavarësisht se studime të ndryshme sugjerojnë se, nëse do të monetizohesh, kjo punë do të përbënte rreth 30-40% të PBB-së në shumë vende. Megjithatë ky indikator makroekonomik nuk merr parasysh vlerën e punës riprodhuese dhe kontributin e saj në zhvillimin e shoqërisë dhe mirëqenien e përgjithshme. Prandaj është e nevojshme të krijohen grupe studimore që të përdorin indekse si HDI (Indeksi i Zhvillimit Njerëzor) dhe GII (Indeksi i Pabarazisë Gjinore) për të analizuar në mënyrë gjithëpërfshirëse ndikimin e punës së papaguar në dimensionet e ndryshme ekonomike dhe sociale. Këto indekse mund të na ndihmojnë të kuptojmë më thellë pabarazitë gjinore dhe të hartojmë politika që synojnë një shpërndarje më të drejtë të punës shtëpiake dhe të kujdesit, si dhe një pjesëmarrje më të madhe të grave në tregun e punës. Kjo do të kontribuojë jo vetëm në rritjen e barazisë gjinore, por edhe në përmirësimin e mirëqenies ekonomike dhe sociale të shoqërisë në tërësi.

Bazuar në raportin e INSTAT-it për 2023 mbi treguesin e rrezikut për të qenë të varfër ose për të rënë në varfëri, vajzat dhe gratë paraqesin një rrezik më të lartë të varfërisë ose përjashtimit

social krahasuar me burrat. Kjo vërehet në të gjitha kategoritë përcaktuese të rrezikut për të qenë të varfër ose për përjashtimin social.

Gratë nuk janë të vetmet viktime të patriarkalizmit. Të dhënat mbi vetëvrasjet e burrave dhe grave në Shqipëri mund të analizohen duke theksuar rolin e strukturave patriarkale dhe normave gjinore që ndikojnë në shëndetin mendor dhe emocional të individëve. Fakti që 69,1% e vetëvrasjeve janë kryer nga burra, ndërsa vetëm 30,9% nga gra, tregon një ndarje të theksuar gjinore që reflekton më shumë se thjesht një ndryshim numerik. Kjo ndarje është rrënjësuar në normat sociale që i detyrojnë burrat të ndiejnë presion për të qenë “të fortë”, të mos shprehin dobësi dhe të mos kërkojnë ndihmë për problemet e tyre mendore dhe emocionale. Në një shoqëri ku maskuliniteti tradicional shoqërohet me ide si pavarësia emocionale, kontrolli dhe ndjenja e dominancës, burrat janë të detyruar të shtypin emocionet e tyre dhe të mos kërkojnë ndihmë profesionale. Ky toksicitet krijon një mjedis ku burrat ndihen të detyruar të përballin problemet e tyre në mënyrë të izoluar, duke rritur rrezikun e krizave mendore dhe vetëvrasjeve. Nga ana tjetër, gratë, megjithëse përballen me presione të tjera sociale dhe ekonomike, kanë më shumë mundësi të shprehin emocionet e tyre dhe të kërkojnë ndihmë, pjesërisht për shkak të pranimi më të gjerë social të “dobësisë emocionale” te to.

Megjithatë, rritja e vetëvrasjeve tek gratë me 15,7% është një tregues shqetësues që nuk duhet të injorohet. Kjo rritje mund të lidhet me rritjen e presioneve sociale dhe ekonomike që gratë përballin në shoqërinë moderne, si pabarazia në tregun e punës, ngarkesa e punës së papaguar në shtëpi dhe dhuna gjinore. Për shumë gra, këto presione mund të jenë të padurueshme, veçanërisht në një kontekst ku mbështetja sociale dhe

shërbimet e shëndetit mendor janë të kufizuara.

Dhuna ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri është një fenomen që thekson pabarazitë e thella gjinore dhe fuqizimin e strukturave patriarkale që ende mbi-zotërojnë në shoqërinë shqiptare. Ky problem ka rrënjë të thella në shoqërinë tonë, ku institucionet dhe normat sociale u japin privilegje dhe kontroll burrave, duke bërë që gratë të jenë viktime të dhunës sistematike, qofshin ato në familje, në lidhje me partnerët intimë ose nga individë të tjerë.

Në vitin 2022, janë regjistruar 13.650 persona të dëmtuar nga veprat penale, prej të cilëve 4.200 janë gra, që përbëjnë rreth 30,8% të totalit. Vajzat e dëmtuara nga krimet seksuale përbëjnë 23,1% të totalit.

Dhuna nga partneri intim është një nga format më të shpeshta të dhunës. 52,9% e grave pohojnë se kanë përjetuar të paktën një herë dhunë gjatë jetës së tyre dhe 36,6% prej tyre pohojnë se aktualisht janë duke përjetuar dhunë. Forma më e zakonshme e dhunës në familje nga partneri intim është kontrolli shtrëngues, pasuar nga dhuna psikologjike, dhuna fizike dhe/ose ajo seksuale.

Rastet më të shpeshta të dhunës ndodhin gjatë vitit të parë deri në vitin e tretë të martesës. Ushtruesit e dhunës në familje janë kryesisht individë me arsim 9-vjeçar (47,9%) dhe arsim të mesëm (30,0%). Grupi i personave që kanë përjetuar më shpesh dhunë janë ata që kanë moshën nga 45-54 vjeç dhe 55-64 vjeç. Të gjitha format e dhunës ndodhin më rrallë në grupmoshën 18-24 vjeç.

Në lidhje me dhunën nga jopartneri, 18,2% e grave të moshës 18-74 vjeç kanë përjetuar ndonjëherë dhe 2,4% aktualisht një ose më shumë lloje dhune fizike dhe/ose seksuale nga dikush që

nuk është partneri i tyre. Gratë kishin më shumë mundësi të përjetonin dhunë fizike nga jopartneri (17,3% ndonjëherë, 2,3% aktualisht) sesa dhunë seksuale nga jopartneri (1,3% ndonjëherë, 0,1% aktualisht).

Sipas të dhënave të INSTAT, gjatë vitit 2022, 70,2% e viktimave të dhunës në familje dhe 81,8% e viktimave të dhunës seksuale kanë qenë gra. Për më tepër, Observatori Shqiptar i Femicidit, që u krijua brenda strukturës së Avokatit të Popullit, publikoi një raport që tregon se 32 gra janë vrarë në Shqipëri gjatë periudhës 2021-2023, ku 90% e vrasjeve janë kryer nga partneri intim ose anëtarët e familjes. Ky raport tregon gjithashtu se 24 raste janë klasifikuar si femicide, që janë vrasje të grave për shkak të gjinisë së tyre. Afërsisht 60% e rasteve të femicitit kanë ndodhur në banesën e viktimës.

Po ashtu, 17 gra shqiptare, brenda dhe jashtë vendit, si emigrante, janë vrarë në vitin 2024 nga partnerët e tyre, ish-partnerët ose bijtë e tyre.

6,5% e pjesëtarëve të komunitetit ku gratë e dhunuara jetojnë, besojnë se dhuna në familje duhet toleruar për të mbajtur familjen të bashkuar. Dhuna fizike që përjetojnë gratë në familje shihet kryesisht si faj i pjesshëm i tyre dhe bërja publike e përjetimit të dhunës jashtë rrethit familjar konsiderohet si një turp.

Bazuar në raportet e Avokatit të Popullit, auditimet e KLSH-së dhe studime të ndryshme të organizatave të shoqërisë civile dhe UN Women, konsiderohen si probleme më imediate në lidhje me dhunën gjinore:

- Mungesa e një strategjie të qartë dhe të vazhdueshme nga strukturat e Policisë së Shtetit për trajtimin e dhunës ndaj grave dhe personave të dhunuar për shkak të orientimit

seksual, identitetit gjinor dhe atij etnik si dhe dhunës në familje.

- Moszbatimi i një qasjeje të bazuar në risk, mungesa e fushatave parandaluese dhe e trajnimeve të dedikuara për punonjësit e policisë në zonat me risk të lartë, pengon identifikimin, raportimin dhe ndjekjen efektive të rasteve të dhunës ndaj grave dhe personave të dhunuar për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor.
- Mungesa e mbulimit të plotë policor në zonat e largëta dobëson reagimin institucional, duke lënë viktimat pa mbrojtje adekuate dhe duke lejuar që dhunuesit të mos mbajnë përgjegjësi ligjore.
- Mungesa e një plani buxhetimi të qartë dhe analitik për fushatat sensibilizuese dhe ndërgjegjësuere për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe personave të dhunuar për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.
- Mungesa e konsolidimit të buxheteve për barazinë gjinore në institucionet qendrore.
- Baza ligjore nuk parashikon ndërhyrjen e shërbimit psikologjik në fazën fillestare të raportimit, duke lënë viktimat pa mbështetjen e nevojshme për të përballuar traumat. Punonjësit e policisë dhe strukturat vendore nuk janë të trajnuar për të identifikuar problemet e shëndetit mendor të dhunuesit apo viktimat, çka ndikon në saktësinë e vlerësimit të riskut.
- Mungesa e asistencës psikologjike gjatë deklarimeve mund të ndikojë negativisht në cilësinë e dëshmive, duke vështirësuar ndjekjen ligjore të rasteve. Trauma e viktimave ndikon në kujtesën dhe gatishmërinë e tyre për të raportuar dhunën, duke i lënë të ekspozuar ndaj ritraumatizimit dhe frikës nga sistemi.

- Në Shqipëri ende nuk ka asnjë shërbim të ngritur për strehimin/rehabilitimin e dhunuesit në momentin kur urdhërohet largimi i menjëhershëm nga banesa.
- Mungesa e infrastrukturës së nevojshme për trajtimin e rasteve të dhunës në familje nuk ka siguruar trajtimin me respekt dhe dinjitet të viktimave, si dhe ruajtjen e konfidentalitetit dhe mbrojtjen e të dhënave të tyre personale.
- Megjithëse numri i rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare arrin në rreth 5,000 raste në vit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror nuk disponojnë ende një vlerësim të kapaciteteve akomoduese në rang kombëtar. Kapacitetet shtetërore për akomodimin e viktimave janë shumë të limituara, me rreth 32 shtretër në qendrat rezidenciale dhe 30 shtretër emergjence në qendrat multifunksionale, të cilat ofrojnë akomodim edhe për problematika të tjera.

Shumë nga problemet që lidhen me papunësinë, pabarazinë në paga, diskriminimin në punë, ndihmat sociale, arsimin dhe shëndetësinë, të cilat janë kyçe për ndryshimin e gjendjes së gruas në Shqipëri, trajtohen në kapitujt përkatës të programit.

Lëvizja Bashkë beson se shumë nga problemet e pabarazive identitare dhe seksuale janë të natyrës strukturore, të cilat mund të zgjidhen vetëm përmes ndryshimit të modelit të zhvillimit ekonomik dhe ndërtimit të një shteti të fortë social. Pavarësisht kësaj, jemi të vetëdijshëm se një shoqëri patriarkale nuk ndryshon sa hap e mbyll sytë, ndaj është e nevojshme të ketë një vëmendje të shtuar ndaj çështjeve që prekin gratë si të tilla.

II. Alternativa e Lëvizjes BASHKË

- Forcimi i legjislacionit dhe i institucioneve kundër dhunës me bazë gjinore e seksuale, duke nisur nga pajisja e policisë me oficerë të trajnuar posaçërisht për të menaxhuar këto raste.
- Lëvizja Bashkë propozon që në sistemin e Gjykatave të Juridiksionit të Përgjithshëm të ngrihet një seksion i veçantë (ose dhomë) që të shqyrtojë çështjet e dhunës me bazë gjinore e seksuale.
- Prania e psikologëve në stacionet e policisë për të ndihmuar procesin e denoncimit dhe mbrojtjes së viktimave.
- Vendosja e protokolleve të detyrueshme për mjekët dhe policinë për të identifikuar dhe raportuar rastet e dhunës.
- Krijimi i një databaze të integruar të aksesueshme nga të gjitha subjektet e mekanizmit të referimit në kohë reale.
- Publikimi i të dhënave mbi rastet e dhunës çdo tre muaj për transparencë, duke ruajtur anonimitetin e viktimave.
- Krijimi i qendrave të specializuara për viktimat e dhunës, me shërbime juridike, psikologjike dhe rehabilituese.
- Zbatimi i programeve për rehabilitimin e dhunuesve, bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare gjatë kohës së dënimit.
- Riintegrimi i viktimave të dhunës në bashkëpunim me strehat, qendrat për punë sociale dhe institucionet e punësimit.

- Gjobitje më e rëndë për mediat që përdorin gjuhë të urrejtjes dhe diskriminuese, si dhe detyrimi për të transmetuar gjatë reklamave një spot ndërgjegjësues mbi barazinë gjinore, të drejtat e njeriut dhe denoncimin e dhunës.
 - Fushata ndërgjegjësimi me sindikata, shoqëri civile, komunitete, shkolla dhe institucione publike për parandalimin e dhunës, bullizmit dhe gjuhës së urrejtjes.
 - Angazhimi i burrave dhe djemve në fushatat kundër dhunës me bazë gjinore për të ndryshuar perceptimet dhe normat shoqërore
 - Integrimi në tregun e punës duke u krijuar lehtësira mbështetëse së grave në tregun e punës, veçanërisht në grupmoshat 20-30 vjeç, për të shmangur penalizimin e tyre për shkak të mëmësisë.
 - Rritja e kapaciteteve për çerdhet, kopshtet dhe shkollat me programe pas mësimi (sport, aktivitete jashtëshkollore) për të ndihmuar gratë të punojnë me kohë të plotë për të qenë më të pavarura.
 - Rishikimi i politikave për lejen e lindjes për të dy prindërit, bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare.
 - Hartimi i politikave institucionale për të shmangur dhe raportuar ngacimet seksuale në vendin e punës.
 - Kontrollat prenatale pa kosto shtesë.
 - Rimbursimi i ekzaminimeve laboratorike dhe ekografike gjatë shtatzënisë, si dhe ndjekja e rregullt në maternitete ose qendra shëndetësore.
 - Krijimi i një programi kombëtar për ndjekjen e shtatzënieve me rrezik të lartë, me referime të shpejta në maternitetet kryesore.
 - Vendosja e protokolleve të qarta për përdorimin e CTG-së dhe matjen e laktatit fetal për të reduktuar lindjet me ndërlikime.
 - Program për shëndetin mendor të grave pas lindjes, duke ofruar shërbime psikologjike falas për gratë me depresion post-partum.
 - Ofrimi i shërbimeve të shëndetit riprodhues, duke përfshirë akses në kontracepsion dhe këshillim mbi fertilitetin.
 - Pajisja e të gjitha spitaleve rajonale me inkubatorë dhe aparatura moderne për të zvogëluar varësinë nga Tirana.
 - Mamografi falas për gratë mbi 40 vjeç dhe PAP-test falas për gratë mbi 25 vjeç.
 - Sigurimi i vaksinës HPV për vajzat 12-16 vjeç si pjesë e kalendarit kombëtar të vaksinave.
 - Garantimi i anestezisë epidurale për të lehtësuar lindjen natyrale.
 - Kryerja e testeve virale për hepatitet dhe HIV për të gjitha gratë shtatzëna.
 - Sigurimi i aksesit të plotë dhe falas në të gjitha metodat e abortit.
 - Detyrimi i mjekëve për raportimin dhe denoncimin e rasteve të abuzimit seksual të miturit pa miratimin e familjes.
 - Pajisja falas me produkte për higjienën menstruale në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme, si dhe heqja e TVSH për këto produkte.
- Barazia gjinore është një parim themelor i drejtave të njeriut dhe një kusht i domosdoshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të një shoqërie. Kur grave u sigurohen të njëjtat mundësi si burrave, ato kontribuojnë në mënyrë të

barabartë në ekonomi, politikë dhe jetën shoqërore. Studimet tregojnë se vendet me nivele më të larta të barazisë gjinore kanë tendenca për ekonomi më të forta, nivele më të ulëta të varfërisë dhe një cilësi më të mirë jetese për të gjithë qytetarët. Përveç kësaj, një shoqëri e edukuar, arsimuar dhe e ndërgjegjësuar për barazinë gjinore është më e aftë të luftojë stereotipat dhe paragjykimet që pengojnë zhvillimin e plotë të individëve dhe të shoqërisë në tërësi.

LEVIZJA BASHKE aspirojnë të kontribuojnë në ndërtimin e një shoqërie ku gratë dhe çdo minorancë identitare të kenë mundësi të jetojnë pa frikë dhe të gëzojnë të drejtat dhe liritë e plota.

4.4 KULTURA

Politikat e neoliberalizimit të skajshëm, privatizimeve dhe zbrazjes së vendit prej elementeve më vitale të saj e kanë prekur edhe më dukshëm kulturën dhe artin në aftësinë transcendentale që ka për të shprehur jo vetëm nevojat, por edhe aspiratat humane të një shoqërie.

Sikurse potencialet rinore të qytetarëve tanë, të cilët u largohen qoshkut prindëror për t'u mëvetësuar, nuk kanë arritur dot të materializojnë ankthet dhe nevojat tona materiale, edhe kultura e industria kreative (e quajtur kështu për hir të incentivëve ekonomikë në vende të përparuara) nuk kanë arritur dot të dalin prej arkaizmave, shitjes së imazhit shqipëtar sipas modelit kolonial që projektohet mbi popujt e vegjël dhe korrupsionit me tregtimin e idesë si mall i çfarëdoshëm.

Ky manifest vjen si nevojë e materializimit të ideve më të shëndosha e demokratike të shoqërisë të cilës aspirojmë t'u japim jetë, pa zhbërë vlera dhe kultura për hir të anihilimit të së shkuarës. Përkundrazi, ne mendojmë se Shqipërinë nuk duhet ta bëjë askush nga e para, e as se historia fillon nga subjekte politike apo individë. Nëse kërkojmë thellë në rrënjët e shoqërisë tonë, do ta gjejmë klithmën e katastrofës dhe aty mandej do të ndërtojmë melodinë e shekullit tonë, të së tashmes që nuk e kemi jetuar dot sot.

1. Gjendja dhe problemet e jetës kulturore

Ashtu sikurse vizioni i qeverisë aktuale shkon për pastrimin e parave të krimit të organizuar dhe oligarkisë vendase, edhe investimi për organizime kulturore

afatgjata mungon. Përdorimi i vendit si autostradë e kapitalit të dyshimtë vendas e ndërkombëtar, hapësirë fizike e ëndrrave koloniale të qeverive të ekstremit të djathtë fqinj dhe strehë e ngrohtë e spekulimit për hir të fitimeve marra-mendëse, e bën edhe artin e kulturën mekanizëm në funksion të kamuflimit sa më të kuruar estetik të këtij mekanizmi. I gjithë potenciali artistik e kulturor shpenzohet për performancë me datë skadence, dhe e jo për emancipim e vlerë kulturore të qëndrueshme si dhe për të krijuar strategji me një pikëmbërritje të caktuar.

Shqipëria gjendet pa një Ministri të Kulturës, e cila është shkrirë në atë që quhet Ministria Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Në paaftësinë për të krijuar ekonomi në vend të tregtimit të gjithçkaje, ra në grackë edhe kultura, duke u lidhur edhe në portofol me dy sektorë të tjerë. Një nga aktet e fundit që bëri ministria e shkrirë tashmë ishte shkurtimi i buxhetit publik për disa sektorë të kulturës, siç për shembull me 25% i buxhetit për Teatrin Kombëtar. Galeria Kombëtare e Arteve vazhdon të jetë e mbyllur edhe pse faza e rikonstruktimit ka përfunduar. Po ashtu gjendemi pa akses në Muzeun Kombëtar, i cili është parashikuar të marrë plot 4 vite për rikonstruktim. Në kinematografi nuk kemi të regjistruar asnjë prodhim filmik për më se një vit, ndërsa Qendra Kombëtare e Kinematografisë nuk regjistron asnjë raportim publik prej vitesh.

Të tjera monumente të kulturës, nga të gjitha kategoritë me vlerë të arkeologjike ofrohen me tarifa të cilat nuk reflektojnë cilësinë e mirëmbajtjes së këtyre objekteve, numrin e ekspeditave thelluese apo rigjeneruese të cilat nuk kanë financim të mjaftueshëm prej shtetit. Aktualisht gjendemi përballë dhënies me koncesion të Parkut Arkeologjik të Butrintit të disa

struktura të cilat quhen fondacione të posaçme, të cilat de facto janë mekanizma ndërmjetësues për dhënien me koncesion të këtyre monumenteve kulturore, ku i vetmi qëllim është të gjenerohet një marzh fitimi maksimal, dhe jo promovimi, studimi apo mirëmbajtja e tyre.

Ligji nuk parashikon asgjë për trajtimin e studentëve të Universitetit të Arteve apo nxënësve të liceve artistikë për punë të vazhdueshme kreative, salla apo bashkësi studentore për ushtrimin dhe promovimin pasuniversitar. Gjithashtu informimi publik mbi kuadrin ligjor të kulturës, transparencën dhe aktivitetet e përditshme është vetëm formal.

Industria kreative është e përfshirë nga një masë e madhe punësimi në kushte prekariati. Nuk ka asnjë emërtim ligjor apo politikë që të rregullojë marrëdhënien dhe problematikat që lindin në marrëdhënien midis punëtorëve të artit dhe prodhuesve të industrisë. Nuk ka tavane pagesash, oraresh apo kufiri turnesh. Pronësia intelektuale rregullohet shpeshherë pa kontrata të rregullta dhe përcaktime mbi afatet e pagesave. Një pjesë e artistëve dhe prodhuesve aderojnë në bashkësi kolektive të cilat nuk e kanë funksionin emancipues apo kritik ndaj gjendjes së artit e kulturës në Shqipëri, por presin lëmoshën e pakët të qeverisë për të zhvilluar aktivitet. Këto grupime e shoqata gjithashtu nuk i janë nënshtruar ndonjë procesi transparent mbi demokracinë e brendshme dhe zhvendosjeve hierarkike brenda strukturave. Reflektohet politika e favoreve gjithashtu në përfaqësimin ndërkombëtar të artistëve tanë me vepra mbi Shqipërinë ekzotike. Ka raste të dokumentuara ku artistët marrin pjesë pa garë në festivale ndërkombëtare arti, me lidhjet e shkurtra në propagandën e pushtetit abuziv që gëzojmë.

Në vend ka pamjaftueshmëri të ambienteve për ushtrimin dhe shfaqjen e veprave artistike në publik, dhe gjithashtu mungesë investimi në sallat ekzistuese, të cilat janë drejt amortizimit. Mungon një kinematekë publike, me arkiv dhe rrjet sallash. Mungojnë orkestra publike, salla muzikore dhe ambiente regjistrimi. Si pasojë e zbrazjes së territorit, shumica e aktivitetit të përhershëm kulturor është e përqendruar në kryeqytet dhe dy ose tre qytete të tjera të cilat kanë mbajtur gjallë njëfarë jete urbane kulturore. Moshë mesatare në trupat e baletit, teatër dhe kinema është tepër e lartë. Repertorët me vlerë teatrale nuk botohen prej vitesh, si vlerë e trashëgimisë kulturore. Salla e Bibliotekës Kombëtare është e aksesueshme vetëm për lexim në arkivat e mangëta digjitale. Duhet përmendur këtu përmbytja disa herë e ambienteve të Bibliotekës, me dëme të paraportuara në materiale të cilat kanë pasur kopje unike.

II. Alternativa e Lëvizjes BASHKË

Lëvizja BASHKË do të hartojë politika progresive e mbështetëse për sektorin kulturor, për ta rritur incentivën prodhuese të artit dhe kulturës në mënyrë të matshme dhe cilësore, duke kontribuar kështu në emancipimin e marrëdhënieve shoqërore.

Më konkretisht zotohemi për këto politika kulturore:

- Rikthimi i Ministrisë së Kulturës dhe Inovacionit, si institucion me portofol të veçuar.
- Do të çojmë përpara ligjin për Statusin e Artistit, me anë të të cilit artistëve të të gjitha disiplinave u njihen kontributet e punës, vjetërsia dhe do të rregullohet pensionimi për ata

që ndërpresin jetën aktive artistike. Statusi do të rregullojë edhe gjendjen ligjore të profesioneve të lira në fushën e artit dhe kulturës, marrëdhënien midis bashkimeve profesionale të punëtorëve të artit dhe asosacioneve të prodhuesve.

- Është i nevojshëm krijimi i një Fondi Kulturor, institucion në varësi të Ministrisë së Kulturës dhe Inovacionit, që menaxhon fondet publike të cilat janë të parashikuara për prodhimin artistik-kulturor, investimet e teknologjive digjitale dhe fushatave të studim-thellimit dhe ruajtjes së monumenteve të kulturës si dhe të trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale (siç specifikohet në konventën e UNESCO-s). Fondi do të ketë prioritet zhvillimin dhe gjenerimin e planeve financiare dhe gjenerimit të të ardhurave për llogari të Ministrisë së Kulturës, lidhjen dhe bashkëpunimin me aktorë ndërkombëtarë dhe sigurimin e financimit publik ose jo për artistët vendas, aktivitetet kulturore dhe monumentet e kulturës. Fondi siguron dhe shpërndan edhe financime publike për institucionet arsimore të të gjitha niveleve për krijimin e praktikave artistike, këshillimin e karrierës artistike, zhvillimin e trajnimeve mbi praktikat artistike dhe sigurimin e aksesit në festivale, ekspozita dhe evente artistike botërore.
- Do të nxitet krijimi i bashkimeve profesionale të artistëve, punëtorëve të artit dhe prodhuesve, së bashku me nxitjen e të gjithë aktorëve për të marrë pjesë në programe edukuese rreth sigurisë në punë, shëndetit mendor brenda ambientit të punës dhe të drejtave në punë.
- Do të vendoset një fond mbështetjeje për të gjitha subjektet prodhuese dhe institucionet kulturore të cilat

punësojnë me kohë të plotë ose të pjesshme studentë të Universitetit të Arteve dhe artistë të rinj. Krijimi i një programi profesional për trajnimin e punëtorëve të artit.

- Rivitalizimi i trupave të Teatrit Kombëtar, Teatrit të Kukullave, TKOB dhe APKV (Ansambli Popullor të Këngëve dhe Valleve), Cirkut Kombëtar dhe ulja e moshës mesatare aktive. Artistët e këtyre trupave do të përfshihen në rrjetin e punësimit më vonë si mësimdhënës dhe menaxhues programesh artistike në lidhje me artet përkatëse. Trajnimet pedagogjike për artistët do të ofrohen pa pagesë nga institucionet arsimore publike.
- Krijimi i trupave artistike dhe orkestrave studentore për studentët e Universitetit të Arteve, si dhe sigurimi i terrenit të mjaftueshëm për zhvillimin e koncerteve, pjesëmarrje nëpër konkurse dhe festivale.
- Do të krijohet një sistem kombëtar i edukimit muzikor, ku përmes përfshirjes të profesionistëve të niveleve të larta do të ofrojnë mundësi të barabarta për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë shqiptarë.
- **Strategji për promovimin e muzikës në shkolla**

Përfshirja e mësimi të një instrumenti tradicional ose klasik do të jetë pjesë e kurrikulave në çdo shkollë, ku prindërve nuk do t'ju duhet të paguajnë tarifa shtesë të privati. Në këtë mënyrë do të nxisim aftësitë mendore, përqendruese dhe do të zhvillojnë kujtesën që në vogëli dhe fëmijët do të kenë mundësi të fitojnë dije artistike, të kultivojnë gustot dhe të kenë njohuri si teorike dhe praktike mbi një instrument.

- **Ngritja e një baze të dhënash për artistët shqiptarë brenda dhe jashtë vendit**

Hartimi i një baze të dhënash kombëtare për artistët shqiptarë, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, mund të ketë një ndikim të thellë në zhvillimin e sektorit të artit në Shqipëri. Krijimi i një platforme online ku artistë freelance në Shqipëri apo diasporë të vetëregjistrohen dhe të kenë akses në marrjen e informacioneve si dhe dërgimin e materialeve që lidhen me punën dhe karrierën e tyre. Kjo strukturë do të shërbejë kontaktin, njohjen e kontributit në formë të prekshme me mundësi promovimi për të ardhmen dhe do të shërbejë për zhvillimin e jetës artistike e kulturore, si dhe rritjen e standardeve.

- **Fond i posaçëm për artet performative**

Krijimi i një fondi të posaçëm për artistët në disiplinat e arteve performative, si teatrit, teatrit të kukullave, baletit, cirikut, muzikës dhe arteve të ndryshme alternative. Ky fond do të shërbejë për të mbështetur performancat artistike, me qëllim nxitjen e prodhimit të produkteve të denja për të konkurruar skenat botërore. Të vetëdijshëm për vështirësitë infrastrukturore dhe interesit të dobët, sërish nuk do të dorëzohemi për të zhvilluar performanca artistike në të gjithë vendin dhe të shpërndajë vlerat artistike kudo.

- **Ngritja e infrastrukturës artistike në Shqipëri**

Ndërtimi i dy sallave të reja koncertesh në Tiranë dhe rrethe. Specifikisht për orkestrën simfonike të Radio Televizionit Shqiptar si dhe për Orkestrën Filarmonike Shqiptare. Ngritja e infrastrukturës muzikore në Shqipëri është një investim në të ardhmen kulturore të vendit. Ky është një hap i guximshëm dhe i domosdoshëm që kërkon investime serioze. Këto mjedise nuk do të shërbejnë vetëm

për koncerte muzikore, por edhe për teatro dhe do të kenë si parim multifunksionalitetin duke krijuar dhe studio të cilat shërbejnë për ushtrimin individual të artistëve. Këto investime do të ofrojnë një shtëpi të përhershme për artistët, do të përmirësojnë cilësinë e interpretimeve dhe do të kontribuojnë në krijimin e një audience më të gjerë. Ndërtimi i mjediseve modeste me akses publik ku mund të regjistrohet muzika apo dhe të bëhen përpunime të ndryshme me qëllim afrimin e të rinjve drejt arteve dhe nxitjen e krijimit të një produkti artistik të pëlqyeshëm.

- Implementimi i ligjit të veçantë për pronësinë intelektuale artistike dhe pronësisë intelektuale në rrjetin digjital. Kontrolli dhe ngushtimi i diferencës midis vlerës së gjeneruar nga platformat digjitale dhe pagesave të punës intelektuale në këto platforma.
- Të kthehen në administrim publik të gjitha objektet të cilat mbajnë titullin "Monument Kulture" dhe janë të pabanuara, dhe të bëhet i mundur rivitalizimi, restaurimi dhe akses i pagesë për fëmijët, studentët, pensionistët dhe personat që përfitojnë ndihmë ekonomike në të gjitha muzetë dhe objekte të tjera të trashëgimisë kulturore. Të njëjtat të drejta do të gëzohen edhe në salla performative si kinema, teatër, opera dhe balet etj.
- Vendorsja e lehtësive fiskale për hapësirat komerciale të cilat organizojnë evente artistike të tilla si ekspozita, koncerte, promovojnë trashëgiminë kulturore si materiale dhe jomateriale etj. Kategorizimi si hapësirë muzikore e këtyre subjekteve do të subvencionohet në bazë të një raporti vjetor dhe dokumentimi të aktiviteteve të tilla.
- Krijimi i një fondi të letërsisë artistike. Ky fond do të ketë për qëllim nxitjen

e krijimtarisë letrare. Përfituesit e këtij fondi do të përzgjidhen nga një juri profesioniste, me integritet dhe eksperiencë në fushën e letrave.

- Rishikimi i ligjit për kinematografinë dhe reformimi i tij, bashkë me rritje të buxhetit vjetor për prodhimin kinematografik. Shqipëria ka kapacitete dhe talente të cilat presin për mbështetjen e duhur për të prodhuar filma që i flasin shoqërisë e kohës tonë. Me rritjen e buxhetit do të rishikohet roli edhe organizimi i brendshëm i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, për të shkuar me parimin e demokratizimit të institucioneve në varësi publike.
- Krijimi i Kinematekës Kombëtare me një infrastrukturë sallash kinemaje të përhapura në të gjithë vendin dhe arkiv të zgjeruar, të cilës i bashkëngjitet Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit. Rrjeti infrastrukturor do të sigurojë organizimin e festivaleve kombëtare dhe ndërkombëtare të filmit në të gjitha zhanret e tij.
- Do të ndërtohet një rrjet infrastrukturor me objekte publike të ushtrimit dhe ekspozimit të artit kontemporan dhe të gjitha nënndarjeve të tij për punë artistike, salla ekspozitash, rezidenca artistike vjetore e sezonale.
- Do të rivitalizohet Teatri Kombëtar dhe rishikohen kushtet teknike dhe projekti i ndërtimit të godinës së Teatrit Kombëtar. Po ashtu do të krijohen laboratorë të shkrimit të dramës, të cilat do të udhëhiqen prej estetëve dhe dramaturgëve bashkëkohorë, me qëllim nxitjen e krijimit të dramës shqipe dhe risjelljen e saj në vëmendje të skenës shqiptare. Do të sigurohet botimi i dramës shqipe klasike e bashkëkohore në kolanë në mënyrë periodike.
- Do të realizohet digjitalizimi i plotë i materialit të Bibliotekës Kombëtare dhe rifunksionalizimi i këtij institucioni në shkallë kombëtare, me salla publike moderne në të gjitha bashkitë dhe njësitë administrative në vend.
- **Artizanati:** Ky sektor do të marrë trajtim të veçantë prej buxhetit dhe vëmendjes praktike nga Ministria e Kulturës dhe Inovacionit. Do t'u sigurohet artizanëve lënda e parë me çmim të ulët, si dhe do t'u ofrohet mundësia e zhvillimit të aktiviteteve në prona publike pa pagesë. Në këto kushte do të zhvillojnë zëjen e tyre duke qenë në ndërveprim me zejtarët e tjerë, për të krijuar kështu mundësinë e transmetimit të traditës të më të rinjtë, për të zhvilluar laboratorë artizanati për fëmijët, nxënësit, turistët dhe të gjithë të interesuarit. Kësisoj do të krijohet koncepti i një pazari artizanati bashkëkohor, ndërvepërues e i hapur. Do të përfshihet në buxhetin publik dhe do të ofrohen programe të dedikuara për ushtrimin dhe zhvillimin e praktikave artizanale, si dhe do të ndërtohet infrastrukturë për ushtrimin e artizanatit dhe sigurohet tregu i nevojshëm për këtë.
- Do të themelohet institucioni i Komisionerit për punën artistike/kulturore të lirë, që monitoron kushtet e punës dhe sigurimin e kontratave të dinjitetshme për punën *freelance*. Kjo do të përfshihet si pikë e dedikuar pasi industria kreative është një nga sektorët me numrin më të lartë të punëtorisë së lirë.

4.5 MEDIA

Rregullimi i mediave prioritet për garantimin e një shoqërie demokratike

Për Lëvizjen BASHKË, mediat janë institucione të rëndësishme së parë sepse me gjithë problemet që kanë, prodhojnë informacion autentik, kanë numër të lartë të punësimit të gazetarëve, janë të rregulluara me ligj dhe normativa më të buta, kanë detyrime të njohura publikisht. Rëndësia e tyre vjen edhe sepse komunitetet e profesionistëve identifikohen rreth tyre dhe ende ekziston një marrëdhënie e vlerësimit të reputacionit të tyre nga ana e publikut. Po ashtu pavarësisht se kemi një ekosistem të çrregulluar të informacionit, mediat janë sisteme reference të rëndësishme, tregu i informimit mbizotërohet prej tyre, si dhe ato ndërtojnë agjenda afatgjatë, formojnë opinionin publik, ushtrojnë diskrecion editorial dhe mbajnë përgjegjësi për çka shkruajnë e publikojnë.

Lëvizja BASHKË u drejtohet në radhë të parë mediave sepse ato janë ente të regjistruara juridikisht, kanë privilegjin e frekuencave publike dhe kanë përgjegjësi ligjore për të garantuar interesin publik.

Media e lirë dhe e pavarur është veçanërisht e rëndësishme kur kemi më shumë se një ide, por me kushtin që ato të kenë shanse të barabarta që të manifestohen përpara publikut, përndryshe idetë më të ekspozuara janë dhe ato që mund të marrin më tepër legjitimitet të pamerituar.

Demokratizimi i mediave nga ana e pronësisë, vendimmarrjes, transparencës ndaj publikut dhe modeleve ekonomike

konkurrente krijon mundësinë që mediat të jenë shumë më afër interesave të qytetarit dhe të mos sjellin asimetri në informacion, pabarazi, që prodhojnë në vijim marrëdhënie mbivendosëse pushteti dhe manipulimi mes atyre që e kanë këtë informacion dhe qytetarëve të thjeshtë të privuar nga informacioni i plotë dhe cilësor.

Ne besojmë se mediat në thelb janë institucione që prodhojnë informacion, përmbajtje, kulturë, që ushqejnë opinionin publik me ide e qëndrime, krijojnë mundësi për përfaqësimin e interesave lokale e komunitare dhe rentabiliteti i tyre ekonomik është dhe çështje me rëndësi publike. Eksperiencat më të mira evropiane i shohin institucionet e pavarura publike shumë aktive në mbështetjen e mediave me subvencione, me mbrojtje të diversitetit të ideve dhe pavarësisë editoriale brenda dhe jashtë institucionit të mediave, përfaqësimin e lokaliteteve në arenën publike dhe ruajtjen e të gjithë mediumeve pa privilegjuar ato më rishtaret, dhe krijimin e kushteve të tregut për konkurrence të ndershme

Forcimi i mediave e ruan informacionin nga presioni i forcave të jashtme që kërkojnë që punën e gazetarit, kontributin editorial ta kthejë në koka lajmi për gjenerim klikimesh, duke dobësuar rezistencën ndaj forcave ekstraktive të platformave digjitale, të cilat mediat u marrin reklamën, audiencën, informacionin dhe në fund pronësinë intelektuale bashkë me reputacionin.

Ne vlerësojmë se mediat si institucione kompozohen nga interesa të ndryshme e jo rrallë kontradiktore mes pronësisë dhe profesionistëve të fushës e qytetarit. Për të garantuar mirëfunksionimin e tyre, legjislacioni do duhet të ndjekë modelin evropian i cili në të njëjtin korpus ligjor mëton të garantojë transparencën e plotë të pronësisë së medias, pavarësinë editoriale të gazetarit dhe një mjedis

sa më plural e përfaqësues ku gjenden ndjeshmëritë dhe interesat e qytetarëve, pavarësisht përkatësisë.

Pse kapja e mediave?

Në një shoqëri ku ka liri shprehjeje dhe ku mediat janë tërësisht disfunktionale, termi censurë nuk ka asnjë kuptim të përdoret. Kapja e mediave është përcaktimi më i saktë për atë që po ndodh në Shqipëri ku të gjithë flasin e megjithatë e vërteta mbytet.

Kapja e mediave nuk vjen kryesisht dhe vetëm prej pushtetit politik. Kapja e mediave prej oligarkisë ekonomike është shumë më e përhapur dhe shpërhytuese se kapja prej pushtetit. Pushtetarët politikë edhe mund të ndërrojnë për shkak të dinamikave politike, por pronarët e mediave qëndrojnë aty, pavarësisht se cili është në pushtet. Pushtetarët votohen, ndërsa njerëzit e pasur nuk votëbesohen. Ata që nuk kontrollohen dot me votë, kemi arsye më shumë për t'i kontrolluar me ligje të drejta dhe me institucione të pavarura në interes të publikut.

Për Lëvizjen BASHKË të luftosh kundër kapjes së mediave do të thotë, në radhë të parë, të mos lësh që të krijohen kushtet që një e gjë e tillë të ndodhë. Sepse liria e mediave është një fenomen gjithmonë e më kompleks në një mjedis mediatik gjithmonë e më të zgjeruar ndërmedial dhe përtejmedial; sepse mediat mund të kapen edhe nëpërmjet resurseve publike prej shtetit dhe nëpërmjet pronësisë private, por edhe në mjedisin digjital, pasi gjejmë qindra operatorë pa asnjë rentabilitet që çregullojnë tërësisht mjedisin e informimit; sepse kemi raste plot në vende autokratike ku liria formale e medias bashkëjeton pa asnjë problem me ndikimin shumë të fortë politik mbi median dhe nuk ka nevojë që të kryejë censurë të drejt-

përdrejtë; sepse nëse themi që media me informimin që i garanton shoqërisë nuk arrin të rregullojë aktivitetin ekonomik dhe politik të një shoqërie, moskryerja e këtij funksioni thelbësor nga ana e mediave ndodh vetëm kur media është krejtësisht disfunktionale, pra e kapur; sepse media mund të kapet nga aktorë përtej censurës së drejtpërdrejtë të politikës; sepse nuk është e vërtetë që aty ku ka më shumë media, ku të gjithë kanë mundësi të flasin, mjedisi informativ është medoemos dhe më i shëndetshmi. Në mjedisin e informimit në Shqipëri, ka me qindra burime informimi, por kjo nuk ka garantuar cilësi informacioni dhe publik më të informuar, ku nuk ka asnjë hierarki faktesh, organizim agjende, dhe qarkullim të ideve; sepse lindja e aktorëve digjitalë në vende si Shqipëria ka ndodhur pak a shumë në të njëjtën kohë me mediat tradicionale, dhe jo në kontradiktë me modelin e tejkaluar ekonomik, ndaj dhe mjedisi digjital jo medoemos është dhe mjedisi i lirisë si antagonistja e kapjes së mediave.

Sipas studimit të qendrës Open Data Albania, afro 80 për qind e mediave televizive shqiptare të konsoliduara janë prona të pesë familjeve, bashkëpronësi midis familjarëve dhe një grupi prej 27 individëve zotërues të mediave televizive kryesore, 84% e kapitalit mediatik zotërohet nga individë, konkretisht rreth 3.5 miliardë lekë, ndërsa subjektet juridike zotërojnë 670 milion lekë, rreth 16% e totalit, shumica e tyre janë familjarë të afërt dhe pasardhës me të njëjtin mbiemër.

Në vitin 2016, Gjykata Kushtetuese vendosi të shfuqizojë pikën 3 të nenit 62 në Ligjin për Mediat Audiovizive 97/2013. Ky nen ndalonte çdo person fizik ose juridik që të kishte më shumë se 40% të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë aksionare, që zotëron një licencë kombëtare për transmetimet

audio apo audiovizive. Tanimë, sipas ligjit shqiptar, një individ apo familje mund të ketë 100% të pronësisë dhe kapitalit pa asnjë limit.

Sipas të dhënave të INSTAT-it, televizionet gjenerojnë 72% të të ardhurave të aktivitetit të publikimeve dhe prodhimeve të programeve. Të gjithë sektorët e tjerë si internet apo rrjetet sociale duket se janë infrastruktura ndihmëse, zgjatuese të një industrie që bërthamën e ka te mediat tradicionale.

Sipas të dhënave nga Idra Media, katër pronarët kryesorë të mediave në Shqipëri zotërojnë diku te 86% të audiencës. Sipas të dhënave të Autoritetit të Mediave, vetëm televizione analoge janë 45. Nëse tregu është kaq i përqendruar në pak aktorë, në pak televizione, në pak individë dhe me dominim të 4/5 televizioneve, me përqendrim të plotë të tregut të reklamës dhe volumit tregtar vetëm në pak televizione, pyetja që shtrohet është: Pse duhen kaq shumë operatorë. Me se mbijetojnë? Arrijnë të informojnë, të prodhojnë përmbajtje, të shpërndajnë kulturë apo t'u japin zë lokaliteteve?

Sipas të dhënave të Unionit të Mediave, në Shqipëri numërohen më së paku 753 portale. Vlerësohet se ka rreth 900 media digjitale vendase në internet në Shqipëri, shpesh të referuara në vend si portale lajmesh. Po sipas Unionit të Gazetarëve, në këto media online punojnë mbi 1700 persona. Megjithatë, shumica e mediave online, me pak përjashtime, nuk kanë burime financiare, kanë redaksi të vogla dhe struktura të dobëta editoriale me një ose dy gazetarë. Kur dihet se mbi 70% e tregut është e përqendruar te televizionet dhe fuqia e reklamës sa vjen e dobësohet, me cila burime financiare mbijetojnë kjo mori mediash digjitale, cili është qëllimi dhe funksioni i tyre?

Për të kuptuar raportin mes parasë dhe mediave, do të shohim që në formë progresive nuk është paraja e gjeneruar nga aktiviteti mediatik që është shtrirë për të hapur terrene të reja të investimit në sektorin e medias apo komunikimit, por pronarët e medias me anë të ndikimit të tyre dhe aksesit në burime shtetërore, koncesione janë shtrirë në biznese të tjera të cilat garantojnë dhe mbijetesën e medias. Qëndrueshmëria financiare varet gjithmonë e më shumë nga sektorë përtej medias, të cilët e kapin median dhe e kthejnë në një zgjatim të interesave përtej saj.

Sipas Open Data Albania, 27 aksionerë dhe zotërues të bizneseve televizive janë ndërkohë aksionerë në 11 deri në 39 biznese të tjerë, në shumë raste të lidhura me fondet publike dhe me qeverinë. "Në total, nga 10 biznese mediatike janë përfituar 10 kontrata apo marrëveshje PPP/koncesione, është fituar një status investitori strategjik, si dhe 3 vendime të Këshillit të Ministrave janë enkas si pjesë e programit Shqipëria 1 Euro. Fitimet që këto biznese nxjerrin nga ky sektori mediatik, nga prodhimi mediatik apo nga audienca përmes mënyrave të ndryshme, janë fare pak krahasuar me fitimin apo me kapitalin, me performancën ekonomike që këta individë kanë në bizneset e tjera.

Sipas studimit të BIRN dhe Regjistrat Global të Medias të vitit 2023, të gjitha grupet mediatike, më saktë 98,34% e medias audiovizive në Shqipëri, kanë biznese të tjera, të cilat marrin para nga qeveria nëpërmjet kontratave, koncesioneve, ose kanë lidhje me grupime politike shqiptare. Ndërsa disa media të njohura marrin subvencione për prodhim programesh televizive dhe koncesione në fusha të tjera të rregulluara nga shteti. Subvencionet dhe kontratat qeveritare nuk kufizohen vetëm në media, por shtrihen edhe në bizneset jomediatike të pronarëve, duke ndërthurur më tej

interesat ekonomike me vendimet editoriale

Sipas BIRN që ka studiuar nivelin e pluralizmit në media, shumica e këtyre pronarëve me ndikim kanë interesa të lidhura në fusha biznesi të rregulluara mirë, si ndërtimi, prokurimet publike, lojërat e fatit, arsimi i lartë fitimprurës dhe bankat.

Në pamje të parë, tregu i mbingarkuar i medias në Shqipëri duket i larmishëm dhe pluralist, por nëse depërtohet dhe interpretohen më thellë të dhënat konstatohet lehtë se tregu i medias nga pikëpamja e strukturës së tregut dhe formave të pronësisë është tërësisht i deformuar dhe i kapur. Mjafton të shihet se sa është niveli i reklamës, hapësira e transmetimit të përmblytur me debate politike, e gjithë prodhimtaria e përquarduar në pak duar dhe gjithmonë drejt sheshimit të shpenzimeve me kahe nga ulja e tyre. Ndaj ne nuk mund të gjykojmë mbi atë që shohim në media nëse ka liri shprehjeje apo jo, por nëse ka diversitet, ka forma alternative distribucione, ka forma të pavarura të financimit, ka njësi alternative të prodhimit dhe mbi të gjitha në kokë nuk ka përqendrim të lartë të pronësisë dhe ka forma alternative të krijimit të vlerës financiare në të gjitha kanalet e mundshme në formë të integruar.

Efekt i kapjes së mediave janë edhe kushtet e punës së punonjësve të medias, në radhë të parë të gazetarëve. Shumë gazetarë janë nën presionin e punëdhënësve të tyre për të mos e kërkuar dhe publikuar të vërtetën e plotë. Po ashtu, një pjesë e gazetarëve shfrytëzohen si punëtorë të cilëve nuk u paguhen sigurimet shoqërore ose marrin ende një pjesë të pagës në të zezë, duke mos gëzuar të drejtat që Kodi i Punës ua njeh të gjithë punonjësve.

Lëvizja BASHKË zotohet që nëpërmjet ndërhyrjeve legislative dhe forcimit

të institucioneve të pavarura të luftojë kontrollin e oligarkisë ekonomike dhe pushtetit politik mbi mediat, të fuqizojë punën dhe organizatat profesionale të gazetarëve, t'i pavarësojë mediat nga çdo kushtëzim që shkon përtej etikës së gazetarit, kërimit të së vërtetës dhe interesit publik.

Ligj i ri që garanton lirinë e medias në një mjedis inter-medial

Liria e medias është e lidhur pazgjidhshmërisht me sistemin ekonomik dhe politik të një shteti. Ndaj është edhe detyrë e institucioneve publike që të garantojnë pluralizmin dhe pavarësinë e tyre, të ushqejnë me gjithë burimet e mundshme gazetarinë cilësore, por dhe të përgjigjen për çdo kërcënim që shfaqet nga platformat e reja dhe komunikimi digjital kur ato e cenojnë këtë liri.

Liria e medias në kuptimin politik nuk ka lidhje thjesht me mediat, por me gjithë mjedisin që garanton që në sferën publike publiku të ketë mundësi në çdo moment të aksesojë informacion cilësor dhe të besueshëm. Në kuptimin e garantimit të interesit publik dhe respektimit të të drejtave të njeriut, roli i institucioneve publike është jetik.

Lëvizja BASHKË e sheh me prioritet lirinë e medias, duke marrë në konsideratë të gjithë kompleksitetin e saj, por më vëmendje të veçantë ato komponentë që e bëjnë prodhimin dhe qarkullimin e lirë të informacionit cilësor nga brenda dhe përtej mediave.

Korpusi juridik që i përgjigjet më mirë këtyre nevojave në plan lokal, por dhe përtejlokal është "European Media Freedom Act" (EMFA), që bashkë me korpuset si tjera si DSA dhe DMA më shumë se

vënë nën fre mediat apo platformat, nuk i lënë ato të veprojnë si sfera të shkëputura nga interesi i gjerë shoqëror. European Media Freedom Act jep mundësinë që dhe shtete të vogla si Shqipëria pa kapacitete për të bërë betejë industriale me platforma globale, mund të forcojë mjedisin mediatik si kundërpesha ndaj çdo forme të ushtrimit të lirisë së shprehjes përtej interesit publik, duke i ngritur politikat mbi mediat në nivel institucional, duke e prekur tregun në nivel strukturor dhe në ekonomiksën e logjikës së ndërtimit të përmbajtjeve, duke i dhënë akses cilësor medias ndaj publikut por dhe publikut të mediat dhe duke garantuar shumësinë e zërave si një prej standardeve më të rëndësishme të lirisë së shprehjes.

Për të arritur këto objektiva ky korpus normativ ka parashikuar garanci normative dhe penalitete për: të mbrojtur mediat dhe lirinë e fjalës nga ndërhyrjet në vendimet editoriale, fuqizimin financiar dhe të lirisë së medias publike, disiplinimin e reklamës dhe financimeve qeveritare në tregun e medias, transparencën e plotë të pronësisë mbi mediat, mbrojtjen e tregut nga monopolet dhe marrëveshjet tregtare përqendruese, shpërndarjen e burimeve sipas peshës reale të audiencës në një sistem transparent dhe mbështetje e posaçme për mediat me karakter të veçantë, si edhe shtrirjen e normativës rregulluese dhe në hapësirës online.

Për të arritur këtë fleksibilitet ndërmedial, mediat nuk quhen më thjesht “media” në kuptimin tradicional, por “shërbime mediatike”, pikërisht për ta zgjeruar interesin ndaj përmbajtjeve mediatike kudo ku ato gjenden, qoftë si programe, apo publikime me vulë editoriale, por edhe për të zgjeruar fushën e veprimit të politikave rregullatore në të gjithë mjediset ku operojnë këto shërbime mediatike, dhe në platformat online, po ashtu në larminë e statuseve të reja profesionale që pasurojnë këtë hapësirë.

Lëvizja BASHKË mbështet frymën rregullatore dhe jo ndërhyrjet ekzekutive me pasojë prishjen e ekuilibrave në tregun e mediave dhe në sferën publike. Për ta bërë të mundur këtë kërkohet një korpus i ri ligjor sepse ligji ekzistues nuk rregullon asnjë nga parametrat e lartpërmendur.

Më konkretisht ne angazhohemi që me anë të një korpusi të ri ligjor të konsultuar më gjithë aktorët në tregun e mediave dhe në hapësirën civile:

Transparenca e pronësisë mbi median;

të ndërtojmë bazën normative që pronësia mbi mediat të jetë krejtësisht transparente, të identifikohet përfituesi final në mënyrë që për çdo operacion tregtar të shmangen konfliktet e mundshme të interesit;

të hartojmë bazën ligjore që pronësia e medias mos të përqendrohet në masën 100% në duart e një familjeje, por pronësia të diversifikohet të aktorë të tjerë dhe format e pronësisë apo qarkullimit të kapitalit të pasurohen. Bilancet e mediave duhen ndarë qartë nga bilancet e bizneseve të tjera, zërat e investimeve dhe të prodhimit të jenë të dallueshme nga pagat dhe format e tjera të përfitimit, raportimi i bilanceve të jetë sa më i detajuar në mënyrë që të shmangen falimente të mundshme në tregun e mediave që kanë pasoja jo të vogla. Megjithatë ekziston një vendim i Gjykatës Kushtetuese që ka hequr kufizimet e pronësisë, ne besojmë se një korpus i ri ligjor i ndërtuar me argumente dhe fakte për kontekstin problematik të operimit të mediave në Shqipëri, do ta përafrojë legjislacionin shqiptar me vendet e BE që e kanë në fuqi një normativë të tillë.

Një hap juridik i rëndësishëm që do të vinte para përgjegjësisë publike tendencat përqendruese, përvetësuese dhe kapëse në tregun e medias, është ngritja

e një databaze kombëtare shoqëruar nga një normativë e detyrueshme nën përgjegjësinë e Autoritetit Rregullator për transparencën e plotë të pronësisë mbi mediat: jo vetëm emrat e pronarëve, po edhe cili është përfituesi i fundmë, ku janë të shtrira kapitalet e tij në media apo jashtë medias, cilat janë të ardhurat që merr nga shteti për aktivitetin mediatik, për të shmangur çdo synim për kapjen e mediave dhe konflikte të mundshme interesi të fshehura.

Përtej detyrimeve ligjore për deklarimin e pronarëve fundorë, përfitues në tregun mediave, me ligjin e ri të mediave Lëvizja BASHKË synon edhe të identifikojë praktikën falimentare në treg, të cilat pasurojnë një ose dy operatorë dhe dëmtojnë tregun në tërësi. Praktika falimentare nuk do të konsiderohen vetëm ato të bilanceve, por dhe ato praktika që deformojnë strukturën e tregut, ndalojnë hyrjen e aktorëve të rinj, nuk lejojnë diversifikimin e aktorëve, blindojnë pozitën e më të fortëve në kurriz të më të dobhtëve në treg, shkatërrojnë kushtet e konkurrencës, pra dobësojnë rolin e mediave në ndërtimin e opinionit publik.

Diversifikimi i tregut të medias

Lëvizja BASHKË konsideron se përtej ligjit tregtar, edhe ligji i ri i medias duhet të përfshijë normativë që nuk lejon kushtet e privilegjuara në treg, përqendrimin e tregut në pak duar, nuk lejon kompani me pronësi ngushtësisht familjare që të ketë në pronësi më shumë se një media, analoge ose digjitale, nuk lejon që para nga biznese të tjera familjare të kanalizohen në media, që operacione tregtare mbi një vlerë të caktuar të qëmtohen paraprakisht. Garantuesi për respektimin e kësaj normative është Autoriteti i Mediave me një strukturë më demokratike dhe të pasuruar me burime njerëzore.

Nëpërmjet ligjit të medias, Lëvizja BASHKË angazhohet që të krijojë kushtet për diversifikimin e tregut me aktorë të rishtarë, të krijojë mundësi për forma pronësie alternative si Trustet apo Fondazione, të krijojë mundësinë lindjes së operatorëve të rinj digjitalë me audienca të shënjestruara, që kanë vullnetin të kërkojnë modele alternative biznesi si p.sh. me anë të nënshkrimeve, apo kontributeve të drejtpërdrejta të qytetarëve. Angazhohemi po ashtu të lehtësojmë oportunitetet për mediat lokale që mbulojnë zona gjeografike të larmishme si alternativë e modelit gjeneralist, si edhe merret angazhim që për mediat më në vështirësi, ato në krizë për shkak të ndryshimeve të fuqishme si media e shkruar, shteti, në bazë kriteresh të konsultuara dhe transparente, t'i ndihmojë me mbështetje financiare me qëllim për garantimin e lirisë dhe pluralizmit të zërave në tregun e mediave në Shqipëri.

Shpërndarja e fondeve publike

Prezenca e shtetit dhe alokimi i fondeve publike në formë mbështetjeje apo kontraktuale kërkon një rregullim dhe monitorim të rreptë për të moslejuar që shteti apo segmente të shtetit të ushtrojnë ndikim të paligjshëm mbi mediat dhe lirinë e tyre. Lëvizja BASHKË e sheh shtetin si aktor aktiv në mbështetje të aktorëve më vulnerabël në treg, si mediat lokale, shtypi i shkruar, media të vogla të pavarura, operatorë OTT, por kjo duhet bërë në një formë krejtësisht transparente duke ngritur një strukturë të pavarur për implementimin dhe monitorimin e procesit. Do të trajtohen me prioritet ato media që janë kritike, që janë më të ekspozuara ndaj praktikave falimentare të strukturës së tregut. Shteti nuk mund të shpërndajë para për reklamë pa iu referuar peshës

së tregut të aktorë të certifikuar nga një sistem i besueshëm i matjes së audiencës dhe prioriteteve që vendos për garantimin e lirisë dhe pluralizmit në treg. Mbështetja financiare duhet bërë e konsultuar, e planifikuar, me aplikime dhe parametra të matjes së performancës për rezultatet e arritura.

Sistemi i unifikuar i matjes së audiencës

Lëvizja BASHKË sheh si të domosdoshme instalimin e një sistemi kombëtar të matjes së audiencës i ofruar nga një kompani serioze ndërkombëtare e gjithëpranuar nga aktorët në treg. Ky sistem për princip do të ndiqet sipas parimit të vetërregullimit nga aktorët në treg, por me disa detyrime ligjore të sanksionuara në ligjin për shërbimet mediatike që kanë të bëjnë me aksesin publik tek të dhënat, me aksesin e mediave për të marrë të dhëna sipas dëshirës dhe pa pagesë, të garantuara nga Autoriteti Rregullator. Autoriteti Rregullator angazhohet po ashtu që të vërë në kushte dialogu të gjithë aktorët në treg për të menaxhuar në formë sa më përfshirëse. Tregu nuk mund të funksionojë me praktika tregtare të jotransparente, abuzive dhe që nuk reflektojnë peshën reale të aktorëve në treg. Të dhënat e audiencës, përtej interesit tregtar, Lëvizja BASHKË i konsideron të një rëndësie të veçantë për të ditur shijet e audiencës, prirjet kulturore, receptivitetin ndaj ofertës në treg, si edhe peshën reale të operatorit publik ndaj aktorëve të tjerë në treg. Pa shkelur mbi sekretin tregtar të operatorit, të dhënat e audiencës konsiderohen si pasuri intelektuale dhe një e mirë ekonomike që duhet të përfshijë dhe aktorët e platformave online për të prodhuar në fund një sistem të integruar dhe të krahasueshëm.

Kushtet në punë dhe pavarësia editoriale e gazetarëve

Lëvizja BASHKË njeh degradimin dhe përkeqësimin e pandalshëm e kushteve të punës në pagesa, lirinë editoriale, organizim dhe respektimin e të drejtave për të gjithë profesionistët apo aktorët *freelance* për shkak të paqëndrueshmërisë së lartë në tregun e shërbimeve mediatike, sidomos të mediat tradicionale.

Lëvizja BASHKË mbështet fuqishëm vetërregullimin me anë të rregullave dhe strukturave të brendshme dhe vetorganizimin e profesionistëve të medias pa dallim në sindikata, këshilla mediash, shoqata gazetarësh, organizata biznesi, të njohura si të drejta themelore, dhe angazhimin e tyre në nivele të larta të vendimmarrjes me përfaqësues apo ura komunikimi institucionale në bordet menaxheriale si dhe lirinë për të zgjedhur stafet menaxheriale apo drejtuesit editorialë, apo aftësisë për të frenuar transaksione tregtare pa konsensusin e tyre në dëm të lirisë editoriale.

Lëvizja BASHKË mbështet me forcë të gjithë të drejtat në punë që u garanton ligji punonjësve në tregun e shërbimeve mediatike dhe atyre *freelance*. Në rast se gjejnë mjedisin e përshtatshëm për të ushtruar profesionin e tyre dhe kanë mospajtim me pronësinë e medias për vlerat editoriale, të ushtrojnë të drejtën të dorëhiqen pa asnjë pasojë dhe t'i transferojnë këto të drejta pa asnjë pasojë në një vend të ri pune. Në cilindo rast ne konsiderojmë që legjislacioni shqiptar duhet të parashikojë masa të rëndësishme për mbrojtjen sociale të gazetarëve për sigurinë e tyre fizike dhe ekonomike, për t'u garantuar qetësinë e nevojshme në ushtrimin e profesionit të tyre.

Lëvizja BASHKË angazhohet që të ndërtojë instrumentet ligjore dhe mekanizmat mbrojtës për çlirimin e gazetarëve nga çdo formë presioni e drejtpërdrejtë apo e tërthorë, të kenë mbrojtjen e mjaftueshme ligjore ndaj çështjeve të stisura gjyqësore (SLAPP), të kenë mundësinë të ruajnë konfidencialitetin e burimeve të informacionit pa asnjë shtrëngim, si edhe të kenë mekanizmat mbrojtës ndaj sulmeve të karakterit kibernetik që cenojnë integritetin dhe konfidencialitetin e punës, si edhe qetësinë psikologjike nga anatemitet e të gjithë formave duke përfshirë dhe platformat online në kornizën e politikave rregullatore.

Lëvizja BASHKË angazhohet me prioritet që, përveç legjislacionit që garanton të Drejtën e Informimit, të shtojë instrumentet e munguara ligjorë e proceduralë në përfundimin e informacionit me dhe në interes të publikut në kohën e përshtatshme nëpërmjet gjithë kanaleve të komunikimit, të aksesueshëm lehtësisht në çdo kohë.

Marrëdhënia me platformat

Lëvizja BASHKË niset prej parimit që problematikën, kërcënimet ndaj lirisë së medias dhe mundësisë së prodhimit dhe qarkullimit të lirë të informimit dhe informacionit nuk kanë kufizime fizike, gjeografike, por mbi të gjitha teknologjike se ku ato manifestohen. Ndaj kërkesat dhe rregullat që vlejné për rregullimin e hapësirës së informimit në tregun e mediave, në dimensionet kryesore janë të vlefshme edhe në platformat online të qarkullimit të videove, por sidomos te platformat e mëdha që sistemin evropian të rregullimit njihen me akronimin e VLOP (Very Large Online Platforms), të cilat dhe në Shqipëri si kudo tjetër kanë gllabëruar audiencë, reklamë dhe të mira financiare pa pasur asnjë rregullim në

aktivitetin e tyre. Është emergjente që përtej legjislacionit shqiptar të ndërtohen raporte institucionale me anë të Autoritetit Rregullator Lokal, i cili monitorin dhe zbatimin e legjislacionit dhe normativës rregulluese për tregun e mediave dhe në mjedisin online.

Duke e njohur realitetin industrial dhe fuqinë novatore të këtyre platformave, ato nuk mund të operojné sikur nuk ekzistojné në Shqipëri duke krijuar disbalanca të fuqishme në tregun e medias për shkak të pabarazisë së trajtimit të aktorëve para ligjit. Pavarësisht se ato nuk janë të licensuara në kornizën juridike të Republikës së Shqipërisë, normativa që rregullon prodhimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve, sidomos me karakter informativ, duhet të jetë njëlojtë e aplikueshme edhe për to. Hapi i parë është regjistrimi i operatorëve mediatikë më kredencialet e tyre në këto platforma, ngritja e një infrastrukture komunikimi zyrtar dhe përcaktimi i qartë i rregullave se si këto platforma mund të sillen me përmbajtjen që vjen nga mediat.

Asnjë përmbajtje e mediave nuk mund të hiqet pa një deklaratë të justifikuar për arsyet e konsiderimit si të papërshtatshme me termat rregullatorë të platformave dhe duke u dhënë mediave mundësinë e ankimit përpara se masa të ekzekutohet. Ne besojmë se kjo do të garantojë lirinë e mediave, e cila mund të cenohet nga këto platforma që për konsideratën tonë në disa drejtime ato ushtrojnë editorin njëlojtë si mediat. Ato nuk mund të përjashtohen nga rregullimi pavarësisht specifikës. Përtej rasteve konkrete, ne besojmë se ky është një proces shumë më i ndërlikuar, që kërkon një dialog dhe marrëdhënie të përhershme mes Autoritetit Rregullator dhe platformave me qëllimin që interesat e mediave të jenë të përfaqësuara, ku të shihen në formë konsultative praktikën e moderimit të përmbajtjeve të këtyre

platformave, si edhe diversiteti i zërave të jetë i mbrojtur e i garantuar dhe në këto hapësira, ku mund të zbatohet dhe parimet e vetërregullimit me të tretë, sidomos kur vjen fjala të përdoruesit e thjeshtë që janë të ekspozuar ndaj censurës dhe mekanizmave më të fshehtë algoritmikë që janë të përafrueshëm me aktivitet editorial.

Reforma e operatorit publik

Lëvizja BASHKË e konsideron urgjente një reformë të thellë në administrimi e tregut të mediave, tregut në tërësi dhe medias publike. Duke ndjekur kahun e reformave në Evropë me korpusin EMFA, Lëvizja BASHKË ka për objektiv që media publike të shkëputet krejtësisht nga Kuvendi, Bordi i saj Menaxhimit të kompozohet dhe zgjidhet prej një Këshilli të Posaçëm që miraton me shumicë të cilësuar anëtarët dhe drejtorin dhe paralelisht në përputhje me normativën evropiane propozojnë ngritjen e një Instituti për Median Publike që monitoron rreptësisht performancën programore dhe financiare të medias publike, ndërkohë që ky institut të mund të propozojë dhe ndryshime në modelet e menaxhimit. Media publike do të konsiderohet jo vetëm një kanal apo kanale mediatike, por dhe një gjenerator i financimit të prodhimit të përmbajtjes dhe gazetarisë me interes publik duke krijuar mundësi financimi dhe për projekte e propozime nga jashtë. Përbërja e stafeve drejtuese dhe menaxheriale duhet plotësuar me kandidatura me karrierë të dallueshme në tregun e medias dhe me integritet të padiskutueshëm. Këto institucione të reja themelohen me Ligjin e Medias në Kuvendin e Shqipërisë dhe e shkëpusin përfundimisht median publike nga absurdi i kontrollit politik nga dypartitizmi. Kjo reformë do të krijojë mundësi të reja, por edhe vështirësi për të legjitimuar modelin aktual të financimit, ku ne

propozojmë dhe forma financimi me taksë të posaçme për produkte që lidhen me teknologjinë e medias, me synimin për ta zbutur barrën financiare arbitrare ndaj xhepit të qytetarëve të cilën nuk marrin mbrapsht investimin që bëjnë në median publike.

Edhe Autoriteti Rregullator i Mediave ka vend të reformohet thellësisht. Në pamundësi për të shkëputur nga Kuvendi për shkak të funksionit dhe misionit të tij, konsiderojmë se modeli dypartiak i tanishëm është krejtësisht i papërshtatshëm dhe kundër interesit publik. Ndaj propozojmë që përbërja e aktorëve të përfshirë në vendimmarrjen dhe drejtimin e institucionit të pasurohet, ku shoqëria civile dhe universiteti apo komuniteti i aktorëve në treg të jenë pjesë e një kompozimi më të gjerë në numër, por më përfaqësues. Duke ruajtur balancat e prezencës dhe me një sistem votimi të cilësuar, është e mundur që vendimmarrjet të jenë më demokratike e më përfshirëse. Autoriteti Rregullator mund të bëhet një institucion krejtësisht i transformuar, i zgjeruar në staf dhe në detyrat e reja të shtuara të sanksionuara në ligjin për median, ku gjithmonë e më shumë do të jetë hallka e ndërmjetme mes shtetit dhe aktorëve në treg, qofshin vendas apo të huaj.

4.6 PJESËMARRJA DHE SIGURIA DIGJITALE

Në një kohë kur teknologjitë zhvillohen me ritme të shpejta dhe çdo aspekt i jetës së përditshme po digjitalizohet, mbrojtja e të drejtave digjitale dhe sigurimi i aksesit të barabartë në teknologji është themelor për çdo agjendë politike progresive. Shqipëria si pjesë e këtij procesi prej disa vitesh ka përqafuar parimet e qeverisjes digjitale, duke ofruar një numër të madh shërbimesh publike në formë elektronike, si dhe duke shtuar ndjeshëm infrastrukturën digjitale që mbështet këto shërbime dhe gjithë mbarëvajtjen e punëve administrative. Ky proces ka ardhur me problematikat e veta, si përjashtim i qytetarëve nga aksesit në shërbime publike, cenim i privatësisë dhe përqendrimi i kontratave për krijimin e dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së nevojshme në pak kompani të mëdha, vendase apo të huaja, që përveç kostos së lartë, shpeshherë janë shoqëruar edhe me aspekte korruptive. Lëvizja BASHKË është e zotuar ndaj një vizioni të një shoqërie më të drejtë, ku infrastruktura digjitale i shërben të mirës publike, ndihmon në tejkalimin e ndasive digjitale dhe mbron qytetarët nga përgjimi dhe shfrytëzimi i të dhënave të tyre personale. Vetëm kështu mund të krijojmë një të ardhme ku teknologjia është një mjet për demokratizimin e shoqërisë, krijimin e mundësive ekonomike dhe fuqizimin e të përbashkëtës.

Para publike, kod publik

Nisma “Para publike, kod publik” promovon përdorimin e softuerëve me kod burim të hapur për çdo projekt të financiar nga para publike. Fushata është

iniciuar disa vite më parë nga Free Software Foundation Europe, organizatë me bazë në Berlini dhe Brukseli, dhe synon të rrisë transparencën, të reduktojë kostot dhe të forcojë sovranitetin digjital për institucionet qeveritare në Evropë.

Softueri i lirë dhe i hapur (Open Source Software, në vazhdim OSS) u lejon institucioneve publike dhe qytetarëve të përdorin, studiojnë, modifikojnë dhe rishpërndajnë programet kompjuterike, ndryshe nga softueri me kod të mbyllur. Për fat të keq, në Shqipëri softueri nuk trajtohet si një pasuri dhe infrastrukturë publike dhe ligjet aktuale nuk i detyrojnë institucionet të përdorin softuer të lirë e të hapur. Kjo ka krijuar një situatë ku pothuajse e gjithë infrastruktura digjitale e qeverisë dhe institucioneve publike përdor softuer të mbyllur, duke shtuar kostot dhe kufizuar transparencën.

Lëvizja BASHKË gjykon se parimet e nismës “Para publike, kod publik” ofrojnë qasjen e duhur për vazhdimin e transformimit digjital në Shqipëri, duke siguruar që ky transformim të sjellë drejtësi shoqërore, transparencë dhe efikasitet.

Ne rekomandojmë marrjen e këtyre masave:

1. Përshtatja për administratën publike

- *Krijimi i një katalogu kombëtar me programe të hapura të certifikuara nga AKSHI (Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit) apo një institucion i ngjashëm: Një katalog që përfshin softuerë të testuar dhe të certifikuar për përdorim të sigurt dhe efikas në administratën publike. Shembuj të programeve:*
 - *Linux:* Për sistemet operative të siguruar dhe me fleksibilitet të lartë.
 - *LibreOffice:* Një alternativë e hapur për redaktimin e dokumenteve dhe prezantimeve.

- QGIS: Një softuer gjeohapësinor për analiza dhe hartografi në projekte publike.
- Thunderbird: Për menaxhimin e e-mail-eve dhe kontakteve në administratë.
- Zammad: Një softuer për menaxhimin e kërkesave dhe ndihmës teknike.
- Nextcloud: Një softuer për menaxhimin e të dhënave.
- Instalimi dhe mirëmbajtja e mjeteve OSS: Çdo institucion të pajiset me programe OSS për funksione bazë si përpunimi i dokumenteve, menaxhimi i e-mail-eve dhe aksesimi i të dhënave.
- Kurse teknike për administratën publike: Ofrimi i moduleve trajnimi nga ASPA (Shkolla Shqiptare e Administratës Publike) për përdorimin e Linux, LibreOffice, dhe mjeteve të tjera OSS.
- Certifikimi i stafit të administratës dhe nxitja për përdorimin e OSS: Të zhvillohet një sistem certifikimi nga ASPA për aftësitë në përdorimin dhe menaxhimin e teknologjive OSS. Të ketë një sistem bonusesh për angazhimin në kështoj trajnimesh.
- Hartimi i udhëzimeve të reja nga ministritë: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me AK-SHI-n, të krijojnë udhëzime për promovimin dhe adaptimin e programeve OSS në prokurimet publike. Shembull: Prioritizimi i softuerëve si LibreOffice dhe Nextcloud për zëvendësimin e mjeteve të tjera.
- Përafrimi i strategjive kombëtare me strategjinë e BE për OSS:
 - Strategjia për Digjitalizimin: Të përfshihet OSS si një prioritet për zhvillimin digjital të institucioneve publike.
 - Strategjia për Sigurinë Kibernetike: OSS të konsiderohet si një zgjidhje më e sigurt për menaxhimin e sistemeve dhe të dhënave.
- Krijimi i një strategjie të re për digjitalizimin vetëmenaxhues: Strategjia duhet të fokusohet në përdorimin e OSS për të arritur sovranitet digjital dhe ulje të varësisë nga kompanitë e mëdha teknologjike.

3. Politikave të Edukimit Drejt Programeve me Kodburim të Hapur

2. Prokurimi publik të përfshijë programe me kodburim të hapur

- Rishikimi i ligjit të prokurimit publik: Të përfshihet një seksion i veçantë që kërkon përfshirjen e softuerëve OSS në analizën e tregut gjatë prokurimeve publike. Kjo hyn në kontekstin më të gjerë të ripërdorueshmërisë së programeve digjitale - e jetësuar nga shtete si Franca, Gjermania, Italia e Spanja prej më shumë se 8 vitesh.
- Përfshirja e OSS në programet mësimore:
 - Në shkollë 9-vjeçare dhe të mesme: Futja e lëndëve që mësojnë bazat e përdorimit të Linux, LibreOffice dhe QGIS.
 - Në universitete: Ofrohen kurse të posaçme për OSS dhe zhvillimin e projekteve në Python, PostgreSQL, dhe QGIS.
- Laboratorë të pajisur me OSS: Të sigurohen laboratorë shkollorë dhe universitarë të pajisur me sisteme Linux dhe mjete OSS për programim dhe analiza.

- Trajnime për mësuesit: Edukimi i mësuesve për të përdorur dhe mësuar OSS në klasë.
- Fushata për ndërgjegjësimin e studentëve dhe nxënësve: Të organizohen aktivitete si hackathone dhe gara për zhvillimin e zgjidhjeve OSS për sfida reale.

4. Përfshirja e parimit “para publike, kod publik” në projekte mbi digjitalizimin

- Integrimi i parimit në projekte me investim nga fondet publike: Çdo projekt i financuar nga buxheti i shtetit të kërkojë përdorimin e softuerëve OSS kur është e mundur. Shembuj projektesh të mundshme:
 - Programe për të rinjtë dhe të sapodiplomuarit: Zhvillimi i aftësive teknike në OSS përmes trajnimeve dhe praktikave të mbështetura nga shteti.
 - Startup-e dhe SME: Mbështetje financiare dhe teknike për bizneset e vogla që përdorin OSS për inovacion.
- Përfshirja në përshkrimet e projekteve: Çdo përshkrim projekti të përfshijë si kriter bazë promovimin e OSS dhe të dhënave të hapura.
- Ndjekja e rezultateve: Krijimi i një raporti vjetor mbi efektet dhe rezultatet e përdorimit të OSS në projekte publike.

Aksesueshmëria e ndërfaqeve të shërbimeve publike

Rritja e numrit të shërbimeve publike që ofrohen përmes platformave digjitale si E-Albania ka krijuar situata ku qytetarët

janë privuar nga këto shërbime për shkaqe si:

- pamundësia e aksesimit të shërbimeve prej mungesës së infrastrukturës dhe pajisjeve në zonat e thella;
- vështirësi në aksesimin e shërbimeve prej mungesës së njohurive teknologjike;
- ndërfaqe që nuk përmbushin standardet e aksesueshmërisë, duke u pamundësuar personave me aftësi ndryshe qasjen e thjeshtuar ndaj shërbimeve të ofruara;

Për të tejkaluar këtë hendek propozojmë:

- rihapjen e sporteleve fizike në vendndodhje të volitshme që mbulojnë gjithë territorin e vendit, ku qytetarët mund të drejtohen për të marrë shërbime;
- implementimin e standardeve të aksesueshmërisë për ndërfaqet digjitale për çdo website qeveritar apo aplikacion ku ofrohen shërbime publike, në mënyrë që të garantohet pjesëmarrja efikase dhe e barabartë e personave me aftësi të kufizuara

Inteligjenca Artificiale dhe algoritma jodiskriminues

Teknologjitë e reja si Inteligjenca Artificiale (IA) apo teknika të ndryshme algoritmike për përmirësimin e punës së administratës ofrojnë mundësi të reja për rritjen e eficiencës dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike. Megjithatë, shpeshherë këto teknologji sjellin probleme të reja si diskriminim i grupeve të marginalizuara apo mbartin paragjykimet që përforcohen nga kodifikimi i tyre në procese teknologjike. Ne propozojmë:

- *transparencë dhe llogaridhënie:* algoritmet dhe sistemet IA duhet të jenë të hapura ndaj auditimeve rreth mënyrën se si operojnë, si marrin vendime, ku i marrin të dhënat fillestare apo si trajtojnë të dhënat e përdoruesve;
- *shmangie e paragjytimeve (bias mitigation):* implementimi i proceseve rigoroze të testimit dhe vlerësimit të proceseve algoritmike për të eliminuar paragjykimet ndaj grave, minoriteteve etnike, gjinore apo grupeve të tjera të marginalizuara;
- *përfshirje qytetare:* përfshirja e qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile dhe ekspertëve në hartimin, implementimin dhe vlerësimin e sistemeve algoritmike dhe IA në shërbime publike.

Aksesi në internet si e drejtë shoqërore

Në shekullin XXI, qasja në internet është kthyer në kush themelor për pjesëmarrjen në jetën sociale, ekonomike dhe politike. Qasja universale në internet është kyç për adresimin e pabarazive mes zonave urbane dhe rurale si dhe mes grupeve të ndryshme socio-ekonomike. Interneti gjithashtu lehtëson dhe krijon mundësi të reja për aksesimin e burimeve edukative dhe pjesëmarrjen qytetare në procese demokratike. Duke njohur internetin si të drejtë shoqërore, institucionet publike do të marrin hapa konkrete që askush të mos mbetet pas në transformimin digjital.

4.7 POLITIKA E JASHTME DHE DIASPORA

Lëvizja BASHKË angazhohet për një politikë të jashtme aktive dhe transformuese, që mbështet interesat kombëtare shqiptare dhe kontribuon në zbatimin e të drejtës ndërkombëtare, barazinë e solidaritetin mes popujve dhe të drejtën e tyre për vetëvendosje. Lëvizja BASHKË do të mbështesë fuqimisht pacenueshmërinë e kufijve të Republikës së Kosovës dhe njohjen e plotë ndërkombëtare të shtetësisë së Kosovës, duke kontribuar kështu në stabilitetin rajonal dhe zbatimin e parimeve të së drejtës ndërkombëtare. Ne do të përshpejtojmë integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe do të forcojmë lidhjet me SHBA dhe partnerët e tjerë strategjikë të Shqipërisë.

1. Marrëdhëniet ndërkombëtare

Integrimi në Bashkimin Evropian

Integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian është një prioritet strategjik i Lëvizjes Bashkë që pasqyron aspiratat tona mbarëshoqërore. Shqipëria është pjesë e pandashme e Evropës, me një identitet dhe histori që lidhet ngushtë me kontinentin tonë. Për ne, integrimi në Bashkimin Evropian nuk është thjesht një proces formal, por edhe përparim shoqëror drejt materializimit të vlerave më të mira të kulturës evropiane. Lufta ndaj korrupsionit, fuqizimi i institucioneve të pavarura, demokratizimi i sistemit politik, respektimi i plotë i të drejtave të njeriut, reformat përparimtare në ekonomi dhe konsolidimi i shtetit social janë sa qëllime në vetvete në emancipimin e shoqërisë

shqiptare, aq edhe afruese të objektivit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Në qeverisjen e Lëvizjes BASHKË Shqipëria do të bëhet së shpejti anëtare e denjë dhe e barabartë e Bashkimit Evropian, jo si koncesion gjeopolitik, por si shembull i një shoqërie që arrin me meritë të jetësojë parimet më të mira të qenies shtet anëtar i Bashkimit Evropian.

SHBA dhe aktorët e tjerë ndërkombëtarë

Marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë një komponent i rëndësishëm i politikës së jashtme të Lëvizjes Bashkë, veçanërisht për forcimin e sigurisë dhe shtetit të së drejtës. Ne vlerësojmë kontributin historik të SHBA veçanërisht në rinjohjen e shtetësisë së Shqipërisë (1920) dhe në çlirimin e Kosovës.

Shqipëria do të fuqizojë marrëdhëniet strategjike me të tjerë partnerë historikë të vendit tonë. Po ashtu do të nxisim marrëdhëniet ekonomike e tregtare, në raporte reciprociteti, me çdo vend të botës që respekton parimet e të drejtës ndërkombëtare dhe njeh interesat kombëtare vitale të Shqipërisë.

Një politikë e jashtme dinjitoze, duke nxitur respektimin e të drejtave të njeriut dhe paqen mes popujve, do të mundësojë që Shqipëria të forcojë pozitën e saj në skenën globale.

Mbrojtja dhe siguria

Lëvizja BASHKË do të angazhohet për forcimin e mbrojtjes dhe sigurisë së Shqipërisë përmes modernizimit të forcave të armatosura dhe përgatitjes së strukturave specifike të sigurisë. Ne do të investojmë në përmirësimin e pajisjeve dhe teknologjive të avancuara për forcat speciale dhe njësitë e mbrojtjes, duke rritur kapacitetin e inteligjencës për të

identifikuar dhe parandaluar kërcënimet. Rritja e bashkëpunimit me aleatët e NATO-s dhe forcimi i sigurisë kibernetike do të jenë prioritet kryesorë, duke siguruar mbështetje të nevojshme për mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe të dhënave të ndjeshme. Gjithashtu, do të promovojmë një qasje gjithëpërfshirëse që angazhon qytetarët në mbrojtjen e sigurisë kombëtare, duke forcuar kështu stabilitetin dhe sigurinë e vendit në mënyrë efektive.

II. Kosova dhe shqiptarët e rajonit

Lëvizja BASHKË do të mbështesë shqiptarët në rajon dhe do të angazhohet për të zgjidhur problemet e shqiptarëve kudo ku jetojnë në trojet e tyre në Ballkan.

Marrëdhëniet me Kosovën

Shqipëria do të luaj një rol aktiv në kërkimin e njohjes së shtetit të Kosovës nga të gjitha shtetet anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Lëvizja BASHKË do të angazhohet për një koordinim të ngushtë të politikës së jashtme të Shqipërisë me atë të Kosovës, duke krijuar një platformë të përbashkët për të promovuar interesa dhe objektiva të përbashkëta në arenën ndërkombëtare. Ne do të punojmë për të koordinuar politikat dhe strategjitë në lidhje me çështjet rajonale dhe globale, duke fuqizuar zërin e përbashkët të dy vendeve në organizata ndërkombëtare.

Lëvizja BASHKË do të angazhohet për forcimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Ne besojmë se rritja imediate e fuqisë mbrojtëse të Kosovës ka përparësi në këtë marrëdhënie dhe është element kyç për sigurinë kombëtare dhe stabilitetin në rajonin e Ballkani. Prandaj, si vend i NATO-s, ne do të angazhohemi për t'i dhënë një prioritet të veçantë

bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes për të kontribuar në rritjen e kapaciteteve ushtarake të Kosovës.

Lëvizja BASHKË është e përkushtuar për të eliminuar çdo barrierë tregtare dhe fizike mes Shqipërisë dhe Kosovës. Ne synojmë të krijojmë një hapësirë ekonomike të integruar, ku lëvizja e forcës punëtore, kapitalit dhe mallrave është tërësisht e lirë. Ky angazhim për një hapësirë ekonomike dhe sociale pa kufij do të ndihmojë në forcimin e lidhjeve dhe zhvillimin e një tregu të përbashkët; gjë që promovon rritjen e dyanshme ekonomike dhe mundësitë për qytetarët e të dyja vendeve, por edhe shtron rrugën e një bashkëpunimi më të gjerë rajonal.

Lëvizja BASHKË angazhohet për të lehtësuar sa më shumë procedurat e fitimit të shtetësisë së Republikës së Shqipërisë për qytetarët e Kosovës dhe shqiptarët e vendeve të tjera të rajonit që jetojnë dhe punojnë në Shqipëri.

Njohja dhe fuqizimi i shtetësisë së Kosovës, nga njëra anë, dhe integrimi reciprok i shpejtë ekonomik e social midis Shqipërisë dhe Kosovës, do ta bëjë më të afërt realizimin e aspiratës kombëtare shqiptare për bashkim.

Shqiptarët e vendeve të tjera në Ballkan

Lëvizja BASHKË do të angazhohet për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut (duke fuqizuar veçanërisht karakterin shtetformues kushtetues të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut), Mal të Zi dhe Serbi, duke kërkuar përmirësimin e kushteve sociale, ekonomike dhe kulturore të shqiptarëve. Ne do të punojmë për të siguruar përfaqësim të drejtë dhe të barabartë në institucionet shtetërore dhe për të mbështetur iniciativat që promovojnë integrimin dhe zhvillimin e këtij komuniteti. Një vëmendje e veçantë do

t'u kushtohet shqiptarëve të Luginës së Preshevës, të cilët përbëjnë komunitetin shqiptar më të diskriminuar në Ballkan. Shqipëria duhet të ngrejë zërin kundër shpërnguljes së shqiptarëve të Luginës së Preshevës dhe do të çojë përpara politikat e sigurimit dhe avancimit të të drejtave kombëtare, sociale dhe ekonomike të shqiptarëve që jetojnë në Serbi.

Po ashtu, Lëvizja BASHKË do të angazhohet për të mbështetur komunitetin çam në kërkesat e tyre për njohjen e të drejtave të tyre nga Republika e Greqisë. Një hap i rëndësishëm në këtë rrugëtim është heqja e ligjit të luftës nga ana e Republikës së Greqisë, e cila ende sot pengon njohjen e të drejtave të shqiptarëve në Greqi. Nga ana tjetër, Republika e Shqipërisë do ta promovojë bashkëjetesën midis shqiptarëve dhe minoritetit grek në Shqipëri si model të marrëdhënieve që shteti grek duhet të ketë me shqiptarët e Greqisë në tërësi dhe komunitetin çam në veçanti.

III. Diaspora dhe problemet e emigracionit

Një përqindje e madhe e shqiptarëve jetojnë jashtë kufijve të Shqipërisë, duke përfaqësuar një nga përqindjet më të larta të diasporës në raport me popullsinë e brendshme në nivel global. Ky fakt thekson rëndësinë e jashtëzakonshme që ka diaspora për zhvillimin ekonomik, kulturor dhe politik të vendit tonë. Lëvizja BASHKË e konsideron diasporën si një faktor kyç për përparimin politik, ekonomik e social të Shqipërisë. Ne do të angazhohemi për të forcuar lidhjet me bashkatdhetarët tanë jashtë vendit, duke hartuar politika që mbështesin njohjen e plotë të të drejtave të tyre në vendet ku jetojnë dhe përfshirjen e tyre aktive në jetën politike, ekonomike dhe sociale të Shqipërisë.

Lëvizja BASHKË do të promovojë politikën që mbështesin **pjesëmarrjen aktive të shqiptarëve në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore të vendeve pritëse**, duke ndihmuar në ndërtimin e urave të bashkëpunimit dhe të përfaqësimit dinjitoz. Përmes organizatave dhe rrjeteve të fuqizuara të diasporës, synojmë të krijojmë një platformë që do të përforcojë ndikimin e tyre në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të shqiptarëve, si dhe në promovimin e vlerave dhe kulturës sonë kombëtare në skenën ndërkombëtare.

Lëvizja BASHKË angazhohet për krijimin e një platforme novatore dhe të sigurt për **regjistrimin dhe vetëdeklarimin e shqiptarëve në botë**. Kjo platformë do të ofrojë një qasje të avancuar dhe të lehtë për përdorim, duke lejuar shqiptarët që të regjistrohen dhe të identifikohen në mënyrë të sigurt dhe transparente. Përdorimi i teknologjisë bashkëkohore do të garantonte mbrojtjen e të dhënave personale, duke krijuar një mjedis besueshëm për ata që dëshirojnë të lidhen me vendin e tyre të origjinës. Kjo nismë do të forcojë lidhjet me diasporën dhe do të ndihmojë në krijimin e një pasqyre të qartë mbi nevojat dhe aspiratat e shqiptarëve jashtë vendit, duke mundësuar zhvillimin e politikave dhe shërbimeve të orientuara drejt mbështetjes së tyre.

Lëvizja BASHKË thekson rëndësinë e **investimeve nga diaspora** si një faktor kyç për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Themelimi i një banke zhvillimore do të ketë si një prej objektivave të saj edhe thithjen e fondeve nga diaspora, të cilat do të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit. Në këtë kuadër të integritit ekonomik, do të merren edhe masa të lehtësimit të procesit të marrjes së shtetësisë shqiptare për diasporën e vjetër shqiptare në Itali, Greqi, SHBA, Turqi, Ukrainë, Kroaci etj.

Lëvizja BASHKË angazhohet për krijimin e një programi ku **profesionistë shqip-**

tarë në diasporë ofrojnë mbështetje për rininë shqiptare që jeton në Shqipëri, duke lidhur profesionistë nga fusha të ndryshme si biznesi, shkenca, arti dhe teknologjia me të rinjtë që kërkojnë ndihmë në zhvillimin e aftësive të tyre; programi do të përfshijë trajnime praktike, *workshop*-e dhe mundësi për praktika profesionale në kompani të njohura, duke krijuar një hapësirë bashkëpunimi që inkurajon të rinjtë të ndjekin ambiciet e tyre dhe të kontribuojnë në zhvillimin e vendit.

Lëvizja BASHKË do të angazhohet për **ruajtjen dhe promovimin e gjuhës shqipe** në diasporë përmes financimit të hapjes së shkollave shqipe në qytetet me prani të rëndësishme të shqiptarëve nëpër botë. Po do të mbështesim krijimin e kurseve gjuhësore dhe kulturore online për çdo shqiptar të diasporës kudo ku jeton. Përmes bashkëpunimit me organizatat lokale dhe qendrat kulturore, do të nxisim përfshirjen e gjeneratave të reja në aktivitete që forcojnë lidhjet me gjuhën dhe kulturën shqipe. Gjithashtu, do të zhvillojmë programe që lehtësojnë përdorimin e gjuhës shqipe në jetën e përditshme të emigrantëve, duke mbajtur të gjallë trashëgiminë tonë kombëtare dhe kulturore.

Lëvizja BASHKË angazhohet për **përmirësimin e ndjeshëm të shërbimeve konsullore** për emigrantët shqiptarë. Ne do të fokusohemi në krijimin e platformave online për aplikime dhe dokumente, duke eliminuar nevojën për takime fizike të panevojshme dhe duke shpejtuar përpunimin e kërkesave për rinovimin e dokumenteve, bashkimin familjar dhe shërbime të tjera të domosdoshme. Ne do të rrisim kapacitetet profesionale dhe trajnimin e stafit konsullor dhe do të përfshijmë studentë që kanë studiuar në vendet ku jetojnë si pjesë të stafit të ambasadave dhe konsullatave.

Lëvizja BASHKË do të zbatojë një program **amnistie fiskale** për të ardhurat e emigrantëve shqiptarë deri në shumën 100,000 Euro, duke pamundësuar kështu praktikën e pastrimit të parave të krimit të organizuar. Ky program ka për qëllim të adresojë realitetin e emigrantëve shqiptarë që për shkak të kushteve të vështira ekonomike në vendet ku jetojnë, shpesh janë të detyruar të punojnë në sektorin informal për të kursyer para. Amnistia do të ofrojë një mundësi të rëndësishme për të lehtësuar transferimin e të ardhurave dhe kapitalit në Shqipëri.

Lëvizja BASHKË do të angazhohet që shteti shqiptar të luajë një rol aktiv në mbrojtjen e të drejtave të emigrantëve që kanë vendosur të jetojnë në vendet ku kanë emigruar. Ne do të punojmë për të siguruar mbështetje ligjore dhe **mbrojtje nga diskriminimi për emigrantët** tanë. Shteti shqiptar do të jetë një partner i fuqishëm për të garantuar akses në shërbime publike, njohjen e të drejtave sociale dhe ekonomike, dhe për të siguruar që emigrantët të kenë mundësi të ruajnë lidhjet e tyre me Shqipërinë, ndërsa ndërtojnë jetën e tyre jashtë vendit dhe që të kenë asistencën e nevojshme nga shteti shqiptar në rastet ku nevojitet.

Lëvizja BASHKË angazhohet për krijimin e një **Agjencie për Mbrojtjen e Punëtorëve Emigrantë**, e cila do të funksionojë pranë ambasadave dhe konsullatave shqiptare. Kjo agjenci do të monitorojë kushtet e punës së emigrantëve, të ofrojë asistencë ligjore për legalizimin e punës, si dhe mbështetje për emigrantët shqiptarë që përballen me shfrytëzim, padrejtësi apo pasiguri në vendet ku jetojnë. Ajo do të krijojë një mekanizëm raportimi të sigurt për punëtorët dhe do të bashkëpunojë me institucionet vendase për të garantuar respektimin e të drejtave të tyre. Nga ana tjetër, Agjencia do të nxisë pjesëmarrjen e punëtorëve emigrantë në sindikatat vendase.

Lëvizja BASHKË do të angazhohet për të mbështetur **bashkimin familjar** të emigrantëve duke ofruar asistencë dhe informacion për ata që dëshirojnë të marrin anëtarë të familjes së tyre në vendin ku jetojnë. Kjo do të përfshijë krijimin e një platforme që ofron udhëzime të qarta mbi procedurat ligjore dhe administrative, si dhe ndihmë në përgatitjen e dokumenteve të nevojshme për aplikimet. Ne do të bashkëpunojmë me ambasadat dhe konsullatat shqiptare për të lehtësuar këto procese dhe për të siguruar që emigrantët të kenë mbështetje të vazhdueshme gjatë gjithë rrugës.

Lëvizja BASHKË e konsideron **rikthimin e të rinjve, punëtorëve dhe profesionistëve në Shqipëri** një prioritet thelbësor, duke i ftuar ata të bashkohen në një mision për të transformuar shoqërinë shqiptare. Ne do të ofrojmë mundësi që i frymëzojnë të rinjtë të kontribuojnë me energjinë dhe idetë e tyre, duke u angazhuar në projekte që ndihmojnë në ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë. Prandaj do të hartohen projekte të veçanta që synojnë përfshirjen e ekspertëve dhe profesionistëve shqiptarë nga diaspora, që ata jo vetëm të kontribuojnë në zhvillimin e Shqipërisë, por edhe të krijojmë lehtësi për kthimin e rinisë në Shqipëri. Më gjerësisht, zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik i vendit tonë, themelimi i një shteti të së drejtës e demokratik, si dhe përmirësimi i ndjeshëm i shërbimeve publike do të shërbejnë si magnet për të tërhequr gjithnjë e më shumë të rinj, punëtorë e profesionistë drejt Shqipërisë.

Lëvizja BASHKË do të angazhohet për hartimin e marrëveshjeve me shtete ku kanë emigruar shumë shqiptarë për të marrë **kompensime financiare dhe institucionale** për kostot e larta që ka mbajtur deri më sot shteti shqiptar nga largimi i forcave punëtore fizike dhe intelektuale nga vendi ynë, të cilat

kanë kontribuar dhe vazhdojnë të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe social të vendeve të tjera.

Lëvizja BASHKË synon të nënshkruajë sa më parë marrëveshje të njohjes së sigurimeve shoqërore me të gjitha shtetet ku jetojnë dhe punojnë shqiptarët, duke kontribuar kështu në sigurimin e pensioneve dinjitoze për të gjithë punonjësit.

4.8 INTEGRIMI NË BASHKIMIN EVROPIAN

Shqipëria përket në Bashkimin Evropian. Vendi ynë ka ndarë historinë me kombet e tjera të Evropës dhe ka kontribuar në momentet më vendimtare të saj. Sot Shqipëria meriton të jetë pjesë e projektit më të madh dhe ambicioz të Evropës dhe t'u bashkohet përpjekjeve për të sjellë mirëqenie në kontinent dhe për t'u përballur me sfidat e përbashkëta të kohës.

Megjithatë, mangësitë në sundimin e ligjit, dobësitë e institucioneve demokratike, kapja e shtetit dhe përhapja e ekonomisë informale po e vonojnë përparimin e vendit në procesin e anëtarësimit.

Procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian nuk është thjesht një detyrë e qeverisë, por një përpjekje kombëtare e gjithanshme që duhet të përfshijë dhe të angazhojë të gjithë shoqërinë.

Ne zotohemi që do ta qasim procesin e anëtarësimit në BE si një objektiv strategjik kombëtar, duke dedikuar çdo burim të nevojshëm për të përsheptuar realizimin e tij me meritë dhe për të përmbushur pritshmëritë e qytetarëve tanë. Përmes propozimeve tona, synojmë të shndërrojmë procesin e anëtarësimit në BE nga një ushtrim burokratik në një strategji dinamike dhe të përvetësuar, që mobilizon të gjithë vendin në rrugën drejt BE-së.

Alternativa e Lëvizjes BASHKË

Negociatat e anëtarësimit

Përmbushja e kriterëve për anëtarësim po ecën me një ritëm të ngadaltë. Kjo pasqyrohet qartë në raportet vjetore të Komisionit Evropian, të cilat theksojnë se në 26 nga 33 kapituj të negociatave (78%) vendi ynë ka përgatitje mesatare ose nën mesatare. Po ashtu, politizimi dhe nepotizmi në administratën publike e bëjnë të pamjaftueshme përgatitjen për të menaxhuar kërkesat teknike dhe strategjike të procesit të anëtarësimit. Strukturat përgjegjëse për integrimin në BE vuajnë nga mungesa e ekspertizës dhe efikasitetit, duke e penguar shfrytëzimin e mundësive që ofrojnë fondet dhe ndihmat e BE-së. Vullneti politik duhet të shoqërohet patjetër me një përgatitje teknike të fortë dhe, nëse këto mangësi nuk adresohen, Shqipëria rrezikon të vonojë edhe më tej anëtarësimin.

Lëvizja BASHKË do të përshpejtojë dhe prioritetizojë përmbushjen e kushteve të kapitujve të negociatave dhe harmonizimin e legjislacionit shqiptar me *acquis-in* e BE-së. Kështu, do të garantojmë që progresi vjetor në përmbushjen e kushteve të anëtarësimit të rritet dhe reformat të mos vonohen.

Ne do të investojmë në krijimin e një administrate publike të kualifikuar përmes rekrutimeve të targetuara dhe programeve të trajnimit të vazhdueshëm në mënyrë që administrata të jetë e përgatitur për të përballuar kërkesat komplekse të procesit të anëtarësimit në BE.

Do të operacionalizojmë mekanizma konsultimi të mirëfilltë për të garantuar një rol më të madh dhe më aktiv për aktorët joshitetorë në formësimin dhe avancimin e agjendës së anëtarësimit.

Do të prezantojmë masa më të forta transparence dhe llogaridhënieje që do të përfshijnë raportime periodike nga grupet e punës për anëtarësimin si përpara Kuvendit, ashtu edhe për publikun.

Do të forcojmë kapacitetet institucionale në nivel qendror dhe lokal me qëllim përfitimin nga fondet e parashikuara nga instrumentet financiarë të BE-së për vendet që janë pjesë e procesit të anëtarësimit.

Do të angazhohemi në zbatimin e Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor dhe përgatitjen e institucioneve vendase për të operuar gradualisht në strukturat dhe platformat e Bashkimit Evropian.

Nismat rajonale

Ne do ta trajtojmë bashkëpunimin rajonal jo si një skenë për gjeste simbolike, por si një mundësi për angazhim të sinkertë dhe ndjekje rigoroze të çështjeve. Angazhimi ynë është të shndërrojmë platformat rajonale në hapësira ku nismat ndiqen në mënyrë kolektive, me mekanizma të qartë llogaridhënieje në mënyrë që marrëveshjet të sjellin progres të vërtetë. Për të arritur këtë, ne:

Do të bashkëpunojmë dhe përgatisim aktorët ekonomikë vendas për të siguruar që projektet e konvergjencës ekonomike rajonale të mos kenë pasoja të padëshiruara për industrinë kombëtare apo bizneset lokale. Qëllimi ynë është të promovojmë integrimin e bizneseve vendase në tregjet rajonale dhe ato të BE-së dhe nxisim rritjen ekonomike gjithëpërfshirëse që përfiton të gjitha sektorët e ekonomisë, veçanërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Synimi ynë është që të fuqizojmë profesionistët dhe sipërmarrjet vendase që të shfrytëzojnë mundësitë për lëvizje të lirë brenda rajonit.

Do të thellojmë përfshirjen e vendit në proceset rajonale duke zgjeruar fushën e bashkëpunimit për të adresuar çështje kritike si qeverisja, sundimi i ligjit dhe reformat demokratike, gjithmonë duke mbajtur të angazhuar BE-në në kapacitet koordinues dhe mbështetës. Trajtimi i barabartë dhe i drejtë mes shteteve të rajonit, duke nisur nga njohja e shtetësisë dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës nga Serbia, do të jetë parim udhërrëfyes i angazhimit të Shqipërisë në rajon.

Do të përshpejtojmë zbatimin e objektivave strategjike si Agjenda e Gjellbër dhe Agjenda Digjitalë. Duke i përpunur këto përpjekje me prioritetet e BE-së, ne do të pozicionojmë Shqipërinë për të adresuar sfidat globale të ngutshme.

Evropianizimi

Proceset formale të integritimit në BE dhe platformat e bashkëpunimit rajonal duhet të shoqërohen nga një përpjekje më e gjerë evropianizimi, e cila përgatit qytetarët, profesionistët, studentët, bizneset dhe shoqërinë në tërësi për reformat dhe transformimet e thella që do të prekin pothuajse çdo aspekt të jetës publike. Kjo qasje është thelbësore për të shmangur një “tronditje vlerash” pasi Shqipëria të bëhet anëtare e BE-së dhe në mënyrë që tranzicioni të jetë i qetë, gjithëpërfshirës dhe i mirëkuptuar. Për këtë propozojmë nismat e mëposhtme:

Bashkëpunim i shtuar me universitetet dhe institucionet akademike për të zhvilluar programe të reja dhe moderne të fokusuara në çështjet e integritimit evropian për të nxitur një kuptim më të thellë të vlerave, sistemeve dhe praktikave evropiane. Kjo do të përfshijë krijimin e programeve të reja të shkëmbimit me universitetet e BE-së. Përmes kësaj synojmë të formojmë një brez studentësh dhe profesionistësh të mirëpërgatitur për sfidat dhe mundësitë që sjell anëtarësimi në BE.

Ne do të kemi një fokus më të madh në forcimin e programeve të arsimit, shkencës, kërkimit dhe kulturës ndërmjet Shqipërisë, rajonit dhe vendeve anëtare të BE-së. Këto nisma do të nxisin shkëmbimin e njohurive, ideve dhe përvojave kulturore, duke ndihmuar në integrimin e Shqipërisë në strukturën intelektuale dhe kulturore të Evropës.

Do të hartojmë dhe zbatojmë fushata të fokusuara të informimit dhe ndërgjegjësimi, të përshtatura për segmente të ndryshme të shoqërisë. Këto fushata do të shpjegojnë në mënyrë të qartë ndryshimet komplekse që Shqipëria do të kalojë gjatë procesit të integrimit në BE, duke ofruar një perspektivë të plotë mbi përfitimet, sfidat dhe përshtatjet që duhen bërë. Në këtë mënyrë, qytetarët do të jenë më të informuar dhe më të angazhuar dhe askush nuk do të mbetet mbrapa në rrugën drejt anëtarësimit në BE.

Përmes këtyre veprimeve, ne synojmë të kultivojmë një identitet evropian të përqafuar nga të gjitha sektorët e shoqërisë, duke siguruar që procesi i integrimit të mos jetë vetëm një projekt politik ose administrativ, por edhe një transformim shoqëror dhe kulturor i përbashkët që fuqizon të gjithë kombin.

Lëvizja BASHKË

<https://levizjabashke.al>

Rruga Islam Petrela Nr. 92, Tiranë

+355 68 40 49 400

info@levizjabashke.al